

# Udhëzues për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të personelit të Forcave të Armatosura

*Secili gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë Deklaratë pa kurrfarë kufizimesh përsa përket racës, ngjyrës, gjini, moshës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore pasurisë, lindjes a të tjerave. Njeriu nuk do të bëhet në bazë të statusit të tij në ndërkombëtar të shtetit ose vendit të tij origjinal, qoftë kushtetiti ose vendi i tij origjinal i shprehur nën kujdestarinë qoftë jo vetëqeveritare ose gjatë çfarëdo kushtesatë tjera të kufizimit të statusit. Neni 3. Gjithkush ka të drejtë të jetojë në liri dhe të ketë siguriminë vetjak. Neni 4. Asnjëri nuk duhet të ndalohet si skllav ose çifçi; skllavëria dhe tregtimi i njerëzve janë të ndalu*

**Dëmshpërblimi për personat e trafikuar dhe të  
shfrytëzuar në rajonin e OSBE-së**

Botuar nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)  
Al.Ujazdowskie 19  
00-557 Varshavë  
Poloni  
[www.osce.org/odihr](http://www.osce.org/odihr)

© OSCE/ODIHR 2008-09-16

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret lirisht dhe të kopjohet për qëllime arsimimi dhe qëllime të tjera jo-fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me citimin e OSBE/ODIHR si burim.

Ky material është botuar fillimisht nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) ne vitin 2008 me titull *Compensation for Trafficked and Exploited Persons in the OSCE Region*. Opinione dhe informacionet që ai përmban nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën dhe qëndrimin e ODIHR.

Përkthimi në shqip është përgatitur dhe botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri me mbështetjen e ODIHR. Përkthimi dhe botimi u mundësuan me ndihmën e financimit të Agjencisë Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA).

ISBN 978-92-9235-224-0

Kapaku dizenuar nga Agnieszka Rembowska  
Dizenuar dhe shtypur nga shtypshkronja Albdesign Sh.p.k  
Tiranë, Shqipëri

# Tabela e përmbajtjes

Falënderime .....	5
Shkurtime dhe akronime .....	7
<b>Përmbledhje .....</b>	<b>8</b>
<b>1. Hyrje.....</b>	<b>13</b>
1.1 Hyrje dhe një historik i shkurtër .....	13
1.2 Metodologjia .....	14
1.3 Fjalor .....	16
<b>2. Dëmshpërblimi sipas së drejtës ndërkombëtare – një vështrim i përgjithshëm.....</b>	<b>20</b>
2.1 Pasqyrim i të drejtës për dëmshpërblim .....	20
2.2 Përfundim .....	22
<b>3. Dëmshpërblimi – kuadri ligjor në vende të ndryshme .....</b>	<b>23</b>
3.1 Mekanizmat e dëmshpërblimit.....	23
3.2 Faktorë specifikë për t’u pasur parasysh në rastet e trafikimit.....	38
3.3 Llojet e humbjes dhe të dëmit.....	42
3.4 Ekzekutimi i vendimit dhe sekuestrimi i pasurisë .....	45
3.5 Sfidat e kërkesave për dëmshpërblim përtej kufijve dhe çështjeve të juridiksionit ....	48
3.6 Shteti i së drejtës .....	50
3.7 Përfundim .....	52
<b>4. Roli i OJF-ve dhe shoqërisë civile në mbështetjen e viktimave dhe në avancimin e interesave të tyre.....</b>	<b>53</b>
4.1 Avancimi i interesave në lidhje me dëmshpërblimin.....	53
4.2 Mbështetja e ojf-ve ndaj viktimave.....	56
4.3 Përfundime.....	59
<b>5. Profilet e vendeve.....</b>	<b>60</b>
5.1 Shqipëria .....	60
5.2 Franca.....	69
5.3 Moldavia.....	85
5.4 Rumania .....	97
5.5 Federata Ruse.....	106
5.6 Ukraina.....	116
5.7 Mbretëria e Bashkuar.....	128
5.8 Shtetet e Bashkuara të Amerikës .....	154
<b>6. Përfundime dhe Rekomandime .....</b>	<b>200</b>
<b>Shtojcat: Standardet dhe Detyrimet Ndërkombëtare .....</b>	<b>213</b>
I: Dokumentet ndërkombëtare ligjorisht të detyrueshme.....	213
II: Dokumentet ndërkombëtare politikisht të detyrueshme.....	221
III: Dokumentet ligjore rajonale detyruese (për shtetet palë) .....	226

IV: Dokumente rajonale politikisht të detyrueshme.....	232
V: Tabelat e nënshkrimeve dhe të ratifikimeve të standardeve ndërkombëtarë përkatese .....	234
<b>Bibliografia .....</b>	<b>237</b>

## **Falënderime**

Ky botim është hulumtuar dhe përgatitur për Programin Antitrafikim të OSBE/ODIHR nga Katy Thompson dhe Allison Jernow.

Studiueset nuk do të mund ta kishin kryer këtë studim pa ndihmën e organizatave dhe njerëzve që vijnë: Prezenca e OSBE-së Shqipëri, në veçanti Juliana Rexha (Këshilltare vendase për Anti-trafikimin); Zyra e OSBE-së në Ukrainë, në veçanti Begona Piniero dhe Hlib Jasnicki; Misioni i OSBE-së në Moldavi, në veçanti Antonia Demeo dhe Otilia Bologan-Vieru; ADPARE në Rumani, në veçanti Alexandra Surcel; Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në Shqipëri, në veçanti Besa Saraçi dhe Aurela Bozo; Asociatia Femeia Pentru Societate, Moldavi, në veçanti Veronica Lupu; Poppy Project, Mbretëria e Bashkuar, në veçanti Sarah Stephens-Smith; Grupi i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut (Mbretëri e Bashkuar), në veçanti Bronwyn Byrnes; Elena Tyuryukanova (Federata Ruse); Georgina Vaz Cabral (Francë); Benedict Bourjois (Francë); Robert Moosy, Drejtor dhe Lorna Grenadier, Koordinatorë për Viktimat/Dëshmitarët e Njësisë së Hetimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Drejtorja e të Drejtave Qytetare, Departament i Drejtësisë, SHBA dhe avokatët me përvojë të çështjeve civile Dan Werner, Kathleen Kim dhe Kent Felty (SHBA).

Ky material u përkthye nga anglishtja në shqip nga Adelina Albrahimi dhe u redaktua nga Kathleen Imholz. Përkthimi nuk do të ishte përfunduar pa ndihmën e Frank Dalton, Violeta Librazhdi, Juliana Rexha, Edlira Ngjeçi dhe Erion Fejzulla të cilët redaktuan materialin në shqip.

Falënderojmë gjithashtu për dialogun e frytshëm, materialet dhe ndihmën: Beate Andrees, Gao Yun dhe Alexander Iafaev, ILO; Richard Danzinger, IOM; Jyothi Kanics i Këshillit Irlandez për Refugjatët; Michele Levoy, PICUM, Jans Matthes, UNICEF; Andrew Painter, UNHCR; Gabriele Reiter; Liliana Sorrentino dhe Anelise Gomes de Araujo, Zyra e Përfaqësueses së Posaçme dhe Koordinatorës për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, OSBE; Don Flynn, PICUM; Mike Dottridge; Rhodri Williams; dhe Marieke van Doorninck, La Strada International.

Ky raport u paraqit si dokument diskutimi në seminarin e ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar, i cili u zhvillua në Barcelonë më 10-12 dhjetor 2007. Falënderojmë gjithashtu të gjithë pjesëmarrësit në seminar për kontributin aktiv në pasurimin e mëtejshëm të këtij raporti: Omer Ahmed, Sindikata e Transportit dhe e Punëtorëve të Përgjithshëm (Mbretëri e Bashkuar); Nataliya Akhtyrskaya, Akademia e

Gjyqtarëve (Ukrainë); Profesore Aurela Anastasi, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (Shqipëri); Alovzat Aliyev, Qendra e Ndhmës Ligjore për Emigrantët (Azerbajxhan); Funda Bacinoglu, Shërbimi Ligjor i Avokatëve Ankara (Turqi); Julie Barton, Poppy Project (Mbretëria e Bashkuar); Dr. Machteld Boot-Mattijssen, Zyra e Raportuesit Holandez për Trafikimin (Hollandë), Benedicte Bourgeois, Comité contre l'esclavage moderne (Francë); Reyes Castillo, PICUM dhe ACCEM (Spanjë); Tatiana Catana, Shoqata e Grave Juriste në Karrierë (Moldavi); Anton Chazov, IOM (Federata Ruse); Iulia Diaconu, Prokurore (Rumani); Marieke Van Doorninck, La Strada International (Hollandë); Yun Gao, ILO (Gjenevë); Marta Gonzalez, Proyecto Esperanza (Spanjë); Lorna Grenadier, Koordinatore e Viktimave Dëshmitare (SHBA); Robin Harms, Zyra e Përfaqësueses së Posaçme të OSBE-së dhe Koordinatores për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (Vienë); Natalia Ieseanu, Tampep (Itali); Mary Japaridze, Neni 42 i Kushtetutës (Gjeorgji); Ulas Karan, Universiteti Bilgi i Stambollit (Turqi); Carl Kelvin, Shërbimi Mbretëror i Prokurorisë (Mbretëri e Bashkuar); Ketevan Khucishvili, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm (Gjeorgji); Janice Lam, Anti-Slavery International (Mbretëri e Bashkuar); Veronica Lupu, Shoqata e Grave Juriste në Karrierë (Moldavi); Dominique Mallassagne, Zyra për Ndhmën ndaj Viktimave, Drejtoria e së Drejtës dhe Drejtësisë (Francë); Vladimir Misev, Instituti për Demokraci "Societas Civilis" (ish Republika Jugosllave e Maqedonisë); Marina Meskhi, Fondi Shtetëror për Mbrojtjen dhe Ndhmën e Viktimave të Trafikimit (Gjeorgji); Veronica Pavel, Juriste (Rumani); Yuri Poliakov, Jurist (Federata Ruse); Juliana Rexha, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Tetyana Rudenko, Zyra e Koordinatorit të Projektit të OSBE-së në Ukrainë, Elena Volochai, Juriste (Ukrainë) dhe Daniel Werner, Qendra Ligjore në Mbrojtje të të Drejtave të Punëtorëve në New York (SHBA).

### **Shënim:**

Kërkimet fillestare për këtë studim përfunduan në prill 2007. Botimi fillestar i këtij libri në anglisht u bë në maj 2008. Për botimin në shqip, të botuar në dhjetor 2010, nuk janë bërë përditësimet përkatëse, por janë korrigjuar gabimet e mundshme. Kjo nuk ka ndikuar në përfundimet dhe rekomandimet.

## Shkurtime dhe akronime

KPP	Kodi i Procedurës Penale
KEDVKDh	Konventa Evropiane për Dëmshtëpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme
BE	Bashkimi Evropian
ONQ	Organizatë ndërqeveritare
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
IOM	Organizata Ndërkombëtare e Migracionit
MKR	Mekanizmi Kombëtar i Referimit
OJF	Organizatë joqeveritare
OSBE	Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
KPU OSBE	Koordinatori i Projektit të OSBE-së në Ukrainë
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
KKBKON	Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar

Shkurtime të monedhave kombëtare (sipas listës ISO 4217, lista e Organizatës Ndërkombëtare për Standardizimin)

ALL	Leku i Shqipërisë
EUR	Euro i Bashkimit Evropian
GBP	Paund i Mbretërisë së Bashkuar
MDL	Leu i Moldavisë
ROL	Leu i vjetër i Rumanisë
RON	Leu i ri i Rumanisë
RUB	Rubla e Ruisë
UAH	Hrivnia e Ukrainës
USD	Dollari i SHBA-së



## Përmbledhje

Rritja e mundësisë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë është një prej objektivave programatikë kryesorë të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), dhe e drejta për dëmshpërblim është një aspekt i rëndësishëm i kësaj pune. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë këtë të drejtë dhe si zbatohet ajo në tetë shtete të ndryshme të OSBE-së. Ky vlerësim gjithashtu paraqet rekomandime për të përmirësuar mundësinë e mekanizmit të dëmshpërblimit, në mënyrë që një numër më i madh i viktimave të trafikimit të përfitojnë dëmshpërblim, si dhe të nxisë një kulturë të gjerë të të drejtave në mbështetje të këtij objekti. Studimi bazohet në punë kërkimore jo në terren dhe pyetësorë me bashkëpunëtorë nga organizata joqeveritare (OJF), organizata ndërqeveritare (ONQ) dhe qeveritë e vendeve: Shqipëri, Francë, Moldavi, Rumani, Federata Ruse, Ukrainë, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky vlerësim u paraqit dhe u diskutua si dokument me informacion bazë për një seminar të ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar, i cili u zhvillua në Barcelonë në dhjetor 2007.

Vlerësimi analizon të drejtën për dëmshpërblim për personat e trafikuar sipas legjislacionit ndërkombëtar nëpërmjet këndvështrimit të disa standardeve ndërkombëtare në lidhje me luftën kundër trafikimit, të drejtat e viktimave të krimit, të drejtat e emigrantëve, të drejtat e punëtorëve dhe të drejtat e viktimave të dhunës për shkak të përkatësisë gjinore. Përfundimi është, se e drejta për dëmshpërblim përbëhet kryesisht nga e drejta për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi dhe, në rastet e krimeve të dhunshme, e drejta për dëmshpërblim nga fondet shtetërore. Këto standarde kanë zhvilluar dhe parimin se përfitimet e kryera nga trafikantët nëpërmjet aktiviteteve të tyre shfrytëzuese duhen përdorur në dobi të personave të trafikuar individualisht ose në mënyrë kolektive.

Ndonëse ka pasur padi të suksesshme në disa raste ndaj trafikantëve/shfrytëzuesve, këto kufizoheshin në raste ku trafikanti ose shfrytëzuesi është proceduar penalisht dhe dënuar, ose i është gjetur vendndodhja dhe ndaj tij është ngritur padia civile. Padia civile mund të ngrihet brenda procesit penal në të gjitha vendet e analizuara, përveç Mbretërisë së Bashkuar. Masa e shpërblimit të dëmit të dhënë nëpërmjet padive të tilla është vlerësuar në mënyra të ndryshme në vende të ndryshme. Padia civile mund të ngrihet dhe jashtë procedimit penal, për shembull kur nuk ka proces penal. SHBA-ja është i vetmi vend ku kërkesa për dëmshpërblimin e viktimës (në SHBA njihet si '*restitution*', një lloj 'kthimi i dëmit') është automatikisht pjesë e procesit penal në çështjet e trafikimit. Ka pasur një

numër të lartë rastesh në SHBA, Ukrainë dhe Moldavi ku personave të trafikuar u është dhënë dëmshpërblimi nëpërmjet padisë civile brenda procesit penal. Në Mbretërinë e Bashkuar, gjykata urdhëron dëmshpërblimin brenda procesit penal, si pjesë e masës së dënimit. Në praktikë, kjo është kufizuar në një shumë të vogël simbolike.

Masa e dëmshpërblimit të dhënë nga gjykatat ndryshon midis vendeve dhe brenda vendeve. Megjithatë, në të gjitha vendet ekziston një problem madhor i moskryerjes së pagesës së dëmshpërblimit, duke i lënë personit të trafikuar barrën e ndjekjes së procedurave të ekzekutimit kundrejt trafikantit/shfrytëzuesit. Gjithashtu, zbatimi i vendimeve shpesh nuk është i suksesshëm, që do të thotë se, pavarësisht ekzistencës së disa mekanizmave të dëmshpërblimit, është jashtëzakonisht e rrallë marrja e shumës së dëmshpërblimit nga personi i trafikuar.

Personat e trafikuar gjithashtu mund të kërkojnë dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi nëpërmjet legjislacionit të punës në rastet kur legjislacioni vendas njeh të drejtat e punës së këtyre personave. Kjo mund të varet nga statusi i emigracionit që ka individi, nga baza dhe natyra e kontratës së punës dhe nga fakti nëse puna është “e ligjshme.” Ka edhe organe kombëtare që rregullojnë standardet e punësimit, për shembull inspektorët e punës që kanë të drejtë të ngrenë padi ndaj punëdhënësve ose t’ua referojnë rastet autoriteteve gjyqësore, të cilat çojnë në pagesën e dëmshpërblimit, për shembull për mosdhënien e pagës ose për dëmtimet në punë. Këto lloj veprimesh të palëve të treta kundrejt një punëdhënësi shfrytëzues ndihmojnë personat e trafikuar, duke shmangur nga ana e tyre nevojën për të ndjekur një rast individualisht.

Më së shumti, të gjitha paditë ndaj trafikantit/shfrytëzuesit kërkojnë pjesëmarrjen aktive të personit të trafikuar në procesin gjyqësor, duke dhënë dëshmi gojore dhe me dokumente në lidhje me shkeljen e kryer, dëmin dhe humbjen e pësuar. Sipas këtij raporti, kjo mund të sjellë ndrojtjen e viktimës, dhe ndihma ligjore falas dhe përfaqësimi janë të domosdoshme për të rritur mundësitë e individit të kryejë procedurat dhe të marrë shpërblimin. Gjithashtu, kjo kërkon kohë dhe mund të jetë e kushtueshme. Të provosh dëmin nëpërmjet provave të viktimizimit të kaluar dhe të tanishëm, si dhe emërtimet apo përkufizimet e disa kategorive të dëmit si “humbja e dinjitetit,” mund të kenë efekt ritraumatizues mbi personin e trafikuar.

Për shkak të këtyre problemeve dhe mospagesës së dëmshpërblimit, sugjerohet në këtë vlerësim se dëmshpërblimi nëpërmjet marrëveshjeve vullnetare apo të ndërmjetësuar, ose të kërkuara nga një palë e tretë (p.sh sindikata nëpërmjet një procedimi kolektiv apo inspektoriati i punës), mund të kenë një shans më të madh suksesi për t’u paguar si dhe

procedimi të jetë më pak traumatizues për personin e trafikuar. Kështu, duhen shfrytëzuar metodat e kryerjes së veprimeve kolektive dhe ndërmjetësimeve nga aktorët shtetërorë ose të shoqërisë civile (p.sh., OJF-të ose sindikatat).

Përveç mundësisë për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi, në Francë, Mbretëri e Bashkuar, Rumani dhe SHBA ekziston dhe mundësia për të kërkuar dëmshpërblim nga një fond shtetëror. Zakonisht nga ky fond përfitojnë viktimat e krimeve të dhunshme ose kur është shkaktuar dëmi. Këto sisteme zakonisht kompensojnë lloje të veçanta të dëmit material (financiare), ndonëse në Francë dhe Mbretëri të Bashkuar mund të kërkohet dëmshpërblim dhe për lloje të tjera dëmi (si 'dhimbje dhe vuajtje'). Këto mekanizma janë relativisht të thjeshtë për sa u përket procedurave dhe garantojnë pagesën. Megjithatë, mundësia e përfitimit nga këta mekanizma kufizohet nga kombësia dhe kërkesat në lidhje me karakterin e kërkuarit, të cilat janë përdorur për të shpallur të pavlefshme kërkesat e personave të trafikuar. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë, ka OJF me përvojë të gjatë dhe ekspertizë që ndihmojnë viktimat të paraqesin kërkesë për përfitime nga këto fonde.

Shërbimet e këshillimit për personat e trafikuar janë një element thelbësor i së drejtës për dëmshpërblim. Për të kërkuar dëmshpërblimin, personat e trafikuar duhet domosdoshmërisht të kenë dijeni për të drejtat e tyre dhe si mund t'i marrin ato. Duhet të ekzistojnë dhe masa që garantojnë sigurinë dhe mirëqenien e personit gjatë kohëzgjatjes së procedurës. Kjo do të thotë se strehimi i përshtatshëm, ndihma sociale, këshillimi ligjor, ndihma mjekësore dhe leja e qëndrimit janë të drejta ndihmëse thelbësore, pa të cilat mundësia për të përfituar dëmshpërblimin është e kufizuar. Në mënyrë më të mirë, duhet siguruar që personi ka mbështetjen e mjaftueshme dhe është në gjendje të paraqesë prova për të mbështetur pretendimet.

Ka dhe shumë faktorë të tjerë që ndikojnë në suksesin e padive për dëmshpërblim: mungesa e provave të disponueshme për të mbështetur pretendimet, apo ligjet të cilat nuk lejojnë që pasuritë e sekuestruara të përdoren për dëmshpërblim, mund të ndikojnë dukshëm në rezultatin e padisë. Gjithashtu, mund të dalin vështirësi në ngritjen e padisë ligjore kur trafikanti ndiqet penalisht në një vend tjetër nga ai ku ndodhet viktimat, ose kur pasuria e trafikantit ndodhet në një vend tjetër nga ai ku vendoset dëmshpërblimi. Së fundi, është i domosdoshëm funksionimi i shtetit të së drejtës; sistemi i dëmshpërblimit mund të funksionojë vetëm po aq mirë sa mjedisi gjyqësor dhe administrativ në secilin vend, prandaj është e rëndësishme që të ekzistojë një kulturë pavarësie, aftësie dhe efience, veçanërisht në punën e gjyqësorit dhe të prokurorisë.

Sipas këtij raporti, grupet e shoqërisë civile kanë luajtur një rol thelbësor në zhvillimin dhe zbatimin e së drejtës të dëmshpërblimit. OJF-të dhe sindikatat kanë lobuar me qeveritë për ndryshime në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, ato kanë qenë dinamika e reformave në nivel kombëtar dhe kanë punuar për sigurimin e shërbimeve të domosdoshme për personat e trafikuar.

Situata e fëmijëve nuk trajtohet gjerësisht në këtë raport për shkak të vështirësive për të siguruar informacionet e detajuara. Megjithatë, është e qartë se kurdoherë ka probleme për personat e trafikuar, ka të ngjarë që ato shumëfishohen në rastet e viktimave të mitura. Për shembull, procedurat ligjore janë më frikësuese për fëmijët, dhe ka ende më shumë nevojë për këshillimin dhe përfaqësimin ligjor që ata të mund të kuptojnë sistemin ligjor dhe të drejtat e tyre. Ka dhe çështje të tjera të lidhura vetëm me fëmijët, si për shembull nevoja për sisteme efektive të punës sociale dhe kujdestarisë, me qëllim sigurimin se dhënia dhe shpenzimi i parave të dëmshpërblimit do të monitorohen dhe se fëmijët do të mbrohen nga prindërit ose kujdestarët në qoftë se veprimet e tyre nuk përkojnë me interesat më të larta të fëmijës.

Si përfundim, ndërsa mekanizmat e dëmshpërblimit ekzistojnë në të gjitha vendet e këtij studimi, vetëm një numër shumë i vogël i personave të trafikuar kanë kërkuar dëmshpërblimin dhe u është dhënë vendimi për këtë, dhe një numër edhe më i vogël kanë marrë pagesën e dëmshpërblimit të vendosur. Ndonëse mund të jetë e pashmangshme që shumica e personave të trafikuar nuk do të ngrenë kurrë padi për dëmshpërblim dhe nuk do të marrin kurrë dëmshpërblim, megjithatë ka një sërë barrierash që mund të hiqen në mënyrë që të përmirësohet realizimi i kësaj së drejte.

Gjithashtu shtetet mund të bëjnë shumë për të përmirësuar mundësinë e përfitimit duke ofruar që disa metoda janë të disponueshme për të siguruar që dëmshpërblimi mund të përfitohet nga të gjitha llojet e personave të trafikuar.

Në të ardhmen, shtetet duhet të rishikojnë mekanizmat e tyre aktualë për dëmshpërblimin dhe të përcaktojnë nëse po jepet nëpërmjet tyre drejtësia për personat e trafikuar. Në këtë drejtim, cilësitë më pozitive të skemave ose praktikave të vendeve të tjera mund të shërbejnë në disa vende për përmirësimin e metodave ekzistuese. Shtete, gjithashtu, duhet të hartojnë politika mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar, bazuar në konsultime me vetë individët dhe OJF-të që përfaqësojnë interesat e tyre. Masat mund të përfshijnë reforma ligjore dhe institucionale në fushat e legjislacionit civil, penal dhe të punës, në mënyrë që të

përmirësohet mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, si dhe sigurimi i asistencës ligjore për personat e trafikuar; sigurimi i informacionit dhe shërbimeve mbështetëse për personat e trafikuar; mundësia për personat e trafikuar që të rregullojnë statusin e tyre gjatë kohëzgjatjes së padisë; forcimi i kompetencave të inspektoriateve të punës dhe të organizmave të ngjashëm për të lëshuar urdhra, përfshirë shpërblimin e dëmit; dhe shqyrtimi i sistemeve jashtëgjyqësore për të negociuar pagesat, si për shembull ndërmjetësimi.

OJF-të dhe sindikatat duhet të vazhdojnë rolin e tyre të rëndësishëm nëpërmjet vlerësimit të legjislacionit civil, penal dhe të punës në vendet e tyre dhe të hartimit të strategjive për avancimin e interesave të viktimave për të përmirësuar mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit dhe të mjeteve të tjera mbrojtëse, si dhe nëpërmjet asistencës për ndërmjetësim. OJF-të që punojnë në fushën e trafikimit mund të përfitojnë nga bashkëpunimi me grupet e tjera që punojnë me viktimat e trafikimit, me të drejtat e emigrantëve dhe me të drejtat e punëtorëve, meqenëse të gjithë këto grupe kanë këndvështrime të dobishme rreth kësaj teme.

# 1. Hyrje

## 1.1 HYRJE DHE NJË HISTORIK I SHKURTËR

OSBE/ODIHR ka përcaktuar “rritjen e mundësisë për viktimat e trafikimit në Shtetet pjesëmarrjes të OSBE-së për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë dhe për të ushtruar të drejtat e tyre,” si një prej qëllimeve kryesore programatike. Një aspekt i rëndësishëm i kësaj pune është pagesa e dëmshpërblimit. Manuali Praktik i ODIHR-it mbi *Mekanizmat Kombëtarë të Referimit* përfshin udhëzime mbi rëndësinë e dëmshpërblimit si një mënyrë për rivendosjen e të drejtave të shkelura të personave të trafikuar me efektin e rëndësishëm riparues dhe parandalues.<sup>1</sup> Standardet ndërkombëtare mbi trafikimin, të drejtat e punës, të drejtat e migrantëve dhe të drejtat e viktimave kanë zhvilluar të drejtën e dëmshpërblimit. Ata kanë vendosur gjithashtu parimin se përfitimet e trafikantëve nga veprimtaritë e tyre shfrytëzuese duhet të përdoren në dobi të personave, të trafikuar në mënyrë individuale ose kolektive. Në lidhje me këtë, Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore i OSBE-së rekomandon që shtetet duhet:

“të shqyrtojnë dispozita ligjore për konfiskimin e mjeteve dhe produkteve të trafikimit dhe veprave penale të lidhura me të dhe se pasuritë e konfiskuara do të përdoren në dobi të viktimave të trafikimit.”<sup>2</sup>

Raporte të shumta kërkimore dhe raporte të konferencave u janë kushtuar çështjeve të lidhura me dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Janë identifikuar disa probleme në lidhje me mundësinë e përfitimit të dëmshpërblimit. Rekomandimet përfshijnë: përmirësimin e ndërgjegjësimit mbi të drejtat; sigurimin e legjitimitit të viktimës si palë në proces, p.sh. si “palë e dëmtuar”; përdorimin e pasurive të trafikantëve; heqjen e kufizimeve për përfitimin nga fonde shtetërore të kompensimit; dhe përmirësimin e mundësive për të qëndruar në vendin ku ngrihet padia civile (ose mundësitë për të siguruar përfaqësim nga një palë e tretë).

Ky raport ka marrë në shqyrtim këto studime dhe standardet ligjore përkatëse, si dhe ka studiuar hollësisht situatën në tetë vende të rajonit të OSBE-së. Vendet e përzgjedhura janë

---

<sup>1</sup> *National Referral Mechanisms Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons, A Practical Handbook* (Mekanizmat kombëtarë të referimit bashkojnë përpjekjet në mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar, Manual praktik) (OSBE/ODIHR, 2004), f. 83-87.

<sup>2</sup> Kapitulli III, Seksioni 1.5.

Shqipëria, Franca, Moldavia, Rumania, Federata Ruse, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Analiza në raportin përqendrohet në çështjen se si personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar mund të përfitojnë dëmshpërblim nëpërmjet proceseve civile, penale dhe të punës apo nëpërmjet skemave shtetërore të dëmshpërblimit në secilin prej këtyre vendeve. Raporti synon të identifikojë praktika të mira dhe të paraqesë rekomandime për veprime të ardhshme.

Pjesa 2 trajton standardet ndërkombëtare në lidhje me dëmshpërblimin, dhe detaje të mëtejshme jepen në Shtojcat. Pjesa 3 bën një rishikim të mekanizmave të dëmshpërblimit në bazë të padive ndaj trafikantëve ose shfrytëzuesve, ose nga shteti, si dhe faktorët që ndikojnë në efikasitetin e tyre. Në këtë pjesë shqyrtohet se si llojet e humbjeve të pretenduara mund të ndikojnë në rezultatin e kërkesës; rëndësia e procedurave të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të konfiskimit të pasurisë; ndikimi i çështjeve ndërkombëtare në suksesin e kërkesave; dhe nevoja për një funksionim të mirë të shtetit të së drejtës. Këtu dalin në pah dhe ndryshimet kryesore dhe ngjashmëritë mes sistemeve dhe disa prej problemeve të veçanta me të cilat ndeshen personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar në paraqitjen e kërkesave. Pjesa 4 trajton rolin e rëndësishëm të komunitetit të OJF-ve në mbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar dhe në ofrimin e shërbimeve. Pjesa 5 përmban profilet e vendeve, ku përfshihen një përmbledhje e kuadrit ligjor dhe institucional kombëtar; funksionimi i skemave shtetërore, dëmshpërblimi nëpërmjet proceseve civile, penale dhe të së drejtës së punës; sekuestrimi i pasurisë; dhe ndihma ndaj personave të trafikuar në secilin vend të studiuar. Profilet e vendeve theksojnë dhe praktika të mira. Pjesa 6 përfundon me rekomandimet për veprime të ardhshme.

## **1.2 METODOLOGJIA**

Ky studim bazohet në një analizë studimore të ligjeve, raporteve të rasteve dhe burimeve dytësore mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Raportet, këshillimi dhe kontributet janë marrë nga përfaqësues të misioneve të OSBE-së, prokuroritë, OJF-të, avokatët e viktimave dhe organizatat ndërkombëtare që punojnë për të drejtat e personave të trafikuar, të drejtat e emigrantëve, të drejtat e viktimave të krimit dhe të drejtat e punëtorëve. Disa prej përgjigjeve bazohen në një pyetësor standard, disa të tjera janë marrë nëpërmjet intervistave dhe komunikimit me studiuesit. Ky raport u paraqit si dokument për diskutim në seminarin e OSBE/ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar, zhvilluar në Barcelonë në dhjetor të vitit 2007. Në seminar u dhanë komente dhe sugjerime mbi dokumentin dhe më pas shumë prej pjesëmarrësve dhanë komente me shkrim. Këto komente dhe sugjerime janë integruar në raport.

Tetë Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së u përzgjedhën për një analizë të hollësishme, me qëllim ilustrimin e mekanizmave të ndryshëm të dëmshpërblimit, studimin e sfidave që duhen kapërcyer për të pasur kërkesa të suksesshme, dhënien e shembujve të praktikave më të mira dhe zhvillimin e rekomandimeve të përgjithshme. ODIHR dëshiron të falënderojë të tetë Shtetet pjesëmarrëse të analizuara dhe aktorët e shoqërisë civile të këtyre vendeve për bashkëpunimin e tyre dhe kontributin në këtë studim. Këtyre tetë Shteteve iu dha mundësia për të dhënë vërejtje dhe sugjerime mbi projekt raportin në prill të vitit 2008. ODIHR dëshiron të falënderojë ato Shtete pjesëmarrëse që dhanë komente. Komentet e tyre të vyera janë marrë në konsideratë dhe janë pasqyruar në raport.

Përqendrimi në këto tetë vende nuk ka si qëllim të nënkuptojë se në ato apo në vendet e tjera të OSBE-së sistemet e dëmshpërblimi të personave të trafikuar ose të shfrytëzuar janë të përsosura apo jo të përsosura. Kjo përzgjedhje është bërë sepse ato përfaqësojnë tradita të ndryshme ligjore (*common law* ose anglo-saksone dhe e drejta civile); vende të Evropës Perëndimore dhe Lindore; anëtarë të rinj të Bashkimit Evropian dhe ato që janë kandidatë për anëtarësimin; vende ku të drejtat e viktimës dhe dëmshpërblimi kanë një histori të gjatë dhe vende ku të drejtat janë konceptuar por nuk kanë lindur ende ose janë të pazhvilluara. Të dhënat më të detajuara janë ato për SHBA-në, ku hapat legjislativë dhe mundësitë e dëmshpërblimit janë më të shumta dhe jurisprudenca është më e zhvilluar sesa në vende të tjera. Ky fakt duhet të jetë i dobishëm për avokatët dhe politikëbërësit e vendeve të tjera.

Ndonëse studimet e bëra paraqesin një përmbledhje të detajuar të standardeve dhe procedurave në secilin vend të përzgjedhur, pranohet që raporti ka boshllëqe në informacion, në veçanti në lidhje me:

- a) Çështjet e së drejtës së punës, ku përfshihet praktika e kërimit të pagës së papaguar ose jo të paguar plotësisht; pushimet e padrejta nga puna; diskriminimi; humbja e së drejtës për ditë pushimi dhe ditëve me raport mjekësor; si dhe informacion rreth çështjeve të ngritura nga emigrantët duke përdorur të drejtën e punës;
- b) Informacionin e hollësishëm mbi sekuestrimin e pasurisë dhe konfiskimin në çështjet civile si dhe penale.
- c) Informacionin nëse vendimet aktuale për shpërblimin e dëmit dhe vendimet gjyqësore janë ekzekutuar dhe nëse janë paguar viktimat;
- ç) Sfidat me të cilat ndeshen fëmijët (nën 18 vjeç) për të përfituar dëmshpërblim për trafikimin dhe shfrytëzimin si dhe një analizë e asaj se çfarë ndodh me masën e



dëmshpërblimit që ata marrin. Sa herë ka qenë e mundur, raporti ka përfshirë informacion rreth këtyre çështjeve.

Raporti përqendrohet në dëmshpërblimin e humbjeve dhe dëmtimeve që pësojnë personat e trafikuar ose të shfrytëzuar nga palët private. Dëmshpërblimi i kërkuar në paditë kundër shtetit për shkelje të të drejtave të njeriut nuk është objekt i këtij studimi. Pra, lexuesit duhet të kenë parasysh se kur një aktor shtetëror është përgjegjës për trafikimin, ose kur shteti nuk ka arritur të mbrojë njerëzit deri në masën ku dështimi shkel të drejtat e njeriut, atëherë viktimat mund të ngrejë padi kundër shtetit (p.sh., në gjykatë kushtetuese ose në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut), dhe nëse padia pranohet mund të gëzojë të drejtën e shpërblimit të dëmit.

### **1.3 FJALOR**

#### **1.3.1 Dëmshpërblimi**

Termet “dëmshpërblim,” “kthim i dëmit,” “kthim” dhe “zhdëmtim” shpesh përdoren për konceptet të cilat janë të njëjta ose shumë të afërta, d.m.th., “të ndreqësh diçka për dikë për humbjen, dëmtimin, veprimin e padrejtë, veçanërisht nëpërmjet pagesës së përshtatshme.”<sup>3</sup>

Në këtë raport, termi “dëmshpërblim” i referohet konceptit të përgjithshëm të pagesës e personit, pavarësisht nga burimi i pagesës apo mekanizmi i përdorur, apo nga llojet e humbjeve që dëmshpërblehen. Pra, dëmshpërblimi përfshin shpërblimin nga skemat me fond shtetëror si dhe shpërblimet e dhëna në proceset ligjore penale, civile ose të së drejtës së punës.

“Shpërblim i dëmit” përdoret në një kuptim më të ngushtë, sepse i referohet “shumës së parave që i takon atij që preket nga vepra penale, marrë si dëmshpërblim nga autori i veprës penale.”<sup>4</sup> Dëmshpërblimi e përjashton kompensimin në rastet kur burimi i financimit është skema shtetërore, dhe për këtë arsye, termi “shpërblim i dëmit (dëmshpërblim)” përdoret në kontekstin e procedurës civile dhe në atë të punës.

Kërkesat për dëmshpërblimin mund të përmbajnë disa elementë të ndryshëm (p.sh., dhimbje dhe vuajtje, shpenzimet mjekësore, dhe paga të papaguara) ose një element të vetëm (p.sh., paga të papaguara). Këta elementë mund të klasifikohen në kategori më të gjera si dëme “morale” dhe “materiale” (që përkufizohen më poshtë).

<sup>3</sup> Përkufizimi i dëmshpërblimit (*compensation*) në *Chambers 21st Century Dictionary* (Fjalori Chambers i Shekullit të 21-të), 2004.

<sup>4</sup> *Black's Law Dictionary* (Fjalori Juridik Black) (botimi i 8të, 2004).

Përdorimi dhe përkufizimi i termave “ndreqje” (*redress*) “kthim” (*restitution*) ose “rivendosja e së drejtës” (*reparation*) në kontekstin ligjor ndërkombëtar ose kombëtar, do të thotë përdorimi i përshtatshëm në atë situatë të veçantë, por përndryshe nuk i atribuohet asnjë kuptim tjetër.

Ka raste kur ndonjëri prej këtyre termave ka një kuptim në legjislacionin e një vendi dhe kuptim tjetër në vende të tjera, p.sh. termi “*restitution*” (kthim i dëmit) në ShBA do të thotë pagesa që i bëhet viktimës nga i pandehuri në zbatim të vendimit të gjykatës, por në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë “*restitution*” do të thotë kthim i mallrave dhe pronës tek pronari i ligjshëm.

### **1.3.2 Dëmet materiale dhe morale**

Secili vend përdor terma të ndryshëm për elementët e humbjes që përfshihen në kërkesën për dëmshpërblim. Megjithatë, në një kuptim të përgjithshëm, kërkesat për dëmshpërblim përmbajnë kryesisht elementë që përfshihen në dy kategori të veçanta: dëmshpërblimi për “dëmin material” dhe dëmshpërblimi për “dëmin moral.”<sup>5</sup>

“Dëmi material” i referohet humbjes financiare ose monetare, p.sh., shpenzimet mjekësore, të shtrimit në spital ose të varrimit, humbja e të ardhurave të pritshme dhe përfitimeve që rrjedhin nga punësimi, pagat e papaguara,<sup>6</sup> dhe kostot e dëmtimeve ndaj pronës. Përkufizimi dhe fusha e zbatimit të dëmeve materiale në kontekstin kombëtar përcaktohet në legjislacion (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *common law* e traditës anglo-saksone) dhe ndryshon nga vendi në vend. Disa mekanizma dëmshpërblimi mundësojnë që të jepet pagesa e të gjitha formave të dëmit material, ndërsa të tjera mundësojnë vetëm kategoritë e kufizuara.

“Dëmi moral” u referohet humbjeve të tjera jofinanciare ose jo-monetare, p.sh., vuajtjeve emocionale, cenimit të nderit ose emrit të mirë, “dhimbjes dhe vuajtjes,” shqetësimi, humbjes së kënaqësisë së jetës, humbjes së shoqërisë dhe të miqësisë. Sërish, përkufizimi dhe fusha e zbatimit të dëmit moral në kontekstin kombëtar përcaktohet në ligj (ose nëpërmjet precedentëve në vendet *common law*) dhe ndryshon nga vendi në vend. Disa mekanizma dëmshpërblimi lejojnë që të kërkohen të gjitha format e dëmit moral, disa të

---

<sup>5</sup> Për një shtjellim të elementeve të tjera të mundshme të dëmeve në disa raste, shih pjesën 3.3 më poshtë.

<sup>6</sup> Duhet theksuar se pagat e papaguara janë një nënkategori e dëmit material. Ka mundësi që në disa padi sipas së drejtës së punës kur bëhet fjalë vetëm për pagën, dëmshpërblimi mund të quhet “pagë e papaguar.”

tjerë lejojnë vetëm lloje të caktuara të dëmit moral dhe disa të tjerë nuk e lejojnë fare paraqitjen e kërkesës në lidhje me dëmin moral.

Shih pjesën 3.3 dhe profilet e vendeve për detaje të mëtejshme mbi ndryshimet e përkufizimeve të dëmeve morale dhe materiale si dhe se si përlogaritja e tyre ndikon në kërkesat e personave të trafikuar për dëmshpërblimin.

### **1.3.3 Personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar**

Ky raport shqyrton dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Ai studion mekanizmat për dëmshpërblimin e individëve pavarësisht nëse janë identifikuar si viktimat trafikimi ose nëse ka çështje penale që i njeh ata si viktimë apo palë e dëmtuar.<sup>7</sup> Faktori përcaktues në këtë raport për përdorimin e termit person i trafikuar ose i shfrytëzuar është nëse përvoja e tyre klasifikohet në përkufizimin ndërkombëtar të trafikimit sipas nenit 3 të Protokollit të Trafikimit të KKBKON-së (shih Shtojcën I). Mund të kërkohej që personi i trafikuar të plotësojë disa kritere që të marrë statusin e “viktimit” në çështjen penale në vendet e caktuara. Kjo ndikon pastaj në mundësinë e personit për të kërkuar dëmshpërblimin, dhe diskutohet në kapitullin e profileve të vendeve. Megjithatë, kjo nuk ka lidhje me mënyrën e përgjithshme sesi përdoret termi ‘person i trafikuar’ këtu.

Ka dhe individë që janë viktimat të shfrytëzimit, duke iu referuar Nenit 3 të Protokollit të Trafikimit, ndonëse mund të mos jetë gjithmonë e qartë nëse realiteti i përvojës së tyre përputhet me përkufizimin ndërkombëtar ose kombëtar të trafikimit (për shembull, nëse janë dërguar në vendin në fjalë për qëllime shfrytëzimi). Këta persona mund të përfshijnë shumë punëtorë emigrantë të shfrytëzuar. Atyre mund t’u ofrohen mundësi për të kërkuar shpërblimin e dëmit, që mund të jetë me interes dhe përfitim në të njëjtën masë për personat e trafikuar. Njëkohësisht, personat e shfrytëzuar mund të përfitojnë mundësitë që u ofrohen personave të trafikuar. Për këtë arsye, ky raport mund të ofrojë gjithashtu informacion për ata që punojnë me grupe të tilla si punëtorët emigrantë të shfrytëzuar ose persona të tjerë të shfrytëzuar, si dhe të japë një panoramë më të gjerë të mjeteve për zhdëmtim në përgjithësi nga të cilat mund të përfitojnë personat e trafikuar.

Ka një numër të madh dokumentesh ligjore ndërkombëtare rreth trafikimit, punës së detyruar, të drejtave dhe standardeve të punës, të drejtave të njeriut, të drejtave të

---

<sup>7</sup> Për një diskutim rreth qëllimeve të ndryshme që mbështesin identifikimin e personave të trafikuar, shih temën e paraqitur në Konferencën e Aleancës kundër Trafikimit 10-11 shtator, 2007, Shivaun Scanlan, “*The Identification of Trafficked Persons in the Face of Conflicting Agendas*” (“Identifikimi i personave të trafikuar në kushtet e qëllimeve kontradiktore”) (OSBE/ODIHR).

punëtorëve emigrantë dhe të drejtave të viktimave të krimit, të cilat janë të gjitha të rëndësishme për këtë studim.<sup>8</sup> E drejta e dëmshpërblimit është pranuar si parim edhe nga Gjykata Ndërkombëtare Penale.<sup>9</sup>

---

<sup>8</sup> Për një pasqyrim të plotë të standardeve ligjore ndërkombëtare dhe analizë me tabelën e ratifikimeve, shih Shtojcën V. Pavarësisht nga fakti se jo të gjitha standardet janë ratifikuara as nuk zbatohen në të gjitha vendet e përfshira në këtë raport, ato kanë rëndësi në rajonin e OSBE-së.

<sup>9</sup> Shih, p.sh., Gjykata Ndërkombëtare Penale – Statuti i Romës (miratuar më 17 korrik 1998, hyri në fuqi më 1 korrik 2002), neni 75: Zhdëmtimi i viktimave: “1. Gjykata vendos parime në lidhje me zhdëmtimin e viktimave, ose në lidhje me ata, duke përfshirë kthimin e dëmit, dëmshpërblimin dhe rehabilitimin. Mbi këtë bazë, në vendimin e saj me kërkesë të palëve ose me iniciativën e saj në rrethana të veçanta, Gjykata mund të përcaktojë shtrirjen dhe masën e dëmit, humbjes dhe dëmtimit të viktimave ose në lidhje me ata, dhe deklaron parimet mbi të cilat vepron. 2. Gjykata mund të marrë vendim urdhërues ndaj të dënuarit, duke përcaktuar zhdëmtimet e duhura për, ose në lidhje me, viktimat duke përfshirë kthimin e dëmit, dëmshpërblimin dhe rehabilitimin. Kur është e përshtatshme, Gjykata mund të vendosë që zhdëmtimi të bëhet nëpërmjet Fondit të Dedikuar të parashikuar në nenin 79...”

## **2. Dëmshpërblimi sipas së drejtës ndërkombëtare – një vështrim i përgjithshëm**

Ekzistojnë një sërë instrumentesh ndërkombëtarë që mund të përdoren për të mbrojtur të drejtat e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar. Përgjithësisht, instrumentet që mbrojnë viktimat e krimit, personat e trafikuar dhe që merren me punën e detyruar, janë të ratifikuar më gjerësisht se ato që mbrojnë të drejtat e punëtorëve emigrantë. Këto standarde tregojnë se, së bashku me praktikën vendase në rritje, e drejta për dëmshpërblim, ashtu si dhe të drejta të tjera ndihmëse, si ajo e ndihmës ligjore, po njihen më gjerësisht. Zbatimi i së drejtës në një shtet në veçanti varet nëse ai shtet ka ratifikuar konventën përkatëse. Megjithatë, është e rëndësishme për t'u mbajtur mend se këto janë standarde minimale që duhen respektuar dhe se shtetet janë të lira të përfshijnë dispozita të zgjeruara.

### **2.1 PASQYRIM I TË DREJTËS PËR DËMSHPËRBLIM**

Shtetet palë të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON)<sup>10</sup> dhe Protokollit i Trafikimit,<sup>11</sup> janë të detyruara të sigurojnë që të paktën një lloj procedure ligjore është në dispozicion të personave të trafikuar me të cilën mund të përfitohet dëmshpërblimi. Shtetet gjithashtu janë të detyruara të sigurojnë që viktimave u jepet informacionin për këtë mundësi. Sipas KKBKON-së, mundësia e dëmshpërblimit duhet nxitur përtej kufijve.

E drejta e personave të trafikuar për dëmshpërblim përforcohet nga Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimin kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (KKEVTQNj),<sup>12</sup> e cila parashikon të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim nga trafikanti si për dëmin moral, ashtu edhe për atë material. Ajo gjithashtu parashikon të drejtën e përfitimit nga një skemë shtetërore dëmshpërblimi, duke iu referuar modelit të paraqitur nga Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (KEDVKDh).<sup>13</sup> Vihet më shumë theksi tek të drejtat ndihmëse, si ndihma ligjore falas, të cilat e bëjnë dëmshpërblimin një mundësi efektive dhe praktike.

---

<sup>10</sup> Miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003.

<sup>11</sup> Protokollit për Parandalimin, Shtypjen dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, veçanërisht Grave dhe Fëmijëve, plotësues i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokollit i Trafikimit). miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003. I ratifikuar nga të gjitha vendet e këtij studimi.

<sup>12</sup> Miratuar më 16 maj 2005, hyri në fuqi më 1 shkurt 2008.

<sup>13</sup> Për më shumë informacion për këtë konventë dhe kufizimet e saj, shih në vijim dhe Shtojcën III.

E drejta për dëmshpërblim nga trafikanti dhe shteti mbështetet nga disa instrumente politikisht detyruese (ose “ligje të buta”), ku spikasin Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit dhe legjislacioni i Bashkimit Evropian si Direktiva e Këshillit të BE-së për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimit.

Megjithatë, e drejta për dëmshpërblim nga shteti është e kufizuar dhe jepet vetëm në rrethana të caktuara. KKEVTQNj e kufizon dëmshpërblimin nga shteti vetëm për rastet e dëmit *material* ku vepra penale ka qenë veprim i qëllimshëm dhune që ka rezultuar në dëmtime fizike ose mendore. Ekzistojnë kufizime edhe në lidhje me legjitimitimin për të përfituar nga skema, ku përfshihen kërkesa për të qenë viktimë e krimeve të caktuara, llojet e dhunës dhe llojet e dëmit, si dhe plotësimi i kriterëve të “karakterit të mirë” dhe statusit të emigrimit. Këto faktorë bëjnë që një person i trafikuar mund të mos ketë të drejtë të përfitojë nga dëmshpërblimi sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, standardet ndërkombëtare dhe ato të BE-së kufizojnë të drejtën e dëmshpërblimit nga shteti për krime që kanë shkaktuar dëme serioze dhe për krimet e dhunshme.

Në çdo rast, të gjithë anëtarët e Këshillit të Evropës janë politikisht të detyruar nga Rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, për shembull *Rekomandimi R (2006) 8 - Mbi ndihmën ndaj viktimave të krimit*, i cili jep informacione të hollësishme mbi këtë të drejtë dhe mbi çështjet e lidhura. Ka gjithashtu detyrime të tjera të ngjashme për të gjitha vendet anëtare të BE-së, dhe të gjitha shtetet pjesëmarrëse në OSBE janë subjekt i angazhimeve politike detyruese të OSBE-së. Të gjitha këto përforcojnë të drejtën për dëmshpërblim nga trafikanti dhe shpërblim nga shteti në rastet e dhunës ose të dëmtimeve serioze.

Standardet ndërkombëtare të punësimit gjithashtu konfirmojnë të drejtën për mjetet riparuese të dëmit, përfshi dëmshpërblimin në rastet e punës së detyruar dhe kur janë shkelur të drejtat e punëtorëve dhe të migrantëve.<sup>14</sup> Sipas tyre, në çdo vend është e nevojshme që të ekzistojnë standarde ligjore të punës për të siguruar kryerjen e pagave<sup>15</sup> dhe rregullimin e agjencive private,<sup>16</sup> në mënyrë që të mbrohen të drejtat e punëtorëve. Kjo përfshin sigurimin e “mjeteve mbrojtëse të përshtatshme” për punëtorët të cilëve u janë shkelur këto të drejta.

---

<sup>14</sup> Konventat e ILO-s 29 e vitit 1930 dhe 105 e vitit 1957 dhe dokumentet e lidhura si dhe Konventa 97 e ILO-s ‘Migracioni për Punësim’ (1949) dhe Konventa 143 ‘Punëtorët Migrantë’ (Dispozita Shtesë) (1975).

<sup>15</sup> Konventa 95 e ILO-s mbi Mbrojtjen e Pagave.

<sup>16</sup> Konventa 181 e ILO-s mbi Agjencitë Private të Punësimit.

## **2.2 PËRFUNDIM**

Ekziston e drejta e dëmshpërblimit në rastet e trafikimit, krimeve të dhunshme, dhunës ndaj grave, shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe kur shkelen standardet ndërkombëtare të punës. Megjithatë, kjo e drejtë kufizohet në dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi. Dëmshpërblimi nga shteti ndodh vetëm në rrethana të kufizuara të krimeve të dhunshme që shkaktojnë dëme fizike dhe mendore.

Standardet ndërkombëtare kanë zhvilluar parimin sipas të cilit përfitimet e trafikantëve nëpërmjet aktiviteteve të tyre shfrytëzuese duhet të përdoren në dobi të personave të trafikuar në mënyrë individuale ose kolektive. Udhëzimet ndërkombëtare me natyrë politikisht detyruese paraqesin gjithashtu detyrimin e mbledhjes së pasurive të krimit dhe përdorimin e kësaj pasurie për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Theksohen gjithashtu edhe interesat e veçanta të grave dhe fëmijëve. Kur rasti përmban shkelje shumë të rëndë të të drejtave të njeriut, shkelje të rëndë të ligjeve humanitare apo krim ndërkombëtar (siç përcaktohet nga Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale), atëherë ekziston një theksim akoma më i madh mbi të drejtën për dëmshpërblim.

### **3. Dëmshpërblimi – kuadri ligjor në vende të ndryshme**

Dallimi kryesor midis mekanizmave të ndryshëm të dëmshpërblimit qëndron në faktin nëse dëmshpërblimi i paguhet personit të trafikuar nga shteti apo nga autori i veprës penale. Kjo pjesë e raportit përmban një pasqyrim të mekanizmave ekzistues të dëmshpërblimit dhe sfidat me të cilat ndeshen individët që kërkojnë dëmshpërblim nga të dy burimet. Shqyrtohen gjithashtu edhe sfidat me të cilat përballen personat e trafikuar në kërkimin e dëmshpërblimit. Llojet e humbjeve që dëmshpërblehen nga mekanizma të veçantë ndikojnë në suksesin dhe masën e shpërblimit. Kjo shihet bashkë me domosdoshmërinë për një zbatim efektiv të vendimeve dhe procedurave të konfiskimit të pasurisë. Së fundi, diskutohen dhe ndërlikimet për shkak të problemeve ndërkombëtare dhe mungesës së shtetit të së drejtës.

#### **3.1 MEKANIZMAT E DËMSHPËRBLIMIT**

Vendet kanë mënyra të ndryshme dëmshpërblimi të cilat ndryshojnë dhe brenda të njëjtit vend. Justifikimi ligjor (shkaku i ngritjes së padisë) për të kërkuar dëmshpërblim ndryshon sipas rrethanave rregulluese (p.sh., në legjislacionin civil ose atë të punës), llojeve të humbjeve që kompensohen, si dhe mund të ndryshojnë dhe metodat që përdoren për të llogaritur masën e shpërblimit. Gjithashtu, janë të ndryshme dhe procedurat dhe kriteret e përdorura për përcaktimin e përfitimit nga shpërblimi në varësi të mekanizmit që përdoret. Çdo ndryshim në procedurë apo në standardin ligjor mund të ndikojë në mundësinë e individit për të paraqitur me sukses kërkesën, dhe për këtë arsye secili mekanizëm ka sfidat ose përparësitë e veta.

Duhet theksuar se SHBA-ja është i vetmi vend në këtë studim ku dëmshpërblimi i viktimave të trafikimit është i detyrueshëm në çështjet penale, ku ekziston një shkak i caktuar për ngritjen e padisë në çështjen civile në lidhje me trafikimin, si dhe ku janë zakonisht të pranueshme kërkesat nga viktimat e trafikimit për dëmshpërblim nga fondet shtetërore për disa lloje humbesh materiale. E drejta për të përfituar dëmshpërblim ekziston pavarësisht nëse vepra penale e trafikimit klasifikohet si krim i dhunshëm (shiko profilin e vendeve, SHBA-ja, për të dhëna të mëtejshme). Në të gjitha vendet e tjera, personat e trafikuar trajtohen njëjloj si paditësit e tjerë, dhe kërkesa vlerësohet në bazë të rrethanave të rastit individual. Ky fakt ka pasojë domethënëse në numrin e padive të suksesshme, p.sh., në Mbretërinë e Bashkuar kërkesa për dëmshpërblim nuk shqyrtohet automatikisht në çështjen



penale të trafikimit, dhe kërkesa për dëmshpërblim nga fondi shtetëror kufizohet vetëm për krimet e dhunshme që kanë shkaktuar dëmtim, duke rezultuar kështu në një numër më të vogël rastesh dëmshpërblimi sesa në SHBA (për më shumë të dhëna shiko profilet e vendeve, Mbretëria e Bashkuar).

Disa karakteristika të mekanizmave të dëmshpërblimit janë të përbashkëta për të gjitha shtetet e rajonit të OSBE-së. Të gjitha strukturat e tilla ligjore dhe administrative paraqesin sfida për cilindo që kërkon zhdëmtim, përfshi dëmshpërblimin. Njohja e këtyre sfidave dhe karakteristikave të përgjithshme duhet të ndihmojë në kuptimin e përparësive dhe dobësive të secilit lloj mekanizmi për personat e trafikuar.

### **3.1.1 Dëmshpërblimi nga trafikanti/shfrytëzuesi**

E drejta për dëmshpërblim nga trafikanti/shfrytëzuesi është fokusi i pjesës më të madhe të standardeve ndërkombëtare mbi dëmshpërblimin. Kjo mund të arrihet në mënyrë vullnetare ose në mënyrë shtrënguese.

Marrëveshjet vullnetare mund të arrihen si pjesë e një marrëveshjeje me ndërmjetësim në një veprim kolektiv ose individual që kryhet jashtë procesit gjyqësor (p.sh., përpara ngritjes së padisë por duke e parashikuar atë); nëpërmjet negociatave brenda procesit penal për marrëveshje që pranon përgjegjësinë ) (p.sh., në SHBA, ku njihet si *'plea agreement'*), ose një marrëveshje pajtimi të ndërmjetësuar nga të tjerët në çështjen penale (p.sh., në Francë); apo si një marrëveshje pajtimi e negociuar në çështjen civile apo e bazuar në legjislacionin e punës (në të gjitha vendet – shiko shembujt në profilet e vendeve për SHBA-në dhe për Federatën Ruse).

Urdhrat shtrënguese lëshohen me vendim gjykate në proceset penale, civile apo të punës. Të gjitha vendet në këtë studim lejojnë mundësinë e ngritjes së padisë të paktën nëpërmjet njërës prej këtyre procedimeve ligjore. Në raste të tilla, gjykata duhet detyrimisht të shqyrtojë të gjitha provat në lidhje me përgjegjësinë (fajin) për humbjen dhe në lidhje me natyrën dhe masën e dëmit. Urdhri i lëshuar nga gjykata mund të paguhet ose jo në mënyrë vullnetare. Mospagesa mund të detyrojë viktimën ose shtetin të ndjekë procedurat përmbarrimore. Këto mund të jenë në fund të fundit jo të suksesshme, që do të thotë se, pavarësisht nga ekzistenca e disa mekanizmave dëmshpërblimi, marrja e masës së dëmshpërblimit nga personi i trafikuar, në praktikë ndodh shumë rrallë.

Procedimi për dëmshpërblimi mund të kryhet i veçuar (p.sh., në çështjen penale) ose bashkë me një padi tjetër ndaj keqbërësit (p.sh., çështja penale se bashku me një çështje të bazuar në legjislacionin e punës). Si alternativë, një padi për dëmshpërblim nëpërmjet procesit penal, civil dhe legjislacionit të punës mund të ndiqet bashkë me një kërkesë për të përfituar nga fondi shtetëror, në qoftë se plotësohen kriteret e pranueshmërisë për fondin.

### ***Procesi penal***

Çështja penale ndiqet nga shteti kundër të dyshuarit, dhe qëllimi kryesor është që të vendoset nëse personi është fajtor ose jo për veprën penale për të cilin akuzohet. Ka standard të lartë për provat që kërkohen. Të drejtat e viktimës në procesin penal ndryshojnë gjerësisht nga njëri vend në tjetrin. Për shembull, në Ukrainë viktimat gëzojnë të drejta shumë të gjera, si për shembull të drejtën për t'u përfaqësuar dhe për të marrë në pyetje dëshmitaret, ndërsa në Shqipëri të drejtat nuk janë të përcaktuara mirë.

Në disa vende, si për shembull në Francë, Moldavi dhe Ukrainë, padia civile për dëmin e pësuar nga personi i trafikuar mund të ngrihet në procesin penal kundër autorit të veprës penale dhe bëhet pjesë e procesit. Kjo padi llogaritet njëllëj ose në mënyrë të ngjashme me padinë në procesin civil të zakonshëm. Në vende të tjera, gjykata mund të urdhërojë që dëmshpërblimi të paguhet nga autori i veprës kur dënohet, për shembull, *urdhurat e kthimit të dëmit* në SHBA ose *urdhurat e dëmshpërblimit* në Mbretërinë e Bashkuar. Është e qartë, se këto lloje padish në procedurën penale kërkojnë që viktimat të jetë identifikuar nga autoritetet dhe që i autori të jetë proceduar dhe shpallur fajtor.

Padia civile në çështjen penale ka përparësi të dyfishtë, që dy procedura bashkohen në një të vetme si dhe që prokurori është përgjegjës për mbledhjen dhe paraqitjen e provave në lidhje me përgjegjësinë e të akuzuarit. Megjithatë, një dobësi e mundshme e padisë civile në procesin penal është se gjykimi i padisë civile zakonisht “qëndron ose rrëzohet” në varësi të suksesit të çështjes penale. Kjo do të thotë se në rastet kur vendoset që ngjarja të mos ndiqet penalisht ose kur i pandehuri shpallet i pafajshëm, ka mundësi që padia civile ndaj të njëjtit të pandehur të rrëzohet. Kjo ndodh në Rumani dhe në Shqipëri.

Në disa vende duket se gjyqtarët mendojnë që padia civile luan një rol më të vogël kundrejt çështjes penale dhe ndonjëherë nuk e marrin fare në shqyrtim (për shembull në Moldavi). Në vende të tjera, prokurorët kanë shprehur mungesën e dëshirës ose të vullnetit për të shqyrtuar padinë për dëmshpërblim në procesin penal, sepse kjo krijon idenë se viktimat ka një motiv të mëtejshëm ose të dyshimtë për të dëshmuar në çështjen (në Mbretërinë e

Bashkuar, në Moldavi dhe në Ukrainë). Kjo lë shkak që marrja në pyetje e viktimës të jetë armiqësore dhe të ngrihen dyshime nga ana e mbrojtjes apo e gjyqtarit, dhe krijon rrezik që ndjekja e procesi penal të dështojë në tërësi, Ky problem duket se ka gjetur zgjidhje në SHBA, ku vendimi për shpërblimin e dëmit është i detyrueshëm në çështjet penale dhe viktimës i është hequr përgjegjësia individuale për ngritjen e padisë civile.

Kur personi i trafikuar ka arritur me sukses të marrë vendimin e dëmshpërblimit ose një vendim civil në procesin penal, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se do të paguhet të gjitha dëmet e pësuar. Urdhri i dëmshpërblimit në procesin penal nuk llogaritet gjithnjë mbi të njëjtat baza si në procesin civil dhe mund të mos reflektojë masën e plotë të dëmit që ka pësuar personi i trafikuar. Në Mbretërinë e Bashkuar, gjykata penale cakton masa dëmshpërblimi nominale (d.m.th., të ulëta), zakonisht duke pasur parasysh vetëm pasuritë e kriminelit. Në SHBA, dëmi moral, p.sh., “dhimbja dhe vuajtja,” nuk përfshihet në fushën e dëmshpërblimit të gjykatës penale. Kjo do të thotë që individi nuk merr dëmshpërblim të plotë dhe duhet të ngrejë padi civile përveç procedimit penal, për të marrë humbjet që nuk u morën. Ngritja e padisë civile kur çështja penale ka përfunduar me dënim të të pandehurit si fajtor do të thotë që përgjegjësia (faji) i tij është vendosur. Çështja civile vetëm vendos llogaritjen e dëmit me vendim gjykate. Megjithatë, procedura të tilla mund të kundërshtohen fortë, veçanërisht kur bëhet fjalë për shuma të mëdha parash. Gjithsesi ato janë më të lehta për individët në krahasim me një padi civile, e cila detyrohet të vendosë si përgjegjësinë e personit që akuzohet, ashtu edhe masën e dëmeve.

Vështirësi të tjera mund të lindin për shkak se mund të mos ekzistojë ndihma ligjore për të vijuar me dëmet shtesë, personi i trafikuar mund të mos ketë lejë qëndrimi në vendin ose mundësinë të sigurojë përfaqësimin nga një palë e tretë në atë vend, ose pasuritë e personit të akuzuar mund të jenë zhdukur ose janë harxhuar për shpenzime ligjore gjatë procesit penal. Kur personave të trafikuar u sigurohet ndihma ligjore pa pagesë si dhe kur viza ose leja e qëndrimit u mundësohet atyre gjatë procedimeve, si në SHBA, atëherë padia civile ka më shumë gjasa për t'u arrirë. Po të krahasojmë vlerësime ndërkombëtare të numrit të personave të trafikuar, shumë pak çështje ndiqen penalisht.<sup>17</sup> Ndjekja penale e çështjeve të

---

<sup>17</sup> Sipas organizatës “A Global Alliance Against Forced Labour” (Aleanca Globale kundër Punës së Detyruar) (ILO 2005), para .56, faqe 14, numri i personave të trafikuar në botë, i vlerësuar afërsisht, është 2.45 milionë. Vetëm një vlerësim i tillë mund të bëhet dhe për numrin e rasteve që ndiqen penalisht (shih raportet e vendeve në *Trafficking in Persons Report 2006* (Raportin e Trafikimit të Personave 2006) të Departamentit Amerikan i Shtetit), por është e qartë, nga numri i vogël i rasteve të përmendura në atë raport, se numri i viktimave çështjet e të cilave ndiqen penalisht është shumë më i vogël se numri i vlerësuar i viktimave (shih dhe faqet 19-24 të raportit të sipërpërmendur të ILO-s për përmbledhjen e ligjeve dhe zbatimit të tyre). Një pikëpamje e ndryshme është se numri real i viktimave është shumë më i vogël sesa vlerësimet; shih *Human Trafficking Evokes Outrage*, Little

trafikimit është e vështirë, sepse shpesh nuk dihet kush është trafikanti ose është larguar nga juridiksioni, provueshmëria e veprës penale varet nga shumë elementë, nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin që puna ishte e pavullnetshme, ose personi i trafikuar nuk ka dëshirë ose mundësi të bashkëpunojë me organet zbatuese të ligjeve. Në shumë vende, ligjet janë ende të reja, dhe ekziston një boshllëk kohor midis hyrjes në fuqi dhe zbatimit. Kështu dëmshpërblimi në procesin penal nuk është një metodë aktualisht e disponueshme për shumicën e personave të trafikuar.

### ***Procesi civil***

Personat e trafikuar mund të ngrenë padi civile për dëmshpërblim si individ privat mbi bazën e një veprë penale, e cila u ka shkaktuar dëm atyre, p.sh., bazuar në të drejtën e dëmeve jashtëkontraktore (*tort law*) (mashtim, dhunë, heqje e lirisë, borxh), shkelje e të drejtave kontraktore ose çdo shkak tjetër për të ngritur padi të përcaktuar në legjislacionin vendas. Procesi gjyqësor civil mund të përdoret në të gjitha vendet dhe të zhvillohet kundër personit përgjegjës për kryerjen e shkeljes, i cili mund të jetë individ ose shoqëri, përfshirë punëdhënësin. Megjithatë, në studimin që i paraprin këtë raport, gjykimet civile jashtë procesit penal u panë, përveç se në SHBA, në shumë pak raste. Në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Rumani, avokatët u përgjigjën se klientët e tyre nuk e merrnin në konsideratë mundësinë e padisë civile për shkak të vështirësive që hasin në sistemin ligjor civil (shpenzimet, koha) dhe risia e një padie të tillë.<sup>18</sup>

Padia civile mund të ngrihet pavarësisht nga fakti nëse po kryhet procesi penal dhe ndonjëherë padia civile ka standarde prove më të ulët se në çështjen penale.<sup>19</sup> Nëse personi i trafikuar vendos të ngrejë padinë civile para përfundimit të çështjes penale, atëherë duhet të provohet se i padituri është përgjegjës për kryerjen e veprës penale, dhe se vepra penale ka shkaktuar humbje dhe dëme. Paditësi duhet të sigurojë prova në lidhje me natyrën dhe masën e dëmit (fatura, prova të pagesës, dëshmi me gojë). Pothuajse gjithmonë, paditësi duhet të paraqitet në gjykatë dhe të japë dëshmi për të provuar këto çështje. Kjo mund të

---

*Evidence* (Trafikimi i qenieve njerëzore shkakton zemëratë, pak prova), Gazeta Washington Post, 23 shtator 2007 në

<http://www.washingtonpost.com/wp-dyn/content/article/2007/09/22/AR2007092201401.html>.

<sup>18</sup> Për një pasqyrim të mëtejshme të vështirësive që hasen në sisteme ligjore në lidhje me emigrantët e parregullt, shih *Ten Ways to Protect Undocumented Migrants* (Dhjetë mënyra për të mbrojtur emigrantët e parregullt) (PICUM, 2005), faqet 74-76.

<sup>19</sup> Ndërsa në sistemet ligjore të *common law*, standardi penal i provës (përtej dyshimit të arsyeshëm) është më i lartë se standardi civil i provës (më i mundshmi), nuk ndodh gjithmonë kështu në sisteme ligjore civile, p.sh. në Francë, standardi i provës është i njëjtë për çdo lloj çështjeje. Gjithsesi, kur padia civile gjykohet në të njëjtën kohë me procesin penal, padia civile zakonisht rrëzohet kur i dyshuari nuk gjendet fajtor në procesin penal, dhe nuk mund të ringrihet procesi civil i veçantë (shih profilet për Ukrainën dhe Moldavinë).

sjellë ndrojtjen e viktimës ose të jetë ritraumatizuese apo edhe e pamundur për persona të trafikuar të caktuar.

Gjyqet civile gjithashtu mund të zgjasin për një kohë të gjatë dhe të jenë të ndërlikuara (në disa vende ato zgjasin me vite). Ato janë dhe të kushtueshme, për shkak të shpenzimeve gjyqësore, ligjore dhe të ekspertëve. Personat e trafikuar kanë nevojë për asistencë ligjore të specializuar me qëllim paraqitjen para gjykatës të fakteve dhe argumenteve juridike. Këta faktorë i përkasin veçanërisht Mbretërisë së Bashkuar, ku padia civile mund të ngrihet vetëm jashtë procesit penal. Megjithatë, në rastet kur padia civile është e suksesshme, dëmshpërblimi normalisht përfshin të gjitha humbjet e pësuar nga personi i trafikuar, dëmin moral si dhe atë material siç përcaktohet në legjislacionin vendas, si edhe kostot. Ndonëse procesi civil mund të duket më i lehtë për një person të trafikuar, meqenëse nuk përfshihet policia, megjithatë dhe në këtë rast kërkohet identifikimi i autorit të veprës penale dhe, në qoftë se personi i trafikuar do të mund të marrë paratë, kërkohet që autori të jetë brenda juridiksionit dhe të ketë pasuri financiare të mjaftueshme. Kur vendimi i gjykatës nuk zbatohet në mënyrë vullnetare, atëherë personi i trafikuar është i detyruar që t'u drejtohet procedurave të përmbarrimit, të cilat paraqesin vështirësi të mëtejshme (shih pjesën 3.4 më poshtë). Të gjithë këta faktorë kufizojnë dobinë e procesit civil për të arritur shpërblimin e dëmit që ka pësuar personi i trafikuar. Në SHBA, ekziston mundësia për “paditë në grup” (*class actions*), të cilat mundësojnë paraqitjen e një çështjeje nga një grup individësh, pa qenë nevoja që barra e çështjes dhe procedurave të bien mbi çdo individ.

### ***Procesi sipas së drejtës së punës***

Personi i trafikuar mund të gëzojë të drejta sipas së drejtës së punës, të cilat ekzistojnë pavarësisht nga fakti nëse personi ka ose jo kontratë pune ose pavarësisht nga dispozitat e kontratës. Nga ana tjetër, personi i trafikuar mund të ketë të drejtë të ngrejë padi për shkelje të kontratës së punës (në mënyrë gojore ose me shkrim) dhe kjo padi mund të gjykohe në gjykatën e punës. Këto të drejta dhe shkelje të kontratës mund të zbatohen ndaj personit të akuzuar (p.sh., punëdhënësi shfrytëzues ose trafikanti) në gjykatat e punës dhe mund të kërkohet dëmshpërblimi. Padi të tilla mund të ngrihen se bashku me procesin penal ose në vend të tij.

Këto padi mund të ngrihen, ndër të tjera, në bazë të pagave së papaguara ose shkeljes së të drejtave ë lidhur me pagesën e lejes mjekësore, pushimet, aksidentet në punë, diskriminimin, mospagesën e pagës minimale apo punën jashtë orarit. Shpërblimi i dëmit mund të kërkohet për dëmin material si, p.sh., paga të papaguara ose nën nivelin minimal,

apo për shpenzimet mjekësore të cilat mbështeten në prova gojore ose të dokumentuara. Shpërblimi i dëmit moral si, p.sh., ai për diskriminimin, përcaktohet me tarifë ose përcaktohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligj. Në vendet *common law*, llogaritja kryhet në bazë të udhëzimeve ligjore të parashtruara në çështje gjyqësore të mëparshme (në Mbretërinë e Bashkuar ka edhe tarifa për udhëzimet dhe kufizim maksimal të përcaktuar për shpërblimin). Paditë mund të japin rezultate të tjera si, p.sh., nxjerrjen e vendimit për rivendosjen e një së drejte të shkelur.

Që personi i trafikuar të mund të marrë paratë, është e nevojshme që keqbërësi të jetë i identifikueshëm, të njihet vendndodhja e tij dhe që ai të ketë pasuri financiare të mjaftueshme. Kjo mund të kufizojë mundësitë e personave të trafikuar për dëmshpërblim. Megjithatë, disa punëdhënës mund të jenë të siguar ndaj padive kundër tyre dhe kjo rrit mundësitë që pagesa e dëmshpërblimit të realizohet në proceset sipas së drejtës së punës.

Paditë sipas legjislacionit të punës hasin vështirësi të ngjashme me ato në proceset civile ndonëse mund të jenë më të lehta dhe më të shpejta për t'u negociuar. Ky është rasti në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë, ku gjykatat e punës kanë në dispozicion formularë më lehtësisht të kuptueshme, të përgatitura posaçërisht për paditë e zakonshme dhe ku vendimi merret në mjedise që janë më pak formale sesa gjykata. Në disa vende, legjislacioni i punës mund të mos jetë i disponueshëm ku bëhet fjalë për shfrytëzim seksual sepse ofrimi i shërbimeve në industrinë e seksit (i detyruar ose jo) është i paligjshëm ose nuk njihet si punësim. Në këtë rast, nuk do të ishte e mundur që të kërkohet paga e papaguar apo të pretendohen shkelje të tjera të këtyre ligjeve të punës ndaj punëdhënësit (shih, p.sh., SHBA-në, ku Ligji i Standardeve të Drejta të Punës (*Fair Labor Standards Act*) nuk zbatohet në rastet e punësimit të paligjshëm).<sup>20</sup>

Të drejtat e punës së individëve pa leje qëndrimi ose leje punësimi në vendin në fjalë (siç ndodh rëndom për personin e trafikuar), gjithashtu hasen me vështirësi. Në disa vende këto të drejta ekzistojnë në parim, por ngritja e një procesi mund të çojë në marrjen e informacionit nga shërbimet e emigracionit, të cilët mund ta përdorin çështjen për të gjetur vendndodhjen e individit dhe për ta deportuar atë. Sipas këtij studimi, raste të tilla kanë ndodhur në Francë. Në shtete të tjera, të drejtat e punëtorëve të parregullt nuk ekzistojnë, meqenëse kontratat e punës nuk konsiderohen si të ligjshme dhe kështu nuk mund të

---

<sup>20</sup> Megjithatë, në Gjermani, sipas ligjit për prostitucionin i vitit 2002, prostituta mund të ofrojë shërbime si "kontraktues i pavarur" ose si i punësuar me kontratë pune, p.sh., në një shtëpi publike. Prostitutat kanë të drejtë ligjore për pagesën për të cilën është rënë dakord dhe mund të çojnë çështjen në gjykatë kundër klientit, nëse operojnë në mënyrë të pavarur, ose kundër punëdhënësit. Shih Raportin "*Sex Workers' Rights*" (Të drejtat e punëtorëve të seksit) të Konferencës Evropiane mbi Punën e Seksit, të Drejtat e Njeriut, Punën dhe Migracionin, Bruksel (2005), faqe 54.

shqyrtohen në gjykatë. Sipas studimit, kështu po ndodh në Rumani, Rusi, Ukrainë dhe në Mbretërinë e Bashkuar.

Vështirësitë mund të lindin dhe sipas së drejtës së punës kur individët nënkontraktohen apo punësohen nëpërmjet agjencive dhe nuk është e qartë se kush është përgjegjës për shkeljen e kushteve të punës. Kjo çon në probleme ligjore, p.sh., përgjegjësitë e agjencisë apo të punëdhënësit.<sup>21</sup> Ky studim ka zbuluar raste kur ishte e mundur që të provohej se përgjegjësia nuk ishte vetëm e shfrytëzuesit të drejtpërdrejtë, por dhe e atyre që përfitonin nga sigurimi i mallrave dhe shërbimeve me një kosto më të ulët. Në SHBA, në çështjen e ngritur në fabrikën me kushte shumë të këqija (*sweatshop*) *El Monte* në shtetin California,<sup>22</sup> u zbatua parimi i përgjegjësisë së përbashkët kontraktore në marrëdhëniet nënkontraktore. Këshilla e avokatit për të identifikuar të pandehurit që duhet paditëshin, është e domosdoshme për ta bërë padinë të suksesshme. I pandehuri duhet të jetë ligjërisht përgjegjës dhe në rastin më të mirë, me burime financiare të mjaftueshme ose i siguruar.

Në disa vende ekzistojnë organe administrative, siç janë inspektoriatet e punës apo këshillat kombëtarë të pagës minimale,<sup>23</sup> të cilët mund të vihen kryesisht në veprim për të hetuar punëdhënës shfrytëzues. Megjithatë, në disa vende këto organe janë të dobëta dhe pa burime të mjaftueshme. ILO ka bërë një sërë rekomandimesh mbi fuqizimin e ndikimit të tyre të përgjithshëm<sup>24</sup> dhe grupet e shoqërisë civile kanë bërë rekomandime të ndryshme për fuqizimin e rolit të tyre për mbrojtjen e punëtorëve, pavarësisht nga statusi i tyre i emigrantit.<sup>25</sup> Në përgjithësi, ato kanë kompetenca të zhvillojnë negociata me punëdhënësit apo t'ua referojnë çështjet organeve gjyqësore kur janë kryer shkelje që kanë nevojë për zgjidhje gjyqësore, duke përfshirë dëmshpërblimin.<sup>26</sup> Dënim penal apo civil mund të

---

<sup>21</sup> Në lidhje me këtë, shih propozimin e ri të BE-së për një direktivë që parashikon sanksione kundrejt punëdhënësve të shtetasve të jashtëligjshëm në vende të treta dhe dispozitat mbi përgjegjësitë e përbashkëta si dhe të veçanta të kontraktorëve (neni 9.2).

<sup>22</sup> Bureerong kundër Uvawas, 922 F. Supp. 1450, 1463 (C.D.Cal.1996).

<sup>23</sup> Këto organe duhen ngritur në shkallë kombëtare në përmbushjen e detyrimeve të Konventës 81 të ILO-s mbi Inspektimin e Punës, miratuar më 11 korrik 1947, e cila hyri në fuqi më 7 prill 1950. Është e ratifikuar nga 136 shtete, përfshi të gjitha vendet e këtij studimi. Shih <http://www.ilo.org/ilolex/cgi-lex/convde.pl?Co81>.

<sup>24</sup> Shih deklaratën për shtyp të ILO-s "ILO bën thirrje për fuqizimin e inspektimit të punës në mbarë botën," 16 nëntor 2006 dhe Sondazhin e Përgjithshëm të raporteve në lidhje me Konventën e Inspektimit të Punës, 1947 (Nr 81), dhe Protokollin e Rekomandimeve të Inspektimit të Punës, 1947 (Nr.82), Konventën e Inspektimit të Punës (Bujqësisë), 1969 (Nr.129), dhe Rekomandimin e Inspektimit të Punës (Bujqësisë), 1969 (Nr.133), Konferenca Ndërkombëtare e Punës Sesion i 95-të, 2006.

<sup>25</sup> Komentet e përbashkëta të ETUC, PICUM dhe SOLIDAR mbi propozimet e pritshme të Komisionit për luftën kundër punësimit "të paligjshëm" dhe kushteve shfrytëzuese të punës, 26 prill 2007 par 5, pika tretë në listë.

<sup>26</sup> Shih faqe 97-99 të Sondazhit të Përgjithshëm të ILO-s mbi Inspektorët e Punës, v. cit., shënim 24.

kërkohet në gjykatë. Si rezultat, mund të arrihen marrëveshje midis palëve ose gjykata mund të urdhërojë shpërblimin e dëmit për viktimat apo grupet e viktimave.<sup>27</sup>

Në SHBA, Departamenti i Punës mund të vendosë dënime ndaj punëdhënësve për shkelje të standardeve të caktuara të legjislacionit të punës (ndër të tjera, ligji i standardeve të drejta të punës dhe ligji për Mbrojtjen e Punëtorëve Sezonal të Bujqësisë dhe Migrantëve (MPSBM), të cilët mund të përdoren të dyja në rastin e personave të trafikuar).<sup>28</sup> Për shembull, kur inspektorët e Divizionit të Pagave dhe Orëve vënë re shkelje, ata mund të rekomandojnë ndryshime në praktikën e punësimit, në mënyrë që punëdhënësi të jetë në përputhje me legjislacionin, si dhe mund të kërkojnë pagesën e pagave të prapambetura që u takojnë punëtorëve. Punëdhënësit mund dhe të hetohen penalisht në rast të shkeljeve me dashje nën kushtet e caktuara. Departamenti i Punës mund të ngrejë padi civile ndaj punëdhënësit për pagat e prapambetura. Për shkelje të MPSBM-së, Departamenti i Punës mund të vendosë sanksione financiare, vlerësim të pagave të prapambetura, si dhe, në rastin e kontraktuesve që punojnë në bujqësi, mund të kërkojë heqjen ose pezullimin e lejeve të regjistrimit. Shkeljet mund të rezultojnë në padi civile ose penale ndaj cilitdo person i cili konstatohet se ka shkelur ligjin. Kjo do të thotë që Departamenti i Punës mund të hetojë shkelje që prekin personat e trafikuar, përfshirë ata që punojnë në mënyrë të paligjshme duke qenë se dhe ata mbrohen nga standardet e punës (për më shumë detaje shih profilin e SHBA-së).

Gjithashtu, Departamenti mund të vendosë një sërë sanksionesh dhe ta hedhë shkelësin në gjyq, nëse është e nevojshme. Ajo që është më e rëndësishme është se sanksionet përfshijnë fuqinë për heqjen e lejes së ushtrimit të aktivitetit të punëdhënësit, e cila kërcënon ekzistencën e të gjitha aktiviteteve të tij dhe i jep kështu më shumë shtytje të zbatojë urdhrat e inspektorëve. Si pasojë, personat e trafikuar mund të përfitojnë nga veprimet e inspektorëve ndonëse nuk ka qenë ata vetë që kanë ngritur padi. Kjo tregon që një inspektoriat, të cilit i janë dhënë kompetenca të mjaftueshme, dhe i cili është proaktiv dhe me burime të mjaftueshme, mund të ndihmojë shumë persona të trafikuar në marrjen e dëmshpërblimit. Megjithatë, Departamenti i Punës nuk detyrohet të ndjekë ankesa individuale, dhe ndonjëherë mekanizmat e tij zbatues kritikohen se janë të dobët.<sup>29</sup>

Hetimet proaktive nga inspektoriatet e punësimit me burime të shumta do të thotë që barra për ngritjen e padisë apo zbatimin e vendimeve të gjykatës ndaj punëdhënësit nuk bie mbi

---

<sup>27</sup> Po aty, paragrafët 303-304, f. 99.

<sup>28</sup> Për më shumë detaje shih faqen e Internet-it të Departamentit të Punës: <http://www.dol.gov/whd/>

<sup>29</sup> A.J.Cortes, "The H-2a Farmworker: The latest incarnation of the judicially handicapped and why the use of mediation to resolve employment disputes will improve their rights" (Punëtori bujqësor H-2a: mishërimi më i fundit i paaftësisë gjyqësore dhe pse ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të përmirësojë të drejtat e tyre), 21 Ohio St.J. on Disp. Resol. 409.



personin e trafikuar. Individu mund të njoftojë këto organe në mënyrë anonime për abuzimet që duhen hetuar, por pa qenë e nevojshme të përgjigjet vetë në avancimin e çështjes para gjykatës (ndonëse kjo nuk përfundon domosdoshmërisht në veprim nga ana e inspektoriatit). Rritja e burimeve dhe ndonjëherë e kompetencave të këtyre organeve administrative mund të rrisë mundësinë e personave të trafikuar për shfrytëzim në punë, për të përfituar dëmshpërblim.

Sipas disa organizatave, ekzistenca e agjencive të ndryshme që merren me aspekte të ndryshme të kushteve të punës dhe shfrytëzimit të mundshëm e ndërlikon situatën më shumë sesa duhet. Ato bëjnë thirrje për ngritjen e agjencive kombëtare për monitorimin e praktikave të punësimit dhe të kushteve të punës dhe për lidhjen e të gjitha agjencive që kryejnë detyra të ndryshme inspektimi siç është “Komisioni i Punësimit të Drejtë,” i kërkuar nga Zyra për Këshillimin e Qytetarëve në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo do të krijonte një sistem më të bashkërenduar për hetimin e ankesave dhe kryerjen e inspektimeve dhe do të synonte një qasje proaktive për zbatimin e ligjeve.<sup>30</sup>

Propozimet aktuale të Bashkimit Evropian<sup>31</sup> parashikojnë shtrirjen e masave administrative dhe penale ndaj punëdhënësve që punësojnë “shtetas të paligjshëm nga vende të tjera.” Sipas Direktivës së propozuar, punëdhënësit do të ishin të detyruar të paguajnë pagat e papaguara ndaj shtetasve të vendeve të treta të punësuar në mënyrë të paligjshme dhe vendet anëtare të BE-së do të ishin të detyruara të ngrenë mekanizma që të sigurojnë se këta shtetas të marrin pagat e prapambetura edhe në qoftë se janë larguar nga vendi anëtar (neni 7). Po sipas këtij neni, vendet anëtare duhet të ngrenë mekanizma që sigurojnë se procedurat për të kërkuar pagat e papaguara vihen në lëvizje automatikisht pa qenë nevoja që personi i interesuar të ngrejë padi.<sup>32</sup>

Parashikohet gjithashtu se “do të prezumohet një marrëdhënie pune me kohëzgjatje të paktën 6 muaj, përveç rasteve kur punëdhënësi provon të kundërtën” (neni 7 (2)) dhe mundësia e dhënies së lejes së qëndrimit të përkohshëm, siç ndodh aktualisht sipas

---

<sup>30</sup> Shih *Trafficking for Forced Labour in Europe* (Trafikimi për Punë të Detyruar në Evropë): raport rreth një studimi në Mbretërinë e Bashkuar, në Irlandë, Republikën Çeke dhe Portugali (Anti-Slavery International, shtator 2006), faqe 12.

<sup>31</sup> Propozim për Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që parashikon masa ndaj punëdhënësve të shtetasve nga vende të treta të cilët janë të paligjshëm, 16 maj 2007, mund të gjendet në: <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:52007PC0249:EN:NOT>.

<sup>32</sup> Duhet përmendur se një projektvendim i Këshillit të Ministrave të OSBE-së mbi trafikimin për shfrytëzim për punë (nëntor 2007) i është referuar këtij parimi të pagesës automatike të ndëshkimeve për personat e shfrytëzuar, në mënyrë që të hiqet nga individit barra e kërimit të pagesës. Megjithatë, referimi ndaj këtij parimi është hequr në projektet e mëvonshme të vendimit.

legjislacionit të BE-së për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore<sup>33</sup> që bashkëpunojnë me autoritetet në raste kur “kushtet e punësimit janë veçanërisht shfrytëzuese” (neni 14.3), dhe në raste të tilla kthimi i tyre duhet të shtyhet derisa ata të kenë marrë pagën që u takonte (neni 7(4)). Këtu përfshihet dhe një dispozitë interesante mbi zinxhirin nënkontraktues, duke ndërmarrë masa financiare përfshirë pagat e prapambetura ndaj kontraktorëve të tjerë në zinxhir (neni 9). Për të lehtësuar paraqitjen e ankesave, direktiva e propozuar parashikon gjithashtu mekanizma nëpërmjet të cilëve mund të paraqiten ankesa ndaj punëdhënësve drejtpërdrejt ose nëpërmjet palëve të treta. Ajo që është më me rëndësi këtu është parashikimi se:

“Vendet anëtare janë të detyruara që të mos marrin masa ndaj palëve të treta të përcaktuara që u sigurojnë ndihmë shtetasve të vendeve të treta për t’u ankimuar, me pretendim që ato palë lehtësojnë qëndrimin e paautorizuar (neni 14.2).”

Pavarësisht nga mbrojtja minimale për punëtorët emigrantë të vendeve të treta të përcaktuara në këtë propozim, ka pasur kritika se mund të jetë diskriminuese dhe vendos barrë shumë të rëndë mbi punëdhënësit, me qëllim që ndikimi i tij në përgjithësi do të jetë negativ për emigrantët.<sup>34</sup> Është propozuar që përgjigja më e përshtatshme ndaj punësimit të huajve të paligjshëm do të ishte thjeshtimi i procedurave për lëshimin e vizave për punë dhe mundësimi që ata të punojnë në mënyrë të ligjshme.<sup>35</sup>

### ***Komente përfundimtare mbi dëmshpërblimin nga trafikanti/shfrytëzuesi***

Mundësia e paraqitjes së padisë për dëmshpërblim ndaj trafikantit/shfrytëzuesit ka disa forma dhe mund të shpjerë në shpërblime të konsiderueshme që mbulojnë të paktën një pjesë të humbjeve që ka pësuar personi i trafikuar. Megjithatë, në të gjitha llojet e padive ndaj trafikantit, fakti që zakonisht kërkohet dëshmia nga personi i trafikuar kundër trafikantit para gjykatës shpesh krijon ndrojtje për paditësin. Ky fakt është vënë re në Rusi, në Shqipëri dhe në Moldavi. Gjithashtu, procedurat në përgjithësi janë të gjata dhe mund të kërkojnë të tilla prova që personi nuk është në gjendje t’i sigurojë.

---

<sup>33</sup> Direktiva e Këshillit të BE-së 2004/81/EC e datës 29 prill 2004 mbi lejet e qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta që janë viktimat e trafikimit ose që janë subject i veprimit për të lehtësuar emigracionin jo të ligjshëm ose që bashkëpunojnë me autoritetet kompetente.

<sup>34</sup> Sergio Carrera dhe Elspeth Guild, “An EU Framework on Sanctions against Employers of Irregular Immigrants: some reflections on the scope, features and added value” (“Kudri i BE-së mbi masat ndaj punëdhënësve të emigrantëve të parregullt: reflektime mbi shtrirjen, tiparet dhe vlerën e shtuar,” Dokument Politik (*Policy Brief*) Nr.140, (Qendra për Studime të Politikave Evropiane/Centre for European Policy Studies, gusht 2007).

<sup>35</sup> Po aty, faqe 6.

Që në fillim, personi i trafikuar mund të dyshojë më të drejtë për ekzistencën e aseteve të disponueshme për të paguar dëmshpërblimin, meqenëse trafikanti mund t'i ketë larguar ose fshehur ato, para procesit ose gjatë ecurisë së tij. Nga ana tjetër, është e mundur që trafikanti t'i ketë shpenzuar të gjithë fondet për shpenzimet ligjore për mbrojtjen kundër padisë civile ose penale, dhe nuk ka më pasuri, siç ndodh në SHBA. Ekziston dhe mundësia që trafikanti të mos ketë pasur kurrë pasuri të mjaftueshme (veçanërisht nëse ka pasur rol të vogël në rrjetin e trafikimit, p.sh. në rekrutim - shih rastet e Ukrainës, ose nëse është një biznes i vogël - shih profilin për SHBA-në.)

Personi i trafikuar mund të vendosë të ngrejë padi nëpërmjet secilit prej proceseve të lartpërmendura, por shpërblimi mund të jetë aq i ulët sa është poshtërues për të ose nuk reflekton humbjet, duke i lënë kështu një ndjenjë padrejtësie (shih për shembull shpërblimet shumë të ulët që jepen në proceset penale në Mbretërinë e Bashkuar, të cilat janë shumë më të ulët se tarifat për dhimbje dhe vuajtje që do të jepeshin në gjykatat civile ose nga skemat shtetërore). Në nivel ndërkombëtar, ka dallime shumë të mëdha në lidhje me përlogaritjen e dëmshpërblimit, masa e të cilit ndryshohet dhe në terma relativë. Sipas këtij studimi, masa e dëmshpërblimit në gjykatat penale e Mbretërisë së Bashkuar është veçanërisht e ulët në krahasim me ato në SHBA dhe Ukrainë.

Kur agjencitë shtetërore, siç janë inspektoriatet e punës, kanë burime të mjaftueshme, ato mund të zbulojnë raste shkeljesh të të drejtave dhe kanë mundësi të negociojnë marrëveshje pajtimi midis punëdhënësve dhe punonjësve apo t'u referojnë gjykatave provat ose rezultatet si dhe kërkesat e individëve ose grupeve, duke ulur kështu presionin mbi ta për ta paraqitur vetë padinë. Gjithashtu, kërkesat për dëmshpërblim që trajtohen nëpërmjet zgjidhjes së negociuar me ndërmjetësim ose nëpërmjet zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjes, kanë një mundësi më të madhe që të shlyhen nga shkelësi, meqenëse çështja zgjidhet vullnetarisht në një mjedis jashtëgjyqësor. Skema të tilla shmangin procedimet armiqësore të gjatë dhe të kushtueshëm, si dhe kanë përparësinë se mund të bihet dakord njëherësh për disa persona të trafikuar nëpërmjet veprimeve kolektive, p.sh., një grup të punësuarish në vend që secili të ngrejë padi individuale. Sindikatat, OJF-të, avokatët dhe agjencitë e ndërmjetësimit (si ACAS<sup>36</sup> apo Zyra për Këshillimin e Qytetarëve në Mbretërinë e Bashkuar) kanë luajtur të gjitha një rol domethënës në negociimin e marrëveshjeve të tilla.

Personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar kanë ende nevojë për ndihmë në ndjekjen e kërkesave, por vlen të zhvillohen këta mekanizma edhe në vende që nuk i kanë krijuar ende ata. Zakonisht ekzistojnë në kuadrin e së drejtës civile dhe në atë të punës, me qëllim

---

<sup>36</sup> <http://www.acas.org.uk> .

parandalimin e çështjeve gjyqësore të tejzgjatura dhe të kushtueshme. Megjithatë, nëse përdoren më shpesh, ata mund të rezultojnë më tërheqëse si mekanizma të drejtësisë, duke pasur parasysh kufizimet e procesit gjyqësor të plotë.<sup>37</sup>

Kështu, megjithëse mund të jetë teknikisht e mundur që të gjendet trafikanti dhe të sigurohet urdhri që ai t'i paguajë viktimës shpërblimin e dëmit, konstatimi i këtij studimi është se përqendrimi vetëm në ngritjen e padisë ndaj keqbërësit nga personi i trafikuar si burim kryesor i dëmshpërblimit, ndikon negativisht në numrin e individëve që kërkojnë ose marrin dëmshpërblim nëpërmjet proceseve gjyqësore.

### **3.1.2 Dëmshpërblimi nga shteti**

Dëmshpërblimi mund të *paguhet dhe nga shteti* nëpërmjet skemave të administruara dhe financuara nga shteti.

Këto skema janë krijuar në disa vende, zakonisht për viktimat e krimeve të dhunshme, si në Francë, Rumani dhe në Mbretërinë e Bashkuar; dhe siç është propozuar në Ukrainë. Skemat e financuara ose të subvencionuara nga shteti kanë përparësinë që i sigurojnë viktimës pagesë të garantuar të dëmshpërblimit. Shpesh këtu përfshihet dhe mundësia e pagesës së menjëhershme ose të ndërmjetme. Disa skema mundësojnë në mënyrë të shprehur që shtetit i kalon (nga viktimat) e drejta për të paditur të pandehurin për dëmet e shkaktuara viktimës, siç është rasti në Francë dhe Ukrainë. Kjo ruan elementin “moral” dhe ndëshkues të skemës së kompensimit. Një përparësi tjetër e skemave të tilla është se nuk ka nevojë që të identifikohet ose të përcaktohet vendndodhja specifike e keqbërësit. Zakonisht mjafton raporti i policisë së bashku me gatishmërinë për të ndihmuar policinë gjatë hetimit.

Skemat shtetërore mund të jenë relativisht të thjeshta, joburokratike dhe më të shpejta sesa procesi civil. Për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë, ka agjenci që ndihmojnë viktimat në plotësimin e kërkesave dhe procedurat janë pa ndërlikime të panevojshme, të lehta për t'u përdorur. Megjithatë, shpesh përmbajnë kritere kufizuese për pranimin, të bazuar në kombësinë ose statusin e viktimës, të cilat mund të mos plotësohen nga një person i trafikuar (shih Rumaninë, ku kërkesa e kombësisë ua jep këtë të drejtë vetëm rumunëve, atyre që qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin rumun si dhe

---

<sup>37</sup> Duhet përmendur gjithashtu se përfundimi i marrëveshjeve kolektive në lidhje me kushtet e punës dhe ato të punësimit, midis përfaqësuesve të punëtorëve dhe punëdhënësve në ato sektorë të prekur nga shfrytëzimi, mund të sigurojë një mënyrë alternative për mbrojtjen e personave të trafikuar ose të shfrytëzuar. Ky studim nuk ka shqyrtuar rolin e marrëveshjeve kolektive, por gjithsesi ato duhen marrë parasysh. Për informacion të mëtejshëm mbi standardet ndërkombëtare të punës në lidhje me negociatat kolektive dhe marrëveshjet kolektive, shih <http://www.ilo.org>.

shtetasve të atyre vendeve me të cilat Rumania është e lidhur me anë të konventave). Ato mund të jenë gjithashtu të disponueshme vetëm për viktimat e disa kategorive krimesh, si vepra penale të përcaktuara ose krime të dhunshme (në Mbretërinë e Bashkuar dhe në Francë). Këto kritere mund të paraqesin pengesa të paarsyeshme në paraqitjen e kërkesave nga personat e trafikuar.

Pavarësisht nga pësimi i traumës, shfrytëzimit dhe dëmit ekonomik, viktimat mund të mos ketë pësuar dhunë gjatë historisë së trafikimit, gjë që nuk do t'i jepte të drejtë të përfitonte nga shumica e skemave shtetërore të dëmshpërblimit për viktimat e krimit. Zgjerimi i mundësisë për të përfituar nga skema të tilla, duke u bazuar në klasifikimin e përvojës së viktimës si i trafikuar dhe jo në provat e dhunës, duhet të bërë të mundur automatikisht që viktimat legjitimohet të paraqesë padinë. (Për më tej shih trajtimin në Shtojcën III). Kështu vepron në Francë, ndonëse në praktikë është identifikuar dhe hetuar vetëm një rast trafikimi. Natyra e përvojës së trafikimit të personit dhe humbjet e pësuar do të përcaktonin pastaj masën e dëmit.

Së fundi, ka shumë mundësi, se shpërblimi që jepet nga shteti nuk do të mbulojë të gjitha dëmet që mund të jepen në padinë civile, p.sh., mund të mos paguhet dëmi moral, siç ndodh në Ukrainë dhe Rumani. Shuma e disponueshme mund të jetë e kufizuar sipas një tarife të përcaktuar, si në rastin e Mbretërisë së Bashkuar, duke i lënë kështu viktimës zgjedhjen të pranojë një shpërblim të ulët ose të padisë të pandehurin në gjykatë civile për pjesën tjetër të dëmeve.

Në disa vende janë krijuar skema të posaçme ose fonde për viktimat të llojeve të caktuara krimesh. Kjo ka ndodhur kryesisht për viktimat e veprimeve terroriste. (Shih *Fonds de Garantie* (Fondi i Garancisë) në Francë<sup>38</sup> ose Programin e Rimbursimit të Viktimave të Terrorizmit Ndërkombëtar dhe Fondin e Dëmshpërblimit të Viktimave të 11 shtatorit<sup>39</sup> në SHBA). Motivimi i tyre është që të sigurohet se vdekja dhe plagosjet e rënda kompensohen kur nuk ka shpresa reale për padi civile.

---

<sup>38</sup> Ligji i 9 shtator 1986.

<sup>39</sup> "Fondi i 11 shtatorit u miratua ...me qëllimin e shprehur për të siguruar dëmshpërblim dhe një alternativë për kthimin e dëmit jashtëkontraktor individëve dhe familjeve të tyre që u vranë apo u plagosën si rezultat i sulmeve, pa nevojë që të provohet faji. Në shkëmbim të heqjes dorë nga e drejta për të paditur, familjaret e atyre që humbën jetën ose u lënduan gjatë sulmeve, iu premtua zgjidhje e shpejtë, jo e kushtueshme dhe e parashikueshme. Viktimat do të merrnin dëmshpërblim të plotë. Shpërblimi do të financohej nga Thesari i shtetit amerikan, pa i kufizuar buxheti i përgjithshëm të programit. Kështu, Fondi i 11 shtatorit ishte një shpenzim i fondeve publike i pashembullt për dëmshpërblimin e viktimave të veprave penale." 79 *Tulane Law Review*, 167, 197 (nëntor 2004).

Disa avokatë të personave të trafikuar mund të mendojnë se një skemë e tillë e posaçme është e përshtatshme për rastet e trafikimit, veçanërisht kur duket se janë shumë pengesa dhe shumë vështirësi praktike dhe ligjore për të përfituar dëmshpërblim. Megjithatë, standardet ligjore ndërkombëtare të negociuara nga shtetet nuk e njohin të drejtën e përfitimit nga skema shtetërore për të gjithë personat e trafikuar, ndërsa standardet për terrorizmin janë më të forta.<sup>40</sup> Gjithashtu, nuk del në pah menjëherë justifikimi moral për të veçuar personat e trafikuar dhe jo viktimat e krimeve të tjera të rënda dhe poshtëruese.

Sipas një qasjeje tjetër, ndonëse këto mekanizma me fonde shtetërore janë krijuar kryesisht për të dëmshpërblyer viktimat e krimeve të dhunshme, mund të krijohen dhe sisteme të tjera të ngjashme për viktimat e formave të tjera të shkeljeve (p.sh., për ata që kanë pësuar dëme sipas së drejtës civile apo të punës, ose për punëtorët emigrantë të paligjshëm të cilët nuk kanë asnjë mundësi tjetër për të ngritur padi). Mundësimi i ngritjes së padisë mbi baza të ndryshme nga ajo e “viktims së krimit” do të parandalonte nevojën e raportimit përpara organeve të policisë, gjë që, për arsye të ndryshme, shumë viktima nuk duan të bëjnë. Kjo, gjithashtu, do të thotë se ato viktima që nuk janë të ndërgjegjshme se janë viktima krimi, por kuptojnë se ndaj tyre është kryer një padrejtësi (p.sh., nuk kanë marrë pagën) mund t'i drejtohen një forumi. Meqenëse në përgjithësi skemat shtetërore kanë më pak kërkesa procedurale, ato përdorën më lehtë nga të gjitha viktimat, veçanërisht viktimat e trafikimit, si dhe kanë përparësinë tjetër që pagesa garantohet. Cilido lloj mekanizmi i financuar nga shteti, i cili fokusohet në viktimat e trafikimit, do të kërkonte procedura identifikimi eficiente dhe të drejta, në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe një mekanizëm të pranueshëm për llogaritjen e dëmit (për më shumë rreth dëmeve shih 3.3).

Skemat shtetërore janë gjithashtu të kushtueshme, si në lidhje me kostot administrative dhe me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit (për një pasqyrim të përgjithshëm i buxhetit, shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar). Qeveritë mund të parapëlqejnë të investojnë në veprimtari të tjera që synojnë forcimin e shtetit të së drejtës apo ndihmën e përgjithshme ndaj viktimave të trafikimit. Për sa u përket detyrimeve ligjore ndërkombëtare, gjendja është e ndryshme në secilin shtet dhe përparësitë për reforma nuk do të jenë të njëjta. Megjithatë, propozuesit e dëmshpërblimit për personat e trafikuar duhet pa tjetër të kenë parasysh çështjet buxhetore të këtyre skemave, kur vendosin se cilat skema ose reforma do të përkrahin.

---

<sup>40</sup> Shih. p.sh.. nenin 13 të Konventës Evropiane mbi Parandalimin e Terrorizmit. Konventa u miratua më 16 maj 2005 dhe hyri në fuqi më 1 qershor 2007.

### **3.2 FAKTORË SPECIFIKË PËR T'U PASUR PARASYSH NË RASTET E TRAFIKIMIT**

Një person i trafikuar mund të pengohet nga një sërë faktorësh në kërkimin e dëmshpërblimit.

Që të përfitojnë nga cilado formë dëmshpërblimi, personat e trafikuar duhet të njohin të drejtat e tyre dhe të jenë në gjendje t'i kërkojnë ato. Ata mund të hasin vështirësi që nuk ndeshen nga të tjerë që kanë qenë viktime krimi apo kanë pësuar humbje ose dëm. Meqenëse shumica e personave të trafikuar janë të huaj në vendin ku do të kërkohet dëmshpërblimi, ka pak të ngjarë që t'i njohin të drejtat e tyre dhe asnjëherë nuk do të kenë liri të mjaftueshme për t'i mësuar ato. Vështirësitë rriten kur ata përpiqen të denoncojnë trafikantin apo të ngrenë padinë. Në të njëjtën kohë, ata që janë në gjendje për t'i ndihmuar personat e trafikuar dhe të shfrytëzuar nuk janë gjithmonë të mirinformuar mbi të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Kjo do të thotë se informacioni mbi mënyrën e përfitimit nga drejtësia dhe mekanizmat e duhur për ta bërë këtë, duhet të jenë të disponueshëm në mënyra që janë të përshatshëm për personat e trafikuar, veçanërisht për ata nga vende të tjera. Puna ndërgjegjësuese e OJF-ve, sindikatave apo komuniteteve të emigrantëve mund të jetë veçanërisht e dobishme në këtë drejtim. Gjatë studimit janë konstatuar shumë pak evidencime të aktiviteteve shtetërore për të rritur ndërgjegjësimin rreth së drejtës për dëmshpërblim, mekanizmave të dëmshpërblimit apo mekanizmave të tjerë të drejtësisë si të drejtat e punës apo gjykatat e punës.

Gjithashtu, duke pasur parasysh shkallën e traumës që shpesh pëson personi i trafikuar, paditë për dëmshpërblim pengohen kur viktimat dyshojnë për sigurinë fizike, kanë frikë dëbimin ose u mungon mbështetja mjekësore, psikologjike si dhe strehimi.<sup>41</sup>

“Frika është ndoshta një nga pengesat më të mëdha....punëtorët pa dokumente shpesh kanë frikë t'u drejtohen mekanizmave qeveritar për të dorëzuar një ankesë, nga frika se mund të zbulohet statusi i tyre i parregullt dhe mund të deportohen. Gjithashtu, ata mund të kenë frikë se, nëse flasin kundër punëdhënësit abuzues, mund të vijnë pasoja negative për anëtarët e familjes dhe/ose miqtë që punojnë për të njëjtin punëdhënës.”<sup>42</sup>

---

<sup>41</sup> Shih v. cit., shënimi 26, par. 5, pika e fundit në listë. Shih gjithashtu “*Trafficking for labour and sexual exploitation in Germany*” (“Trafikimi për punë dhe shfrytëzimi seksual në Gjermani”) (ILO, 2005), faqet 17-47.

<sup>42</sup> V. cit., shënim 18, PICUM, Dhjetë mënyra, faqe 74.

Personi i trafikuar mund të mos ketë dëshirë ose vullnet të nisë një proces ligjor që i kërkon të theksojë dhe të provojë dëmin fizik dhe psikologjik të kaluar, të tanishëm ose të ardhshëm, ndërkohë që po përpiqet të rehabilitojë jetën e vet. Çdo provë e dëmit të pësuar do të rrisë masën e dëmshpërblimit, por ka efektin e theksimit të traumës, gjë që mund të ketë efekt demoralizues.<sup>43</sup>

Në të gjitha vendet e shqyrtuara për efekt të këtij studimi, ekzistojnë shërbime mbështetëse, të ofruara kryesisht nga OJF-të. Megjithatë, ndikimi i tyre është i kufizuar për shkak të përmasave të ulëta të tyre; ato përqendrohen pothuajse në mënyrë ekskluziv në viktimat e shfrytëzimit seksual (shih, p.sh., në Mbretërinë e Bashkuar, ku e vetmja qendër posaçërisht për personat e trafikuar strehon vetëm viktimat të shfrytëzimit seksual), ato vuajnë nga mungesa fondesh ose varen nga donatorë ndërkombëtarë, ose mungon një njohje zyrtare nga shteti ose marrëveshje bashkëpunimi me shtetin. Në Moldavi dhe në Rusi, këta faktorë kanë pasur ndikim negativ në punën e OJF-ve që këshillojnë dhe përfaqësojnë personat e trafikuar.

Aktualisht ka gjasë që viktimat do t'i njohin të drejtat e tyre vetëm nëse lidhen me agjenci këshillimi, OJF, sindikata, shërbime sociale, punonjës të shërbimit shëndetësor, ose punonjës të tjerë shtetërorë, p.sh., punonjës të policisë, inspektoriatit të punës apo të emigracionit. Madje dhe në këtë rast, ato jo domosdoshmërisht do të informohen mbi të drejtat e tyre në mënyrë të kuptueshme, kjo ose për shkak të pengesave gjuhësore apo kulturore ose për shkak se përfaqësuesit e sipërpërmendur mund të jenë të keqinformuar.

Këto probleme janë shfaqur në Rusi dhe në Moldavi, ku gjuha e përdorur nga policia për t'u shpjeguar viktimave të drejtat e tyre është shumë e ndërlikuar dhe informacioni jepet shumë shpejt, pa kohë të mjaftueshme. Gjithashtu, në një takim të OSBE-së kohët e fundit me organizata të shoqërisë civile që merren me çështje të shfrytëzimit për punë, u raportua se shumë prej tyre që janë të përfshirë në identifikimin dhe ndihmën ndaj personave të shfrytëzuar nuk janë në dijeni të të drejtave të këtyre personave dhe është e nevojshme që të punohet më shumë për të ndërgjegjësuar këta aktorë "të vijës së parë."<sup>44</sup> Ky studim gjithashtu tregon se shpjegimi i të drejtave duhet bërë në një format të lehtë për t'u kuptuar (për shembull, fletëpalosje në një gjuhë që viktimat e njohin, ose nëpërmjet përkthimit) dhe pa i vënë detyrimin për të marrë një vendim të shpejtë. Këto masa të thjeshta bëjnë të

---

<sup>43</sup> Julie Barton e *Poppy Project*, Mbretëri të Bashkuar, në seminarin e Programit Antitrafikim të ODIHR-it mbi dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të shfrytëzuar (*Workshop on Compensating Trafficked and Exploited Persons*), Barcelonë, 10-12 dhjetor 2007.

<sup>44</sup> Shih "Report on Civil Society Meeting" (Raport mbi takimin me shoqërinë civile), Varshavë 24 prill 2007: Metoda e MKR-së për trafikimin për punë dhe zbatimin e saj për trafikimin për shfrytëzimin e punës (OSBE/ODIHR 2007).



mundur që personat e trafikuar të marrin vendimin e informuar për të drejtat e tyre, me ndikim të ndjeshëm në gatishmërinë tyre për të ngritur padinë.

Gjithashtu, kur viktimat vihet në lidhje me shërbimet e këshillimit dhe zyrtarët shtetërorë, është e rëndësishme që zyrtarët shtetërorë të jenë të detyruar me ligj për t'i dhënë informacion viktimës rreth mundësive për dëmshpërblim. Kjo nuk ndodh në Shqipëri, ku me sa dihet nuk janë bërë padi për dëmshpërblim brenda proceseve penale të trafikimit.

Probleme janë hasur dhe në Mbretërinë e Bashkuar, ku viktimat janë kthyer në vendin e origjinës dhe përpjekjet për të mbledhur prova për padinë e tyre vështirësohen nga pengesat gjuhësore dhe burokratike. Është jashtëzakonisht e vështirë që paditë për dëmshpërblim të ndiqen nga jashtë vendit, kështu që do të ishte shumë mirë që në të gjitha vendet e destinacionit të kenë shërbime dhe sisteme që mundësojnë përdorimin e mjeteve për të kërkuar drejtësinë. Kur viktimat nuk ka zgjedhje tjetër përveçse të kthehet në vendin e origjinës ose dëshiron të kthehet pa vonesë, duhet siguruar përfaqësimi ligjor në mënyrë që personi të jetë i përfaqësuar në mungesë.

Sistemet ligjore dhe të drejtat zakonisht janë aq të ndërlikuara, sa është i nevojshëm këshillimi dhe përfaqësimi i viktimës nga një avokat. Ky studim tregon se ndonëse ndihma ligjore falas është thelbësore që të përmirësohet mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, ajo ofrohet rrallherë. Ndihma ligjore për viktimat e trafikimit ofrohet në disa raste në çështje penale, siç ndodh në SHBA, ose ekziston këshillimi mbi të drejtat e punës por jo përfaqësimi, siç ndodh në Mbretërinë e Bashkuar. Megjithatë, asnjë shtet nuk u garanton shërbimin gjithëpërfshirës viktimave. Ky fakt thekson rëndësinë e sigurimit të ndihmës ligjore falas, e cila ka aftësi të këshillojë viktimën për të gjitha aspektet e dëmshpërblimit dhe çështjet e lidhura me të. Nga ana tjetër, kjo tregon se mekanizmat e dëmshpërblimit duhet të jenë më pak të ndërlikuar dhe më të lehtë për t'u përdorur, dhe/ose duhen hartuar sisteme alternative më të thjeshtë ose në të cilat viktimat nuk ka nevojë të jetë aktori kryesor në ngritjen dhe ndjekjen e padisë.

Për sigurimin e dëmshpërblimit, vështirësi të tjera lindin nga fakti se numri i çështjeve të trafikimit të hetuara është shumë i vogël në krahasim me numrin e viktimave (shih shënim 17). Dhe në rastet kur kryhet hetimi penal, vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore, edhe pse e parashikuar në legjislacion, mund të mos jetë vepër penale që hetohet në atë rast të veçantë. Në Francë, është vepra penale e trafikimit ajo që aktivizon të drejtën e dëmshpërblimit nga shteti, por, në të shumtën e rasteve, kjo vepër nuk ndiqet në çështjen penale, por zëvendësohet nga një tjetër që është e afërt.

Pengesa të tjera në kërkimin e dëmshpërblimit përfshijnë turpin për të pranuar përfshirjen në aktivitete seksuale me pagesë apo shfrytëzimin për punë. Personat mund të mos dëshirojnë ta pranojnë situatën para familjes apo miqve. Disa të tjerë mund të kenë frikë t'u drejtohen autoriteteve apo agjencive ndihmëse, nga frika e hakmarrjes në vendin e origjinës ndaj familjareve.<sup>45</sup> Në Rusi janë raportuar raste të personave të trafikuar që kërkojnë plotësimin e nevojave të tyre të menjëhershme për siguri, qëndrueshmëri, strehim, punë dhe status të qëndrueshëm të emigrantit dhe atyre u duhet kohë që të fillojnë të mendojnë për drejtësinë në formën e kërkesës për dëmshpërblim.

Është domethënëse dhe fakti që “viktimë trafikimi” mund të jetë një etiketim, të cilin një person i trafikuar apo i shfrytëzuar nuk e pranon për veten. Persona të tillë mund të mos duan t'u drejtohen organeve të drejtësisë për sanksione penale ndaj punëdhënësit/shfrytëzuesit, por mund të jenë të prirur të kërkojnë drejtësi, p.sh., për abuzim në vendin e punës.<sup>46</sup> Ata mund të kenë të drejtë të ngrenë padi për dëm, nëpërmjet veprimeve sipas kodit të punës, p.sh., për mospagim të pagës ose nëse kanë punuar në kushte të pasigurta ose kushte diskriminimi. Kjo metodë mund të jetë e përdorshme dhe për ata punëtorë, situata e të cilëve nuk plotëson përkufizimin ligjor të trafikimit, ose për ata që klasifikohen si viktima krimi, por dëshirojnë të ngrenë padi për shkelje të të drejtave të punës përveç procesit penal. Në Mbretërinë e Bashkuar, përveç procesit penal, padia kundër punëdhënësit mund të ndiqet në gjykata të veçanta të punës (“*employment tribunals*”).

Një problem tjetër i lidhur me ato është identifikimi i saktë i personit të trafikuar. Në disa vende, njohja zyrtare si viktimë trafikimi sjell një sërë të drejtash të tjera, të cilat përndryshe mund të mos njiheshin, si lejet e qëndrimit dhe përfitimi nga ndihma ligjore, si në rastin e SHBA-së, apo mundësia e përfitimit të dëmshpërblimit nga shteti, si në Francë. Kështu, një sistem identifikimi i drejtë dhe efektiv është një kusht plotësues thelbësor për shumë mekanizma dëmshpërblimi. Këto sisteme aktualisht nuk janë efikase në shumicën e vendeve të studiuara këtu, ndonëse në SHBA funksionimi i avokatëve profesionistë për viktimat në zyrat e policisë dhe prokurorisë ka ndihmuar shumë situatën. Këta zyrtarë ndihmojnë organet e policisë dhe të prokurorisë të intervistojnë viktimat e mundshme, duke përcaktuar besueshmërinë e viktimave, ndihmojnë viktimat që të përfitojnë shërbime dhe u sigurojnë informacion viktimave dhe dëshmitarëve të tjerë në lidhje me zhvillimin e çështjeve. Një

---

<sup>45</sup> Shih rastet e trafikimit për punë të detyruar në industrinë e seksit në “*Trafficking for labour and sexual exploitation in Germany*” (“Trafikimi për punë dhe shfrytëzim seksual në Gjermani”) (ILO, 2005), faqet 17-21.

<sup>46</sup> Shih v. cit., shënimin 44 “Raport mbi takimin e shoqërisë civile,” sipas të cilit shumë persona të shfrytëzuar deri në masën e madhe nuk e konsiderojnë veten “viktimë.”

skemë e tillë mund të zbatohet dhe në vende të tjera dhe në pjesë të tjera të sistemit ligjor dhe rregullator, si, p.sh., në inspektoriatet e punës.

### **3.3 LLOJET E HUMBJES DHË TË DËMIT**

Dëmshpërblimi i paguhet vetëm dikujt që ka pësuar humbje ose dëmtim. Përgjithësisht këto humbje dhe dëme duhen provuar nëpërmjet paraqitjes së provave. Jo gjithmonë përfshihen llojet specifike të humbjes dhe dëmit të pësuar nga personi i trafikuar në kategoritë e dëmit të parashikuara nga skemat ekzistuese të dëmshpërblimit.

Padia për dëmshpërblim e ngritur nga personi i trafikuar zakonisht përmban disa elementë, të cilët ndahen në kategoritë e gjëra të dëmit “moral” (jofinanciar) dhe “material” (financiar) (shih pjesën 1.3, Fjalor). Për shembull, viktimat mund të ngrejë padinë për dhimbje dhe vuajtje për shkak të dhunës fizike ose psikologjike (dëmin moral), si dhe shpenzime mjekësore të veçanta (dëme materiale). Megjithatë, ka mundësi që mekanizmi i dëmshpërblimit të rimbursojë vetëm elementin e dëmit material ose të urdhërojë një pagesë vetëm simbolike për dëmin moral.

Për të kryer vlerësimin e dhënies së dëmshpërblimit viktimës, duhet të merren parasysh një sërë faktorësh: natyra dhe masa e humbjes, dëmeve apo plagosjes; nëse këto lloj humbjesh do të paguhen nga mekanizmi ekzistues i dëmshpërblimit; nëse ka masë maksimale ose minimale të dëmshpërblimit; nëse viktimat mund të përlligjë humbjen me anë të provave si dhe forca bindëse të provave. Këta faktorë ndikojnë në mundësinë e viktimës për të ngritur padi, natyrën e padisë dhe masën e shpërblimit.

Disa skema dëmshpërblimi e kanë të përcaktuar që kompensohet vetëm “dëmi material” ose kufizojnë humbjet e rimbursueshme në disa lloje të përcaktuara të “dëmeve materiale.” Për shembull, në Shqipëri, nuk lejohet ngritja e padisë për dëm moral në procedimin civil brenda procesit penal. Në SHBA dhe në Mbretërinë e Bashkuar, skemat e dëmshpërblimit të subvencionuara nga shteti rimbursojnë vetëm disa lloje të përcaktuara të dëmeve materiale dhe jo të gjitha dëmet materiale (për listat e plota, shih profilet e vendeve, p.sh., në Rumani pagesa e dëmshpërblimit nga skema shtetërore mbulon shpenzimet e shtrimit në spital, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e varrimit, dëme ndaj disa lloj sendesh që kanë një vlerë tregu, humbjen e të ardhurave dhe mirëmbajtjen e personave në ngarkim).

Viktimat e trafikimit mund të pësojnë humbje të tjera që nuk përfshihen në kategoritë e parashikuara nga mekanizmat ekzistues të dëmshpërblimit. Këto mund të jenë, p.sh., pagë e

papaguar, “tarifat” që u janë paguar agjencive rekrutimi, “gjobat” e vendosura nga trafikantët për sjellje të keqe, “zbritjet” nga paga që janë të tepërta, mashtruese ose të paligjshme për qiranë, shpenzimet e përditshme, transportin dhe “pagesat” e tatimeve apo të sigurimeve shoqërore. Kategori të tilla të dëmeve materiale të cilat rezultojnë nga shfrytëzimi nuk rimbursohen gjithmonë nga skemat e dëmshpërblimit, që kanë vendosur kufizime të rrepta mbi dëmet materiale që do të paguajnë. Këto kufizime rrjedhin nga qëllimi fillestar i këtyre skemave, i cili ishte dëmshpërblimi i dëmeve nga krimet e dhunës, dhe nuk janë ndryshuar që të trajtojnë dhe faktet e ndërlikuara që mund të paraqesë një rast trafikimi.

Shpërblimi i dëmit material zakonisht pasqyron humbjen e pretenduar të pësuar në fakt, por normalisht masa e dëmit duhet provuar me anë të dëshmimeve, faturave ose dokumentacionit tjetër. Personat e trafikuar në shumicën dërrmuese të rasteve do të kenë vështirësi të provojnë dëmin e tyre material, veçanërisht nëse dëmi ka lindur përgjatë kohës së trafikimit.<sup>47</sup> Për këtë arsye, është e rëndësishme që skemat e dëmshpërblimit të pranojnë deklaratat me shkrim ose me gojë të viktimës si provë të mjaftueshme për të provuar padinë (shih për shembull Ukrainën, ku kërkohen prova të dokumentuara me shkrim, dhe krahaso SHBA-në, ku dëshmia me gojë mjafton). Për shkak të kësaj nevojë madhore për të siguruar prova, ka një OJF e cila këshillon ata që merren me këshillin e emigrantëve pa dokumente, që t’i ndihmojnë me gjetjen e mënyrave origjinale për sigurimin e këtyre provave nëpërmjet fotografive dhe përshkrimeve të vendit të punës, gjetjes së dëshmitarëve, dhe sigurimit të uniformave dhe pajisjeve të tjera me të cilat është pajisur punëtori.<sup>48</sup>

“Dëmi moral” përcaktohet dhe llogaritet në mënyra të ndryshme në sisteme të ndryshme ligjore. Për shembull, dëmet e tilla llogariten në bazë të udhëzimeve që u jepen gjyqtarëve nga ligjvënësit në Mbretërinë e Bashkuar, nëpërmjet ‘precedente’ (vendime gjyqësore të mëparshme) (Mbretëri e Bashkuar dhe SHBA), pa u dhënë udhëzime apo pa pasur përputhshmëri midis tyre (shih Moldavinë dhe Ukrainën). Në Rumani dhe në vende të tjera në tranzicion nga komunizmi, ky koncept është ende mjaft i pazhvilluar dhe vetëm së fundi është rifutur në kodet civile. Ashtu si dhe me dëmin material, kategoritë e posaçme të dëmit moral dhe natyra e provave që kërkohen për t’i provuar ato, ndryshojnë sipas vendeve dhe skemave të kompensimit. Pothuajse gjithmonë “dhimbja dhe vuajtja” të shkaktuara nga dëmi fizik apo psikologjik duhen provuar me anë të një raporti mjekësor ose psikiatrik, të cilin viktimi është e detyruar ta sigurojë vetë ose me anë të ndihmës ligjore apo nëpërmjet

---

<sup>47</sup> V. cit., shënimi 18, PICUM, Dhjetë Mënyra, f. 74-75.

<sup>48</sup> Po aty, f. 90.

një OJF-je.<sup>49</sup> Në disa raste, llojeve të dëmit moral u vihen emra ose përkufizime që kanë nënkuptime të cilat personat e trafikuar mund të kërkonin t'i shmangin, p.sh., “humbja e emrit të mirë” apo cënimi i “nderit,” veçanërisht kur ata përpiqen të ruajnë ose të rindërtojnë jetën e tyre me dinjitet.<sup>50</sup>

Ka më tepër të ngjarë që personat e trafikuar, veçanërisht ata të shfrytëzuar seksualisht, të ngrenë padi për dëm moral dhe jo material, veçanërisht në Evropën Lindore dhe Qendrore. Kjo për shkak se një padi për mosdhënie të pagesës për ofrimin e shërbimeve seksuale nuk do të pranohet nga gjykata, kur vetë aktiviteti konsiderohet i paligjshëm ose pamoralshëm. Gjithsesi, mund të mbështetet më mirë me anë të provave një padi për dëm moral gjatë shfrytëzimit seksual, megjithëse në Ukrainë gratë e trafikuar që kanë hyrë me dijeni në industrinë e seksit kanë marrë një shpërblim më të ulët për dëmin, pavarësisht se sa i rëndë ishte shfrytëzimi i pësuar. Kjo do të thotë se nëse dëmi moral nuk mbështetet nga një mekanizëm i caktuar dëmshpërblimi dhe/ose nëse koncepti nuk është i mirëzhvilluar, nuk njihet apo nuk trajtohet në mënyrë konsekuente, atëherë ka mundësi që padia të mos pranohet ose të pushohet (kjo ndodh në Shqipëri, Moldavi, Ukrainë dhe Rumani).

Në disa vende, bashkë me dëmin moral dhe material mund të kërkohet nga viktimat e trafikuar dhe kthimi i dëmeve ‘shtesa,’ që njihen si të rënduara (*aggravated*), të dhëna si shembull me qëllim që të mos përsëritet vepra (*exemplary*), ose dëmet për ndëshkim në tejkalim të dëmeve të pësuar në fakt (*punitive*) (p.sh., në Mbretërinë e Bashkuar dhe në SHBA, masës së shpërblimit ose një pjese të tij i shtohet një shumëfishues) ose nën një shkak tjetër të veçantë për ngritjen e padisë (p.sh., “dëme të trefishuara” të urdhëruara sipas ligjit amerikan “Akti kundër organizatave kriminale dhe të korrupsionit” (“*Racketeer Influenced and Corrupt Organizations Act (RICO)*” në SHBA). Zakonisht shërbejnë për ndëshkimin e keqbërësit për sjellje veçanërisht të rëndë dhe mund të lidhen me pasuritë që zotëron i pandehuri. Kështu, shërbejnë si masë e cila dekurajon përsëritje të veprës. Këto koncepte janë të panjohura në sisteme të tjera ligjore, por mund të merren në konsideratë nëse lloji i veprimit që dëmshpërblehet meriton një përgjigje veçanërisht ndëshkuese në kuadrin e politikës publike.

Në vendet e studiuara këtu, mbetet ende për t’u eksploruar dëmshpërblimi i të ardhurave të fituara padrejtësisht apo i përfitimeve të fituara nga trafikanti ose shfrytëzuesi, ndonëse

---

<sup>49</sup> OSBE/ODIHR aktualisht mbështet zhvillimin e një mekanizmi në Rumani nëpërmjet OJF-së *Alternative Sociali* për vlerësimin e traumës psikologjike të trafikimit mbi viktimat, i cili do të përdorte për vlerësimin e dëmit moral në paditë për dëmshpërblim.

<sup>50</sup> Kontribut i Natalia Ieseanu, Komiteti i të drejtave civile të prostitutave në Itali (TAMPEP), Seminarin në Barcelonë i ODIHR-it për Dëmshpërblim, dhjetor 2007, shih shënimin 43.

është shqyrtuar në SHBA. Për shembull, në SHBA, sipas dispozitave mbi kthimin e detyrueshëm të dëmit të parashikuara në ligjin për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, shpërblim penal për pagat e humbura llogaritet si më i madhi i këtyre dy shifrave: “të ardhurat neto ose vlera për të pandehurin e shërbimeve apo të punës së viktimës, ose vlera e punës së garantuar të viktimës,” në mënyrë që këto dy teori dëmshpërblimi për pagat e humbura përfshijnë një pasqyrim të vlerës së punës së viktimës për të pandehurin.

Në ngritjen e padisë, viktimat e trafikimit ka nevojë për këshillim për përzgjedhjen e të gjitha llojeve të humbjeve që ka pësuar ajo si dhe mënyrat për të siguruar prova për këto humbje. Skemat e dëmshpërblimit mund të mos e kthejnë të gjithë shumën, sepse ato mund të kenë kufizime për llojet e dëmeve që shpërblehen dhe për mënyrën e përlllogaritjes së tyre. Disa skema mund të kryejnë vetëm shpërblime simbolike të cilat nuk pasqyrojnë humbjet faktike, ndërsa skema të tjera mund të japin vetëm shuma fikse për disa lloje veprash penale (shih Mbretërinë e Bashkuar). Skema shtetërore mund të jetë më efikase kur masa e dëmshpërblimit përcaktohet nga tarifat e caktuara, ndonëse viktimat nuk mendon se në këtë mënyrë pasqyrohen drejt humbjet e pësuar.

#### **3.4 EKZEKUTIMI I VENDIMIT DHE SEKUESTRIMI I PASURISË**

Kur lëshohet urdhri që dëmshpërblimi të kryhet nga autori i veprës penale, shpesh duhen marrë masa për të siguruar që do të kryhet pagesa. Në rastet kur padia ngrihet kundër një pale të siguar, për shembull kundër punëdhënësit apo një të pandehuri “me xhepat plot,” si për shembull një ‘biznesmen’ i pasur, mundësitë që pagesa të kryhet janë të mëdha dhe mund të mos jetë nevoja për ndërhyrjen e përmbarimit. Megjithatë, masat për sekuestrimin e pasurisë që në fazën fillestare të hetimit apo gjatë padisë civile mund të jenë me rëndësi në sigurimin e pagesës.

Kur i pandehuri refuzon të paguajë dëmshpërblim në mënyrë vullnetare, atëherë është nevoja e ekzekutimit të urdhrit për të siguruar pagesën. Teknikat e mbledhjes dhe të ekzekutimit kanë ndikim dhe efikasitet të ndryshëm, në varësi të rrethanave të çështjes dhe të të pandehurit (p.sh., nëse ka në zotërim prona që mund të sekuestrohen) dhe në varësi të teknikës së përdorur, për shembull, mund të ndërmerren masa të tjera penale kur nuk kryhet pagesa e vendosur nga gjykata në çështjen penale (shih Mbretërinë e Bashkuar), mund të merren masa për ta zbritur shumën nga paga apo pagesa e sigurimeve shoqërore në burim (shih Francën dhe Mbretërinë e Bashkuar), ose ndërhyr organ ekzekutues si përmbarimi për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, duke llogaritur vlerën e saj (shumica e vendeve).

Në Francë ka pasur një rast kur gjykata e ka mbajtur shumën ekuivalente të dëmshpërblimit të parashikuar gjatë gjykimit të padisë civile, si garanci për lirimin me kusht në çështjen penale. Në asnjë prej vendeve të këtij studimi, nuk monitorohet sistematikisht përqindja e rasteve të suksesshme të ekzekutimit të urdhrave të gjykatës. Mënyra të ndryshme përdoren në vende të ndryshme.

Vetë viktimat duhen të marrin masa për ekzekutimin e urdhrave, sepse kjo shihet si çështje e së drejtës private (si në Francë). Kjo mund dhe të jetë e kushtueshme. Veprime të tilla mund edhe të jenë të pamundura për viktimat, po të kemi parasysh kërkesat procedurale dhe ligjore të nevojshme. Përgjithësisht, organet e ngarkuara me zbatimin e vendimit janë të shkëputura nga gjykatat që marrin atë. Për shkak të burokracisë dhe të shpenzimeve për ekzekutimin e urdhrave, realizimi mund të jetë i pamundur dhe në fund të fundit, viktimat mund të mos marrë fare shpërblimin.

Masat për ekzekutimin e urdhrave nuk janë të nevojshme, kur pasuritë janë të bllokuara apo të sekuestruara që në fillim të çështjes. Legjislacioni për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive është i ndërlikuar. Ekzistojnë masa me karakter detyrues për vendet anëtare të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Krimin e Organizuar Ndërkombëtar “në masën më të lartë të mundshme në sistemin ligjor vendas”<sup>51</sup> në lidhje me hetimin penal të krimeve që janë të rënda, ndërkombëtare dhe të organizuara, në përkufizimin e Konventës.<sup>52</sup> Legjislacioni civil dhe ai penal zakonisht përcaktojnë kompetenca të veçanta për zbulimin dhe bllokimin e pasurisë që në fillim të çështjes dhe më vonë për konfiskimin e pasurive nëse provohet akuza.

Në disa vende, shteti është tashmë i autorizuar të kryejë sekuestrimin e pasurisë në fillim të çështjes penale (siç ndodh në Shqipëri dhe në Mbretërinë e Bashkuar). Kështu, mund të përdoret autoriteti i plotë i shtetit për të gjurmuar pasuritë e të pandehurit, duke përfshirë informacionin e siguruar nga i pandehuri si dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit. Megjithatë, dobia e këtij autoriteti mund të kufizohet nga një sërë faktorësh, që përfshijnë: shkallën e aftësisë dhe të vullnetit të zyrtarëve shtetërorë për identifikimin dhe gjurmimin e pasurisë; efikasitetin e të dhënave zyrtare në lidhje me, p.sh., llogaritë bankare, aksionet dhe pronat; ekzistencën dhe funksionimin e legjislacionit vendas në lidhje me pastrimin e parave; shpenzimet dhe vlerën relative të përpjekjeve në një rast të veçantë, shkallën e ushtrimit të këtij autoriteti brenda parametrave të të drejtave legjitime njerëzore dhe civile të të pandehurit. Çështja e konfiskimit të pasurisë duhet parë edhe nën këndvështrimin e të

---

<sup>51</sup> Neni 12.

<sup>52</sup> Neni 3.

drejtave të njeriut dhe ato civile dhe kjo duhet pasur parasysh nga ata që mendojnë se rritja e autoritetit shtetëror është një zgjidhje e problemit të zbatimit të dëmshpërblimit.<sup>53</sup> Në SHBA ekziston një perceptim se “sekuestrime i pasurisë përpara procesit gjyqësor është një lloj si konfiskimi i pronës pa një proces të rregullt gjyqësor,”<sup>54</sup> ndërsa ekzistojnë dispozita mbrojtëse kushtetuese (Amendamenti i Katërt i Kushtetutës Amerikane) kundrejt marrjes së pronës pa mbrojtje procedurale.

Në çështjen civile, autoriteti për gjurmimin, bllokimin dhe konfiksimin e pronës ushtrohet nga individi, meqenëse çështja civile ndaj të pandehurit trafikant zakonisht është një çështje private.<sup>55</sup> Në këto raste, çështja zakonisht gjykohet nga një gjykatë civile. Kompetencat, nëse ekzistojnë, janë më të kufizuara sesa ato të shtetit, dhe gjykata ushtron më shumë diskrecion në dhënien e miratimit për ushtrimin e tyre. (Për shembull, mund të kufizojë masën e pasurive të bllokuara të jetë e barazvlefshme me dëmin e pretenduar dhe jo me “të gjitha pasuritë,” dhe mund të autorizojë gjurmimin e pasurisë vetëm në rrethana shumë të veçanta, kur paditësi provon një rrezik të lartë se pasuria do të tjetërsohet – për më shumë detaje shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar. Këto procese janë të kushtueshme për shkak të tarifave ligjore dhe kostove të tjera, dhe jo domosdoshmërisht ka ndihmë ligjore për të paguar kostot e një çështjeje të tillë.

Kur pasuria mund të gjendet dhe të sekuestrohet apo të bllokohet, atëherë duhet të ekzistojë dhe kompetenca për konfiskimin e saj, në mënyrë që të sigurohet pagesa e vendimit civil apo urdhrit për dëmshpërblim. Në një çështje civile, konfiskimi zakonisht kufizohet me vlerën e dëmit të shpërblyer, por në një çështje penale mund të konfiskohet e gjithë pasuria e lindur si rezultat i veprës penale apo aktivitetit të përgjithshëm kriminal, në varësi të rregullave ligjore të atij juridiksioni. Pra, duhet të ketë lidhje të qartë ligjore midis pasurisë së konfiskuar dhe pagesës së dëmshpërblimit (shih legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar dhe të Shqipërisë). Kur kjo mungon, mund të pengohet ose të vonohet pagesa e dëmshpërblimit. Një alternativë është përdorimi i të gjitha pasurive, ose i një pjese të tyre, për krijimin apo kontribuimin në një fond për dëmshpërblimin e viktimave të krimit ose posaçërisht për viktimat e trafikimit (siç sugjerohet nga ligji në Shqipëri si dhe në pjesën 3.1.2 më lart).

Neni 14(2) i KKBKON-së, OSBE, UNHCR dhe Këshilli i Evropës të gjithë rekomandojnë përdorimin e pasurive kriminale për dëmshpërblimin e viktimave ose krijimin e fondeve

---

<sup>53</sup> 2001/2 Raport i Komitetit të Përbashkët të Drejtave të Njeriut i Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar mbi rishikimin e projektligjit për produktet e krimit.

<sup>54</sup> *United States' Attorneys's Manual*, seksioni 2084. Ky është manuali për prokurorët federalë në SHBA-në, i cili përmban udhëzime për punën e tyre.

<sup>55</sup> Ushtrimi i kompetencave nga shteti si pale kundër një individi sipas kodeve të procedurave civile mund të ketë më shumë forcë sesa ushtrimi nga dy palë private kundrejt njëri-tjetrit.



mbështetëse për viktimat ose për rehabilitimin (shih pjesën 3). Kjo mund të kryhet në forma të ndryshme, p.sh., krijimi apo kontribuimi në një fond të përgjithshëm për dëmshpërblimin e të gjitha viktimave të krimit; krijimi apo kontribuimin në një fond të pasurive të trafikantëve për të gjithë personat e trafikuar; përdorimi i pasurive të një trafikanti të veçantë për dëmshpërblimin e viktimave të këtij trafikanti; përdorimi i fondeve për mbështetjen e personave të trafikuar apo viktimave të krimit në përgjithësi, apo cilido kombinim i atyre të sipërpërmendura. Megjithatë, duhet theksuar se krijimi i një skeme për mbështetjen e përgjithshme të viktimave nuk është në përputhje me kërkesat ligjore ndërkombëtare për një mekanizëm efikas dëmshpërblimi për viktimën e veçantë.

Në fund të fundit, këto çështje kanë kuptim vetëm kur i pandehuri ka pasuri ose ka gjase se do ta ketë në të ardhmen (periudha e ekzekutimit të vendimit të gjykatës), megjithëse kjo varet nga teknikat vendase për mbledhjen e pasurisë. Në Francë, ligji lejon që dëmshpërblimi të paguhet nga paga ose shumat që i pandehuri merr nga shteti gjatë kohës së burgimit.

Asnjë nga vendet e vëzhguara për këtë studim nuk ka arritur të sigurojë praktika gjurmimi, sekuestrimi dhe konfiskimi të pasurisë që të sigurojnë pagesën e dëmshpërblimit për viktimat dhe as të krijojnë fonde shtetërore për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. (Në Mbretërinë e Bashkuar, një agjenci qeveritare me profilin e lartë përgjegjëse për konfiskimin e pasurive të zëna si rezultat i veprimtarisë kriminale është kritikuar ashpër se nuk ka arritur të bëjë punën e saj dhe se nuk justifikon paratë e shpenzuara për të – shih profilin e Mbretërisë së Bashkuar). As nuk janë ekzekutuar vendimet për shpërblimin e dëmit për shkak të procedurave të dobëta për ekzekutimin, të kompetencave për sekuestrim që janë të munguara, të dobëta ose që nuk ushtrohen siç duhet, ose të për të dy arsyt. Është teknikisht dhe praktikisht e vështirë që të bëhen përmirësime në këto drejtime si dhe kjo varet dhe nga funksionimi i shtetit të së drejtës dhe nga kushtet buxhetore. Megjithatë, këto çështje janë ngritur këtu sepse janë të lidhura ngushtë me zbatimin efektiv të mekanizmave të dëmshpërblimit.

### **3.5 SFIDAT E KËRKESAVE PËR DËMSHPËRBLIM PËRTEJ KUFIJVE DHE ÇËSHTJEVE TË JURIDIKSIONIT**

Natyra ndërkombëtare e trafikimit të qenieve njerëzore paraqet sfida të veçanta. Viktimat që kanë ndryshuar juridiksion nga ai ku është kryer krimi ose nga ai ku janë identifikuar si persona të trafikuar, përballen me vështirësi të qarta praktike në ndjekjen e padisë për dëmshpërblim përtej kufijve. Vështirësi hasen dhe kur trafikanti transferohet në një juridiksion tjetër për hetim dhe gjykim, apo kur pasuria e një kriminelit ose e një të

pandehuri ndodhet kryesisht jashtë territorit. Këto probleme rriten kur vendet në fjalë nuk kanë marrëveshje detyruese bashkëpunimi në lidhje me çështjen, siç e kanë vendet anëtare të Këshillit të Evropës ose të Bashkimit Evropian.

Brenda Bashkimit Evropian, janë bërë përpjekje për të lehtësuar procesin e ngritjes së padive ndërkombëtare të dëmshpërblimit nga skemat shtetërore nëpërmjet direktivës që synon zgjidhjen e këtyre problemeve si dhe nismave praktike që nxisin shkëmbimin e informacionit.<sup>56</sup>

Kjo nismë synon të përmirësojë mundësinë për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë për viktimat e krimit të dhunshëm që kanë ndodhur në vende të tjera. Gjithashtu, qeveria e SHBA-së jep burime informacioni për skemat e huaja të dëmshpërblimit për viktimat e krimit në faqen e *Internet*-it të Departamentit të Drejtësisë.<sup>57</sup> Po kështu, ekzistojnë një sërë standardesh në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, p.sh., rreth dhënies së provave, zbatimit të vendimeve të gjykatës civile dhe sekuestrimit të pasurisë, por kryesisht, qëllimi i tyre është që të rrisë bashkëpunimin mes vendeve anëtare të BE-së ose të Këshillit të Evropës.<sup>58</sup>

Sa më lehtë të jetë për t'u kuptuar një skemë dëmshpërblimi, aq më i lehtë është përdorimi i saj nga një vend tjetër. Megjithatë, ekzistojnë pengesa të dukshme gjuhësore dhe të komunikimit, si dhe vështirësi në dhënien e provës, shpenzime udhëtimi si dhe nevoja për sigurimin e vizave për të qenë të pranishëm në seancat gjyqësore, si dhe mundësi të kufizuara për transferimin dhe investimin e fondeve të marra.

Janë bërë përpjekje për zgjidhjen e këtyre problemeve, p.sh., në Meksikë janë ngritur disa OJF posaçërisht për të ndihmuar të kthyerit nga SHBA-ja për ngritjen e padisë civile përtej kufirit.<sup>59</sup> Disa vende kanë regjim të tillë vizash që mundëson viktimën të qëndrojë në vend

---

<sup>56</sup> Direktiva e Këshillit të BE-së mbi dëmshpërblimin e viktimave të krimit e vitit 2004 dhe "European Judicial Atlas in Civil Matters" (Atlasi gjyqësor evropian për çështjet civile, [http://ec.europa.eu/justice\\_home/judicialatlascivil/html/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice_home/judicialatlascivil/html/index_en.htm) Për informacion rreth zbatimit të vendimeve gjyqësore brenda BE-së, drejtohuni në burimin e mëposhtëm: "European Judicial Network: Civil and Commercial Matters" (Rrjeti gjyqësor evropian: Çështjet civile dhe tregtare), [http://ec.europa.eu/civiljustice/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/civiljustice/index_en.htm) .

<sup>57</sup> Directory of International Crime Victim Compensation Programs (Drejtoria e Programeve të Dëmshpërblimit të Viktimave të Krimit Ndërkombëtar), <http://www.ojp.usdoj.gov/ovc/publications/infores/intdir2005/welcome.html> .

<sup>58</sup> Brenda BE-së, mund të përdoret ky burim informacionesh: *European Judicial Network: Civil and Commercial Matters* (Rrjeti gjyqësor evropian: Çështjet civile dhe tregtare).

<sup>59</sup> *Centre de los Derechos del Migrante* (Qendra për të Drejtat e Emigrantëve) si dhe *Global Workers Justice Alliance* (Aleanca Globale e Drejtësisë për Punëtorët). Kjo e fundit e ka selinë në New York, megjithëse merret me Amerikën Qendrore.

gjatë kohëzgjatjes së padisë (shih SHBA-në), megjithëse s'duhet harruar se viktimat mund të dëshirojnë të kthehet në vendin e vet dhe më vonë mund të vendosë të ngrejë padinë.

Kur viktimat riadhesohet brenda një kohe të shkurtër pas marrjes së pagesës, mund të ketë nevojë për ndihmë në transferimin dhe investimin e parave. Kjo mund të jetë veçanërisht e vështirë, kur viktimat është e mitur dhe do të ketë mbrojtje të kufizuar kur të kthehet në vendin e vet.

OJF-të që merren me procesin e riintegrit mund të përqendrojnë përpjekjet në mbledhjen e informacionit dhe të njohurive të duhura për të ndihmuar viktimat, dhe vendet e origjinës mund të përpiqen të krijojnë lidhje institucionale me organet që mbështesin viktimat në vendet e destinacionit, në mënyrë që të sigurojnë informacion dhe të mbështesin paditësit.

Në rastet kur një i pandehur është ekstraduar ose transferuar në një juridiksion tjetër për ndjekjen e çështjes, ka të ngjarë që pasuria i tij të ketë vendndodhje tjetër, dhe për zbatimin e çdo urdhri dëmshpërblimi do të jetë i nevojshëm bashkëpunimi ndërkuftar sipas KKBKON-së.<sup>60</sup> Viktimat gjithashtu rrezikojnë mundësinë për të ngritur padinë civile në procesin penal apo padinë për dëmshpërblim, nëse çështja gjykohet në një vend tjetër, përveç rasteve kur marrin ndihmë të specializuar për ndjekjen e hapave ligjorë. Vështirësitë rriten kur çështja, e cila është në gjykim e sipër jashtë, nuk bazohet në disa fakte ose të gjitha faktet e çështjes së viktimës (p.sh., nëse ka dhe viktimat të tjera ose prova të krimeve që nuk kanë lidhje me krimin që prek viktimën).

Këto lloj faktorësh kompleksë në lidhje me zbatimin e ligjit ekzistojnë në të gjitha çështjet penale të trafikimit të cilat kalojnë kufijtë, dhe janë gjithnjë të vështira. Për këtë arsye, është thelbësore që të vendosen marrëdhënie të mira të komunikimit ndërmjet agjencive shtetërore dhe OJF-ve në vendet e origjinës dhe të destinacionit. Megjithatë, marrëdhëniet duhet të shtrihen, në mënyrë që të përfshijnë bashkëpunimin në lidhje me të gjitha të drejtat e viktimës, duke përfshirë kërkesën për dëmshpërblim në çdo drejtim, dhe të mos kufizohen vetëm në fushën e zbatimit të legjislacionit penal. Kjo theksohet në detyrimet sipas nenit 25(2) të KKBKON-së, i cili gjithashtu nxit lidhjen e marrëveshjeve dypalëshe në çështje të tjera të ndihmës ndërsjellë ligjore.

### **3.6 SHTETI I SË DREJTËS**

Mekanizmi i dëmshpërblimit nuk mund të funksionojë më mirë se mjedisi i përgjithshëm juridik. Meqenëse mekanizmat e dëmshpërblimit në thelb bazohen në sistemet e rregullave

---

<sup>60</sup> Nenet 12, 13, 14 dhe 18.

dhe procedurave të administruara nga gjyqësori ose nëpunësit civilë, efikasiteti i tyre lidhet me funksionimin e shtetit të së drejtës në vendin e caktuar. Kur ka probleme me pavarësinë, aftësinë apo integritetin e aktorëve shtetërorë, vihet në rrezik realizimi i së drejtës për të marrë dëmshpërblim. Viktimat nuk do të kenë besimin e nevojshëm tek drejtësia për të ngritur një padi. Gjithashtu, probleme të rrënjosura thellë në vende të caktuara, si procedura civile të tejzgjatura (që zgjasin për vite në disa vende), ndikojnë në efikasitetin e skemave të dëmshpërblimit. Në vende ku probleme të tilla janë të mirëfillta, duke parashtruar sfida praktike në kuadrin kombëtar, reforma ligjore ose institucionale e përqendruar në përmirësimin e mekanizmit të dëmshpërblimit mund të jenë të kotë, dhe probleme thelbësore mund të kërkojnë zgjidhje të tjera të cilat nuk lidhen me dëmshpërblim.

Në disa raste, mosfunksionimi i mekanizmit të dëmshpërblimit për personat e trafikuar thjesht rezulton nga mungesa e informacionit nga ana e prokurorëve që merren me çështjet e trafikimit (në Francë, ndryshe nga SHBA-ja, vetëm së fundi trafikimi njihet si vepër penale) ose përdorimi i një koncepti të ri ose kompetence të re nga ana e policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve (p.sh., dëmi moral në Rumani apo konfiskimi i pasurisë në Shqipëri). Në të gjitha juridiksionet, ndryshimet ligjore nuk kanë një ndikim të menjëhershëm në praktikën, dhe ndonjëherë ka vonesa në marrjen e masave praktike për zbatimin e tyre (p.sh., trajnimi i gjyqtarëve, udhëzimet për prokurorinë). Në këto rrethana, ONQ-të dhe OJF-të nëpërmjet aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve mund t'u vijnë në ndihmë vendeve që nuk kanë traditën përkatëse juridike. Megjithatë, duhen përshtatur në masën e duhur pritshmëritë e arritjeve të mundshme në periudha të shkurtra kohore, shpesh me burime të kufizuara dhe mungesa të përvojave vendase.

Së fundi, sfidat e përmirësimit të sistemit të përgjithshëm ligjesh dhe procedurash (p.sh., sistemi i padisë civile brenda procesit penal) mund të jenë veçanërisht të vështira, nëse ndryshimet nxiten vetëm nga një institucion shtetëror. Nevojiten një sërë aktorësh të angazhuar që kërkojnë reformën apo ndërtimin e mekanizmit të dëmshpërblimit (p.sh., duke përfshirë ministrinë e drejtësisë dhe të brendshme, si dhe gjyqësorin) dhe jo thjesht organi shtetëror që merret me çështjet e trafikimit.

### 3.7 PËRFUNDIM

Ekzistojnë mundësi të ndryshme në vende të ndryshme për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Në më të shumtën e rasteve, dëmshpërblimi kryhet nëpërmjet procesit penal ose nëpërmjet skemës shtetërore për viktimat e dhunës. Përdoren më pak, dhe njihen më pak, paditë e veçanta për dëmshpërblim në procesin civil apo në procesin sipas legjislacionit të punës.

Ekzistojnë sfida konkrete ligjore dhe procedurale (p.sh., kriteret mbi mundësinë e përfitimit, kohëzgjatja e proceseve, kërkesa për ndihmën ligjore, ekzistenca e llojeve të caktuara dëmi), që do të thotë se të gjithë sistemet në shumicën e rasteve dështojnë në dhënien e dëmshpërblimit për personat e trafikuar. Kështu ndodh si në kërkesën e dëmshpërblimit nga keqbërësi ashtu dhe nga shteti. Ka shumë mundësi që personat e trafikuar nuk do të kenë të drejtë përfitimi nga sistemet ekzistuese, ndonëse në dukje mekanizmat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare të dëmshpërblimit. Vështirësitë me të cilat ndeshet cilido person që u drejtohet organeve të drejtësisë, rriten në rastin e personave të trafikuar, të cilët, ndër faktorë të tjerë, mund të mos kenë status ligjor në vendin ku ngrenë padinë, mund të hasin pengesa gjuhësore dhe mund të kenë ndrojtje ta ndjekin çështjen për shkak të procedurave ose të frikës së trafikantit/shfrytëzuesit.

Në çështjet e dëmshpërblimit në të cilat jepen vendimet gjyqësore për pagesën, paraqiten gjithashtu sfida në lidhje me mbledhjen joefektive të pasurive dhe me teknikat e zbatimit të vendimit që nuk funksionojnë mirë në lidhje me sekuestrimin e pasurive. Sfida të tjera përfshijnë vështirësitë e bashkëpunimit ndërkombëtar, si dhe vështirësitë me të cilat ndeshen mekanizmat e dëmshpërblimit për shkak të mungesës së përgjithshme të shtetit të së drejtës.

Si rezultat i këtyre problemeve, paditë kolektive, zgjidhjet e ndërmjetësuara dhe paditë e ngritura nga shteti kundër punëdhënësve (p.sh., nga inspektoriatet e punës) mund të kenë më shumë mundësi sesa paditë individuale për të siguruar pagesën e dëmshpërblimit për personin e trafikuar, veçanërisht në rastet e shfrytëzimit për punë. Kërkimi i dëmshpërblimit nga skemat shtetërore do të kenë më shumë sukses në qoftë se rishikohen kriteret e së drejtës për të përfituar nga ato, në mënyrë që të merren parasysh rrethanat e veçanta të personave të trafikuar. Mundësi të tjera përfshijnë edhe krijimin e fondeve të veçanta për personat e trafikuar.

## **4. Roli i OJF-ve dhe shoqërisë civile në mbështetjen e viktimave dhe në avancimin e interesave të tyre**

Grupet e shoqërisë civile si sindikatat, ata që bëjnë fushata dhe lobim, organizatat e diasporës dhe OJF-të kanë pasur historikisht ndikim të fuqishëm në vendosjen e standardeve vendase dhe ndërkombëtare për të drejtat e viktimave, të drejtat e punës dhe të drejtat e emigrantëve, duke përfshirë të drejtën për dëmshpërblim dhe zhdëmtime efektive. Siç është theksuar më parë në këtë raport, funksionimi efektiv i mekanizmave të dëmshpërblimit dhe i të drejtave të viktimave nuk sigurohet vetëm me ekzistencën e një sistemi ligjor, por varet dhe nga ndihma që u jepet personave të trafikuar për t'i informuar ata në lidhje me të drejtat e tyre si dhe për t'u ofruar asistencë në kapërcimin e pengesave që hasen në praktikë. Kjo ndihmë duhet të jepet nga organet kompetente përkatëse shtetërore. Megjithatë, organizatat joqeveritare zakonisht janë treguar më efikase në ofrimin e këtyre shërbimeve. OSBE/ODIHR rekomandon, si pjesë e mekanizmit kombëtar të referimit (MKR), që shtetet të krijojnë marrëdhënie pune aktive me grupe të tilla, dhe në veçanti, të financojnë ose të subvencionojnë aktivitetet e tyre.<sup>61</sup>

Kjo pjesë e raportit diskuton qëndrimet e OJF-ve për të ndihmuar personat e trafikuar në marrjen e dëmshpërblimit si dhe rolin e shoqërisë civile brenda kuadrit kombëtar për të siguruar që mekanizmat e dëmshpërblimit janë efikase dhe që viktimat e trafikimit mund të përfitojnë prej tyre. Duhet theksuar se sa më jetëgjatë dhe aktiv të ketë qenë lobimi në nivel kombëtar, aq më efektiv është regjimi i të drejtave të viktimës (shih SHBA-në<sup>62</sup>), duke përfshirë realizimin e së drejtës për dëmshpërblim.

### **4.1 AVANCIMI I INTERESAVE NË LIDHJE ME DËMSHPËRBLIMIN**

Ka grupe të ndryshme në nivel ndërkombëtar që merren me çështjet e dëmshpërblimit për personat e trafikuar. Ato punojnë nga këndvështrimi i trafikimit të qenieve njerëzore; të drejtësisë për viktimat e krimit; dhe të drejtave të punës, të emigrantëve dhe të prostitutave. Duhet njohur roli i rëndësishëm i këtyre aktorëve në zhvillimin e standardeve që kanë lidhje me viktimat si dhe pasurimin e njohurive të të gjithëve nga përvojat e që shkëmbehen, kur bëhet fjalë për trafikimin e qenieve njerëzore.

---

<sup>61</sup> Parimet Bazë të Marrëveshjeve të Bashëkpunimit në Manualin e MKR-së, v. cit., shënim 1, faqe 65-79.

<sup>62</sup> Shih *Crime Victim's Rights in America: An historical overview*, National Center for Victims of Crime [Të drejtat e viktimave të krimit në Amerikë: Një pasqyrim historike, Qendra Kombëtare për Viktimat e Krimit], [http://www.ncjrs.gov/ovc\\_archives/ncvrv/2005/pg4b.html](http://www.ncjrs.gov/ovc_archives/ncvrv/2005/pg4b.html).

Veprimtaritë e lidhura me të drejtat e viktimave të krimit kanë një histori të gjatë. Megjithatë, të drejtat e viktimave të krimit dhe “viktimologjia” janë bërë çështje e së drejtës më vete në vitet 1980, gjatë kohës së hartimit të Deklaratës së Parimeve të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe të Abuzimit të Pushtetit<sup>63</sup> miratuar më 1985. Në nivel kombëtar, qeveritë reagues ndaj kësaj çështjeje, duke rritur të drejtat e viktimave në proceset penale në SHBA dhe nëpërmjet krijimit në Francë të një skeme shtetërore dëmshpërblimi. Pak më vonë, në vitin 1993, u bënë propozime për standardet ndërkombëtare mbi mjetet mbrojtëse dhe zhdëmtimin për abuzimet me të drejtat e njeriut dhe ato humanitare,<sup>64</sup> por ato u miratuan vetëm në vitin 2005 pas lobimit nga ana e komunitetit ndërkombëtar të OJF-ve.<sup>65</sup>

Në nivel kombëtar janë ndërmarrë një sërë nismash për përkrahjen e viktimave të krimit dhe zbatimin e politikave mbi të drejtat e viktimës (shih për shembull INAVEM dhe partnerët në Francë, *Victim Support* (Mbështetja e Viktimave) në Mbretërinë e Bashkuar). Forumi Evropian për Shërbimet ndaj Viktimave bashkon të gjitha këto organizata, dhe zëri i tij dëgjohet në nivelin e BE-së për nxitjen dhe zhvillimin e së drejtave të viktimave, duke përfshirë “nxitjen e dëmshpërblimit të drejtë dhe të barabartë për viktimat e krimit në Evropë, pavarësisht nga kombësia e viktimës.” Ky forum ofron dhe informacion për viktimat në të gjitha vendet e BE-së.<sup>66</sup> Ka shumë OJF të tjera që merren me të drejtat e llojeve të ndryshme të viktimave dhe përgjithësisht përkrahin veprime të ngjashme për rivendosjen në vend të të drejtave, ku dëmshpërblimi dhe zhdëmtimi shpesh përbëjnë temën kryesore.<sup>67</sup>

Komuniteti ndërkombëtar i OJF-ve që përkrah viktimat e trafikimit, dhe që morën pjesë në hartimin e Protokollit të Trafikimit, sollën parimet e të drejtave të viktimave në procesin e negociimit, dhe në vijim ka bërë lobim për këto të drejta dhe zbatimin e tyre në nivel kombëtar. Është komentuar në veçanti çështja e dëmshpërblimit.<sup>68</sup> Studimet përqendrohen në nevojën për informacion dhe asistencë proaktive nga ana e policisë, për legjislacion të

---

<sup>63</sup> Shih Shtojcën II.

<sup>64</sup> Shih propozimet e Theo van Boven, *UN DOC E/CN.4/Sub.2/1993/8*, para.137.

<sup>65</sup> Shih sesionin e 61-të të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 14 mars – 22 prill 2005, pika 11 e rendit të ditës: Të drejtat qytetare dhe politike, 10 shkurt 2005, ndërhyrje e përbashkët me shkrim mbi parimet themelore dhe udhëzimet për të drejtën e mjeteve mbrojtëse dhe zhdëmtimin për viktimat e shkeljeve të mëdha të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, në faqen e *Internet-it*: <http://www.redress.org/smartweb/reports/reports>

<sup>66</sup> <http://www.euvictimservices.org>

<sup>67</sup> Shih p.sh., organizatën *REDRESS* për viktimat e torturës, <http://www.redress.org/>.

<sup>68</sup> Shih E.Pearson, “*Historical Development of Trafficking – The Legal Framework for Anti-Trafficking Interventions*” (Zhvillimi historik i trafikimit – Kuadri ligjor për ndërhyrjet kundër trafikimit) dhe M.Cunneen, “*Lobbying in Europe*” (Lobimi në Evropë) në *Challenging Trafficking in Persons Theoretical Debate and Practical Approaches* (Sfida ndaj trafikimit të qenieve njerëzore: Debat teorik dhe qasje praktike) (Nomos/GTZ,2005).

mirë në fushën e sekuestrimit të pasurisë dhe përdorim të pasurisë për dëmshpërblimin e personave të trafikuar, për njohjen e statusit të viktimës/palës së dëmtuar në çështjet penale, për mundësinë e përfitimit nga skemat shtetërore dhe për të lejuar që viktimat të qëndrojnë në vendin e huaj ndërkohë që ndjekin padinë civile për dëmshpërblim.<sup>69</sup> Në vitin 2006, Aleanca Globale kundër Trafikimit të Grave zhvilloi konferencën “Mundësia për t’iu Drejtuar Organeve të Drejtësisë”<sup>70</sup> sipas së cilës edhe në ato pak raste në botë që kanë përfunduar me dënimin e autorit të veprës penale, është tejet e vështirë për viktimën të marrë dëmshpërblimin dhe se mekanizmat janë të dobët dhe të pamjaftueshëm.<sup>71</sup>

Nga një këndvështrim tjetër, por i lidhur, Platforma për Bashkëpunim Ndërkombëtar mbi Emigrantët pa Dokumente (PICUM) ka si synim nxitjen e respektimit të të drejtave të njeriut për emigrantët pa dokumente në Evropë, nëpërmjet nxitjes së respektimit të të drejtave shoqërore (duke përfshirë të drejtat e punës dhe mundësinë për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë), si dhe rregullimin e emigrantëve pa dokumente. Ata besojnë se “deklarimi i të drejtave të punëtorëve pa dokumente në sistemin ligjor” është një nga mënyrat thelbësore për mbrojtjen e punëtorëve emigrantë pa dokumente.<sup>72</sup> Nëpërmjet ndërmjetësimit, veprimeve kolektive, padive dhe përdorimit të agjencive shtetërore, ata bëjnë përpjekje për të siguruar këto të drejta, veçanërisht në lidhje me pagën e papaguar:

“Një nga format më të përhapura të shfrytëzimit të punëtorëve pa dokumente është paga. Jo vetëm që punëdhënësit ofrojnë paga që janë nën nivelin e pagës minimale, por në mënyrë të vazhdueshme punëtorët pa dokumente paguhen me vonesë dhe në shumë raste nuk paguhen fare.”<sup>73</sup>

OJF-të vendase të antitrafikimit kryejnë lobim edhe në lidhje me të drejtat e viktimave në vendet e tyre si dhe nxjerrin raporte ku analizojnë zbatimin e këtyre të drejtave, ku përfshihet dhe dëmshpërblimi. Shpesh OJF-të vendase janë në një pozitë të mirë për të lidhur viktimat me informacionin rreth mekanizmave të dëmshpërblimit në vende të tjera ose me agjencitë të cilat këshillojnë viktimat. Në SHBA, OJF-të kanë pasur një ndikim të

---

<sup>69</sup> Shih “*Human traffic, human rights: redefining victim protection*” (Trafikimi i qenieve njerëzore dhe të drejtat e njeriut: ripërcaktimi i mbrojtjes së viktimave), Anti-Slavery International 2002, faqet 57-59.

<sup>70</sup> Kjo u raportua në *Alliance News* [Lajmet e Aleancës], *Access to Justice* [Mundësia për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë], Numri 26, *Global Alliance Against Traffic in Women* [Aleanca globale kundër trafikimit të grave, dhjetor 2006].

<sup>71</sup> Po aty, f. 7.

<sup>72</sup> V. cit., shënim 18, PICUM.

<sup>73</sup> Po aty, f. 69. PICUM ka krijuar rrjete në mbarë Evropën, mbledh informacion mbi legjislacionin dhe praktikën në lidhje me të drejtat shoqërore dhe formulon rekomandime për përmirësimin e pozicionit ligjor dhe shoqëror të këtyre emigrantëve. Informacion i detajuar dhe botime rreth zbatimit të të drejtave shoqërore mund të gjenden në buletine, botime dhe faqen e *Internet-it*. Shih [www.picum.org](http://www.picum.org).



madh në reformën ligjore për asistencën ndaj viktimave të trafikimit, nëpërmjet hartimit të legjislacionit model për të bërë dëmshpërblimin penal të detyrueshëm për veprat penale të trafikimit, lehtësimin e barrës së provës për viktimat e trafikimit në kërkimin e përfitimit nga skemat shtetërore, dhe përfshirjen e trafikimit në listën e veprave penale që mbuloohen nga ato skema. Gjithashtu, OJF-të kanë hartuar modele legjislacioni për shtetet e SHBA-së, me synim krijimin e mundësisë për të ngritur padi civile për viktimat e trafikimit.

Sindikatat dhe organizatat e punëtorëve marrin pjesë në zhvillimin e standardeve ndërkombëtare nëpërmjet strukturës së ILO-s si organizatë trepalëshe. Ata mund dhe të parashtrojnë ankesë për shkelje të konventave të ILO-s.<sup>74</sup> Shumë sindikata bëjnë një punë aktive për ndërgjegjësimin e punëtorëve emigrantë për të drejtat e tyre, siç është Sindikata e Punëtorëve të Ndërtimit dhe të Industrisë së Materialeve të Ndërtimit i Federatës Ruse që punon me punëtorët që kanë emigruar nga Taxhikistani në Moskë si dhe Kongresi i Sindikatave në Mbretërinë e Bashkuar, i cili së fundi ka krijuar një faqe *Internet*-i për punëtorët polakë.<sup>75</sup> Punëtorët emigrantë kanë më tepër nevojë për mbështetjen e sindikatave se punëtorët e tjerë, pikërisht sepse shpesh janë të dobët dhe nuk janë në gjendje të ushtrojnë të drejtat e tyre të punës. Gjithashtu, punëtorët që veprojnë individualisht hasin zakonisht vështirësi për të përballuar praktika shfrytëzuese të punëdhënësve, që mund të përfundojë në punë të detyruar. Sindikatat mund të ofrojnë një sërë shërbimesh për emigrantët, duke përfshirë shërbimet e përkthimit, informacion mbi të drejtat e punës në gjuhën e emigrantit, dhe përfaqësim në procedurat e masave disiplinore dhe të ankesave sipas kontratës kolektive dhe në rastet e pushimit nga puna.<sup>76</sup> Për shkak të pozicionit të dobët të shumë punëtorëve, janë bërë thirrje që sindikatat të marrin të drejta autonome brenda legjislacionit të punës, veçanërisht të drejta për zbatimin e legjislacionit të punës pa punëtorë individualë, në rastet kur këta të fundit nuk duan të ankohen për shkak të frikës nga reagimi i punëdhësit ose thjesht nuk dëshirojnë vetë të ngrenë padi.<sup>77</sup>

#### **4.2 MBËSHTJETJA E OJF-ve NDAJ VIKTIMAVE**

Siç u tha në hyrjen e kësaj pjese, është tashmë fakt i njohur se mbështetja e OJF-ve ndaj personave të trafikuar është tepër efikase, madje dhe në ato raste kur agjencitë shtetërore nuk i marrin përsipër përgjegjësitë e tyre në këtë drejtim. Në disa vende ka shembuj të partneritetit “publik-privat” apo “marrëveshjeve të bashkëpunimit,” kur shteti dhe një OJF

---

<sup>74</sup> Në përputhje me procedurat sipas nenit 24 të Kushtetutës së ILO-s.

<sup>75</sup> <http://www.pracawbrytaniai.eu> .

<sup>76</sup> Për më shumë mbi të drejtat e sindikatave shih Bernard Ryan (red.) *Labour, Migration and Employment Rights* (Të Drejtat e Punës, Emigracionit dhe Punësimit), (Londër 2005), faqe 99.

<sup>77</sup> Po aty.

punojnë zyrtarisht së bashku për përkrahjen e interesave të viktimës dhe mbështetjen e viktimave individuale. Marrëveshje të tilla rrisin identifikimin e duhur të personave të trafikuar dhe sigurimin e informacionit dhe shërbimeve, duke përfshirë ndihmën ligjore.<sup>78</sup> Për shembull, ngritja e grupeve të veçanta (“*task forces*”) në 42 shtete të SHBA-së, në përbërjen e të cilave janë agjenci federale, shtetërore dhe vendore të zbatimit të ligjeve si dhe OJF:

“shërben si një mënyrë për të përfshirë organizatat që ndihmojnë viktimat e krimit, financuar nga grante federalë, në aktivitetet e agjencive të zbatimit të ligjeve në zonën e tyre. Organizatat komunitare dhe fetare vendore kanë një rol thelbësor në ndihmën për ato viktimat në komunitete që janë të izoluar për shkak të pozicionit gjeografik, të kulturës apo të gjuhës.”<sup>79</sup>

Edhe kur nuk ekzistojnë mekanizma të tillë të zyrtarizuar, është e qartë se mbështetja zhvillohet nëpërmjet një sërë veprimtarish vullnetare apo marrëveshjesh me shkrim me OJF-të. Shumë OJF ofrojnë mbështetje të specializuar për viktimat e trafikimit, si për shembull *Poppy Project* në Mbretërinë e Bashkuar, *Sisters* në Rusi, *La Strada* në Ukrainë dhe Moldavi, *ADPARE* në Rumani, dhe *Coalition Against Slavery and Trafficking* (Koalicioni kundër Skllavërisë dhe Trafikimit), *Safe Horizon (Horizont i Sigurt)* dhe *Polaris Project* (Projekti Polaris) në SHBA. Ka edhe agjenci që punojnë me:

- Shërbime ligjore të përgjithshme dhe këshillimi falas (si Qendrat e Avokatisë dhe Zyrat për Këshillimin e Qytetarëve në Mbretërinë e Bashkuar ose Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNLQ ose *CLCI*) në Shqipëri);
- Të drejtat e viktimave të krimit (anëtarët e *INAVEM* në Francë, *Victim Support* (Mbështetja e Viktimave) në Mbretërinë e Bashkuar);
- Këshillimin e grupeve të veçanta të emigrantëve dhe diasporës (Qendra e Ligjeve dhe Emigracionit/Fondacioni *Taxhikistan* në Rusi, Qendra Kineze për Informacion dhe Këshillim në Mbretërinë e Bashkuar, *Florida Immigrant Advocacy Center* (Qendra e Avokatisë për Emigrantët në Florida) (SHBA), *Refugee Women’s Network* (Rrjeti i Grave Refugjate) (SHBA), *Asian-Pacific American Legal Center* (Qendra Ligjore Amerikane Aziatike dhe të Zonës së Paqësorit) (SHBA);

---

<sup>78</sup> Si dhe strehim, kujdes mjekësor dhe psikologjik, punësim dhe këshillim ligjor mbi emigracionin, etj.

<sup>79</sup> *Attorney General’s Annual Report to Congress on US Government Activities to Combat Trafficking in Persons* (Fiscal Years 2001–2005) (Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm para Kongresit mbi veprimtarinë e qeverisë për luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore) (Vite financiare 2001-2005).

- Këshillim për të drejtat e emigrantëve dhe punonjësve pa dokumente (p.sh. GISTI në Francë dhe *Sweatshop Watch* (Vëzhguesit i fabrikave me kushte shumë të këqija)(SHBA), Worker's Rights Law Center (Qendra Ligjore për të Drejtat e Punonjësve) (SHBA);
- Këshillim për kategori të veçanta punëtorësh (p.sh., Kalayaan i cili merret me punonjësit shtëpiakë në Mbretërinë e Bashkuar, CODETRAS me punonjësit e bujqësisë në Francë, *Farmworkers Legal Services* (Shërbime Ligjore për Fermerët) (SHBA); dhe
- Sindikatat që këshillojnë dhe përfaqësojnë individët në lidhje me të drejtat e punës (TGWU në Mbretërinë e Bashkuar, CGT në Francë dhe Sindikata e Punonjësve të Ndërtimit dhe të Industrisë së Materialeve të Ndërtimit në Federatën Ruse).

OJF-të që punojnë me çështje që nga dhuna në familje deri tek diskriminimi merren dhe me ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve për viktimat. Ky komunitet aktiv këshillohet është një vlerë që u shtohet përpjekjeve mbarëbotërore për antitrafikim. Megjithatë, burimet e disponueshme mund të mos përdoren në çdo rast në mënyrë optimale për të mirën e viktimave. Për shembull, agjencitë mbështetëse të viktimave me përvojë në paditë për dëmshpërblim mund të mos jenë të ndërgjegjësuarat për nevojat e personave të trafikuar ose mund të mos jenë pjesë e rrjetit të ofruesve të shërbimeve, gjë e cila vërtetohet nga mungesa e kërkesave për dëmshpërblim nga skema shtetërore të paraqitura nga viktimat në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo do të thotë se këshilla për një temë të caktuar, siç është kërkimi i dëmshpërblimit, mund të jepet nga dikush i cili nuk është specialist, ndërkohë që viktima do të përfitonte më shumë në qoftë se përfshihet një agjencie tjetër.

Sfidat praktike me të cilat haset personi i trafikuar që ndërmerr hapa për të kërkuar dëmshpërblimin janë theksuar së fundi nga IOM, i cili që prej 13 vjetësh është marrë gjerësisht me organizimin e ndihmës dhe financimin për viktimat e trafikimit. Në një libër udhëzues për OJF-të mbi ndihmën ndaj viktimave të trafikimit të botuar së fundi, thuhet: “Viktimat duhen informuar mbi të drejtat e tyre për dëmshpërblim dhe zhdëmtim, dhe kur është e mundur, të ndihmohen për të ndjekur padi të tilla.”<sup>80</sup> Njëkohësisht, kur personat e trafikuar këshillohen në lidhje me pagesat e dëmshpërblimit, është e rëndësishme që të merret parasysh dhe këshillimi nga psikologët si dhe vlerësimi i niveleve të riskut me të cilin përballet viktima për shkak të padisë, p.sh. në vendet ku nuk garantohet siguria e viktimës

---

<sup>80</sup>*The IOM Handbook on Direct Assistance for Victims of Trafficking* (Doracakut i IOM-it për Ndihmën e Drejtpërdrejtë për Viktimat e Trafikimit) (IOM, 2007), faqe 280.

sepse shteti ligjor është i dobët ose ka korrupsionin ose thjesht mungesën e lehtësirave të duhura.<sup>81</sup>

### **4.3 PËRFUNDIME**

Pa veprimtarinë e shoqërisë civile, e drejta për dëmshpërblim e viktimave të krimit në përgjithësi, dhe të personave të trafikuar në veçanti, nuk do të ishte krijuar as nuk do të ishte zbatuar në mënyrë aq të mirë. OJF-të mund të jenë forca shtytëse kryesore për të nxitur qeveritë të bëjnë ndryshimet e nevojshme. Në përgjithësi, përpjekjet për përkrahjen e të drejtave të viktimave dhe të drejtën e dëmshpërblimit janë bërë nga një sërë organizatash, ndonjëherë të ndara, sepse përqendrojnë në interesa të ndryshme. Kjo do të thotë, që ato nuk janë të ndërgjegjësuar në çdo rast për faktin që interesat e ndërsjella janë të lidhura me njëri-tjetrën apo se si përfituesit e secilës organizate mund të përfitojnë nga njohuritë dhe përvoja që kanë mbledhur OJF-të e tjera. Do të ishte e vlefshme për OJF-të që të ndërmerrnin veprimtari të përbashkëta për grupet e ndryshme të interesit të cilat merren me temën e dëmshpërblimit, këshillimit e viktimave dhe ndihmës ndaj tyre, si dhe që të nxisnin veprimtari të përbashkëta të tilla.

---

<sup>81</sup> Po aty, f.282-283.

## 5. Profilet e vendeve

Këto profile janë përfunduar në prill 2007. Që nga ajo kohë është përfshirë informacion shtesë, p.sh., nëse janë bërë ndryshime të rëndësishme ligjore ose të praktikës gjyqësore, apo nëse partnerët tanë kanë ngritur çështje të rëndësishme. Megjithatë, profilet nuk janë ndryshuar në mënyrë gjithëpërfshirëse. Siç theksohet në fillim, të dhënat mbi profilet e vendeve nuk janë përditësuar që prej botimit të librit në anglisht në maj të vitit 2008.

### 5.1 SHQIPËRIA

#### 5.1.1 Kuadri ligjor dhe institucional

Shqipëria është palë në konventat kryesore ndërkombëtare mbi trafikimin, punën e detyruar dhe emigracionin (përveç Konventës së OKB-së mbi Emigracionin). Shqipëria gjithashtu ka nënshkruar Konventën Evropiane kundër Trafikimit dhe Konventën Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme.<sup>82</sup> Shqipëria nuk është anëtare e Bashkimit Evropian por “është vend kandidat i mundshëm” pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit më 12 qershor 2006.<sup>83</sup> Ka probleme korrupsioni dhe dobësi në funksionimin e shtetit të së drejtës, për të cilat Bashkimi Evropian i ka kërkuar Shqipërisë t'i zgjidhë si pjesë e procesit të hyrjes në BE.<sup>84</sup>

Në vitin 2001 qeveria ngriti një grup pune ndërministror për hartimin e planit kombëtar kundër trafikimit. Ekzistonte Komiteti Shtetëror, dhe në nëntor të vitit 2005 u krijua zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Ministrinë e Brendshme, e mbështetur nga Njësia Antitrafik.<sup>85</sup> Është miratuar edhe Strategjia Kombëtare 2005-2007 dhe Mekanizmi Kombëtar i Referimit, i miratuar në vitin 2005.<sup>86</sup> Në vitin 2005, me anë të një urdhri të përbashkët ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, u krijua Autoriteti Përgjegjës, një organizëm i përbashkët përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e procesit të referimit për asistencën, mbrojtjes dhe riintegrimin të viktimave

<sup>82</sup> Shih tabelën e ratifikimeve, Shtojca V.

<sup>83</sup> <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/275&format=HTML&aged=0&>.

<sup>84</sup> [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2006/l\\_035/l\\_03520060207en00010018.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2006/l_035/l_03520060207en00010018.pdf).

<sup>85</sup> Urdhër i Kryeministrit nr.203, datë 19.12.2005.

<sup>86</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi për Krijimin e një Mekanizmi Kombëtar Referues për Identifikim dhe Ndihmë të Përmirësuar për Viktimat e Trafikut të Qenieve Njerëzore (2005) midis: Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Punëve të Jashtme, VATRA, Vizion Tjetër (*Another Vision*) dhe Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin – IOM.

dhe viktimave të mundshme të trafikimit, regjistrimit të tyre dhe raportimit periodik të të dhënave.

Në qershor të vitit 2006, u krijuan Komitetet Rajonale Antitrafik, që përbëhen nga përfaqësues të policisë, shërbimeve sociale, institucioneve arsimore dhe shëndetësore, pushtetit vendor dhe aktorë të tjerë që kanë lidhje me fushën.<sup>87</sup> Në tetor 2006, nisi funksionimin linja telefonike kombëtare falas për raportimin e rasteve të trafikimit. Në lidhje me trafikimin e fëmijëve është miratuar një strategji e veçantë dhe është firmosur me Greqinë një marrëveshje e posaçme.<sup>88</sup>

Trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar si vepër penale në vitin 2001,<sup>89</sup> dhe më vonë u përfshi në Kodin Penal si neni 110. Ekzistojnë dhe dispozita të tjera në lidhje me trafikimin e femrave dhe të fëmijëve,<sup>90</sup> ndërsa në vitin 2004 këto përkufizime u ndryshuan.<sup>91</sup> Sipas Kodit Penal, përbën vepër penale si trafikimi për shfrytëzim prostitucioni, ashtu edhe ai i punës. Po në vitin 2004, u krijua një gjykatë për krimet e rënda dhe u miratuan ligje për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe luftën kundër krimit të organizuar që përqendrohet në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë (shih më poshtë).<sup>92</sup>

Ekzistojnë shumë OJF që ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për shqiptarët e trafikuar, ku përfshihen Qendra Psiko-Sociale Vatra, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, “Të Ndryshëm por të Barabartë” dhe një qendër shtetërore për referimin e viktimave. Sipas raporteve, bashkëpunimi midis OJF-ve dhe autoriteteve zbatuese të ligjeve mbi identifikimin dhe ndihmën ndaj personave të trafikuar është në përmirësim.<sup>93</sup>

## **5.1.2. Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

### **5.1.2.1. Skemat shtetërore të dëmshpërblimit**

Pavarësisht nga ratifikimi i KEDVKDh-së, në kohën e hartimit të këtij raporti nuk ka të dhëna në lidhje me ekzistencën ose planet për krijimin e ndonjë skeme shtetërore për

---

<sup>87</sup> Urdhër për Krijimin e Komiteteve Rajonale Anti-Trafik për Luftën Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nivel Qarku (2006).

<sup>88</sup> Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit (2005) dhe Marrëveshja midis Qeverisë së Republikës Greke dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Fëmijëve Viktima të Trafikimit (2006).

<sup>89</sup> Ligji nr. 8733, datë 24 janar 2001.

<sup>90</sup> Nenet 114b dhe 128b përkatësisht.

<sup>91</sup> Ndryshuar me Ligjin nr.9188, datë 12.02.2004.

<sup>92</sup> Ligji nr. 9205 “Për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe të Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë” (2004) dhe Ligji nr. 9284 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” (2004).

<sup>93</sup> Shih Vajzat dhe Trafikimi: Studim mbi zhvillimin e trafikimit të grave në Shqipëri (Vatra, 2005).

dëmshpërblimin.<sup>94</sup> Megjithatë, shih pjesën me poshtë mbi sekuestrimin e pasurisë, në lidhje me një skemë shtetërore të sapolindur për dëmshpërblimin nga pasuritë e trafikantëve.

### **5.1.2.2. Dëmshpërblimi nga gjykatat civile, penale dhe të punës**

#### *Proceset penale dhe civile*

Legjislacioni shqiptar krijon mundësinë e dëmshpërblimit nëpërmjet padisë civile në procesin penal ose padisë civile të pavarur sipas procedurave civile. Ndryshimi kryesor midis të dyjave është se nuk mund të kërkohet dëmi moral me anë të padisë në çështjen penale. Kjo mund të dekurajojë personat e trafikuar në bërjen e kërkesave, duke qenë se në shumicën e rasteve padia e tyre është për dëme morale, dhe në këtë rast ajo duhet ngritur në gjykatën civile ku ka probleme të shpenzimeve, kohës dhe rezultateve të paqartë. Ka shumë mundësi që kjo në vetvete do të ulë numrin e kërkesave për shpërblim të dëmit në Shqipëri.

Neni 58 i Kodit të Procedurës Penale u jep viktimave të krimit të drejtën “të kërkojnë procedimin e fajtorit dhe shpërblimin e dëmit.”<sup>95</sup> Sipas nenit 61:

“Ai që ka pësuar një dëm material nga vepra penale ose trashëgimtarët e tij mund të ngrenë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit.”

Kështu, viktima bëhet “paditësi civil” në procesin penal dhe mund të përfaqësohet me përfaqësues ligjor.<sup>96</sup> Në përfundim të çështjes, dhe kur merret me dënimin dhe shpenzimet, gjykata duhet të merret gjithashtu me padinë për dëmshpërblimin, duke e pranuar atë tërësisht apo pjesërisht ose duke e rrëzuar.<sup>97</sup> Gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile dhe dërgimin e saj në gjykatën civile nëse gjykimi i saj “vështirëson ose zvarrit” procesin penal.<sup>98</sup> “Kur provat e marra nuk mundësojnë saktësimin e dëmit, gjykata disponon për të drejtën e shpërblimit të dëmit në tërësi dhe ia dërgon aktet gjykatës civile...”<sup>99</sup> Kjo është bërë një praktikë e njohur, pavarësisht nga justifikimi ligjor, ndonëse në raportet e kohëve të fundit të OJF-ve shqiptare, thuhet se ata besojnë se ratifikimi i KEDVKDh-së mund të ketë

---

<sup>94</sup> Korrik 2007.

<sup>95</sup> Këtu krijohet paqartësi për shkak se dëmit i referohet vetëm neni 58, ndërsa dëmit material neni 61. Pra, është e mundshme që të interpretohet se ekziston e drejta për të kërkuar shpërblim e dëmit moral në procesin penal. Megjithatë, duket se avokatët dhe gjyqtarët nuk e kuptojnë atë në këtë mënyrë.

<sup>96</sup> Neni 67 i KPrP.

<sup>97</sup> Neni 68 i KPrP.

<sup>98</sup> Neni 62 i KPrP.

<sup>99</sup> Neni 395 i KPrP.

pasur ndikim në praktikën gjyqësore, sepse një gjykatë në Tiranë ka pranuar së fundi padinë civile në procesin penal në një çështje “shfrytëzim prostitucioni.”<sup>100</sup> Megjithatë, nëse padia civile rrëzohet në procesin penal, ajo nuk mund të ngrihet përsëri në gjykatën civile.<sup>101</sup> E vetmja mënyrë e riparimit të dëmit moral nga gjykata penale, me kërkesë të paditësit civil, është botimi në gazetë i dënimit të autorit të veprës penale në gazetë.<sup>102</sup>

Sipas Raportit të OSBE-së në kuadër të Programit për Zhvillimin e një Gjykimi të Drejtë, fusha e së drejtës për dëmshpërblim në Shqipëri është mjaft e pazhvilluar, sepse në asnjë prej çështjeve penale të ndjekura nuk ishin paraqitur kërkesa për dëmshpërblim.<sup>103</sup> Ky studim trajtoi një sërë krimesh. Një studim tjetër, i kryer nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, e cila analizon 54 çështje penale trafikimi gjatë periudhës 2001-2003, nuk ka hasur asnjë rast ku të jetë paraqitur kërkesa për dëmshpërblim.<sup>104</sup> Arsyet që jepen për këtë janë: mungesa e ndihmës ligjore falas për viktimat e trafikimit; niveli i ulët i ndërgjegjësimit nga ana e viktimave të trafikimit mbi të drejtat e tyre ligjore; fakti që avokatët nuk i këshillojnë siç duhet klientët e tyre; dhe fakti që personat e trafikuar kanë frikë të kërkojnë shpërblimin e dëmit, sepse rrezikojnë hakmarrjen ose ritrafikimin.<sup>105</sup> Sipas Kryetarit të Gjykatës për Krime të Rënda (ku gjykohen çështjet e trafikimit), nuk ka pasur kurrë padi për dëmshpërblim.<sup>106</sup>

Për shkak të kufizimeve të procesit civil për të kërkuar dëmet materiale, personat e trafikuar ka pak të ngjarë të ngrenë padi, përveç rasteve kur mund të provojnë humbjen e të ardhurave si në rastin e lartpërmendur (shih shënimin 101). Ata mund të mos kenë pësuar dëm material ose mund të kenë aq shumë vështirësi për të provuar humbjen me anë të dokumenteve, sa që padia do të ishte e pavlerë. Gjithashtu, organet e policisë dhe të prokurorisë nuk kanë detyrim të informojnë viktimat mbi të drejtën e tyre për dëmshpërblim, dhe si rrjedhojë, njohja e kësaj së drejte nga ana e viktimave dhe mbështetja

---

<sup>100</sup> Me sa duket në këtë çështje gjykata vendosi që paditësit (viktims) t'i jepej shuma prej 2 milion ALL (rreth 16 000 EUR) si shpërblim i dëmit material për fitimin e munguar, ndonëse shfrytëzimi seksual normalisht do të konsiderohej si “punë e paligjshme.” Vendimi u ankimua, por u la në fuqi nga Gjykata e Apelit. Megjithatë, vendimi nuk është zbatuar ende. Informacion i dhënë nga QNLQ në seminarin e ODIHR-it në Barcelonë, dhjetor 2007, shih shënimin 43.

<sup>101</sup> Neni 68 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>102</sup> Neni 399 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>103</sup> *Analysis of the Criminal Justice System of Albania* (Analizë e Sistemit të Drejtësisë Penale në Shqipëri), OSBE 2006, faqe 131.

<sup>104</sup> *Monitoring of the court decisions related to THB in the District Courts of Tirana, Vlora, Shkodra for the period 2001 – 2003* (Monitorimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me Trafikimin e Qenieve Njerëzore në gjykatat e shkallës së parë Tiranë, Vlorë, Shkodër për periudhën 2001-2003). CLCI (QNLQ) 2003.

<sup>105</sup> Korrespondenca me postë elektronike midis hartueses së studimit dhe avokatëve që QNLQ-së, 15 prill 2007.

<sup>106</sup> Informacion i marrë nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, dhënë hartueses së studimit më 20 prill 2007.



që kanë, varet nga fakti nëse ato këshillohen nga OJF-të. Është e nevojshme që viktimat t'i njohin të drejtat e tyre sa më parë të jetë e mundur, në mënyrë që të merren masat për të hartuar kërkesëpadi të vlefshme. Pavarësisht nga kufizimet aktuale të dëmeve që mund të kërkohen, viktimat mund të paraqesë kërkesë, p.sh., për fitimet “e fituara padrejtësisht” nga trafikanti, për të cilat ajo nuk ka qenë në dijeni.

Kodi i Procedurës Penale nuk i atribuon të drejta të qarta viktimës. Vetëm nëse merr statusin e paditësit civil në procesin penal, ajo ka të drejtë të përfaqësohet. Si rrjedhojë, njohja e përgjithshme dhe roli i viktimës në procesin penal është i mangët (p.sh., nuk ka të drejtë t'u drejtojë pyetje dëshmitarëve), dhe kjo mund të sjellë pasoja në praktikë ku të drejtat e viktimës nuk merren seriozisht nga policia, nga prokuroria ose nga vetë gjykata. Edhe në rastet kur viktimat ka përfaqësim ligjor, përfaqësuesit kanë shumë pak të drejta ligjore për të kërkuar në emrin e klientëve.

Në kushtet e mungesës së informacionit në lidhje me paditë civile në procesin penal, është e pamundur që të bëhet një vlerësim i nivelit të ekzekutimit të vendimeve. Megjithatë, duke pasur parasysh dobësitë në garantimin e gjykimit efektiv të padisë civile, ka të ngjarë që dhe mekanizmat e ekzekutimit të vendimeve të jenë po aq të dobët.

Kodi Civil parashikon ngritjen e padisë civile në procesin penal në rastet kur individit është dëmtuar nga vepra penale.<sup>107</sup> Të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës civile e kanë dhe të huajt.<sup>108</sup> E drejta për shpërblim të dëmit material (pasuror) në dukje përbëhet si vijon:<sup>109</sup>

- a) i pandehuri shpërblen “dëmin e pësuar” dhe “fitimin e munguar”;
- b) shpenzimet e kryera në mënyrë të arsyeshme për të shmangur dëmin ose për të pakësuar atë;
- c) shpenzimet e arsyeshme të kryera për të siguruar shpërblimin në rrugë jashtëgjyqësore;
- c) detyrimi të shpërblejë dëmin që i pandehuri ka shkaktuar ndaj shëndetit të tjetrit, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësinë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij si dhe shpenzime të tjera që janë bërë në lidhje me dëmin e shkaktuar” (Sipas nenit 641 dhe nenit 642, duket se masa e shpërblimit të dëmit mund të rritet në të ardhmen në rast të rëndimit të shëndetit);
- d) kur është shkaktuar vdekja e një personi, dëmet që duhet të shpërblehen përbëhen nga: shpenzime për ushqim e jetesë të fëmijëve të tij të mitur,

---

<sup>107</sup> Neni 608.

<sup>108</sup> Neni 3.

<sup>109</sup> Nenet 640-644 të Kodit Civil.

bashkëshortit dhe personave të tjerë në ngarkim, shpenzimet për varrimin e të vdekurit;

- dh) neni 644 vendos të drejtën për të kërkuar përfitimet e padrejta kur i pandehuri i ka shkaktuar dëm viktimës.”

Neni 625 i Kodit Civil sanksionon se personi që pëson një dëm të ndryshëm nga ai material (d.m.th., dëm moral), ka të drejtë të shpërblehet kur:

- “a) ka pësuar dëmtim të shëndetit ose është cenuar në nderin e personalitetit të tij;
- b) është fyer kujtimi i një të vdekuri, dhe kërkohet nga bashkëshorti me të cilin ka bashkëjetuar deri në ditën e vdekjes, ose nga të afërmit e tij deri në shkallën e dytë, përveç kur fyerja është kryer kur i vdekuri ka qenë gjallë dhe i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për fyerjen e bërë.”

### *Procesi gjyqësor sipas së drejtës së punës*

Kodi i Punës i Shqipërisë trajton vetëm marrëdhëniet “ligjore” ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nëse kryhet punë e pavullnetshme, kjo do të përbënte shkëlqje të parimeve bazë të Kodit dhe duhet trajtuar nëpërmjet instrumenteve të tjera ligjore në Shqipëri (p.sh. Kodi Civil, Kodi Penal), sepse lidhja punëdhënës-punëmarrës nuk konsiderohet që ka ekzistuar.

Neni 8 i Kodit të Punës e ndalon punën e detyruar, por sipas QNLQ-së<sup>110</sup> për këto raste nuk parashikohen dënime. Me sa duket, e vetmja masë është urdhri për ndalimin e veprimtarisë së paligjshme dhe përgjegjësia ligjore civile sipas Kodit Civil.

### **5.1.2.3 Sekuestrimi i pasurisë**

Kodi i Procedurës Penale parashikon sekuestrimin e pasurisë në rastet kur është ngritur padia civile.<sup>111</sup> Gjithashtu, Ligji nr. 9284 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar” u jep autoritet policisë dhe prokurorisë të gjurmojnë, identifikojnë, hetojnë dhe sekuestrojnë pasuritë e paligjshme të personave të dyshuar si pjesëmarrës, ndër të tjera, në trafikim e personave, të bashkëshortëve dhe familjarëve të tyre.<sup>112</sup> Më pas, gjykata mund të vendosë për konfiskimin e pasurisë, e cila i kalon shtetit.<sup>113</sup> Kreu 7 i të njëjtit ligj thotë se

---

<sup>110</sup> Korrespondencë me postë elektronike midis QNLQ-së dhe hartueses së studimit më 15 prill 2007.

<sup>111</sup> Neni 63.

<sup>112</sup> Neni 3.

<sup>113</sup> Nenet 25 dhe 30 të Ligjit nr. 9284.

pasuria mund të shitet dhe, ndër të tjera, mund të përdoret për “zhdëmtimin e viktimave”<sup>114</sup> dhe qëllime sociale “për qendrat e asistencës për rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore.”<sup>115</sup> Deri tani kjo nuk është kryer.

Në raportin vjetor të Koordinatorit Kombëtar, botuar në shkurt 2006, thuhet se “skema për dëmshpërblimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit, bazuar, ndër të tjera, në pasuritë e konfiskuara të trafikantëve...do të krijohet së shpejti.”<sup>116</sup> Megjithatë, deri në dhjetor 2006, nuk ka pasur raste kur pasuritë e konfiskuara të jenë përdorur për dëmshpërblimin e personave të trafikuar, dhe përfaqësuesit e qeverisë u shprehën se Këshilli i Ministrave pritet të nxjerrë një vendim tjetër në lidhje me këtë çështje.<sup>117</sup> Ndër prioritetet e Koordinatorit Kombëtar për 6-mujorin e parë të vitit 2007 është edhe:

“sigurimi i dëmshpërblimit të viktimave me anë të përdorimit të pasurisë së trafikantëve si rezultat i veprimtarisë kriminale, dhe hartimi i një vendimi qeverie mbi përdorimin e pasurisë së konfiskuar nga grupet e organizuara kriminale. Do të ngihet një grup i gjerë pune për të vendosur mbi çdo pasuri dhe ndarjen e saj për qëllime sociale, pushtetit vendor dhe agjencive zbatuese të ligjeve, si dhe për dëmshpërblimin e viktimave deri në 40% të pasurisë së konfiskuar.”<sup>118</sup>

Mbetet ende për t’u parë si do të funksionojë ky sistem, si do të përcaktohen “viktimat” dhe si do të shpërndahen pasuritë. Mbetet gjithashtu e paqartë cila është shuma e parave në dispozicion të një fondi të tillë, dhe ka mundësi që do të ketë nevojë për subvencionim shtetëror plotësues.

Duhet theksuar se një skemë e tillë nuk është në përputhje me detyrimet e Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme të ratifikuar nga Shqipëria, e cila kërkon krijimin e një skeme shtetërore për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme.

---

<sup>114</sup> Neni 34 (1).

<sup>115</sup> Neni 34 (2).

<sup>116</sup> Faqe 12.

<sup>117</sup> Sipas Ligjit nr.9284 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar,” kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Financave. Megjithatë, Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore thekson se përveç Ministrisë së Financave, kjo është përgjegjësi edhe e Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>118</sup> Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore “Prioritetet afatshkurtra për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe disa arritje kryesore në 2006,” Arkivi i ODIHR-it.

#### **5.1.2.4 Ndhimja për viktimat**

As policia, as prokuroria dhe as gjykata nuk kanë detyrim të informojnë dhe të këshillojnë viktimat e krimit në lidhje me të drejtat e tyre. Pra dhe kjo nuk do të ndodhë, sipas të gjitha gjasave, përveç rasteve kur viktimat informohen nga një palë e pavarur. Kur viktimat marr pjesë në procesin penal si paditës civil, ka të drejtë të përfaqësohet nga një avokat mbrojtës, duke qenë se është palë në proces.<sup>119</sup> Megjithatë, fakti që nuk ka asistencë ligjore të paguar ose të subvencionuar mund të ndalojë përdorimin e përfaqësimit ligjor nga viktimat, përveç rasteve kur ofrohet vullnetarisht nga OJF-të.

Të paktën një OJF, QNLQ, merret me këshillimin e personave të trafikuar, por me sa duket kjo nuk është pjesë e një sistemi referimi të sanksionuar nga shteti. IOM-i ofron asistencë ligjore falas në qendrën kombëtare pritëse, dhe OJF-ja “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” drejton një strehëz. Në përgjithësi, strehëzat bashkëpunojnë me OJF-të si QNLQ apo Klinika Ligjore për të Mitur. Për këto dy organizata, thuhet se ofrojnë shërbim cilësor meqenëse të dyja kanë përvojë në këshillim ligjor. Është shumë e rëndësishme që ndihma ligjore të përfshijë edhe përfaqësimin ligjor dhe që kjo e drejtë të pasqyrohet në Kodin e Procedurës Penale.

#### **5.1.3 Përfundime për Shqipërinë**

Mekanizmat aktualë për dëmshpërblimin e viktimave të krimit, në veçanti të trafikimit, janë jashtëzakonisht të dobët. Nuk ka skemë të financuar ose të subvencionuar nga shteti, as plane të dukshme për të ngritur një skemë të tillë, pavarësisht nga ratifikimi i Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme. Për të krijuar një sistem më të thjeshtësuar, duhet shqyrtuar mundësia e zbatimit të një skeme dëmshpërblimi të financuar nga pasuria e kriminelëve dhe/ose fondet shtetërore. Kjo gjithashtu do të mundësonte personat e trafikuar që kanë identifikuar ose gjetur vendndodhjen e të pandehurit të paraqesin kërkesë kundër tyre.

Viktima ka të drejtë të kërkojë dëmet materiale si paditës civil në procesin penal, por në të vërtetë ajo nuk këshillohet paraprakisht për këtë dhe mesa duket e drejta ushtrohet rrallë. Një rast i kohëve të fundit shënon një hap të vogël përpara në lidhje me vullnetin e mirë të gjykatave për të gjykuar padinë dhe për të dhënë dëmin material. Megjithatë, këto probleme kanë një ndikim të përgjithshëm mbi të drejtat e personave të trafikuar në Shqipëri, dhe është e nevojshme që Koordinatori Kombëtar të monitorojë nga afër paditë civile për

---

<sup>119</sup> Neni 67 i KPrP.

dëmshpërblim brenda procesit penal, njëkohësisht me monitorimin e statistikave mbi numrin dhe llojet e çështjeve dhe dënimeve. Është gjithashtu e nevojshme në përgjithësi që të përmirësohet pozicioni i viktimës/paditësit civil në legjislacionin penal dhe të përmirësohet zbatimi i së drejtës për të ngritur padi civile:

- Duke vendosur detyrimin për policinë, prokurorinë dhe gjykatat që të informojnë, këshillojnë dhe të rikujtojnë viktimat në lidhje me të drejtat e tyre civile (dhe të tjera) sa më shpejt të jetë e mundur dhe rregullisht gjatë gjithë çështjes;
- Duke forcuar detyrimin ligjor i policisë dhe prokurorisë për të siguruar mbledhjen e provave dhe paraqitjen e tyre në gjykatë për të mbështetur padinë civile;
- Duke siguruar që këshillimi dhe përfaqësimi ligjor të jetë falas dhe i disponueshëm në fazën më të hershme për të gjitha viktimat;
- Duke marrë masat që mundësojnë viktimën dhe paditësin civil të jetë palë me të gjitha të drejtat në procesin penal;
- Duke siguruar se mund të kërkohet shpërblimi i dëmit moral dhe material për të shmangur nevojën për dy procese të veçanta, si dhe të rishikohen e të qartësohen a) përkufizimet e dëmeve morale dhe materiale dhe b) llojet dhe natyra e provave të kërkuara që të pasqyrohen më qartë nevojat e viktimave të krimit, veçanërisht atyre të trafikimit;
- Duke ofruar këshille dhe trajnime për gjyqtarët dhe prokurorët mbi zbatimin e këtyre të drejtave, përcaktimin dhe llogaritjen e dëmeve, dhe mbi mënyrat për të siguruar që çështjet e dëmshpërblimit arsyetohen në vendimet gjyqësore;
- Duke u dhënë mundësinë gjyqtarëve të çështjeve penale të japin vendime për dëmshpërblimin kryesisht, d.m.th., pa qenë nevoja që viktimat të ngrejë padi civile (si në Moldavi ose në Ukrainë).

Në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në dhjetor të vitit 2006, dolën problemet e mëposhtme në lidhje me dëmshpërblimin e viktimave të trafikimit:

- Mungon informacioni nga ana e strehëzave dhe avokatëve në lidhje me mundësinë për të kërkuar shpërblimin e dëmit;
- Padi civile nuk duhet veçuar nga procesi penal. Janë të njohura problemet e gjyqësorit shqiptar në lidhje me procese të gjata gjyqësore, veçanërisht ato civile;

- Legjislacion është i paqartë.<sup>120</sup>

Këto gjetje janë konfirmuar nga ky studim.

Për të përmirësuar statusin e përgjithshëm të viktimës në sistemin e drejtësisë penale, janë të nevojshëm këshillimi ligjor i specializuar dhe përfaqësimi në momentin e parë kur viktima përballohet me sistemin. Njëkohësisht, shoqëria civile duhet të ngrejë zërin në mbrojtje të të drejtave të viktimave në përgjithësi. Përfaqësimi ligjor i ofruar duhet të përmirësojë hartimin e padive dhe arsyetimin për të mbështetur paditë civile të personave të trafikuar, duke përfshirë mundësinë e padisë për “përfitime të padrejta.”

#### **5.1.4 Praktika të mira në Shqipëri**

- Mundësia për të kërkuar shpërblimin e dëmit nga përfitimet e trafikantit si rezultat i shfrytëzimit të viktimës;
- Ekzistenca e Koordinatorit Kombëtar në nivel shtetëror;
- Përpjekja për të thjeshtësuar ligjin për sekuestrimin e pasurisë dhe lidhjen e përcaktuar nga ligji midis konfiskimit të pasurisë dhe dëmshpërblimit të viktimës.

## **5.2 FRANCA**

### **5.2.1 Kuadri ligjor dhe institucional**

Franca është e detyruar të zbatojë të gjitha standardet kryesore mbi trafikimin dhe punën e detyruar, duke përfshirë dhe Konventën Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.<sup>121</sup> Gjithashtu ajo është palë e Konventës Evropiane mbi Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme.<sup>122</sup> Nuk ka ratifikuar konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e emigrantëve, përveç Konventës 97 të ILO-s mbi emigracionin për punësim. Franca është gjithashtu anëtare e BE-së dhe rrjedhimisht e detyruar nga të gjitha direktivat dhe vendimet e BE-së.

---

<sup>120</sup> Informacion nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

<sup>121</sup> 9 janar 2008.

<sup>122</sup> Shih tabelën e ratifikimeve, Shtojca V.

Franca ka traditë ligjore të së drejtës civile. Trafikimi i qenieve njerëzore u njoh si veprë penale me miratimin e Ligjit mbi Sigurinë e Brendshme,<sup>123</sup> i cili përcaktohet në nenin 225-4-1 të Kodit Penal dhe përfshin trafikimin si për qëllime shfrytëzimi seksual si dhe punësimi.<sup>124</sup> Kjo veprë penale dënohet me burgim gjer në 7 vjet dhe me gjobë deri në 150 000 EUR dhe mundësi dënimi me burgim të përjetshëm dhe gjobë 4.5 milion EUR në rastet e kryerjes së “veprimeve barbare të torturës.”<sup>125</sup> Ligji gjithashtu trajton çështje të lidhura me prostitucionin, sigurinë dhe emigracionin. Autoritetet e kanë trajtuar çështjen e trafikimit kryesisht nën këndvështrimin e rregullimit të “rendit publik” (p.sh., ndjekja penale e sigurimit të femrave për qëllime seksuale, nenet 225(9) dhe 225(10) të Kodit Penal). Vepra penale, siç përcaktohet në nenin 225(4), është ndjekur penalisht vetëm një herë në një çështje të trafikimit të foshnjave me origjinë bullgare, ku u dhanë vetëm dëme simbolike.<sup>126</sup>

Më 13 shtator 2007, u miratua dekreti që trajtonte në mënyrë të shprehur të drejtat dhe mbrojtjen e viktimave të huaja të trafikimit të qenieve njerëzore. Shpresohet që viktimat e huaja të kenë më tepër mundësi të ushtrojnë të drejtat e tyre gjatë qëndrimit në territorin francez nëpërmjet zbatimit të këtij dekreti, i cili për herë të parë përfshin dispozita për një periudhë reflektimi për viktimat.<sup>127</sup>

---

<sup>123</sup> Ligji nr.2003-239, datë 18 mars 2003, neni 32, botuar në Fletoren Zyrtare e Francës më 19 mars 2003, ndryshuar nga Ligji nr. 2007-1631, datë 20 nëntor 2007, neni 22, Fletorja Zyrtare e datës 21 nëntor 2007.

<sup>124</sup> Kodi Penal Francez në anglisht gjendet në:

[http://www.legifrance.gouv.fr/html/codes\\_traduits/code\\_penal\\_textan.htm](http://www.legifrance.gouv.fr/html/codes_traduits/code_penal_textan.htm).

<sup>125</sup> Neni 225-4-4 i Kodit Penal.

<sup>126</sup> Gjykata gjeti që provat për njohjen e dëmeve më të mëdha nuk ishin të mjaftueshme: “*Conseil General i Seine Saint-Denis-it*, duke vepruar si administrator *ad hoc*, pretendon dëme si palë civile, për një prej viktimave të mitura të krimit të trafikimit të qenieve njerëzore. Padia u pranua nga gjykata për të gjitha veprat penale të pretenduara. Megjithatë, duke qenë se pala civile nuk ka siguruar mjete për vlerësimin e dëmit, gjykata çmoi se “ishte e vështirë t’i vlerësojë ato konkretisht mbi shumën 1 EUR.” Po ashtu, *Conseil General i Paris-it* ishte palë civile për njërin prej fëmijëve. Ishte e vështirë për gjykatën të “vlerësonte masën e dëmit që kishte pësuar fëmija dhe të llogarisnin dëmin dhe interesat e pretenduara, kryesisht nga prindër birësues në të ardhmen, përveç shumës 1 EURO.” Gjithashtu, atij i ishin dhënë dy shpërblime prej 2000 EUR sipas nenit 475-1 të Kodit Procedurës Penale.” Pjesë e shkëputur nga vlerësimi i MKR-së në Francë kryer nga ODIHR: *TGI Bobigny, 13<sup>ème</sup> chambre, Affaires Ministère Public c/ Sandov, Hristova, Landouer et autres, 2 février 2007*, tekst 17, faqe 15340. Për më shumë informacion mbi rastin në fjalë shih gjithashtu “*Dozens convicted in French trial over Bulgarian baby-trafficking network*” (“Dhjetra të dënuar në gjyqin francez në lidhje me rrjetin bullgar të trafikimit të foshnjave”), 2 shkurt 2007, *International Herald Tribune*.

<sup>127</sup> Dekreti nr. 2007-1352, 13 shtator 2007, mbi pranimin për qëndrim, mbrojtjen, pritjen dhe strehimin e të huajve që janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore dhe të shfrytëzimit për qëllime seksuale, duke ndryshuar gjithashtu kodin e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve dhe e të drejtave të azilit (dispozitat rregulluese (*Décret no.2007-1352 du 13 septembre 2007 relatif à l’admission au séjour, à la protection, à l’accueil et à l’hébergement des étrangers victimes de la traite des êtres humains et du proxénétisme et modifiant le code de l’entrée et du séjour des étrangers et du droit d’asile (dispositions réglementaires)*), botuar në Fletoren Zyrtare e Francës, 15 shtator 2007, teksti 17, faqe 15340. Për më shumë të dhëna mbi dekretin dhe zbatimin e tij shih vlerësimin e MKR-së në Francë kryer nga ODIHR.

Ka shumë organizma zyrtarë që merren me trafikimin dhe çështje të tjera të lidhura me të, duke përfshirë Zyrën Qendrore Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (*Office central pour la répression de la traite des êtres humaines* – OCRTEH), e cila është pjesë e Drejtorisë Qendrore të Policisë Gjyqësore (Ministria e Brendshme) dhe Zyra Qendrore për Luftën kundër Punës së Paligjshme (*Office central de la lutte contre travail illégal*), e cila është pjesë e drejtorisë së policisë kriminale të Xhandarmërisë Kombëtare.

Komuniteti i OJF-ve që merren me një sërë çështjesh në lidhje me viktimat e krimit, trafikimit të qenieve njerëzore, shfrytëzimin e fëmijëve, antisklavërinë, përkrahjen dhe mbrojtjen e personave “*sans papiers*” (emigrantët e parregullt) dhe viktimat e punës së detyruar, duke përfshirë edhe atë shtëpiake, është i gjerë dhe aktiv.<sup>128</sup>

### **5.2.2 Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

Franca ka një histori të gjatë të njohjes së të drejtave të viktimave, por vetëm që nga vitet 1980 janë marrë masa konkrete.<sup>129</sup> Masat institucionale, procedurale dhe ligjore të shumta përfshijnë krijimin e disa skemave dëmshpërblimi dhe forcimit të rolit të viktimave si paditës civilë. Ekziston dhe një rrjet agjencish, i vendosur prej kohësh, që u ofrojnë mbështetje viktimave të përgjithshme të krimit.

#### **5.2.2.1 Skemat shtetërore të dëmshpërblimit**

Që prej 6 qershorit 1990, viktimat e veprave penale të qëllimshme të dhunës (apo personat nën ngarkim e këtyre) gëzojnë status të veçantë dhe mund të përfitojnë “solidaritet kombëtar” nëpërmjet pagesës së dëmshpërblimit nga Fondi i Garancisë për Viktimat e Akteve të Terrorizmit dhe Veprave të tjera Penale (*Fonds de Garantie des victimes des acts de terrorisme et d'autres infractions* (FGTI)).<sup>130</sup> Këto administrohen nga Komisioni mbi Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimit (*Commissions d'Indemnisation des Victimes d'Infraction* - CIVI).<sup>131</sup>

---

<sup>128</sup> Ekziston dhe një koalicion i OJF-ve i përbërë nga 22 grupe, i cili organizon veprimtari në fushën e antitrafikimit. Shih <http://www.contrelatraite.org>.

<sup>129</sup> Në vitin 1982 Robert Badinter krijoi një komitet me kryetar Prof. Milliez për të studiuar pozitën e viktimave. Raporti i këtij komiteti çoi në krijimin e një sërë shërbimesh në mbështetje të viktimave dhe ndryshimesh procedurale. Për një përmbledhje të detajuar mbi historinë dhe mbi sistemin ligjor francez për viktimat, shih M.E.I Brienen dhe E.H.Hoegen, *Victims of Crime in 22 Criminal Justice Systems* (Viktimat e Krimit në 22 Sisteme të Drejtësisë Penale), Kapitulli 8 (2000), faqe 295 – 352, në adresën e *Internet-it*.

<sup>130</sup> Për informacion të detajuar shih <http://www.fondsdegarantie.fr/>.

<sup>131</sup> Ligji Nr. 77-5 datë 3 janar 1977 krijoi Komisionin për Dëmshpërblimin e Viktimave (CIVI). Ky ligji u ndryshua me Ligjet Nr. 81-82, datë 2 shkurt 1981, Nr. 83-608, datë 8 korrik 1983, Nr. 90-589, datë 6 korrik 1990 dhe Nr. 2000-516 datë 15 qershor 2000.



Që të kërkojë dëmshpërblimin, viktimat duhet ta ketë denoncuar krimin në polici. Megjithatë, nuk është e nevojshme që shkelësi i ligjit të jetë identifikuar apo të ketë qenë i dënues. Kur çështja penale është në gjykim, nuk është e nevojshme që çështja të ketë përfunduar. Gjithashtu, nuk është e nevojshme që të ngrihet padia civile ndaj shkelësit.

Për viktimat e krimeve të rënda ndaj personit, shpërblimi i dëmit jepet *i plotë*:

- a) kur vepra penale: shkakton vdekjen, paaftësinë e përhershme apo paaftësinë e plotë në punë për një muaj ose më shumë; ose
- b) kur vepra penale është përdhunim, marrëdhënie seksuale me dhunë, trafikim i qenieve njerëzore<sup>132</sup> ose veprat penale seksuale kundër një të mituri nën 15 vjeç.<sup>133</sup>

FGTI jep shumë pak të dhëna në lidhje me llojet e dëmeve që përbëjnë shpërblim “të plotë,” por shprehet se “merren parasysh të gjitha format e dëmit, si për viktimën e lënduar, ashtu edhe për trashëgimtarët e viktimës që nuk jeton më; dëm fizik, ekonomik, moral, etj.<sup>134</sup> Në informacionin e qeverisë franceze dhënë Komisionit Evropian, kjo përcaktohet si më poshtë:<sup>135</sup> “të gjitha humbjet ose dëmtimet që rezultojnë nga sulmi ndaj personit, me natyrë pasurore (në frëngjisht, “*patrimonial*”) apo jo,<sup>136</sup> siç përcaktohet nga legjislacioni francez mbi përgjegjësinë penale. Në rastet kur viktimat e krimit nuk përmbushin kriteret e përfitimit për marrjen e zhdëmtimit të plotë nga FGTI (p.sh., për veprat penale kundër personit që shkaktojnë paaftësi në punë deri në më pak se një muaj si dhe viktimat e veprave penale kundër pronës), ato kanë të drejtë të përfitojnë dëmshpërblim të kufizuar, nëse përmbushin kriteret, duke përfshirë dhe gjendjen e tyre financiare.<sup>137</sup> Në këto raste, në vitin 2008 dëmshpërblimi kufizohet në një masë jo më shumë se 3984 EUR.<sup>138</sup>

Skemat e dëmshpërblimit janë të vlefshme nëse vepra penale është kryer në territorin francez (Franca evropiane dhe ‘departamente’ përtej detit ose territoret e saj), dhe nga këto skema mund të përfitojnë:

---

<sup>132</sup> Shtuar në 2005 me Ligjin Nr. 2004-204 i datës 9 mars 2004, neni 169, Fletorja Zyrtare e Francës e datës 10 mars 2004, hyri në fuqi më 1 janar 2005.

<sup>133</sup> Përcaktuar nga Kodi francez i Procedurës Penale, neni 706(3).

<sup>134</sup> Shih informacionin në faqet e *Internet*-it <http://www.fondsdegarantie.fr/> .

<sup>135</sup> *EC European Judicial Network Pages on Compensation to Victims of Crime* (Faqet e Rrjetit Gjyqësor Evropian të KE-së mbi Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimit, në adresin e *Internet*-it [http://ec.europa.eu/civiljustice/comp\\_crime\\_victim/comp\\_crime\\_victim\\_fra\\_en.htm](http://ec.europa.eu/civiljustice/comp_crime_victim/comp_crime_victim_fra_en.htm) .

<sup>136</sup> “*Patrimonial*” i referohet humbjes së pësuar drejtpërdrejt ose nëpërmjet humbjes së anëtarit të familjes i cili fiton të ardhurat për familjen.

<sup>137</sup> Sipas Kodit francez të Procedurës Penale (KPrP) në nenin 706-14.

<sup>138</sup> Shih <http://www.fondsdegarantie.fr/> .

- a) Shtetasit francezë;
- b) Shtetasit e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian; dhe
- c) Shtetasit e vendeve të cilat kanë nënshkruar traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, shtetasit e huaj me leje qëndrimi të vlefshme në kohën e kryerjes së veprës ose në kohën e aplikimit.

Nëse vepra penale është kryer jashtë vendit, dëmshpërblimi mund të kërkohe vetëm nga personat me nënshtetësi franceze.

Masa e dëmshpërblimit mund të ulet ose të refuzohet, në rast se viktimja nuk arrin të provojë një lidhje të drejtpërdrejtë shkakësore midis krimit dhe humbjes ose dëmit. Në rast se faji është i viktimës, dëmshpërblimi mund të ulet ose të përjashtohet, p.sh., nëse viktimja ka përdorur fjalë fyese, ka marrë pjesë në përleshje ose ka marrë pjesë në veprimtari kriminale (*une activité delictueuse*).<sup>139</sup> Kjo vlen edhe për trashëgimtarët e viktimës së vdekur. CIVI bën gjithashtu zbritjen e shumës së marrë nga sigurimet shoqërore apo nga shoqëritë private të sigurimit. Masa e dëmshpërblimit mund të ulet nga çdo shumë tjetër që i është dhënë pretenduesit si palë civile në proces penal (shih më poshtë) ose viktimës mund t'i kërkohe të ripaguajë shumën, nëse merret më vonë nga kjo e fundit.

Është i rëndësishëm fakti që FGTI në emër të viktimës mund të padisë të pandehurin në procesin penal dhe është raportuar se zbatimi i vendimit në çështjet civile është më i mirë se në rastet kur padia për dëmshpërblim ngrihet vetëm nga viktimja, për shkak se ka një shkallë më të lartë bashkëpunimi midis gjykatave dhe FGTI-së sesa midis gjykatave dhe individëve.<sup>140</sup>

Është e nevojshme që kërkesa për dëmshpërblim të behët brenda tre vjetëve nga data e veprës penale ose brenda vitit, pas vendimit të formës së prerë në procesin penal, dhe Komisioni ka mundësi të shtyjë më tej këtë afat, nëse ka arsye të vlefshme. Kjo procedurë zbatohet pavarësisht nga lloji i dëmshpërblimit që kërkohe.

Me kërkesë të viktimës, mund të kryhet dhe pagesa paraprake e përkohshme. Kërkesa për dëmshpërblim duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

---

<sup>139</sup> “A titre d'exemple, la faute pourra être retenue en cas d'imprudence, d'injures proférées, de participation à une bagarre ou à une activité delictueuse.” (“Për shembull, faji mund të caktohet në rast të moskujdesjes, të fyerjeve, të pjesëmarrjes në një përleshje ose në një veprimtari që përbën kundërvajtje”) Faqja e Internet-it, e FGTI <http://www.fondsdegarantie.fr/> .

<sup>140</sup> Neni 706 9-11 KPrP dhe faqe 311, v. cit., shënim 129, Brienens dhe Hoegen.

- a) Datën, vendin dhe rrethanat e veprës penale (duke bashkëngjitur një kopje të kallëzimit, dokumente nga procesi penal etj.);
- b) Gjykatën ku është gjykuar vepra penale (duke bashkëngjitur një kopje të vendimit);
- c) Llojin e dëmtimeve, kohëzgjatjen e mungesës në punë (duke bashkëngjitur vërtetime mjekësore, shënime rreth sëmundjes, raporte të vizitave mjekësore);
- ç) Kërkesat jogyjqësore të bëra dhe çështjet gjyqësore e nisura, si dhe çdo shumë e paguar si formë dëmshpërblimi (duke bashkëngjitur mandate pagese të shumave për përballimin e jetës së përditshme, pensione, shuma të paguara nga autorët e veprës penale, shoqëritë e sigurimit etj);
- d) Shumën e dëmshpërblimit që kërkohet nga CIVI.

Nëse kërkesa bëhet për dëmshpërblim nga skema në lidhje me përmbushjen e kriterëve lidhur me gjendjen financiare (nenet 706-14 i KPrP), ajo duhet të përcaktojë gjithashtu burimet financiare të kërkuesit (të provuara nga vlerësimi i tatimit mbi të ardhurat për vitin e mëparshëm) dhe prova përse ai nuk është i siguruar si dhe të dhëna mbi ndonjë situatë të rëndë materiale ose psikologjike të shkaktuar nga vepra penale.

Kur kërkesa mbërrin në CIVI, shqyrtohet nga një magjistrat. Magjistratët kanë kompetenca të gjera: ndër të tjera, ata mund të kërkojnë nga gjykatat kopje të raporteve të veprave penale dhe dokumentacionin e procesit penal, edhe nëse këta janë ende në proces; ata mund të thërrasin dëshmitarë dhe mund të kryejnë hetime sipas dëshirës. Më pas dosja e plotë dërgohet nga CIVI tek FGTI. Më pas FGTI ka dy muaj kohë për t'i paraqitur një ofertë kërkuesit. Nëse kërkuesi e pranon ofertën, FGTI e dërgon marrëveshjen pranë kryetarit të CIVI-së, i cili e miraton, në mënyrë që të kryhet pagesa e dëmshpërblimit. Nëse kërkuesi nuk e pranon ofertën ose nëse FGTI e hedh poshtë shpërblimin e dëmit për arsye të cilat FGTI duhet t'i deklarojë, faza jogyjqësore mbaron dhe procedura vazhdon pranë CIVI-së. Në këtë rast, CIVI e dërgon kërkesën në Prokurori dhe tek FGTI për komente, të cilat jepen jo më vonë se dy javë para datës së caktuar për zhvillimin e seancës. Kërkuesi dhe FGTI duhen thirrur të paktën dy muaj para datës. Seanca nuk është publike. CIVI nxjerr një vendim ku urdhëron dëmshpërblimin ose e hedh poshtë kërkesën. Vendimi i CIVI-së u njoftohet kërkuesit dhe FGTI-së, dhe FGTI brenda një muaji pas njoftimit paguan dëmshpërblimin e rënë dakord.

Si kërkuesi, ashtu edhe FGTI kanë të drejtën e apelimit. Apeli duhet bërë nga një avokat brenda një muaji nga data e njoftimit të vendimit. Kërkesa për pagesë në gjykatë mund t'i

paraqitet Kryetarit të CIVI-së, i cili është i detyruar të përgjigjet brenda një muaji nga data e kërkesës.

Në vitin 2004, FGTI shqyrtoi 16 877 kërkesa. Shumat e paguara në vitin 2004 arrinin në 209 541 638 EUR,<sup>141</sup> dhe në të njëjtin vit, 32 milionë EUR u konfiskuan nga kriminelët.<sup>142</sup> Kjo do të thotë se 15% e buxhetit të përgjithshëm u rimor. Megjithatë, këtu nuk llogariten kostot e përgjithshme për funksionimin e skemës.

Skema ka një përparësi të ndjeshme, në faktin që ofron mundësinë që të kërkohet dëmshpërblimi kur nuk ka autor të veprës penale ose çështje penale në proces, dhe procedura është relativisht e thjeshtë. Në rastin e veprës penale të trafikimit, ofrohet ndihmë ligjore dhe dëmshpërblimi jepet i plotë (duke përfshirë dëmin moral si dhe atë material). Vetë skema për dëmet e shkaktuara mund të marrë përsipër rolin e paditësit ndaj autoreve të veprës, duke siguruar kështu përgjegjësinë e tyre për të paguar, por gjithashtu duke lehtësuar viktimën nga barra e zbatimit të vendimit të gjykatës civile.

Në rastin e zbatimit të kësaj skeme për viktimat e trafikimit, mund të lindin probleme. Një çështje që nuk ndiqet si vepër penale e trafikimit (neni 225-4 i Kodit Penal) nuk do të përfitonte automatikisht shpërblimin e plot të dëmit. Një rast i tillë do të përfitonte nga kjo skemë vetëm nëse kërkuesi është në gjendje të provojë që ai ka pësuar vuajtje që ka shkaktuar vdekje, paaftësi të përhershme apo paaftësi në punë për më shumë se një muaj.<sup>143</sup> Ky studim nuk ka gjetur asnjë rast ku viktimat e trafikimit të jenë dëmshpërblyer nga skema si viktima trafikimi.<sup>144</sup>

Ekziston një rast ku faktet janë të ngjashme me një rast trafikimi, por vepra penale është klasifikuar si “marrje e shërbimeve të papaguara nga një person në pozicion të pambrojtur.”<sup>145</sup> Në këtë rast, gjykata penale konstatoi se ishte ushtruar dhunë e

---

<sup>141</sup>Shih *EC Manual* (Manualin e KE-së) faqe 3

[http://ec.europa.eu/justice\\_home/judicialatlascivil/html/pdf/manual\\_cv\\_fra\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/justice_home/judicialatlascivil/html/pdf/manual_cv_fra_en.pdf) .

<sup>142</sup> Shih <http://www.fondsdegarantie.fr/>

<sup>143</sup> Shih <http://195.83.177.9/code/index.phtml?lang=uk> .

<sup>144</sup> Në prill 2008 ODIHR mori informacion nga Ministria e Drejtësisë se gjatë periudhës 1 janar 2007 dhe 31 dhjetor 2007, FGTI kishte deklaruar se kishin të drejtë të merrnin dëmshpërblim viktimat të trafikimit në pesë çështje. Përpara se studimi u dorëzua për botim, ishte e pamundur që të siguronim informacion të saktë mbi këto çështje, duke përfshirë faktet, klasifikimin ose jo si trafikim i qenieve njerëzore, nëse viktima kishin aplikuar ose jo për dëmshpërblim dhe nëse CIVI kishte marrë vendim. Shpresojmë se Ministria e Drejtësisë ose FGTI do t'i japin këtë informacion ODIHR-it në kuadrin e vlerësimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit në Francë.

<sup>145</sup> Neni 225(13) i Kodit Penal: marrja e shërbimeve të papaguara apo shërbimeve për të cilat kryhet një pagesë, e cila dukshëm nuk ka lidhje me rëndësinë e punës së kryer nga një person, pozicioni i pambrojtur i të cilit ose varësia është e qartë ose e ditur për autorin e veprës penale, dënohet me pesë vjet burgim dhe gjobë 150 000 EUR.

vazhdueshme. Për shkak të konstatimit të dhunës, CIVI kishte mundësi ta merrte në shqyrtim rastin. Pasi mori në shqyrtim provat mjekësore, sipas CIVI-së, viktima kishte të drejtë të dëmshpërblehej për shkak të paaftësisë së pjesshme (5%) në punë. Ata vendosën se kjo paaftësi ishte shkaktuar nga kërcënimet verbale, të cilat kishin shkaktuar probleme psikologjike. Ata theksuan në veçanti se viktima ndodhej në një situatë të vështirë ekonomike dhe materiale, dhe se ishte shkëputur nga shoqëria, që kishte shkaktuar vulnerabilitet shoqëror dhe psikologjik. Viktima mori dëmshpërblim prej 6 000 EUR.<sup>146</sup>

Viktima e trafikimit mund të hasë vështirësi të tjera që përfshijnë nevojën për të pasur leje qëndrimi në Francë. Viktima mund të mos ketë leje qëndrimi dhe jo për faj të saj (si rezultat i drejtpërdrejtë i veprës penale të trafikimit) ose mund të mos i jetë dhënë vizë e përkohshme. Autoritetet kanë një farë diskrecioni në çmimin e këtij problemi. Sipas kufizimeve të bazuara në “karakter,” kërkuesi duhet të mos ketë kryer vepra penale të dënueshme dhe është e paqartë nëse këtu përfshihen edhe ata që konsiderohen se kanë hyrë në Francë në mënyrë të paligjshme ose janë rezidentë të paligjshëm. Gjithashtu, kërkesat për dokumentacion janë thelbësore. Këto kërkesa kërkojnë që viktima patjetër të ndihmohet nga avokati.

### **5.2.2.2 Dëmshpërblimi nga gjykatat penale, civile dhe të punës**

#### *Proceset penale dhe civile*

Viktima e krimit ka të drejtë të marrë pjesë në proces si palë civile (*partie civile*). Neni 2 i Kodit të Procedurës Penale thotë se të gjithë ata që kanë pësuar dëm personal për shkak të kryerjes së veprës penale mund të ngrenë padi civile për dëmet e shkaktuara nga krimi, kundravajtja apo vepër penale tjetër. Mjafton që të provohet humbja ose dëmi i shkaktuar nga vepra penale që të kërkohet dëmshpërblimi, pa kufizim të shumës maksimale të kërkuar (neni 420 (1) KPrP). Dëmet mund të vendosen kundër atij që është i akuzuari për kryerjen e veprës penale bashkë me dënime të tjera penale, duke përfshirë burgimin.

Broshura e qeverisë me informacion për të drejtat e viktimave përshkruan llojet e dëmeve që mund të kërkojnë paditësit civilë:

- a) Dëme fizike ose mendore;

---

<http://195.83.177.9/code/index.phtml?lang=uk> .

<sup>146</sup> Dokumentacioni i çështjes janë marrët në frëngjisht nga Bénédicte Bourgeois e *Comité contre l'Esclavage Moderne* (CCEM). Vendimi u mor në nëntor 2005. Përkthimi është bërë nga autorja.

- b) Dëme për shkak të shqetësimit (*desagrément*), për shembull pamundësia për të ndjekur ndonjë veprimtari të zakonshme të jetës së përditshme, p.sh., sportin ose ndonjë argëtim tjetër;
- c) Dëme morale - të pamatshme, si, p.sh., humbja e njerëzve të dashur ose humbja e emrit të mirë, si dhe
- ç) Dëme materiale, si, p.sh., shkatërrimi ose dëmtimi i pronës.<sup>147</sup>

Megjithëse paditësi bëhet palë në proces, përgjegjësinë për të provuar çështjen e ka prokurori dhe/ose gjykatësi hetues. Megjithatë, viktima mund të përfaqësohet nga një avokat mbrojtës,<sup>148</sup> dhe shpenzimet e avokatit mund të kërkohen si pjesë e dëmshpërblimit, bashkë me shpenzime të tjera për ekspertët.<sup>149</sup> Pala civile ka një sërë të drejtash, si, p.sh., të drejtën për të paraqitur pretendimet përpara gjyqtarit dhe për të marrë në pyetje dëshmitarët,<sup>150</sup> të drejtën për t'u njoftuar për vendimet procedurale dhe informacion për kohën e zhvillimit të gjyqit,<sup>151</sup> si dhe të drejtën për të apeluar çdo vendim që cenon padinë civile.

Nëse merret pëlqimi i prokurorit, padia për shpërblimin e dëmit mund t'i jepet oficerit ose agjentit të policisë gjyqësore nga viktima gjatë hetimit. Kjo është zakonisht një deklaratë e thjeshtë e fakteve dhe e dëmeve. Oficeri bën regjistrimin zyrtar të deklaratës. Kjo mund të bëhet dhe me faks ose letër me postë rekomande dhe duhet të arrijë në gjykatë të paktën 24 orë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore. Duhet dhënë prova të dëmeve. Në këto raste, viktima nuk është e detyruar të jetë e pranishme në seancë. Megjithatë, viktima mund të kërkojë shpërblimin e dëmit duke qenë vetë e pranishme në gjykatë. Kërkesa mund të paraqitet që nga koha e hetimeve fillestare deri në ditën që gjykata jep vendimin.

Padia civile nuk mund të pranohet në rast se i pandehuri shpallet i pafajshëm për kryerjen e një veprë penale, përveç në dy lloj rrethanash: kur çështja është shqyrtuar në gjykatën penale rajonale (në frëngjisht, '*cour d'assises*'), kështu që fajësia e të pandehurit vendoset nga njerëz që nuk janë gjyqtarë ose magjistratë, ose kur i pandehuri ka një justifikim (*absolution*) për kryerjen e veprës penale.<sup>152</sup>

Kërkesa duhet të përmbajë shifra për humbje ose dëm, duke përfshirë dëme si materiale si dhe morale. Kjo duhet shoqëruar me prova me dokumente, p.sh., vërtetime mjekësore, raporte mjekësore për mungesë në punë, humbje të të ardhurave, fatura, vlerësime etj. Në

<sup>147</sup> *Les droits des victimes* (Të drejtat e viktimave), faqe 6.

<sup>148</sup> Neni 424 KPrP.

<sup>149</sup> Nenet 375, 475 e 543 KPrP.

<sup>150</sup> Neni 460 KPrP.

<sup>151</sup> Neni 391 KPrP.

<sup>152</sup> Nenet 372, 470, 541 KPP.

rastin kur pretendohet dëmtimi fizik, gjykata mund të caktojë një ekspert për vlerësimin e shkallës së dëmtimit, kryesisht ose me kërkesë të viktimës. Ndërkohë që pritet rezultati i shqyrtimit nga ekspertit, viktimia mund të përfitojë një shpërblim të përkohshëm.<sup>153</sup> Gjykata vendos pagesën e të gjitha dëmeve, pavarësisht nëse i pandehuri ka mjete të mjaftueshme financiare për të paguar të gjithë shumën. Gjyqtari i çështjes shpesh urdhëron që kryerja e pagesës të bëhet me këste, duke qenë se zakonisht ka shumë pak informacion në lidhje me të ardhurat e të pandehurit, përveç rasteve kur kjo ka qenë pjesë përbërëse e procesit të hetimit.

Pagesa e dëmeve nga i pandehuri, në qoftë se kryhet, mund të ketë ndikim pozitiv në vendime të tjera gjyqësore që lidhin me çështjen e tij. Për shembull autori i veprës penale mund të marrë një përgjigje pozitive për kërkesën për të shtyrë ose për të pezulluar dënimin me burgim. Pagesa e dëmshpërblimit mund të luajë një rol të rëndësishëm në marrëveshjet me ndërmjetësim (d.m.th., çështjet që nuk shkojnë në gjykatë, por zgjidhen paraprakisht midis autorit të veprës penale dhe viktimës, pas ndërmjetësimit të një ndërmjetësi gjyqësor). Prokurorët shpesh pushojnë akuzën, kur dëmshpërblimi kryhet pas ndërmjetësimit.<sup>154</sup>

Përndryshe, praktika më e zakonshme është që në fund të çështjes, viktimia dhe avokati i të pandehurit përpiqen të bien dakord në lidhje me pagesën, dhe nëse nuk merren vesh, zbatohen metodat e zakonshme të ekzekutimit të vendimit.<sup>155</sup> Për fat të keq, paditësi civil (si paditës privat) ka rolin kryesor në procedurat e ekzekutimit të vendimit ndaj të pandehurit që nuk do të paguajë. Shoqatat e avokatëve dhe të atyre që ndihmojnë viktimat ofrojnë shërbime për viktimat pas dhënies së vendimit dhe mund ta mbështesin ato gjatë procedurave të ekzekutimit të vendimit. Megjithatë, këto procedura janë të ndërlikuara dhe që të përfundohen me sukses, bashkëpunimi i agjencive shtetërore dhe të të pandehurit kërkohet. Nëse dënimi ndaj të pandehurit përfshin detyrimin për dëmshpërblim, atëherë përfaqësuesi i shërbimit të lirit me kusht ose i burgut duhet të lidhet me viktimën për të parë detajet praktike të rimbursimit (ose sipas udhëzimeve të qeverisë mbi të drejtat e viktimave, viktimia duhet të kontaktojë vetë burgun).<sup>156</sup> Në rastet kur i pandehuri vuan dënimin në burg, administrata e burgut hap automatikisht në emër të tij llogarinë bankare, e cila shërben për të menaxhuar burimet financiare të tij gjatë periudhës së burgimit. dhe një pjesë e këtyre parave i shkon automatikisht viktimës.<sup>157</sup> Viktimia mund të bëjë kërkesë edhe

---

<sup>153</sup> Neni 464 KPP.

<sup>154</sup> V. cit., shënim 129, *Viktimat e Krimit në 22 Sisteme Evropiane të Drejtësisë Penale*, S.7.1, kapitulli 8.

<sup>155</sup> Informacion nga Bénédicte Bourgeois e *Comité contre l'Esclavage Moderne*.

<sup>156</sup> *Les droits des victimes* (Të drejtat e viktimave), faqe 33, në [http://www.vos-droits.justice.gouv.fr/art\\_pix/guide\\_victime.pdf](http://www.vos-droits.justice.gouv.fr/art_pix/guide_victime.pdf).

<sup>157</sup> Neni 728-1 KPrP.

në zyrën e përmbartimit, e cila mund ta ndihmojë atë, duke negociuar ose duke konfiskuar paratë nga rroga ose llogaria bankare. Përmbartimi mund të kërkojë bashkëpunimin e prokurorisë, dhe mund të përdorë të dhënat e FICOBA-s (një bazë të dhënash për të gjitha llogarive bankare në Francë), duke bërë të mundur identifikimin e llogarive bankare të debitorit. Ky proces është i vështirë dhe sfidues për viktimën, së cilës mund t'i kërkohej të dhëna rreth autorit të veprës penale, të cilat viktimat nuk mund t'i sigurojnë. Pretendimet e viktimës shtrihen mbi pasuri të tjera të të pandehurit, por aftësia për ekzekutimin varet nga gjetja e vendndodhjes së të pandehurit dhe pasurive të tij, si dhe nga konfiskimi i tyre me ndihmën e prokurorëve.

Në praktikë, ushtrimi i këtyre funksioneve është shumë i vështirë, dhe prokurorët kanë treguar mungesë vullneti për të shpjeguar shkaqet.<sup>158</sup> Në vitet 1993 dhe 1998, sipas raporteve të Ministrisë së Drejtësisë, pagesa e dëmshpërblimit edhe pjesërisht ishte e kufizuar, dhe në vitin 2000, akademikët arritën në përfundimin se ekzekutimi i vendimeve gjyqësore mbetet “një problem madhor” në Francë.<sup>159</sup> CCEM ka të dhënat e një rasti ku gjyqtari përdori një metodë origjinale për të siguruar pagesën e dëmshpërblimit. Përpara ngritjes së padisë civile, ai urdhëroi të pandehurin të paguante 22 000 EUR si garanci për lirimin me kusht. Kjo shumë parash u mbajt nga gjykata dhe ishte automatikisht e disponueshme për të paguar dëmin prej 18 000 EUR dhe 4 000 EUR për shpenzimet ligjore në përfundim të çështjes.<sup>160</sup>

Ndonëse deri në fund të vitit 2006 nuk kishte raste konkrete trafikimi, ka pasur shumë raste vendimesh civile ku është njohur dëmshpërblimi në procesin penal të trafikimit, p.sh., shërbim shtëpiak i pavullnetshëm.<sup>161</sup> Është e paqartë nëse këto viktime kanë marrë dëmshpërblimin pavarësisht se u është njohur dëmi, meqenëse nuk ka qenë i mundur sigurimi i informacionit në lidhje me ekzekutimin e vendimeve:

“Çështja e Siliadinës:<sup>162</sup> një vajzë 15-vjeçare nga Togo e sollën në Francë për të punuar pranë një familjeje franceze, me premtimin se do ta dërgonin në shkollë dhe do t'i rregullonin statusin e emigrantit. Ajo nuk u pagua për punën e kryer, nuk u lejua të shkonte në shkollë dhe iu mor pasaporta. Pak kohë më pas “iu dha borxh” një familjeje tjetër (familja B) dhe u bë shërbyese, duke punuar nga ora 07.30 deri në 22.30, dhe i lejohej të dilte vetëm ndonjëherë për meshën e kishës të së dielës. Ajo

---

<sup>158</sup> V. cit., shënim 129, Viktimat e Krimit në 22 Sisteme Evropiane të Drejtësisë Penale, faqe 339-342.

<sup>159</sup> Po aty.

<sup>160</sup> Informacion nga Bénédicte Bourgeois e *Comité contre l'Esclavage Moderne*

<sup>161</sup> Shih p.sh. *Esclavage Encore – Actualité Juridique* (Ende skllavëri – Aktualitete Juridike): botimet e prill dhe nëntor 2006 (CCEM).

<sup>162</sup> Kjo çështje u dërgua në GjEDNJ në lidhje me legjislacionin penal, i cili u ndryshua më vonë; (Kërkesa Nr.73316/01 26 korrik 2005).



flinte në dhomën e foshnjës mbi një dyshek mbi dysheme, dhe duhej të kujdesej për foshnjën gjatë natës. Vajza arriti të largohej nga kjo situatë dhe të gjente një punë tjetër si shërbyese me rrogë të përshtatshme, por, nën presionin e familjes, u kthye tek familja B, e cila i premtoi se do t'i rregullonte statusin e emigrantit, gjë të cilën nuk e bënë, dhe rrethanat e tjera mbetën si më parë. Më pas vajza arriti të merrte pasaportën e saj dhe ia shpjegoi gjendjen ku ndodhej një fqinji, i cili ia raportoi atë një OJF-je. Pas ndërhyrjes së policisë, familja u ndoq penalisht dhe u dënua në shkallën e parë. Vajza mori dëmshpërblim në gjykatën civile (15 245 EUR). Në tetor të vitit 2003, gjykata e punës gjithashtu urdhëroi shpërblimin e kërkueses me një shumë që përfshinte 31 238 EUR të pagave të papaguara.

“*Çështja e Fatima O*, prill 2005:<sup>163</sup> një burrë u dënua me 12 vjet burg dhe gruaja e tij me 6 muaj burg, si edhe u urdhëruan të paguanin dëmshpërblim me vlerë 35 000 EUR dhe 15 000 EUR secili për skllavërimin e dy vajzave marokene dhe përdhunimin e njëres prej tyre. Zoti dhe zonja Oughalmi e kishin sjellë Fatimën nga Maroku, me anë të martesës së rreme me vëllanë e bashkëshortit. Kur ajo refuzoi të punonte si prostitutë, e rrahën shumë herë atë dhe më në fund ajo u arratis. Majda, vajza tjetër, ishte e mitur në atë kohë dhe dëshmoi se ishte detyruar me forcë që të ofronte shërbime seksuale për të shlyer detyrimin e hyrjes së saj ilegale në Francë.

“*Mimi Télé Mensah* u shpall fajtor në vitin 2006 nën akuzën e dhunës seksuale dhe ushtrimit të dhunës nëpërmjet torturës dhe veprimeve barbare. I pandehuri u dënua me gjashtë vjet burg dhe ishte urdhëruar të paguante 25 000 EUR dëme morale për secilën prej dy viktimave. Viktimat nga Togo, të cilat në fillim të ngjarjes qenë të mitura, u sollën në Francë me premtimin se do të punonin si dado, kundrejt pagesës dhe shkollimit. Ato nuk u paguan dhe nuk u dërguan në shkollë, dhe për vite të tërë iu nënshtruan poshtërimit, mbajtjes në izolim, rrahjeve dhe dhunës ekstreme.”<sup>164</sup>

Paditësit civilë kanë një sërë të gjatë drejtash në procesin penal, dhe si rezultat, shpërblimi i kënaqshëm për dëmet materiale dhe morale ka qenë urdhëruar për viktimat. Megjithatë, mesa duket dispozitat në lidhje me ekzekutimin e vendimeve nuk janë aq të forta sa duhet, në mënyrë që të sigurojnë që viktimat të marrin prej të pandehurve dëmshpërblimin edhe pjesërisht.

---

<sup>163</sup> Shih “FATIMA O. – APRES LE PROCES”, 21 prill 2005, në faqen e *Internet-it* CCEM. [www.esclavagemoderne.org/actujuridique.php?id=27](http://www.esclavagemoderne.org/actujuridique.php?id=27)

<sup>164</sup> Shih “*Olivia et mabelle: Esclavage en HLM*” në *Esclavage Encore* Nr. 29, korrik 2006 (CCEM), në adresën e *Internet-it* [http://www.esclavagemoderne.org/img\\_ee/ee29.pdf](http://www.esclavagemoderne.org/img_ee/ee29.pdf).

## *Procesi gjyqësor sipas së drejtës së punës*

Në Francë të gjithë punëtorët kanë formalisht mbrojtje në nivel minimal, edhe kur janë të punësuar në mënyrë të parregullt.<sup>165</sup> Neni 341-6 i Kodit të Punës shprehet se punëdhënësi është e vetmja palë përgjegjëse për marrjen në punë të punëtorit pa dokumente. Pra, punëtori pa dokumente shihet si viktimë, dhe kështu duhet të ketë mundësi që t'i drejtohet gjykatës për shkelje të të drejtave të tij nga ana e punëdhënësit. Kjo bazohet në prezumimin se punëdhënësi ka përfituar nga dhënia e pagës së ulët, shmangia e detyrimeve të sigurimeve shoqërore etj. Të drejtat e punëtorit rrjedhin nga ekzistenca e marrëdhënieve të punës me punëdhënësin.<sup>166</sup> Kështu, punëtori i parregullt ka të drejtë të ketë një rrogë të denjë (që nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e garantuar); pagesën e orëve të punës jashtë orarit; përfitime sipas marrëveshjes kolektive që ka punëdhënësi; dëmshpërblimin e ditëve të pushimit të paguara; si dhe pagesë në rast se përfundon marrëdhënia e punës (e cila nuk mund të jetë më pak se një pagë mujore).

Ka gjithnjë pengesa ligjore për të provuar se ka pasur një marrëdhënie pune midis punëdhënësit dhe punëtorit të parregullt. Mundësitë janë të kufizuara edhe kur ka prova me dëshmitarë, prandaj edhe konsiderohet si thelbësor shërbimi i këshillimit nga sindikata. Për të pasur shërbim të tillë, nuk është e nevojshme anëtarësia në sindikatë.

OJF-të GISTI<sup>167</sup> dhe PICUM raportojnë se gjykatat franceze janë gjithnjë e më tepër të prirura t'i konsiderojnë punëtorët pa dokumente si punëtorë të pavarur (*travailleurs indépendants*), veçanërisht kur ata punojnë në shtëpi. Kështu, ata kanë përgjegjësi ligjore dhe nuk konsiderohen si viktimë me të drejta. Parimi sipas të cilit emigrantët pa dokumente të punësuar në mënyrë të parregullt konsiderohen si viktimë, po zbatohet gjithnjë e më rrallë. Si rezultat, mbrojtja ligjore dhe kompensimi i pagave të papaguara po bëhen shumë më të vështirë për t'u siguruar.

Kur studiuesit e ILO-s intervistuan juristë francezë në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave, iu tha se megjithëse e drejta për të kërkuar dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të punës ekziston formalisht, nuk ka garanci që autoritetet e emigracionit nuk do ta shfrytëzojnë procesin për të arrestuar viktimën ose ta ndalur atë. Intervistat treguan se

---

<sup>165</sup> Informacion i marrë nga faqja e Internet-it e PICUM: <http://www.picum.org/article/basic-social-rights-france> dhe *Sans papiers mais pas sans droits* (Pa dokumenta, por jo pa të drejta), botimi i 4-t, (GISTI, qershor 2006), faqet 49-51, në adresën <http://www.gisti.org/doc/publications/2004/sans-papiers/index.html>.

<sup>166</sup> Kjo parashikohet në nenin L 341-6-1 të Kodit të Punës.

<sup>167</sup> V. cit., shënim 165, *Sans papiers mais pas sans droits*, faqe 51.

kishte pasur raste kur punëtorët e parregullt kishin marrë para, por për fat të keq nuk u dha asnjë rast konkret (megjithatë, shih më sipër çështjen *Siliadin*).<sup>168</sup>

Sipas CCEM-së, procedurat e së drejtës së punës janë përdorur për të kërkuar pagat e papaguara paralelisht me procedurën penale dhe, në këto linja, është zhvilluar praktika gjyqësore. Kjo procedurë mund të përdoret dhe në rastet kur punëdhënësi ka status diplomatik.<sup>169</sup>

### **5.2.2.3 Sekuestrimi i pasurisë**

Neni 225-25 i Kodit Penal francez jep mundësinë e konfiskimit të pasurive të autorëve të veprave penale si një masë plotësuese dënimi në veprat e penale të trafikimit (seksioni 1 bis dhe 2 i kapitullit V të Kodit Penal). Ai përfshin “konfiskimin e një pjese apo të të gjithë pasurisë, të çdo lloji, të luajtshme ose të paluajtshme, në pronësi individuale ose të përbashkët.” Në një çështje të kohëve të fundit të trafikimit të foshnjave, prokurori e kërkoi këtë masë dënimi për autorin e veprës penale, por ajo nuk u pranua nga gjykata.<sup>170</sup>

### **5.2.2.4 Ndhimja për viktimat**

Nenet 53(1) dhe 75 të Kodit të Procedurës Penale shprehen se organet hetimore të policisë duhet të informojnë viktimat në lidhje me të drejtat e tyre. Kjo përfshin veçanërisht të drejtën për të përfituar dëmshpërblim për humbjet dhe vuajtjet e pësuarat. Viktimat e trafikimit që janë të huaj të mitur, dëshmitarë dhe paditës civilë kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë ligjore. Kjo ndihmë ligjore duhet të jepet që prej fillimit të procesit, dhe drejtoria e hetimit e policisë është e detyruar që të informojë viktimën mbi të drejtën e saj për të pasur ndihmë ligjore, që në fazën e parë të hetimit dhe ndjekjes penale.

Deklarata e të Drejtave të Viktimës e vitit 2002, edhe pse nuk përmban shumë të dhëna të hollësishme, përvijon informacionin bazë për viktimat. Kohët e fundit, Ministria e Drejtësisë ka nxjerrë udhëzues prej 40 faqesh për të drejtat e viktimave, i cili trajton të gjitha çështjet mbi dëmshpërblimin, padinë civile dhe ndihmën ligjore.<sup>171</sup>

---

<sup>168</sup> Gao Yun dhe Veronique Poisson, *Le trafic et l'exploitation des immigrants chinois en France* (ILO, mars 2005), faqe 106.

<sup>169</sup> Informacion nga Bénédicte Bourgeois e *Comité contre l'Esclavage Moderne*.

<sup>170</sup> TGI Bobigny 13<sup>ème</sup> chambre, *Affaires Ministère Public c/Sandov, Hristova, Landouer et autres*, 2 shkurt 2007. Falënderojmë Georgina Vaz Cabral për informacionin në këtë paragraf.

<sup>171</sup> V. cit., shënim 156, Të drejtat e viktimave (*Les droits des victimes*).

Ligji i vitit 2003 mbi Sigurinë e Brendshme bën të mundur që viktimat e trafikimit të përfitojë leje qëndrimi dhe leje punësimi në bazë të disa kriterëve kufizuese, që përfshijnë kushtin për të bashkëpunuar me organet hetimore.<sup>172</sup> Në vitin 2006 këto dispozita u zbutën disi, duke mundësuar viktimën të merrte lejeqëndrimi që quhet *permis de sejour* (dhe jo *autorisation de sejour*, e vlefshme vetëm për 3 muaj), duke i dhënë kështu më tepër siguri viktimës. Megjithëse legjislacioni nuk përcakton kohëzgjatjen e vlefshmërisë të këtij lejeqëndrimi, dekreti i shtatorit 2007 përcakton se leja do të jetë e vlefshme për të paktën gjashtë muaj dhe mund të përtërihet për kohëzgjatjen e procesit penal.<sup>173</sup>

Ministria për Punësim dhe Solidaritet Social si dhe autoritetet vendore të Parisit financojnë strehimin dhe mbrojtjen e individëve, ndërmjet të cilëve dhe disa viktimat e trafikimit që kanë nevojë për një mjedis të sigurt. Një OJF, *Accompagnement Lieux d'accueil Carrefour éducatif et social* (ALC), financohet për të koordinuar referimin e viktimave në shtëpi të sigurta (duke përdorur kapacitetet e rrjetit të strehëzave *Accueil Sécurisant* (Ac.Sé)).<sup>174</sup> Ndonëse ky është një zhvillim pozitiv në bashkëpunimin e shtetit me OJF-të, shkalla dhe ndikimi i tij janë të kufizuara. Gjatë periudhës shkurt 2002 deri në gusht 2007, 323 persona u referuan për strehim të sigurt pranë shoqatës Ac.Sé, dhe 235 u strehuan përfundimisht.<sup>175</sup>

Në të gjithë vendin, numërohen 150 organizata të pavarura në mbështetje të viktimave, shumica e të cilave janë pjesë e rrjetit kombëtar të agjencive që njihet si INAVEM (*Institut national d'aide aux victimes et de médiation*).<sup>176</sup> INAVEM ka hapur dhe një linjë telefonike falas për këshillim (08VICTIMES), e cila në vitin 2005 mori 28 300 kërkesa. Këshillimi jepet dhe nëpërmjet postës elektronike. Organizatat në nivel qendror dhe vendor marrin financim nga shteti (në 2004 kostot e përgjithshme të rrjetit INAVEM dhe të anëtarëve të tij ishin 17.6 milionë EUR). Këshillimi përfshin këshilla dhe ndihmë për t'iu drejtuar shërbimeve mjekësore, ligjore, psikologjike dhe sociale dhe jepet falas. Duke qenë agjenci kombëtare, INAVEM merret dhe me koordinimin e çështjeve të viktimave, nxit ndryshimin e politikave

---

<sup>172</sup> Shih gjithashtu Ligj no. 2006-911 datë 24 korrik 2006 mbi emigrimin dhe integrimin (*Loi no. 2006-911 du 24 juillet 2006 relative à l'immigration et à l'intégration*).

<sup>173</sup> Neni 1, seksioni 1, Dekreti nr. 2007-1352, 13 shtator 2007, mbi pranimin për qëndrim, mbrojtjen, pritjen dhe strehimin e të huajve që janë viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të shfrytëzimit për qëllime seksuale, duke ndryshuar gjithashtu kodin e hyrjes dhe të qëndrimit të të huajve dhe e të drejtave të azilit (dispozitat rregulluese (*Décret no 2007-1352 du 13 septembre 2007 relatif à l'admission au séjour, à la protection, à l'accueil et à l'hébergement des étrangers victimes de la traite des êtres humains et du proxénétisme et modifiant le code de l'entrée et du séjour des étrangers et du droits d'asile (dispositifs réglementaires)*), botuar në Fletoren Zyrtare e Francës, 15 shtator 2007, teksti 17, faqe 15340.

<sup>174</sup> Për më shumë informacion rreth ALC-së dhe shoqatës Ac-Sé, shih [www.acse-alc.org](http://www.acse-alc.org).

<sup>175</sup> Coordination Ac-Sé, Association ALC, *Conférence de lancement du Guide pratique - Identifier, accueillir et accompagner les victimes de la traite des êtres humains* (Konferenca për inaugurimin e Udhëzuesit praktik: Identifikimi, pritja dhe shoqërimi i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore), 26 shtator 2007.

<sup>176</sup> Për më shumë informacion shih <http://www.inavem.org>

dhe rrit ndërgjegjësimin mbi të drejtat dhe nevojat e viktimave, veçanërisht të profesionistëve që punojnë me viktimat. Nuk mund të vërtetohet që organizata ka përvojë të veçantë me viktimat e trafikimit. Megjithatë, njohuritë e tyre duhet t'u shërbejnë atyre grupeve.

Personat me status të parregullt dhe viktimat e trafikimit mund të përfitojnë ndihmë ligjore falas nga rrjeti i gjerë i OJF-ve, shumë prej të cilave brenda personelit të tyre kanë ekspertë ligjorë ose avokatë apo njerëz të cilët, për ndihmë ligjore falas, mund t'i bëjnë referim tek ekspert ligjor ose avokat. Jo të gjitha këto organizata punojnë në mënyrë të veçantë me trafikimin, por me çështje të lidhura me të, p.sh., CODETRAS është një grup i përbërë nga disa OJF që punojnë në mbështetje të punëtorëve të bujqësisë. Ndihma ligjore ofrohet nga një prej anëtarëve të këtij grupi, ESPACE; GISTI (*Groupe d'information et de Soutien et des immigrants*) mbështet të drejtat e emigrantëve, dhe CCEM (*Comité contre l'esclavage moderne*) punon me punëtorët e shfrytëzuar në kushte të skllavërisë dhe kushte të ngjashme me skllavërinë.

### **5.2.3 Përfundime për Francën**

Franca ka skema të zhvilluara për kërkimin e dëmshpërblimit nga shteti dhe nga i pandehuri dhe në këtë drejtim paraqet disa shembuj pozitivë të praktikave të mira. Ofrohet ndihma ligjore falas, dhe ka një sërë OJF-sh aktive dhe me përvojë. Megjithatë, skemat nuk u janë përshatur nevojave të viktimave të trafikimit dhe pothuajse nuk ekziston ndjekja penale e trafikimit. Kjo do të thotë që në praktikë, mundësia e përfitimit të dëmshpërblimit është e kufizuar. Ka edhe probleme të tjera në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile, që do të thotë se ndonëse dëmshpërblimi shpesh njihet, pagesa rrallë kryhet. Kjo krijon një barrë të rëndë për viktimën, e cila vetë duhet të marrë masat e nevojshme për të marrë paratë, përveç rasteve kur gjyqësori dhe avokatët janë në gjendje dhe kanë vullnet për të qenë origjinalë në gjetjen e rrugëve për sigurimin e pagesës. Praktikrat e ekzekutimit të vendimit gjyqësor janë veçanërisht të vështira për t'u ndjekur, nëse viktima nuk jeton më në Francë (p.sh., pas përfundimit të afatit të lejes së qëndrimit).

Të gjitha kategoritë e punëtorëve pa dokumente në Francë janë mbrojtur historikisht nga e drejta e punës, por OJF-të tashmë kanë më pak besim se sistemi mund të përdoret pa rrezikun që të dhënat e tyre t'u shkojnë autoriteteve të emigracionit. Ekzistojnë procedura për të përfituar pagat e papaguara, dhe OJF-të i kanë përdorur gjerësisht ato paralelisht me procesin penal.

#### **5.2.4 Praktika të mira në Francë**

- Pagesat e përkohshme jepen nga skema shtetërore e dëmshpërblimit;
- Skema shtetërore e dëmshpërblimit mund të ngrejë padi ndaj autorit të veprës penale në procesin civil;
- Skema shtetërore bën njohjen e plotë të dëmeve;
- Dhuna psikologjike njihet si formë e dhunës nga skema shtetërore;
- Në padinë civile brenda procesit penal, nuk është e nevojshme që padia të ngrihet në fillim të procesit, por mund të ngrihet deri në ditën e fundit të gjykimit;
- Policia ka detyrim ligjor t'u ofrojë viktimave informacion mbi të drejtat e tyre;
- Gjykatat e pranojnë parimin e pagesës së shumave të mëdha për dëmin moral;
- Viktimat mund të marrin pjesë në procesin penal si palë civile dhe mund të përfitojnë ndihmë ligjore falas;
- Parat e paguara nga i pandehuri si garanci për lirim me kusht mund të përdoren për shpërblimin e dëmit;
- Komuniteti i OJF-ve që mbështesin një shumëllojshmëri viktimash është i gjerë dhe aktiv dhe ka disa shembuj partneriteti midis OJF-ve dhe agjencive shtetërore;
- Po zhvillohet praktika gjyqësore në lidhje me paditë penale dhe sipas së drejtës së punës. Gjykata e punës urdhëroi pagesën e pagave të papaguara në çështjen Siliadin që ishin pothuajse dy herë më të larta se dëmshpërblimi që u dha në çështjen penale.

### **5.3 MOLDAVIA**

#### **5.3.1. Kuadri ligjor dhe institucional**

Moldavia është shtet palë në konventat kryesore ndërkombëtare të lidhur me trafikimin dhe punën e detyruar. Ajo ka nënshkruar gjithashtu Konventat Evropiane kundër Trafikimit, por Konventën Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme ende jo, megjithëse nënshkrimi është parashikuar.<sup>177</sup> Ajo nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, por ka një Marrëveshje Partneriteti dhe Bashkëpunimi me BE-në dhe ka marrë pjesë në

---

<sup>177</sup> Shih Paragrafin 1.2 lidhur me angazhimin e Planit Veprimi Kombëtar.

Planin e Veprimit e hartuar nga Komisioni Evropian si pjesë e Politikës Evropiane të Fqinjësisë.<sup>178</sup>

Që prej vitit 2000, një zyrë e specializuar e prokurorisë heton trafikimin dhe rastet e lidhura me të. Kodi Penal i vitit 2002 penalizon trafikimin në nenet 165 dhe 206 dhe Gjykata e Lartë ka nxjerrë një komentuar gjithëpërfshirës mbi natyrën dhe kuptimin e kësaj vepre penale.<sup>179</sup> Ekziston gjithashtu ligji për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore,<sup>180</sup> i cili miraton një plan veprimi kombëtar. Komiteti Kombëtar është krijuar për të zbatuar planin kombëtar të veprimit. Ai përcakton funksionet e organizmave të tjerë të administratës publike dhe të ministrive, si dhe të agjencive zbatuese të ligjeve për sa i takon trafikimit të personave. Ai përcakton një mori mjetesh mbrojtëse, masash për ndihme dhe angazhimesh për rehabilitimin e personave të trafikuar, shumë prej të cilave parashikohet që të zbatohen nga OJF-të.<sup>181</sup>

Më 8 dhjetor 2006 u miratua vendimi i qeverisë, i cili krijoi Rregulloren Kuadër për Qendrat e Ndihmës dhe Mbrojtjes ndaj Viktimave të Trafikimit. Rregullorja u hartua me nismën e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me qëllim zbatimin e ligjit kundër trafikimit të miratuar në vitin 2005. Ajo parashikon hollësi lidhur me krijimin dhe administrimin e Qendrave Territoriale të Ndihmës dhe Mbrojtjes; tërësinë e shërbimeve që ato do të ofrojnë; si dhe parashikon që qeveria dhe autoritetet e administratës publike vendore do t'u sigurojnë qendrave fonde nga buxheti qendror dhe vendor. Përfitues të shërbimeve të qendrave do të jenë viktimat e trafikimit dhe viktimat e mundshme, si dhe fëmijët e viktimave.<sup>182</sup>

Më 6 shtator 2005, qeveritë e Moldavisë dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nënshkruan një marrëveshje për të punuar së bashku me qëllim krijimin e Qendrës Ndërinstitucionale për Luftën kundër Trafikimit të Personave. Kjo njësi e posaçme e zbatimit të ligjit përqendrohet në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore. Ajo më parë ishte e vendosur brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe tani është përfshirë në Qendrën e re. Qendra përfshin programin për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe një zyrë analitike. Një nga

---

<sup>178</sup> [http://eeas.europa.eu/moldova/index\\_en.htm](http://eeas.europa.eu/moldova/index_en.htm)

<sup>179</sup> Nr. 241-XVI datë 20 tetor 2005 dhe nr. 164-167/812 datë 9 dhjetor 2005, Monitori Zyrtar i Republikës të Moldavisë.

<sup>180</sup> Nr. 241-XVI datë 20 tetor 2005 dhe nr. 164-167/812 datë 9 dhjetor 2005, Monitori Zyrtar i Republikës të Moldavisë.

<sup>181</sup> Për kopje të ligjeve përkatëse, Plan Veprimi Kombëtar, etj., shih "Trafficking in Human Beings in Moldova Normative Acts" ("Trafikimi i Qenieve Njerëzore në Moldavi Akte Normative") (OSCE/La Strada, 2006) në [http://www.osce.org/documents/mm/2006/06/19678\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/mm/2006/06/19678_en.pdf).

<sup>182</sup> Proçesverbali i Takimit Teknik Koordinues të kryesuar nga Misioni i OSBE-së në Moldavi, dhjetor 2006.

qëllimet e elementit të mbrojtjes së dëshmitarëve është edhe pasurimi i shërbimeve për mbrojtjen e viktimës, duke përfshirë këshillimin përgjatë procesit ligjor.

Ekziston një komunitet aktiv OJF-sh që punojnë për të ofruar ndihmë efikase dhe mbështetje ndaj personave të trafikuar. Këtu përfshihen La Strada, Komiteti për Parandalimin e Trafikimit të Grave dhe një strehëz e IOM-it. Ato merren edhe me mbrojtje ligjore, me studime dhe zbatime të shërbimeve për personat e trafikuar përmes një mekanizmi referimi.

### **5.3.2. Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

Ligji për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në thelb rithekson të drejtat ekzistuese ligjore për dëmshpërblim dhe nuk shkon më tej se kaq:

“Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë të drejtë të dëmshpërblehen për dëmet e pësuar, siç parashikohet në ligj.”<sup>183</sup>

Megjithatë, Plani i Veprimit Kombëtar për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>184</sup> synon të vendosë parashikime ligjore për mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit nga trafikantët apo nga shteti<sup>185</sup> dhe të garantojë zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që mundësojnë marrjen e dëmshpërblimit.<sup>186</sup> Dëmshpërblimi nga shteti synohet që të arrihet

“duke rimbushur fondin për shpërblimin e personave të trafikuar me mjete monetare të siguruar nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme prej trafikantëve.”

Një synim tjetër është që të:

“rritet niveli i njohurive të viktimave për sa u takon mundësive të dëmshpërblimit [...duke] u siguruar personave të trafikuar ndihmë ligjore me avokatë në të gjitha shkallët e procesit penal,” si dhe “duke u ofruar materiale informuese lidhur me të drejtat dhe mundësitë e marrjes së dëmshpërblimit gjatë procesit penal.”

---

<sup>183</sup> Neni 23(2)

<sup>184</sup> Miratuar me Vendimin e Qeverisë nr. 903, datë 25 gusht 2005 dhe botuar në Monitorin Zyrtar nr.119-122/987, datë 7 shtator 2005.

<sup>185</sup> Paragrafi 1.2(e).

<sup>186</sup> Paragrafi 4.4.



Megjithëse përgjegjësia lidhur me këtë çështje u takon organeve shtetërore, pjesa më e madhe e këtij funksioni është kryer nga OJF-të, ndërkohë që qeveria nuk i ka përmbushur përgjegjësitë e saj. Kjo gjendje mund të ndryshojë me veprimtarinë e Qendrës së re.<sup>187</sup>

### **5.3.2.1. Skemat shtetërore të dëmshpërblimit**

Pavarësisht nga angazhimet në Planin Veprimi Kombëtar (PVK), nuk ekzistojnë plane konkrete deri më tani për një skemë dëmshpërblimi të financuar nga shteti apo fond nga pasuritë e trafikantëve për të financuar zhdëmtimin e viktimave të trafikimit.

Deri në vitin 2005, Neni 60(1) i Kodit të Procedurës Penale parashikonte garanci shtetërore për shlyerjen e dëmeve morale dhe materiale të shkaktuara nga veprat penale, duke përfshirë këtu trafikimin e qenieve njerëzore. Ky nen është shfuqizuar.

### **5.3.2.2 Dëmshpërblimi i dhënë nga gjykatat civile, penale dhe të punës**

*Proceset civile dhe penale*<sup>188</sup>

Sipas Kushtetutës së Moldavisë:

“çdo individ ka të drejtë për zhdëmtim efektiv nga gjykatat kompetente kundrejt veprave që shkelin të drejtat, liritë dhe interesat e tij të ligjshme.”<sup>189</sup>

Gjykata penale mund t’u kërkojë të pandehurve të dënuar që të “japin mbështetje financiare për familjen e viktimës” dhe të dëmshpërblejnë viktimën për dëmet e shkaktuara brenda afatit të caktuar nga gjykata.<sup>190</sup> Padia mund të jetë për dëme morale dhe materiale, siç përcaktohet në nenin 219 të Kodit të Procedurës Penale të Moldavisë:

---

<sup>187</sup> Detyrimet u përkasin Prokurorisë së Përgjithshme dhe Komitetit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, siç raportohet në ABA CEELI “*Human Trafficking Assessment Tool Moldova Report*” (Raporti i Modelit për Vlerësimin e Trafikimit Njerëzor – Moldavia), qershor 2005, f. 86.

<sup>188</sup> Kjo pjesë mbështetet në masë të madhe në materialin e Lori J. Mann dhe Igor Dolea, *OSCE Trial Observation Manual for the Republic of Moldova* (OSBE Manuali i Vëzhgimit të Gjyqeve për Republikën e Moldavisë) (OSCE, 28 shkurt 2006), i cili gjendet në: <http://www.atnet.md>.

<sup>189</sup> Neni 20(1) mbi mundësinë për t’iu drejtuar lirshëm organeve të drejtësisë.

<sup>190</sup> Neni 90(6)(d), (e), Kodi Penal i Moldavisë.

- “(2) ...1) Kthimi në natyrë i pasurive apo kundravleftës së pasurive të humbura apo të shkatërruara si pasojë e faktit të ndaluar nga legjislacioni penal;
- 2) Shpërblimi për shpenzimet e sigurimit të pasurive të humbura apo të shkatërruara apo për të rivendosur cilësinë, imazhin tregtar, si dhe zhdëmtimin për pasuritë e dëmtuara;
  - 3) Dëmshpërblim për fitimin e munguar si pasojë e veprave të ndaluara nga legjislacioni penal;
  - 4) Zhdëmtim i dëmeve morale si dhe, në disa raste, të dëmtimit ndaj emrit të mirë në profesion.

(3) Dëm material quhet ai dëm i lidhur me kryerjen e një veprimi të ndaluar nga e drejta penale, atëherë kur mund të përkthehet në shpenzime për:

- 1) Trajtimin dhe përkujdesjen e palës së dëmtuar;
- 2) Varrimin e palës së dëmtuar;
- 3) Pagesën e sigurimeve, zhdëmtimeve dhe pensioneve;
- 4) Zbatimin e kontratës së depozitimit të pasurive.

(4) Për të caktuar sasinë e zhdëmtimit monetar të dëmit moral, gjykata merr në konsideratë vuajtjen fizike të viktimës, dëmin estetik, humbjen e shpresës në jetë, humbjen e besimit të besnikëria bashkëshortore, humbjen e nderit nga shpifja, vuajtjen psikologjike të pësuar nga vdekja e të afërmeve, etj.”

Këto janë përkufizime mjaft të zgjeruara të dëmeve që do të përfshinin paga të papaguara dhe vuajtje fizike. Kështu, ato u mundësojnë viktimave liri të gjerë veprimi për t’u kërkuar dëmshpërblim, si dhe gjyqtarëve hapësirë të mjaftueshme ligjore për të dhënë dëmshpërblim në rast se ka prova të mjaftueshme për dëmet.

Procedura penale vendase bën dallimin e “viktimës së një krimi,” “palës civile,” “palës së dëmtuar” dhe “dëshmitarit.” Tërësia e të drejtave procedurale të të interesuarit varet nga ky status. Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë të njihen si palë e dëmtuar apo palë civile.<sup>191</sup>

---

<sup>191</sup> Sipas OJF-së CPTW, Raporti i Veprimtarive 2003-2006 f.19, kategorizimi i viktimave të trafikimit të përfaqësuar prej tyre grupohet si vijon:

“*Si viktimë* – të numrit total të personave të trafikuar, vetëm 22% u pranuan në gjykim si viktimë, shumë e cila është një e pesta e personave të trafikuar.

*Si persona të dëmtuar* – 79% e numrit total të personave të trafikuar u pranuan në gjykim si persona të dëmtuar. Një në çdo pesë persona të trafikuar (10%) është konsideruar në gjykim si person i dëmtuar disa herë. Si pasqyron kjo kategoritë e dhëna më lart?

*Si palë civile* – janë pranuar në gjykim ato viktimë që kërkuar përcaktimin dhe dëmshpërblimin për dëme të shkaktuara ndaj tyre nga krimi. Pra, përbëjnë 85% të numrit të përgjithshëm të viktimave”.

“Viktima” përkufizohet si një person fizik apo juridik që pëson dëme morale, fizike apo materiale si pasojë e një krimi. Kërkohej që viktima të bëjë kërkesë para autoriteteve ligjore me qëllim që të regjistrohet zyrtarisht si viktimë e krimit.<sup>192</sup> (Nuk ekziston ndonjë dispozitë në nivel kombëtar që t’i njohë si viktima personat e lidhur me viktimën kryesore.) Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë informacion nga organi i akuzës apo nga gjykata për sa u takon vendimeve që merren në lidhje me të drejtat dhe interesat e tyre.<sup>193</sup>

Gjithashtu, viktimat kanë të drejtë, sipas procedurës penale, të njihen si “palë civile” në një padi civile brenda procesit penal kundër të njëjtit autor.<sup>194</sup> Kjo i mundëson viktimës të kërkojë zhdëmtim për pasoja morale apo materiale të shkaktuara nga krimi dhe çështja.<sup>195</sup> Si palë civile, viktima mund të kërkojë kthim të pronës që i është marrë nga autoritetet me pëlqimin e viktimës për t’u përdorur si provë përgjatë procesit, si dhe kthim të pronës që i është marrë nga autori i krimit.<sup>196</sup>

Gjithashtu, viktimat mund të njihen si “palë e dëmtuar,” d.m.th., personi fizik që vuan pasojat morale, fizike apo materiale të shkaktuara nga krimi. Organi i hetimit lëshon një urdhër, në përputhje me ligjin, dhe e njeh personin si palë të dëmtuar menjëherë, pasi ka përcaktuar arsyet për ta bërë këtë kategorizim dhe pasi viktima ka dhënë pëlqimin e saj.<sup>197</sup> Ndërkohë që palës së dëmtuar i njihen këto të drejta të tjera, ajo merr përsipër gjithashtu detyrimin për të bërë deklaratë para policisë, prokurorëve dhe gjykatës.

Si palë zyrtarisht pjesëmarrëse në çështjen, palët civile dhe të dëmtuara kanë të drejtën për të bërë deklaratë dhe të ngrenë akuza para gjykatës, si dhe të paraqesin dokumente dhe prova të tjera për shqyrtim nga gjykata. Ato kanë të drejtë të kundërshtojnë veprimet e ndërmarra nga organi i hetimit apo gjykata. Gjithashtu, ato lejohen të marrin pjesë në procedimet që lidhen me dëmet.<sup>198</sup>

Pasardhësit përfitues të palëve të dëmtuara ose civile kanë të njëjtat të drejta, ashtu si edhe të viktimat e ndjera.<sup>199</sup> Viktimave që kanë statusin e palëve të dëmtuara ose civile, ose

---

(Megjithatë, këto shifra mund të përfshijnë numërim të dyfishtë, pasi viktimat mund të kenë më shumë se një status në të njëjtën kohë.)

<sup>192</sup> Neni 58(1), (2), Kodi i Procedurës Penale i Moldavisë (“KPrP i Moldavisë”).

<sup>193</sup> Neni 58(3) dhe 62, KPrP i Moldavisë.

<sup>194</sup> Neni 58(3), (6), KPrP i Moldavisë.

<sup>195</sup> Neni 61, KPrP i Moldavisë.

<sup>196</sup> Neni 62 (1) (20), KPrP i Moldavisë.

<sup>197</sup> Neni 59 (1)-(2), KPrP i Moldavisë.

<sup>198</sup> Neni 60 and 62, KPrP i Moldavisë.

<sup>199</sup> Neni 81, KPrP i Moldavisë.

dëshmitarëve, duhet t'u ofrohet mundësia e rimbursimit të shpenzimeve të kryera gjatë pjesëmarrjes në procesin penal.<sup>200</sup> Kjo përfshin pagesën e shpenzimeve për dëshmitarët që jetojnë në një shtet tjetër, për udhëtimin e tyre, si dhe të shpenzimeve për vendosjen e komunikimeve teknologjike, si për shembull lidhjet me telefon apo video.

Kodi i procedurës penale kërkon që të gjitha vendimet gjyqësore të dënimit duhet të përfshijnë, ndër të tjera, disponimin e padisë civile në qoftë se padia e tillë është ngritur. Gjithashtu, kodi i jep gjykatës kompetencë për të marrë vendimin lidhur me zhdëmtimin e dëmeve materiale si dhe vendimin lidhur me konfiskim të veçantë pavarësisht nga fakti nëse viktima ka paraqitur ose jo një kërkesë padi për këtë.<sup>201</sup> Gjykata është kompetente edhe për të ndarë padinë civile dhe t'ia dërgojë atë gjykatës civile për zgjidhje.

Mundësitë e shumta për të patur status në gjykatën penale mund të duken çorientuese dhe në praktikë mund të kërkohej që viktima detyrohet të dëshmojë disa herë. Megjithatë, këto statuse u japin viktimave legjitimitimin dhe mundësojnë praninë e tyre në procesin gjyqësor.

Në përgjithësi, Kodi i Procedurës Penale kërkon që të gjitha vendimet e gjykatave të jenë përfundimtare, para se ato të ekzekutohen.<sup>202</sup> Për çdo vendim, gjykata i lëshon paditësit një urdhër ekzekutimi.<sup>203</sup> Urdhri i dorëzohet zyrës së ekzekutimit që operon pranë asaj gjykate.<sup>204</sup> Kërkesa për ekzekutim të detyruar duhet të depozitohet pranë gjykatës që ka shqyrtuar çështjen dhe ka marrë vendim. Vendimet civile të marra në proceset penale ekzekutohen sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale.<sup>205</sup> Kodi parashikon gjithashtu procedura për ekzekutimin e detyrueshëm në rastet kur asetet ose mjetet financiare janë të pamjaftueshme për kompensim.<sup>206</sup>

Nën rrethana specifike, paditësi mund t'i kërkojë gjykatës që të urdhërojë ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit gjatë procesit gjyqësor ose me shpalljen e vendimit. Kjo mund të kërkohej kur ka arsye të mjaftueshme për të besuar, se ekzekutimi i mëvonshëm do të

---

<sup>200</sup> Neni 7, Vendimi Kuadër i Këshillit Evropian për legjitimitimin e viktimave në procesin penal.

<sup>201</sup> Neni 385(11) dhe neni 397(1), (2), (4), (5), KPrP i Moldavisë.

<sup>202</sup> Neni 467(1), KPrP i Moldavisë.

<sup>203</sup> Neni 468, KPrP i Moldavisë.

<sup>204</sup> Zyrat e ekzekutimit janë pjesë e Drejtorisë së Ekzekutimit të Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>205</sup> Neni 469(2), KPrP i Moldavisë.

<sup>206</sup> Neni 255, KPrP i Moldavisë.

pasjellë dëme të konsiderueshme dhe të pariparueshme.<sup>207</sup> Gjykata kryesisht mund të urdhërojë ekzekutimin e menjëhershëm në raste të veçanta.<sup>208</sup>

Avokatet kanë shprehur shqetësimin, se ky sistem i ekzekutimit të detyrueshëm është mjaft i paqartë dhe i komplikon procedurat e ekzekutimit.<sup>209</sup>

Sipas organizatës joqeveritare CTPW:

“shumica e padive civile të regjistruara në gjykatë kundër trafikantëve kanë të bëjnë vetëm me dëme morale, për shkak të mungesës së provave që vërtetojnë shkaktimin e dëmeve materiale. Për më tepër, shpenzimet e marra përsipër lidhur me riatdhesimin, trajtimin, rikthimin e dokumenteve të identifikimit dhe shpenzimeve gjyqësore janë përballuar nga CPTW-ja dhe IOM-i. Mesatarisht, sasia e dëmeve morale të kërkuara nga viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore është 50 mijë MDL. Në dy të tretat e rasteve të gjyqeve penale, pas shpalljes së vendimit të fajësisë, gjykata pranon, në parim, paditë për dëmshpërblim të paraqitura nga juristët e CTPW-së, duke orientuar paditësin në regjistrimin e këtyre padive në gjykatat civile, me qëllim përcaktimin e saktë të dëmeve morale dhe materiale të pretenduara nga viktimat.”<sup>210</sup>

Në raportin e përbashkët të një projekti të zbatuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara dhe Gjykata e Lartë e Drejtësisë, u analizuan 106 çështje të zgjidhura të trafikimit nga 2004 deri në shtator 2005. Dyzet e pesë për qind i viktimave (afërsisht 38) në rastet me një total prej 84 viktimash ngritën padi për dëme, ndërsa u pranuan 11 për qind prej tyre (afërsisht 9). Fatkeqësisht, arsyet e refuzimit ose të pranimit të kërkesës nga gjykata nuk jepen në raport, por duket që disa prej tyre mund t’u jenë dërguar gjykatave civile. Shuma mesatare e vendosur për një viktimë ishte 12 618 MDL (afërsisht 756 EUR). Nuk është e qartë nëse kjo ishte për dëme materiale apo ato morale.<sup>211</sup>

---

<sup>207</sup> Neni 257, KPrP i Moldavisë.

<sup>208</sup> Për shembull, ekzekutimi i menjëhershëm parashikohet për vendimet që urdhërojnë kompensim për dëmet fizike, dëmet shëndetësore ose vdekjen, në qoftë se pagesa duhet të bëhet në këste mujore. Neni 256(1c), KPrC i Moldavisë.

<sup>209</sup> Procesverbal i takimit të Koordinimit Teknik të Antitrafikut i datës 8 shkurt 2006, i organizuar nga Misioni i OSBE-së në Moldavi.

<sup>210</sup> Raporti i Veprimtarisë së CTPW-së 2003-2006, f. 19.

<sup>211</sup> C. Cojocaru dhe H. Wiseman, *Trafficking in Persons – An In-depth Analysis of Closed Criminal Case Files in Moldova for 2004-September 2005* (Trafikimi i personave – Një analizë e thelluar e dosjeve penale të mbyllura në Moldavi për periudhën 2004 – shtator 2005 (qershor 2006), f. 28.

CTPW-ja raporton se në vitin 2005, nga 79 viktimat të përfaqësuara, 38 prej tyre paraqitën padi civile për dëme të pësuar nga vepra penale.<sup>212</sup> Në tetë padi civile të shqyrtuara nga gjykata, si dhe në dy raste padish administrative, u pranuan të gjitha kërkesat e viktimave. Shuma më e vogël e marrë nga një viktimë ishte 5 000 MDL (295 EUR) dhe shuma më e lartë ishte 180 000 MDL (10 638 EUR). (Nuk ka të dhëna mbi hollësitë e çështjeve, dhe nuk është e qartë si ishin ndarë këto dëme midis atyre materiale dhe atyre morale.)

Nuk ka asnjë shpjegim për pabarazinë midis shumave të kërkuara dhe atyre të njohura nga gjykata, ose mbi bazën ku mbështeten kërkesat për dëme morale. Gjithashtu, nuk ka asnjë raport që të provojë nëse paratë për dëmshpërblim janë marrë në fakt nga njerëzit e trafikuar. Për këtë arsye, nuk është e lehtë të krijosh një tablo të qartë për praktikën gjyqësore lidhur me të drejtën për dëmshpërblim në Moldavi, dhe do të ishte e dobishme nëse do të bëhej një vlerësim konsekuent për të gjitha çështjet e trafikimit të ndjekura deri më tani. Megjithatë, ekziston praktika e paraqitjes së padive për dëme morale ndaj viktimave dhe të pranimit të tyre nga gjykatat, me gjitha ndryshimet në shumën që u jepet atyre.

Nëse padia civile nuk është zgjidhur brenda çështjes penale apo nëse nuk ka pasur çështje penale, personat e trafikuar mund ta paraqesin këtë padi në një proces civil kundër trafikantit/shfrytëzuesit. Në këtë rast do të zbatohet neni 1398 i Kodit Civil. Sipas tij, personi që vepron në mënyrë të kundërligjshme ndaj dikujt tjetër, është i detyruar të zhdëmtojë dëmin material, dhe në rastet e parashikuara nga ligji, edhe dëmin moral të shkaktuar nga veprimi apo mosveprimi i tij.

#### *Procesi gjyqësor sipas së drejtës së punës*

Neni 44 i Kushtetutës së Moldavisë e ndalon punën e detyruar. Në rastet e punës së detyruar, mund të ngrihet padi duke përdorur procedurat civile dhe penale, siç u paraqitën me hollësi më lart ose, në mënyrë alternative, viktimat mund të përdorin Kodin e Punës.

Neni 7 i Kodit të Punës e ndalon punën e detyruar, që përkufizohet si çfarëdolloj pune apo shërbimi të imponuar një personi me kërcënim apo pa pëlqimin e tij. Veprimet që përbëjnë punë të detyruar, sipas nenit 7, paragrafi 4, janë:

- Paga e dhënë përtej datës së caktuar apo dhënia e pjeshme e pagës;

---

<sup>212</sup> Duhet të vëreni se disa prej këtyre çështjeve dhe ato nga raporti i Ambasadës së Shteteve të Bashkuara (paragrafi i mëparshëm) mund të jenë të njëjtat. OJF-ja CPTW ishte palë zbatuese e raportit të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara.

- Mossigurimi nga punëdhënësi e pjesëmarrjes në skemat kolektive apo individuale të mbrojtjes sociale kur janë të zbatueshme apo kur puna paraqet rrezik për shëndetin ose jetën e punëmarrësit.

Neni 329 i Kodit të Punës parashikon, se punëdhënësi është i detyruar të shpërblejë plotësisht dëmin material dhe moral ndaj punëmarrësit që ka ardhur si rezultat i punës apo i privimit të paligjshëm nga puna. Padi të sipas së drejtës së punës mund të regjistrohen në gjykatë brenda një viti nga çasti kur punëmarrësi vihet ose duhet vërë në dijeni të shkeljes së të drejtave, ose brenda tri vitesh nga çasti kur e drejta në fjalë ishte fituar prej punëmarrësit.<sup>213</sup>

Në rastet e punës së detyruar, sipas nenit 7 të Kodit të Punës, punëdhënësi mund të ngrejë padi para gjykatës bazuar në nenin 355 të Kodit të Punës, edhe nëse nuk ka një kontratë pune me shkrim të nënshkruar me punëdhënësin. Kontrata e shkruar nevojitet vetëm në rastet kur punëdhënësi është shoqëri tregtare.

Neni 58, paragrafi 3 i Kodit të Punës parashikon se nëse kontrata e punës nuk është me shkrim, marrëveshja e punës konsiderohet e lidhur për një periudhë të pacaktuar dhe është e vlefshme nga dita kur punëmarrësi ka filluar punë për punëdhënësin. Nëse punëmarrësi arrin të provojë faktin e punësimit, punëdhënësi do të detyrohet të firmosë kontratën e shkruar më vonë.

### **5.3.2.3. Sekuestrimi i pasurisë**

Procedura penale e Moldavisë i lejon shtetit të marrë pronësinë mbi pasuritë që ishin përdorur gjatë kryerjes së veprës penale ose është fituar nga ajo vepër. Nëse këto pasuri nuk ekzistojnë më, atëherë shteti mund të konfiskojë pasuri me të njëjtën vlerë. Pasuritë mund të konfiskohen edhe nëse autori i veprës penale nuk ka marrë dënim penal.<sup>214</sup> Këto kompetenca nuk janë përdorur gjerësisht në çështjet e trafikimit për të dëmshpërblyer viktimat.

Plani Kombëtar parashikon krijimin e fondit për dëmshpërblimin e personave të trafikuar me anë të mjeteve monetare të siguruara nga sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurive të trafikantëve që ishin fituar me mjete kriminale. Deri në kohën kur doli ky raport, nuk është ndërmarrë asnjë hap për të realizuar këtë plan.

<sup>213</sup> Neni 355, Kodi i Punës.

<sup>214</sup> Neni 106(1), (4), KPrP i Moldavisë; shih gjithashtu nenet 203-210 (që japin procedurën e përgjithshme për sekuestrimin e pasurive).

#### 5.3.2.4. Ndhimja për viktimat

Plani Kombëtar i Veprimit ofron ndihmën ligjore ndaj personave të trafikuar përgjatë të gjitha shkallëve të procesit. Në të njëjtën mënyrë, Ligji kundër Trafikimit parashikon se “mundësia për t’iu drejtuar falas organeve të drejtësisë” është një parim themelor për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore.<sup>215</sup> Kodi i Procedurës Penale parashikon që viktimës t’i ofrohet ndihmë ligjore *pro bono* (falas) si pjesë e detyrës së gjykatësit për të garantuar mbrojtje dhe sigurim të viktimave dhe dëshmitarëve. Ndhimja e avokatit për viktimën mund të jepet ose me kërkesë të tij ose nga gjykata *ex officio* (kryesisht).<sup>216</sup> Viktimat që janë qytetarë të huaj apo persona pa shtetësi kanë gjithashtu të drejtë për ndihmë ligjore falas gjatë të gjithë shkallëve të procesit penal, si atij civil lidhur me trafikimin.<sup>217</sup> Prokuroria e Përgjithshme, ndër të tjera, “mbikëqyr respektimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë ato të viktimave të trafikimit.” Megjithatë, qeveria nuk ofron ndihmë të tillë dhe në realitet shërbimet deri tani janë ofruar nga OJF-të dhe nga IOM-i, me fonde të dhënë nga burime të tjera.

Ndër format e tjera të “rehabilitimit social” dhe “mbrojtjes e ndihmës” që u ofrohen viktimave sipas këtij ligji përmendet veçanërisht “ndihma ligjore.”<sup>218</sup> Qendrat e mbrojtjes (të parashikuara në ligjin e dhjetorit 2006) duhen pajisur për të ofruar “ndihmë ligjore emergjente” dhe OJF-të mund të mbrojnë dhe ndihmojnë viktimat e trafikimit, duke përfshirë mbrojtjen e interesave të tyre me anë të padisë penale ose civile.<sup>219</sup> Mbetet ende i paqartë se si roli i qendrave të reja do të rrisë angazhimin e qeverisë apo financimin për përfaqësim ligjor.<sup>220</sup>

Është thelbësore që viktimat/dëshmitarët të kuptojnë mundësitë e ndryshme që ata kanë për të marrë pjesë në procese gjyqësore. Shtrirja e së drejtës së viktimës për të marrë informacion ndryshon shpesh në varësi të pozitës së saj procedurale, për shembull, si palë e dëmtuar, palë civile apo dëshmitare, prandaj është thelbësore që ato të këshillohen për këtë në fazën sa më të hershme. Në realitet, ka prirje që viktimat të drejtohen tek OJF-të për

---

<sup>215</sup> Neni 4(e), Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Nr.241-XVI, 20 tetor 2005.

<sup>216</sup> Neni 58(4) (2), KPrP i Moldavisë.

<sup>217</sup> Neni 24(4), Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Nr. 241-XVI, 20 tetor 2005.

<sup>218</sup> Nenet 16 dhe 20(1), Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Nr. 241-XVI, 20 tetor 2005.

<sup>219</sup> Nenet 17(1) dhe 20(1), (7), Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Nr. 241-XVI, 20 tetor 2005.

<sup>220</sup> Neni 11(5), Ligji për Parandalimin dhe Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Nr. 241-XVI, 20 tetor 2005.



këshillim dhe, për këtë arsye, është e vështirë që të bëhet vlerësimi i zbatimit të së drejtës së informimit nga ana e shtetit.

### **5.3.3. Përfundime për Moldavinë**

Shteti ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm si me ligj edhe në politikëbërjen për të rregulluar trafikimin dhe për mbështetjen ndaj viktimave. Për më tepër, qeveria mund të shqyrtojë ratifikimin e Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (KEDVKDh) dhe të zbatimit të një skeme të financuar apo të subvencionuar nga shteti për viktimat prej të cilës do të përfitonin personat e trafikuar.

Gjykatat penale kanë kompetencë të japin dëmshpërblim si rezultat të padisë së ngritur nga viktima për një gamë të gjerë dëmsh. Gjithashtu, shpërblimi për dëme materiale mund të jepet kryesisht nga vetë gjyqtari. Nuk ka të dhëna lidhur me përdorimin e kësaj kompetence kryesisht në çështjet penale të shqyrtuara, por kjo është një kompetencë e rëndësishme, që nuk ekziston në të gjitha vendet e tjera. Kodi i Procedurës Penale liston të drejta të hollësishme dhe të veçanta për viktimat e veprës penale që gjatë procesit gjyqësor ndryshojnë në varësi të pozitës së viktimave. Gjithashtu, ato kanë të drejtë të përfaqësohen falas, pavarësisht se në praktikë kjo e drejtë nuk përmbushet nga shteti.

Një sërë padish civile për dëme morale kanë qenë të suksesshme. Megjithatë, cilësia dhe suksesi i padive dhe i ekzekutimit të vendimeve ka nevojë për më tepër analizim, për të identifikuar pengesat për zbatimin e së drejtës për dëmshpërblim. Qëndrueshmëria në cilësi dhe në natyrë e kërkesave, si dhe në shumën e dhëna si dëmshpërblim nga gjykata, mund të lehtësohen përmes këshillimit dhe trajnimit të avokatëve, prokurorëve dhe gjyqtarëve. Viktimat mund të mos kenë marrë shumën e dëmshpërblimit të vendosur nga gjykata. Vëmendje i duhet kushtuar zhvillimit të praktikave më efektive të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe të sekuestrimit të pasurisë.

Ekzistojnë gjithashtu të drejta lidhur me situatat e punës së detyruar, të cilat mund të gjykohen nga gjykatat e punës dhe për të cilat mund të jepet dëmshpërblim. Këtu mund të përfshihen padi për dëmshpërblim, edhe kur nuk ka kontratë pune të regjistruar zyrtarisht.

Ekziston një komunitet OJF-sh aktive dhe me përvojë që mbështet, këshillon dhe përfaqëson viktimat e trafikimit, ndonjëherë duke përmbushur detyrimet që i takojnë shtetit (për shembull, duke paguar shpenzimet e udhëtimit të dëshmitarëve).

### 5.3.4. Praktika të mira në Moldavi

- Ekzistenca Ligjit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore, i cili fuqizon dhe përforcon të drejta të tjera ekzistuese dhe përmirëson koordinimin;
- E drejta për ndihmë ligjore falas njihet nga legjislacioni;
- Ka të drejtën për të qenë palë në procesin penal;
- Ekziston mundësia e gjykatës penale për të dhënë disa elementë të dëmshpërblimit me nismë të vetë gjyqtarit;
- Është pranuar praktika gjyqësore për dëmshpërblimin e dëmit moral në çështjet e trafikimit;
- Shteti po ndërmerr hapa për të koordinuar dhe financuar një sistem kombëtar të mbrojtjes dhe mbështetjes për sa i takon trafikimit;
- Ka një komunitet aktiv të OJF-ve për të mbështetur dhe ndihmuar viktimat, duke përfshirë ofrimin e mbështetjes ligjore si dhe të mbrojtjes me avokat të të drejtave të viktimave; si dhe
- Në prokurori ka një ekip të specializuar.

## 5.4 RUMANIA

### 5.4.1 Kuadri Ligjor

Rumania është palë në KKBKON dhe në Protokollin e Trafikimit, në Konventat e ILO-s për Punën e Detyruar dhe në Konventat Evropiane kundër Trafikimit dhe për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme. Si vend që së fundmi është bërë shtet anëtar i Bashkimit Evropian, janë detyruese për të të gjitha direktivat dhe vendimet përkatëse të BE-së.

Rumania së fundmi ka bërë përpjekje konkrete për të harmonizuar legjislacionin e saj me angazhimet ndërkombëtare.<sup>221</sup> Janë miratuar dhe janë në fuqi ligjet e mëposhtme: Ligji nr. 678/2001 për trafikimin e qenieve njerëzore, Ligji nr. 211/2004 për masa të caktuara për mbrojtjen e viktimave të krimit dhe Ligji nr. 272/2004 për përkrahjen dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Janë krijuar dy agjenci të specializuara: Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e Familjes dhe Agjencia Kombëtare për Parandalimin e Trafikimit të Qenieve

---

<sup>221</sup> Shih raportin e Ministrisë së Drejtësisë së Rumanisë në Konferencën e 27 të Ministrave Evropianë “*Victims: Place, Rights, Assistance*” (“Viktimat: Vendi, të Drejtat, Ndihma”), 12-13 tetor 2006 Yerevan. MJU-27, Këshilli i Evropës (2006)12, e disponueshme në [http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/minjust/mju27/MJU-27\(2006\)12E-Romania.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/minjust/mju27/MJU-27(2006)12E-Romania.pdf)

Njerëzore dhe Vëzhgimin e Ndhmës së Dhënë për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

Ka një numër të konsiderueshëm OJF-sh aktive që punojnë për çështje të trafikimit, duke përfshirë ofrimin e ndihmës dhe të këshillave ligjore, si dhe strehën dhe shërbimet e tjera. Me sa duket këto shërbime nuk ofrohen mbi bazën e marrëveshjes me qeverinë por me bashkëpunimin e qeverisë.

## **5.4.2 Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

### **5.4.2.1 Skemat shtetërore të dëmshpërblimit<sup>222</sup>**

Ligji për Mbrojtjen e Viktimave ka hyrë në fuqi më 1 janar 2005.<sup>223</sup> Ligji trajton shumë çështje, si për shembull, ndihmën ligjore, ofrimin e këshillimit për viktimat si dhe pagimin e dëmshpërblimit për dëmet materiale nga fondi shtetëror. Dispozitat për dëmshpërblimin zbatohen vetëm për viktimat e “krimeve të rënda”, ku përfshihen krimet e dhunës dhe krimet seksuale.<sup>224</sup> Ligji zbatohet për krimet e kryera në territorin e Rumanisë, ku pala paditëse është nënshtetas rumun ose nënshtetas i huaj që jeton në mënyrë të ligjshme në Rumani, ose kur ka një konventë ndërkombëtare të detyrueshme për Rumaninë.

Sipas ligjit, në këto raste dëmshpërblimi u duhet dhënë viktimave pas kërkesës/aplikimit të tyre, por vetëm kur “ajo njofton strukturat e ndjekjes penale ose gjykatën brenda 60 ditëve nga data e kryerjes së veprës penale.”<sup>225</sup> Gjithsesi, afati prej 60 ditësh mund të llogaritet nga dita e ndërprerjes së problemeve fizike dhe psikologjike që e bëjnë raportimin të pamundur. Kjo do të thotë, se kërkohet që viktima të jetë e gatshme për të marrë pjesë në procesin gjyqësor, në mënyrë që të ketë mundësi për të ngritur padinë për dëmshpërblim. Kjo është analizuar nga UNICEF-i, i cili paraqet pikëpamjet e ndryshme që ndahen mbi çështjen në fjalë:

---

<sup>222</sup> Ky seksion është hartuar me kontributin dhe ndihmën e Alexandru Surcel-it, avokat pranë OJF-së ADPARE, Rumani, si dhe f. 234-235, *Victims – Support and Assistance* (Viktimat – Mbështetja dhe Ndihma) (Këshilli i Evropës, shtator 2006) dhe ligjërimit i mbajtur nga Eugenia Chivulescu, Prokurore e Përgjithshme pranë Gjykatës së Apelit të Ploiesti-it në një konferencë të organizuar nga Instituti Ludwig Boltzmann në Vjenë në mars 2007.

<sup>223</sup> OUG (Urdhri i Emergjencës së Qeverisë) nr. 211/2004, Mbrojtja e Viktimave të Krimit.

<sup>224</sup> Këto përkufizohen si vrasje, vrasje e mbetur në tentativë, dëmtim i rëndë fizik dhe vepra të kryera me dashje që shkaktojnë vdekjen ose dëmtime të rënda fizike, përdhunim, marrëdhënie seksuale me një të mitur, perversitet seksual i kryer me një të mitur ose duke ushtruar dhunë.

<sup>225</sup> Neni 23(1) i Ligjit 211/2004.

“Sipas institucioneve shtetërore, me përjashtim të gjykatave, kjo është një dispozitë e mirë, sepse ajo i nxit viktimat që të bashkëpunojnë me organet gjyqësore në zbulimin dhe dënimin e krimit. Në të njëjtën kohë, ajo dekurajon spekulatorë të mundshëm të sistemit, d.m.th., personat të cilët do të kërkonin dëmshpërblim pa qenë palë e dëmtuar nga vepra penale.

“Megjithatë, përfaqësuesit e shoqërisë civile, punonjësit socialë dhe psikologët që punojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për rimëkëmbjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, theksojnë se pasoja e kësaj qasjeje të autoriteteve është se viktimat nuk merr asnjë lloj ndihme atëherë kur ajo ka më shumë nevojë për të, duke qenë se personi i trafikuar ka nevojë për më shumë kohë për stabilizimin e sjelljes mendore. Sipas mendimeve të disa psikologëve me përvojë këtë fushë, çrregullimi i stresit posttraumatik mund të shfaqet edhe 6-12 muaj pas largimit të viktimës nga trafikimi. Viktimës gjithashtu i duhet të përballet me turpin shoqëror që mbartin rrethanat (ose të menduar si turp nga viktimat, si rezultat i faktorëve të tjerë) për të kapërcyer mosbesimin e saj tek institucionet shtetërore (të nxitura dhe nga trafikanti në mënyrë që ta mbajtur më lehtësisht viktimën në skllavëri) dhe, jo si faktor i fundit, për të shpëtuar nga kompleksi psikologjik i lidhjes me agresorin. (Me sa duket trafikantët bëhen gjithnjë e më të zotë në përdorimin e kësaj arme).”<sup>226</sup>

Dhënia përfundimtare e dëmshpërblimit, gjithsesi, nuk varet nga identifikimi i autorit të krimit. Në fakt, ligji përmban kritere të ndryshme në varësi të faktit nëse autori njihet ose jo. Në rastet kur autori njihet, parashikohet afati kohor prej një viti nga përfundimi i çështjes penale për paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim. Gjithashtu, viktimat duhet të ketë depozituar padinë civile brenda procesit penal (me përjashtim të rasteve kur prokurori e ka pushuar çështjen), autori duhet të ketë falimentuar ose nuk gjendet, dhe viktimat nuk duhet t'i ketë marrë dëmet e plota nga siguracioni. Kur autori nuk njihet, viktimat ka tre vjet kohë për të depozituar ankimin, dhe nëse viktimat është e mitur, ajo ka kohë tre vjet nga ditëlindja e 18 e saj.

Ka kritere të tjera pranimi që lidhen me karakterin e viktimës – viktimat nuk duhet të ketë qenë e dënuar për pjesëmarrje në një grup kriminal të organizuar ose për krime të tjera të rënda dhune. Viktimat nuk duhet të ketë provokuar autorin që të vetëmbrohet, ose “ta ketë

---

<sup>226</sup> “*Evaluation of Anti-trafficking Policies in Romania*” (“Vlerësim i Politikave Antitrafikim në Rumani” (UNICEF), f. 43, mund të gjendet në faqën e *Internet-it* [http://www.childtrafficking.org/pdf/user/UNICEF Evaluation of Antitrafficking Policies in Romania.pdf](http://www.childtrafficking.org/pdf/user/UNICEF%20Evaluation%20of%20Antitrafficking%20Policies%20in%20Romania.pdf)

sfiduar atë.' E para me sa duket i referohet një sulmi fizik, ndërsa e fundit i referohet fjalosjeve.

Paditë për dëmshpërblim duhet të regjistrohen në gjykatën e shkallës së dytë ku ka vendbanimin viktimas. Pranë secilës nga këto gjykata, është ngritur një Shërbim për Lirimin me Kusht dhe Mbrojtjen e Viktimave. Paditë për dëmshpërblim trajtohen nga Bordi për Dëmshpërblime Financiare për Viktimat e Krimit, i cili përbëhet të paktën nga dy gjyqtarë. Në procedurë nuk ka nevojë për dhënien e provave gojore, por në përgjithësi viktimas duhet të jetë e pranishme në seancë.

Kur kërkesa bëhet me shpejtësi, pagesa “paraprake” mund të jepet që në fillim të procedurave.

Pagesat e dëmshpërblimit nga skema shtetërore e dëmshpërblimit mbulojnë shpenzimet e shtrimit në spital, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e varrimit, dëmet materiale (p.sh., dëmet për sende të veçanta të cilat kanë një vlerë tregu), humbjet e të ardhurave dhe mirëmbajtjen për personat në ngarkim.

Skema nuk përfshin “dëme morale,” megjithëse këto dëme mund të pretendohen dhe mund të ngrihen me anë të padisë civile (shih më poshtë). Pagesat e bëra me anë të padisë civile për dëmet nga autori i veprës ose nga pagesat e siguracioneve mund të zbriten nga pagesa e dëmshpërblimit (ose anasjelltas).

Ndërsa në teori, skema u afrohet standardeve evropiane, për sa i përket zbatimit praktik, nuk funksionon ende mire. Megjithëse skema nuk është shumë burokratike, organet shtetërore nuk kanë ende fondet e nevojshme. Për më tepër, ekziston një problem i vazhdueshëm i armiqësisë ose antagonizmit nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve për personat e trafikuar, të cilët i konsiderojnë viktimat “se janë po aq fajtores sa dhe kriminelët.”<sup>227</sup> Ka gjithashtu probleme në informimin e viktimave për të drejtat e tyre (shih më poshtë seksionin “ndihmë për viktimat”).

Legjislacioni nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme për fëmijët. Kjo vjen si rezultat i faktit se dëmet janë të kufizuara në llojet specifike të dëmeve materiale. Nëse jepet dëmshpërblimi, paratë e marra duhet të administrohen nga kujdestarët ligjorë të fëmijës dhe zakonisht nuk ka mbrojtje ose kontroll nga autoritetet e mbrojtjes së fëmijëve. Kjo do të thotë se paratë mund të përdoren shumë kollaj në mënyra që nuk janë në dobi të viktimave që janë fëmijë.

---

<sup>227</sup> Përgjigje e pyetësorit nga një jurist i shoqatës ADPARE.

Skema është në fazat e para, por nuk janë gjetur shembuj të viktimave të trafikimit që kanë ngritur një padi të suksesshme ndaj shtetit për dëmshpërblim. Viktimat e trafikuar do të gjejnë veten të kufizuar nga kriteri i krimit të dhunshëm, kufiri kohor për raportimin e veprës dhe llojin e dëmeve të disponueshme (d.m.th., dëmet morale nuk lejohen).

#### **5.4.2.2. Dëmshpërblimi nga gjykatat civile, penale dhe të punës**

Sipas Kodit Penal dhe Kodit Civil Rumun,<sup>228</sup> mund të ngrihet padia civile kundër trafikantit, kundër prindërve/kujdestarit të trafikantit (nëse është i mitur) ose kundër punëdhënësit të trafikantit (nëse krimi lidhet me punën e kriminelit). Procedura mund të nisë në të njëjtën kohë si çështja penale dhe mund t'i dërgohet të njëjtit gjyqtar ose mund të fillohet si çështje e veçantë civile. Në praktikë, është më e zakonshme alternativa e parë. Është e mundur (megjithëse shumë rrallë) që çështja civile të jetë e suksesshme edhe kur ajo penale nuk është e tillë. Megjithatë, nëse padia civile nuk është e suksesshme brenda procesit penal, ajo nuk mund të riformulohet dhe të dërgohet veçmas sipas procedurës civile.

E drejta për të ngritur padinë civile nuk varet nga kombësia ose nga banimi në Rumani. Padia mund të ngrihet edhe kur krimi nuk klasifikohet si “i rëndë” për qëllimet e skemës së dëmshpërblimit shtetëror. Shkalla e rëndësisë së krimit ka ndikim vetëm në masën e zhdëmtimeve që jepen.

Ashtu si në të gjitha juridiksionet, është e nevojshme që të gjendet një lidhje shkakore ndërmjet veprës dhe dëmeve të kërkuara. Kjo duhet të bëhet me anë të provave që paraqiten në seancë gjyqësore, në prani, zakonisht, të palës paditëse si dhe të palës së paditur.

Duke qenë se pjesa më e madhe e padive civile ngrihen brenda procesit penal, atëherë si viktimat si dhe pala e akuzuar japin dëshmi gojore gjatë procesit gjyqësor penal.<sup>229</sup> Nëse padia ndiqet vetëm si procedim civil, nga ana tjetër, prania në gjykatë dhe dëshmia gojore e paditësit nuk është gjithnjë e nevojshme.

Kërkesa për praninë fizike të viktimës në gjykatën penale dhe nevoja për të dhënë dëshmi gojore, duke konsideruar të gjitha rreziqet dhe traumat për viktimën që mund të lidhen me pjesëmarrjen e saj në proces, frenon dukshëm pjesëmarrjen në çështjen penale dhe marrjen

---

<sup>228</sup> Neni 998-1002 i Kodit Civil Rumun përcakton përgjegjësinë për dëmet e shkaktuara nga *vepra të paligjshme*.

<sup>229</sup> Me dispozita mbrojtëse përkatëse të cilat disponohen sipas Ligjit 682/2002, Ligjin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

e vendimit për dëmshpërblim. Për më tepër, çështja mund të zgjasë shumë; ndonjëherë ajo zgjat jo vetëm disa muaj, por me vite.

Gjykata civile mund të njohë të njëjtat kategori dëmsh si skema e dëmshpërblimit me shtesën e dëmeve ‘morale.’ Këtu përfshihen dëmshpërblimi i pastër për dëmin fizik dhe psikologjik, vuajtja morale, shkaktimi i stresit, cenimi i emrit të mirë dhe i figurës publike. Koncepti i dëmit moral në të drejtën rumune u rifut pas rënies së Komunizmit, dhe përlllogaritja dhe pagesa e tij në Rumani ende është subjekt i debateve të shumta në profesionin ligjor dhe juridik. Kjo mund të çojë në një farë arbitrariteti dhe mungese të koherencës në masën e dhënë në vendimet. Dëmet vendosen nga gjykatat sipas konstatimeve të saj në lidhje me pretendimet e viktimës, seriozitetin e çështjes dhe dëmin moral. Pavarësisht nga lloji i procedimit, provat duhet paraqitur (d.m.th., në qoftë se pretendohen dëme për dëmtime fizike ose psikologjike, duhet të identifikohen me anë të raporteve mjekësore). Të gjitha dëmet e tjera kërkojnë fatura dhe dokumentacione, ose me dëshmitarë, për kontrata ose të ardhura nën 250 RON.<sup>230</sup>

Sipas një prokurori rumun, ka pasur vetëm katër çështje trafikimi ku është marrë vendim për dëmshpërblim. Ky numër i kufizuar i çështjeve të suksesshme ka ndikim mbi besimin e njerëzve të tjerë të trafikuar se sistemi i drejtësisë mund të shpërblejë dëmin.<sup>231</sup> Një çështje që shërben si shembull është dhënë nga OJF-ja ADPARE për tri gra të trafikuar për shfrytëzim seksual në Turqi, njëra prej të cilave mbeti shtatzënë nga shfrytëzimi, dhe kërkoi dëmshpërblimin e dëmit material dhe moral në procesin civil. Dy prej viktimave iu dhanë 5000 RON (1480 EUR) dhe tjetra, 4000 RON (1184 EUR). Trafikantët u dënuan njëri me 12 vjet 8 muaj dhe tjetri me 8 vjet heqje lirie. Këto vendime u lanë në fuqi dhe nga Gjykata e Apelit në vendimin e saj në vitin 2006. Gjithsesi, ka probleme të vazhdueshme për zbatimin e vendimeve.

Kur merret një vendim gjykate për dëmet civile, viktimat më pas has problemin e marrjes së pagesës nga trafikanti/kujdestari/punëdhënësi. Nëse kjo nuk realizohet me vullnet të lirë, atëherë viktimat është e detyruar të aplikojë pranë një “përmbartuesi gjyqësor” për ekzekutimin civil, procedurë e cila është e ndërlikuar dhe me shpenzime të larta. Është e qartë se ka shumë mundësi që dëmet nuk do të paguhen kurrë.

---

<sup>230</sup> Deri në rivlerësimin e monedhës rumune ‘leu’ (sipas ISO-së 4217, ROL) në vitin 2006, barra e palës paditëse për provat e dokumentuara për të gjitha kontratat dhe të ardhurat mbi 250 ROL ishte shumë e lartë (250 ROL kishte vlerë shumë të ulët). Kjo çoi në mosparaqitjen e kërkesave. Gjithsesi, 250 RON (lei të rinj) barazohet me 2.5 milionë ROL, kështu që problemi u zgjidh.

<sup>231</sup> Informacioni i dhënë nga prokurorja Iulia Diaconu, në seminarin e ODIHR-it në Barcelonë, dhjetor 2008, shih shënim 43.

### *Procedurat gjyqësore sipas Kodit të Punës*

Pagat e papaguara ose nën nivelin e kërkuar mund të kërkojnë duke përdorur dispozitat e Kodit të Punës dhe Kodit Civil, në varësi të llojit të pagave. Të ardhurat që parashikohen në Kodin e Punës duhet të jenë të paktën në nivelin e pagës minimale, të përcaktuar çdo vit nga qeveria, dhe ato mund të vlerësohen gjithashtu në lidhje me tregun e punës. Sipas OJF-ve vendase, ka pasur vetëm disa raste të punonjësve lokalë në situata shfrytëzimi në Rumani, kështu që ka pak përvojë në lidhje me vështirësitë e veçanta të cilat do të hasnin gjatë procesit të ngritjes së një padie në sistemin ligjor rumun.

#### **5.4.2.3. Sekuestrimi i pasurisë**

Ligji kundër Trafikimit parashikon kompetenca të qarta në lidhje me sekuestrimin e pasurisë, kur gjykatat merren me veprat penale që trajtohen nga ky ligj. Këto shtrihen tek “paratë, sendet me vlerë ose çdo pasuri tjetër e përfituar nga kryerja e veprave penale” ose “që është përdorur për të kryer vepra të tilla penale.” Këtu përfshihen “automjetet që përdoren për të transportuar personat e trafikuar, si dhe pajisjet që janë përdorur për të strehuar këta persona ... nëse ato u përkasin autorëve të veprave penale.”<sup>232</sup> Gjithsesi, nuk është e qartë se si do të disponohen këto pasuri (p.sh., nëse ato bëjnë pjesë të fondit shtetëror) ose nëse ato do të përdoren për të financuar dëmet ose dëmshpërblimet kërkuara nga personi i dëmtuar i cili dëshmon në çështjen në fjalë.

#### **5.4.2.4 Ndhimja për viktimat**

Në teori, çdo autoritet gjyqësor (policia, prokuroria, gjyqësori) detyrohet që të informojë viktimat për të drejtat e tyre në momentin e kontaktit të parë. Kjo praktikë nuk është zbatuar mirë deri në miratimin e ligjit për mbrojtjen e viktimës nr. 211/2004, i cili në këtë pikë ishte më i detajuar sesa ligji i trafikimit. Gjithsesi, praktika është ende e varfër dhe OJF-të vazhdojnë të ndërhyjnë për të marrë përsipër këtë rol. Sipas një avokati i cili punon në këtë fushë, megjithëse frytdhënëse, puna e OJF-ve bëhet në mënyrë joformale pa ndonjë marrëveshje zyrtare bashkëpunimi me autoritetet dhe pa financim të mjaftueshëm.<sup>233</sup>

Është komentuar gjithashtu se, si rezultat i mungesës së përkufizimit të termit “viktimë” në këto ligje, viktimat mund të keqetikohen ose të mos njihen si të tilla dhe, si pasojë, bëhet e

---

<sup>232</sup> Nenet 19(1) dhe (2) të Ligjit 679/2001.

<sup>233</sup> Shih analizën e Gjyqtarës Nicoleta Stefanoi për mbrojtjen e viktimës, që mund të gjendet në faqen e *Internet-it* për Anti-trafikimin: [http://www.antitrafic.ro/sections/1/asfgds/?t\\_id=op12p4&ksrc=nicoleta\\_stefaroi](http://www.antitrafic.ro/sections/1/asfgds/?t_id=op12p4&ksrc=nicoleta_stefaroi) .



pamundur që ato të përfitojnë nga masat mbrojtëse, duke përfshirë dëmshpërblimin.<sup>234</sup> Për shembull, gjatë gjyqeve, gjyqtarët në mënyrë jo të saktë u drejtohen viktimave si “dëshmitarë” dhe jo si “palë të dëmtuara,” dhe kjo tendencë i mohon viktimës disa të drejta të caktuara ligjore.<sup>235</sup>

Këshillimi psikologjik pa pagesë për deri në tre muaj (deri në gjashtë muaj për fëmijët) duhet t’u vihet në dispozicion viktimave të veprave penale të përmendura në Ligjin kundër Trafikimit dhe të konfirmuar në Ligjin për Mbrojtjen e Viktimës 211/2004. Ky këshillim duhet të ofrohet nga Shërbimi (shtetëror) për Lirimin me Kusht dhe Mbrojtjen e Viktimave.

Pavarësisht nga fakti që ligji përmban një angazhim mbi ndihmën ligjore për personat e trafikuar (neni 44), ai është i paqartë në lidhje me faktin se kush ka të drejtë, çfarë lloj ndihme duhet të jepet dhe nëse kjo ndihmë shtrihet edhe për proceset civile dhe në paditë për dëmshpërblim. Si rezultat, ai ka qenë subjekt kritikash.<sup>236</sup> Në praktikë, duket sikur ndihma ligjore, në përgjithësi, jepet, pas aplikimit, për viktimat e drejtpërdrejta të krimeve të rënda, duke përfshirë të gjitha viktimat e trafikimit,<sup>237</sup> viktimat jo të drejtpërdrejta, ku viktima e sëmurë ka vdekur, kur viktima është nën moshën 18 vjeç dhe kur viktima edhe pse e rritur nuk ka mjete financiare. Gjithsesi, edhe kur jepet ndihma ligjore, pagesa që marrin avokatët për këtë punë nuk është e lartë, dhe si rezultat, standardi i ndihmës mund të jetë i ulët. Për shkak të këtyre faktorëve, OJF të specializuara e kanë marrë përsipër këtë rol, duke përdorur fondet e tyre.

Agjencia Kombëtare për Parandalimin e Trafikimit të Personave dhe për Monitorimin e Ndihmës për Viktimat e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, e cila është krijuar kohët e fundit, duhet të jetë në gjendje të monitorojë dhe të përmirësojë ndihmën për viktimat e trafikimit, por ekzistenca dhe ndikimi i saj janë shumë të reja për t’u vlerësuar në këtë raport. Në vitin 2006, Agjencia iu nënshtrua një proces riorganizimi, por Ministria e Drejtësisë tha se ajo do të përbëhej nga 15 qendra rajonale dhe një linjë telefonike këshillimi. Janë krijuar qendra tranziti për qendra të përkohshme dhe ndihmën me traumat. Megjithatë, edhe duke marrë si të mirëqena shifrat e vetë qeverisë, këto masa duket sikur i kanë ardhur në ndihmë vetëm një pjesë të vogël të viktimave të identifikuar (në vitin 2006 merrnin ndihmë 132 nga më shumë se 1000 viktima).<sup>238</sup>

---

<sup>234</sup> V. cit., shënimi 226, raporti i UNICEF-it, f. 42.

<sup>235</sup> Po aty.

<sup>236</sup> Shih v. cit., shënim 226, raporti i UNICEF-it, f. 63 dhe rekomandimin nr 3, f. 95. Shih gjithashtu gjyqtare Nicoleta Stefaroi, shënim 233.

<sup>237</sup> Neni 44 i Ligjit të Trafikimit.

<sup>238</sup> Shih shënim 221, raportin e Ministrisë së Drejtësisë, f. 8-9.

### 5.4.3 Përfundime për Rumaninë

Rumania ka bërë hapa të dukshëm përpara drejt përmirësimit të situatës së viktimave të krimit në përgjithësi dhe viktimave të trafikimit në veçanti. Këta hapa janë reflektuar në faktin se vendi ka ratifikuar KEDVKDh-në dhe Konventën Evropiane kundër Trafikimit.

Në mënyrë që skema e krijuar kohët e fundit për viktimat e trafikimit të ketë më shumë përfitime të prekshme, duhet të rishikohen dispozitat mbi dëmet për të përfshirë elementin e dëmit moral. Sipas kufizimeve aktuale për llojet e dëmeve të disponueshme dhe detyrimit për t'u bërë paditës civil në procesin penal, viktimat e trafikimit duhet të ndjekin dy rrugë për dëmshpërblim. Ky proces mund të çojë në ndrojtje nga viktimat dhe gjithashtu do të kërkojë shumë kohë. Do të ishte mirë që shteti të krijonte sistemin sipas të cilit shteti do të paguante dëmshpërblimin, por do të kishte edhe të drejtën për të ngritur padi civile ndaj autorit të veprës dhe, si rrjedhojë, të marrë rimbursimin e një pjese të pagesave për viktimën (krahaso sistemet e Ukrainës, të propozuar, dhe të Francës). Kur viktimat nuk është në gjendje ta identifikojë autorin, ajo do të kishte të drejtë vetëm për dëme materiale. Kriteret e tjera për përfitimin nga skema, në veçanti kërkesa që dhuna të ketë përdorur, si dhe afatet kohore, mund të kenë gjithashtu ndikim negativ tek personi i trafikuar dhe duhet të rishikohen pas një periudhe vlerësimi. Rishikimi mund të përfshijë edhe vëzhgimin dhe vlerësimin e shpejtësisë me të cilën procedohet me paditë dhe të ndihmës që u jepet personave të trafikuar.

Viktima mund të ngrejë padi civile brenda procesit penal për të gjitha llojet e dëmeve dhe për këtë mund të marrë ndihmë ligjore falas. Detyrimet e aktorëve shtetërorë për të informuar viktimat për këtë të drejtë kohët e fundit janë forcuar. Gjithsesi, duket sikur në praktikë përfaqësimi dhe informimi vjen ende kryesisht nga komunitetit i OJF-ve, i cili ia ka arritur që të argumentojë me sukses për dëme morale.

Është pozitive që gjykatat janë të gatshme të japin dëmshpërblime morale në shumica të arsyeshme, edhe pse nuk është e qartë mbi ç'bazë bëhen përlllogaritjet.

Si në të gjitha juridiksionet, vëmendje i duhet kushtuar përmirësimit të sekuestrimit të pasurisë, si dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, pasi, megjithëse janë parashikuar kompetenca, ato nuk sigurojnë se viktimat marrin dëmshpërblim në masën e vendosur në vendimet e gjykatave.

Janë parashikuara në ligj e drejta për ndihmë ligjore falas dhe për t'u informuar. Gjithsesi, mbështetja tek komuniteti i OJF-ve për zbatimin e këtyre dispozitave mbetet ende e lartë. Do të ishte mirë që të qartësohej ligji në lidhje me ndihmën ligjore dhe përfaqësimin e personave të trafikuar, si dhe që të sigurohej se avokatët e pavarur janë trajnuar siç duhet për përfaqësimin e viktimave dhe paguhen mirë për shërbimet e tyre.

#### **5.4.4. Praktika e mirë në Rumani**

- Agjenci kombëtare kanë përgjegjësi të qarta për trafikimin
- Skema e financuar nga shteti, megjithëse është ende e re, ekziston dhe është një hap shumë pozitiv
- Janë krijuar agjencitë shtetërore për të administruar dëmshpërblimin dhe për të koordinuar veprimtaritë e ndihmës për trafikim;
- Parapagesa mund të jepet nëpërmjet skemës shtetërore;
- Gjykatat pranojnë parimin e pagimit të dëmit moral për personat e trafikuar;
- Të drejta ligjore ekzistojnë për ndihmë ligjore dhe informacion falas; dhe
- Ndihma praktike jepet nga shumë OJF të specializuara.

### **5.5 FEDERATA RUSE**

#### **5.5.1 Kuadri Ligjor**

Federata Ruse është palë në konventat kryesore ndërkombëtare për trafikimin dhe punën e detyruar. Ajo është anëtare e Këshillit të Evropës, por nuk ka nënshkruar Konventën për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore dhe as Konventën Evropiane mbi Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme. Federata Ruse është e detyruar të zbatojë Deklaratat dhe dokumentet<sup>239</sup> e Kombeve të Bashkuara.

Në vitin 2003, trafikimi i qenieve njerëzore u bë vepër penale, nëpërmjet ndryshimeve në Kodin Penal, ku u parashikuan tri vepra të reja - trafikimi i personave (neni 127(1)), përdorimi i punës skllavërore (neni 127(2)) dhe pornografia e fëmijëve (neni 242(1)).

---

<sup>239</sup> Shih tabelat e ratifikimeve, Shtojca V.

Gjithashtu, u ndryshuan ligjet që lidhen me rekrutimin për prostitucion (neni 240) dhe organizimin e veprimtarisë së prostitucionit (neni 241).<sup>240</sup>

Ka disa OJF dhe sindikata të cilat punojnë në mënyrë aktive me njerëzit që i janë nënshtruar shfrytëzimit për punë (Qendra e Ligjeve dhe e Migracionit/Fondacion Taxhikistan, Sindikata e Punëtorëve të Ndërtimit, Shoqata e Emigrantëve të Detyruar etj.), si dhe shfrytëzimit seksual (p. sh. Koalicioni ‘Engjëll,’<sup>241</sup> Motrat,<sup>242</sup> etj.). Në lidhje me shërbimet e ofruara prej tyre, nuk ka asnjë marrëveshje zyrtare kombëtare me shtetin, por sipas burimeve kërkimore në Rusi, është diskutuar gjerësisht mundësia për një bashkëpunim të tillë zyrtar, duke përfshirë edhe marrëveshje model bashkëpunimi.<sup>243</sup> Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Tregtisë së Lirë ka komentuar se Federata Ruse nuk ka shërbime mbrojtjeje të mjaftueshme për viktimat, dhe se mungon reagimi kombëtar koordinuar ndaj trafikimit, duke përfshirë legjislacionin dhe politikat<sup>244</sup> konkrete kombëtare të antitrafikimit.

ILO ka identifikuar gjithashtu probleme në lidhje me politikën e emigracionit, probleme të cilat mund të çojnë në situata<sup>245</sup> shfrytëzimi për emigrantët e punës, si dhe probleme që lidhen me reagimin ndaj punës së fëmijëve.<sup>246</sup> Gjithsesi, shpresohet se dispozitat e reja më liberale për emigracionin që kanë hyrë në fuqi që prej 15 janarit të vitit 2007, mund ta ndihmojnë situatën e emigrantëve të punës.<sup>247</sup>

Një grup pune i Dumës së Shtetit (dhoma e ulët e parlamentit rus)<sup>248</sup> hartoi një projektligj në vitin 2003 për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i cili aktualisht është nën shqyrtim. Projekti “parashikon një sistem organizimesh për luftën kundër trafikimit dhe përmban dispozita në lidhje me parandalimin e trafikimit, si dhe mbrojtjen e rehabilitimin e

---

<sup>240</sup> Ligji federal nr. 162-FZ për ndryshime dhe amendime në Kodin Penal të Federatës Ruse, 21 nëntor 2003, që hyri në fuqi më 16 dhjetor 2003, f. 10-13 Rossijskaja Gazeta, 16 dhjetor 2003.

<sup>241</sup> Shih [www.angelcoalition.org](http://www.angelcoalition.org).

<sup>242</sup> <http://www.owl.ru/syostr> ose <http://legislationline.org/topics/country/7/topic/14>.

<sup>243</sup> Informacion nga Elena Tyuryukanova, konsulente kërkimore e ODIHR-it për trafikim.

<sup>244</sup> *Report of ILO Committee of Experts on the Application of Conventions and Recommendations* (Raporti i Komitetit të Ekspertëve të ILO-s për Zbatimin e Konventave dhe të Rekomandimeve), ILO 2007, f. 206.

<sup>245</sup> E. Tyuryukanova, *Forced Labour in the Russian Federation Today: Irregular Migration and Trafficking* (Puna e detyruar në Federatën Ruse sot: Migracioni i parregullt dhe trafikimi i qenieve njerëzore) (ILO, 2005).

<sup>246</sup> V. cit., shënim 244, Raporti ILO 2007, f. 260-261.

<sup>247</sup> Informacion nga Elena Tyuryukanova dhe US TIP Report 2007, Russia Country Profile (Raporti TIP 2007 Profili i Rusisë) në adresën e Internet-it:

<http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2007/82807.htm>

<sup>248</sup> Projektligji mund të gjendet në faqen e Internet-it të Dumës:

<http://www.duma.gov.ru/comlaw/job/conf.shtm> ose  
<http://legislationline.org/topics/country/7/topic/14>

viktimave.”<sup>249</sup> Miratimi dhe zbatimi i këtij ligji mund të rrisë shumë përgjigjen ruse ndaj problemi të trafikimit.<sup>250</sup>

### **5.5.2 Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

E drejta e dëmshpërblimit të viktimave të krimit mbrohet nga Kushtetuta e Federatës Ruse në nenin 52:

“E drejta e personave që kanë pësuar dëme nga krimet dhe nga abuzimet e pushtetit mbrohet me ligj. Shteti u garanton viktimave mundësi për t’iu drejtuar organeve të drejtësisë si dhe shpërblimin e dëmeve.”

Kjo i referohet vetëm mundësisë për të kërkuar dëmshpërblimin nga individi që ka shkaktuar dëmin dhe jo garancive shtetërore për pagesën e dëmshpërblimit. Ashtu siç jepet në detaje më poshtë, shteti i ka pranuar përgjegjësitë e tij për të paguar dëmshpërblim në rrethana të kufizuara, aty ku ai mund të konsiderohet përgjegjës në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Gjithsesi, krimi i trafikimit nuk konsiderohet të jetë i klasifikuar si i tillë.<sup>251</sup>

Në përgjithësi pranohet se rastet e dëmshpërblimit sipas procedurës penale ruse janë të rralla. Kjo është diskutuar në mënyrë të detajuar në një tryezë të rrumbullakët të kohëve të fundit të organizuar nga OJF-ja Rezistenca (*Сопротивление*) në Dumën<sup>252</sup> ruse.

#### **5.5.2.1. Skema shtetërore e dëmshpërblimit**

Për personat e trafikuar ose për viktimat e krimit në përgjithësi, nuk ka skemë dëmshpërblimi të financuar nga shteti.<sup>253</sup>

---

<sup>249</sup> V. cit, shënimi 244, Raporti i ILO-s 2007 që citon përgjigjen e qeverisë, f. 206.

<sup>250</sup> Për më shumë detaje për ligjet, politikat dhe praktikat e antitrafikimit në Federatën Ruse, shih vlerësimin e ODIHR-it të MRK-së në Federatën Ruse.

<sup>251</sup> Sipas Marianna Kochubejit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, siç raportohet nga Elena Tyuryukanova; shih shënimin 245.

<sup>252</sup> “Sfidat e statusit ligjor dhe shoqëror të viktimave në Rusi,” i mbajtur më 15 janar 2007 në Dumën e shtetit rus. Shih I.L.Trunov “Çështjet e lidhura me respektimin e të drejtave dhe lirive të viktimave të krimit,” në <http://www.pvlast.ru/archive/index.pr378.php> dhe faqja e *Internet*-it të partisë politike “Rusia e Bashkuar” në <http://www.edinros.ru/news.html?id=118380>

<sup>253</sup> Gjithsesi, fenomeni i dëmshpërblimit shtetëror nuk është i panjohur. Në vitin 1998, Federata Ruse krijoi një skemë për viktimat e terrorizmit, e cila parashikonte se detyra e dëmshpërblimit të viktimave të tilla u takon distrikteve federale. Ligji kundër Terrorizmit, 25 korrik 1998.

### 5.5.2.2. Dëmshpërblimi që jepet nga gjykatat civile, penale dhe të punës

#### *Procedurat civile dhe penale*

Gjatë procedimit penal, viktimat mund të ngrejë padi civile kundër palës së akuzuar, e cila gjykohet paralelisht me çështjen penale.<sup>254</sup> Padi mund të përmbajë si dëmet materiale, ashtu edhe ato morale siç përcaktohet nga Kodi Civil:<sup>255</sup>

#### *“Neni 150 i Kodit Civil. Vlerat jomateriale*

1. Jeta dhe shëndeti, dinjiteti personal dhe paprekshmëria personale, nderi dhe emri i mirë, reputacioni i mirë i biznesit, paprekshmëria e jetës private, sekretet personale dhe të familjes, e drejta e lëvizjes së lirë, zgjedhja e vendit për të qëndruar dhe për të banuar, e drejta e emrit, e drejta e autorit dhe të drejta të tjera personale jopasurore dhe vlerat e tjera jomateriale që zotërohen nga qytetari që prej lindjes së tij ose të dhëna me ligj, janë të patjetërsueshme dhe të patransferueshme në çdo mënyrë. Në rastet e parashikuara me ligj dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj, të drejtat personale jopasurore dhe vlera të tjera jomateriale të zotëruara nga personi i vdekur mund të ushtrohen dhe të mbrohen nga persona të tjerë, duke përfshirë trashëgimtarët e pronarit ligjor të tyre...

#### *“Neni 151. Dëmshpërblimi i dëmit moral*

Nëse qytetari i është shkaktuar një dëm moral (vuajtje fizike ose morale) prej veprimesh, të cilat shkelin të drejtat e tij personale jopasurore ose cenojnë të drejta të tjera jomateriale në zotërim të tij, si dhe në raste të tjera të parashikuara nga ligji, gjykata mund t'i caktojë shkelësit detyrimin e pagimit të dëmshpërblimit monetar për dëmet e evidentuara. Kur përcaktohet masa e dëmshpërblimit për dëmet morale, gjykata merr në konsideratë nivelin e fajit të shkelësit dhe rrethana të tjera që meritojnë vëmendje. Gjykata duhet të marrë parasysh gjithashtu nivelin e vuajtjeve fizike dhe morale të lidhura me veçoritë individuale të personit që ka pësuar dëmin.”

Neni 150 parashikon detaje në lidhje me atë që mund të përbëjë dëm moral, duke përkufizuar vlerat jomateriale, megjithëse përkufizimi nuk është shterues. Ky parashikim ndryshon nga shumë kode civile të vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik ose kode të tjera të

<sup>254</sup> Neni 44(1), Kodi i Procedurës Penale i Federatës Ruse

<sup>255</sup> Nenet 130, 150 dhe 151. Për përkthim jozyrtar në anglisht, shih <http://www.russian-civil-code.com/PartI/SectionI/Subsection3/Chapter8.html>.

Evropës Lindore, të cilat në përgjithësi nuk japin udhëzime në lidhje me kuptimin e dëmeve morale. Kuptimi i dëmeve morale i lihet në dorë gjyqtarit. Kjo konsiderohet si problematike, pasi dëmet vlerësohen mbi bazën e “arsyes” dhe të “drejtësisë,” të cilat nga ana e gjyqtarëve kanë rezultuar të jenë koncepte të vështira për interpretim. Rrjedhimisht, dëmshpërblimet e dhëna kanë qenë minimale.<sup>256</sup>

Që prej vitit 1992, Kodi përcakton se padia civile në procesin penal më pas ndahet në procesin e veçantë. Në praktikë, gjyqtarët i shqyrtojnë këto padi pasi është dhënë dënimi në çështjen penale, kështu që në qoftë se vendimi nuk është i plotë, ai mund ta ndalojë shqyrtimin e padisë civile në të njëjtën kohë.<sup>257</sup>

Në fillim të hetimeve është procedura formale, sipas së cilës viktimat nënshkruan protokollin ku thuhet se ajo konsiderohet si “palë e dëmtuar” dhe se do të marrë pjesë në këtë cilësi në procesin penal. Viktima, si palë e dëmtuar në proces, duhet të njoftohet nga oficeri i policisë/hetuesi ose prokurori për të drejtat e saj, duke përfshirë të drejtën për të paraqitur padinë civile gjatë procedurave penale. Gjykata nuk mund ta kërkojë këtë kryesisht, prandaj është shumë e rëndësishme që viktimat ta kërkojnë të drejtën e tyre në këtë fazë. Prokurori mund të ngrejë padinë civile vetëm në emër të fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuar ose të individëve të tjerë të cilët për arsye të ndryshme, nuk mund t’i mbrojnë të drejtat e tyre.<sup>258</sup> Kështu që pala e dëmtuar detyrohet të ngrejë padinë civile dhe të sjellë prova për ta mbështetur atë. Duke qenë se padia civile rregullohet me anë të ligjeve të ndryshme, pala e dëmtuar nuk është në gjendje ta mbështesë atë pa këshillim ligjor dhe në përgjithësi ky këshillim nuk ofrohet pa pagesë.<sup>259</sup> Policia dhe prokurorët detyrohen të mbledhin prova të mjaftueshme për të treguar se i dyshuari ka kryer krimin, por ata nuk detyrohen që mbledhin të dhëna për të provuar natyrën dhe shkallën e dëmeve që ka pësuar viktimat. Kjo është përgjegjësia e palës paditëse. Nëse gjykata konstaton që nuk provohen dëmet, atëherë ajo mund ta rrëzojë padinë civile.

Viktimat e trafikimit kanë mundësi të hedhin në gjyq trafikantin, pavarësisht nga fakti nëse çështja po hetohet ose po zhvillohet një gjykim civil ndaj atij personit. Ashtu siç është e zakonshme në të gjitha çështjet civile, viktimat duhet të provojë fakte për veprimet që ajo mendon se kanë çuar në dëme dhe të japë prova për vlerën e dëmeve. Këto janë procese të gjata dhe të lodhshme, dhe disa ekspertë kanë mendim se trafikantët ose punëdhënësit/shfrytëzuesit ndonjëherë kërkojnë mbrojtje nga zyrtarët e lartë pranë

---

<sup>256</sup> V. cit., shënimi 252, Trunov.

<sup>257</sup> Shih vlerësimin e ODIHR-it i MRK-së në Federatën Ruse.

<sup>258</sup> Neni 44, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale.

<sup>259</sup> <http://www.pvlast.ru/archive/index.pr378.php>.

strukturave që zbatojnë ligjet dhe, si rezultat, kanë “imunitet” nga pretendimet që u drejtohen gjykatave.<sup>260</sup> Veç kësaj, emigrantët jetojnë me frikën e hakmarrjes, e cila bëhet lehtësisht në një ambient ku ata gëzojnë pak ose aspak mbrojtje nga policia.

Gjatë vlerësimit të ODIHR-it të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) në Rusi, OJF-të që ofrojnë ndihmë për viktimat u kanë thënë studiuesve, se ato nuk kanë dijeni për asnjë person të trafikuar për shfrytëzime seksuale që të ketë kërkuar dëmshpërblim përmes një çështjeje civile ose penale. OJF-të ruse citojnë si arsye: frikën e rivendosjes së kontaktit me trafikantin, dëshirën e personit për të harruar ngjarjen e trafikimit si dhe mosbesimin te gjykata.<sup>261</sup> Gjithsesi, shqetësimi që ngrihet shpesh është edhe problemi se personat e trafikuar janë nën presion për të bërë kërkesë, menjëherë pasi marrin kontakt me strukturat e ndihmës ose të zbatimit të ligjeve. Në përgjithësi, ka një afat kohor të gjatë për fillimin e procesit civil (p.sh., tre vjet në Kodin e Procedurës Civile Ruse nga data kur u pësuan dëmet). Vetë OJF-të ruse deklarojnë se gratë, pas një periudhë stabilizimi, ndiejnë keqardhje që nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim më parë. Prandaj, strukturat e ndihmës dhe të këshillimit mund t'i këshillonin klientët e tyre, që kërkesat mund të paraqiten brenda periudhës trevjeçare, d.m.th., nuk është e nevojshme që këtë të drejtë ta ushtrojnë menjëherë, edhe pse kjo do të krijonte disa vështirësi praktike, si, për shembull, lidhur me gjetjen e vendndodhjes së të pandehurit.

Në një rast të raportuar në Rusi, gjykata e Horolskut në rajonin e Primorskut dha vendimin e dëmshpërblimit të 144 000 RUB (3817 EUR) (44 000 RUB për pagat e papaguara dhe 100 000 RUB për dëmet morale) për viktimën e shfrytëzuar në një fermë gjedhi.<sup>262</sup> Raste të tilla duhet të dokumentohen dhe të publikohen më shumë, për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve dhe të viktimave të trafikimit për mundësitë që ekzistojnë për kërkimin e dëmshpërblimit.

#### *Paditë në procedimet sipas Kodit të Punës*

Në nenin 37 të Kushtetutës dhe në nenin 4 të Kodit të Punës, legjislacioni rus e ndalon punën e detyruar. Kodi i Punës përmban një përkufizim të “punës së detyruar,” i cili shtrihet në situatën kur “nuk merren parasysh datat e caktuara për pagesë si dhe kur pagesat nuk janë të plota,” pa qenë nevoja për format e tjera të shtrëngimit ose të kërcënimeve.

---

<sup>260</sup> V. cit., shënim 250, vlerësimi i MRK-së në Federatën Ruse, f. 5.

<sup>261</sup> Po aty, citim i intervistave me OJF-të “Motrat” dhe Koalicioni “Engjëll,” f. 3.

<sup>262</sup> Për më shumë detaje shih deklaratën për shtyp në <http://www.prosecutor.ru/pressrelese/print/118697842>.



Neni 381 i Kodit të Punës parashikon rrethanat në të cilat mund të trajtohet mosmarrëveshja individuale e punës. Ai specifikon, se punonjësi individual dhe punëdhënësi “të cilët më parë kanë qenë në marrëdhënie pune” kanë të drejtë të ngrenë padinë. Në praktikë, shumë persona të trafikuar janë punonjës të padokumentuar, kështu që marrëdhëniet e tyre të punës janë jozyrtare dhe të paregjistruara, që do të thotë që ata nuk do të mbrohen nga Kodi i Punës. Neni 11 rregullon marrëdhëniet e punës për nënshtetasit e huaj me status të rregullt (ata që kanë lejen e duhur të lëshuar në përputhje me nenin 18). Një problem tjetër është kur punonjësit emigrantë, të cilët dëshirojnë ta ngrenë padinë në gjykatë, mund të kenë liri të kufizuar lëvizjeje, gjë që sjell pamundësinë për t’iu drejtuar avokatit, OJF-ve ose gjykatës,<sup>263</sup> ose ata mund të jenë të frikësuar se mos dëbohen për shkak të statusit të tyre të parregullt. Pra, për punonjësit që janë emigrantë të parregullt, legjislacioni rus nuk ofron mbrojtje nëpërmjet së drejtës së punës.<sup>264</sup>

Gjithsesi, për sa u përket viktimave të shfrytëzimit të punës, kërkesat për dëmshpërblim janë negociuar me sukses nga sindikatat ose përfaqësuesit e OJF-ve, në emër të punonjësve emigrantë të trafikuar ose të shfrytëzuar. Sipas Sindikatës së Punonjësve të Ndërtimit, punonjësit në përgjithësi janë të frikësuar nga dalja e mundshme në gjykatë dhe parapëlqejnë t’i drejtojnë pretendimet e tyre për pagat e papaguara ose të nënpaguara ose për dëmtimet e lidhura me punë, nëpërmjet bisedimeve në telefon.<sup>265</sup> Kështu që, këto pretendime nuk trajtohen në mënyrë strikte brenda kuadrit ligjor. Për më tepër, sindikatat kanë akses vetëm në vendet e punës ku punon të paktën një anëtar, dhe prandaj kërkohet që punonjësit të anëtarësohen në sindikatë për të marrë përfaqësim dhe ndihmë prej tyre.<sup>266</sup>

Sipas një OJF-je që ndihmon kryesisht punonjës emigrantë nga Taxhikistani, “Qendra e Ligjeve dhe e Migracionit/Fondacion Taxhikistan,” gjykatat janë më pak efikase në sigurimin e dëmshpërblimit sesa negociatat. OJF-ja merr të dhëna për forcë pune dhe punëdhënësin nga personi që kërkon ndihmë dhe fillon negociatat telefonike, të pasuara nga paralajmërime për proces ligjor, dhe kërkon ndihmë nga sindikata përkatëse. Ata përdorin gjithashtu dhe Shërbimin Federal të Emigracionit, i cili mund t’i gjobisë punëmarrësit për marrjen në punë të emigrantëve të paligjshëm. Këto metoda kanë pasur sukses.<sup>267</sup>

---

<sup>263</sup> V. cit., shënimi 245, Tyuryukanova, f. 24-25.

<sup>264</sup> Po aty, f. 27.

<sup>265</sup> V. cit., shënimi 250, vlerësimi i MRK-së në Federatën Ruse, f. 3.

<sup>266</sup> Informacion i marrë nga ODIHR-i gjatë intervistave pranë Sindikatës së Punonjësve të Ndërtimit, Moskë, korrik 2006.

<sup>267</sup> Informacion i marrë nga Elena Tyuryukanova gjatë kërkimit të saj për vlerësimin e ODIHR-it të MKR-së. Shih gjithashtu vlerësimin e ODIHR-it të MKR-së në Federatën Ruse.

Gjithsesi, mjaft nga punonjësit emigrantë më të cenueshëm që janë të trafikuar ose të shfrytëzuar punojnë në mjedise tërësisht pa sindikata, nuk kanë kontratë ose leje pune dhe shpesh jetojnë në situata të tilla, ku liria e lëvizjes dhe e mundësitë e komunikimit janë të kufizuara. Si rezultat, ata nuk mund të përfitojnë nga ndihma e sindikatave dhe pretendimet e tyre për dëmshpërblim të mbështetur në ekzistencën e marrëdhënieve të punës bëhen shumë të vështira për t'u paraqitur dhe për t'u provuar në gjykatë. E gjitha kjo duhet parë nën këndvështrimin e faktit, që edhe punonjësit e rregullt e kanë të vështirë zbatimin e të drejtave të tyre të punës.<sup>268</sup>

### 5.5.2.3 Sekuestrimi i pasurisë

Punonjësi i policisë ose prokurori mund të kërkojë nga gjykata kufizime mbi pasuritë që në fillim të një procesi hetimi, me qëllim që të parandalohet tjetërsimi i shpejtë të pasurive të personit i cili e kupton se është nën hetim.<sup>269</sup> Konfiskimi i pasurive ose përdorimi i tyre si dëmshpërblim është më pas i mundshëm në proceset penale për vepra të caktuara (duke përfshirë dhe trafikimin).<sup>270</sup> Kjo përfshin vetëm:

“Nenin 104.1 a. dhe b.: Paratë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera të përfituara nëpërmjet sjelljes kriminale ose përfitimeve të saj (ose barasvlerë në “formën e tyre të konvertuar,” p.sh., përfitimet e krimeve që përdoren për të blerë një shtëpi).

“Nenin 104.1 c.: Paratë, sendet me vlerë dhe pasuri të tjera që përdoren për të financuar terrorizmin, njësinë e armatosur ose organizatën kriminale,

“Nenin 104.1 d.: Armët, pajisjet ose instrumente të tjera të krimit që i përkasin të akuzuarit.”

---

<sup>268</sup> Shih raportin e ILO-s, 2007, për Konventën e Mbrojtjes së Pagave në Federatën Ruse, 1949 (nr. 95) (ratifikimi: 1961): “... Komisioni kujton vëzhgimet e tij të mëparshme në lidhje me fenomenin e vazhdueshëm të akumulimit të pagave të papaguara të akumuluar që prekin miliona punëtorë dhe familjet e tyre dhe nevojën për të intensifikuar përpjekjet e Qeverisë në mënyrë që të parandalohet që fenomeni të transformohet në një proces endemik ose ciklik. Vihet re me keqardhje se raporti i Qeverisë nuk është marrë ende. Për më tepër, Komisioni konstaton vëzhgimet e bëra nga Unioni i Pavarur i Peshkatarëve të Kamchatkasë në lidhje me zbatimin e Konventës. Organizata e punëtorëve pretendon se pagat, të cilat duhen peshkatarëve dhe punëtorëve në lëmin e prodhimit të produkteve të peshkut – një degë e aktivitetit ekonomik më forcë pune të vlerësuar në 20,000 peshkatarë që gjeneron 80,000 vende pune të bregdeti – në përgjithësi nuk paguhet, dhe se nuk ka mjete të duhura dhe efektive për të siguruar pagat e papaguara. Komiteti e fton Qeverinë që të përgjigjet në mënyrë që këto komente të mund të shqyrtohen në detaje në sesionin pasardhës. Qeverisë i kërkohej të japë përgjigje në detaje për komentet aktuale brenda vitit 2007.

<sup>269</sup> Neni 115 i Kodit të Procedurës Penale të Federatës Ruse.

<sup>270</sup> Neni 15.1, 104.1-3 i Kodit Penal të Federatës Ruse 20.11.2006, neni 115 i Kodit të Procedurës Penale 20.11.2006.

(Paratë ose pasuritë që i janë kaluar një personi tjetër mund të konfiskohen, vetëm kur personi ishte në dijeni që ato ishin përfituar nëpërmjet mjeteve kriminale. Kur pasuria është në përdorim, mund të merret vlera e saj monetare).

Në dhënien e vendimit, në fund të gjyqit penal, gjyqtari vendos nëse pasuritë e sekuestruara ose e kufizuara mund të përdoren si shlyerje e drejtpërdrejtë për dëmshpërblimin që jepet në procesin penal apo nëse ato duhet të konfiskohen ose që të dyja.<sup>271</sup>

Megjithatë, viktimat duhet të ketë depozituar padinë për dëmshpërblim para përfundimit të shqyrtimit në gjykatën e shkallës së parë, përndryshe kjo nuk mund të ndodhë.<sup>272</sup> Në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore, nuk dihet të ketë ndodhur asnjë rastë i tillë.

#### **5.5.2.4 Ndhimja për viktimat**

Sipas Kodit të Procedurës Penale, policia ose prokurorët detyrohen të japin informacion rreth të drejtave të palëve të dëmtuara, duke përfshirë dhe të drejtën për të ngritur padinë civile. Gjithsesi, nuk ofrohet ndihmë ligjore për përfaqësimin e viktimave/palëve të dëmtuara në gjykatë.

Nuk ka ndonjë skemë mbarështetërore për të ndihmuar personat e trafikuar, megjithëse ekziston institucioni i Avokatit të Popullit si dhe Zyra e Komisionerit të Drejtave të Njeriut të Federatës Ruse, e cila në të shkuarën është marrë me të drejtat e viktimave<sup>273</sup> dhe është ngarkuar me shqyrtimin dhe ndjekjen e ankesave individuale për shkeljet e të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe ankesat e të huajve në territorin rus, si dhe për të rishikuar legjislacionin për ngritjen e shqetësimeve në lidhje me të drejtat e njeriut.<sup>274</sup> Në raportin e Avokatit të Popullit të vitit 2006, çështja e trafikimit të personave nuk është trajtuar në mënyrë specifike. Megjithatë, për herë të parë, në të përfshihet një kapitull për të drejtat dhe liritë e njeriut, në kuadrin e çështjeve të emigracionit.<sup>275</sup> Raporti përmend gjithashtu se si autoritetet që zbatojnë ligjin shfrytëzojnë njerëzit që janë detyruar të punojnë si skllëvër dhe nuk u japin atyre trajtim të mjaftueshëm:

---

<sup>271</sup> Nenet 230, 299 i Kodit të Procedurës Penale të Federatës Ruse.

<sup>272</sup> Neni 44(2) i Kodit të Procedurës Penale të Federatës Ruse. (Paragrafi i futur në Kodin nga Ligji federal 92-F3 2/4/2003).

<sup>273</sup> Raporti vjetor i vitit 2003 që përqendrohet kryesisht në viktimat e terrorizmit, i cili gjendet në <http://www.ombudsmanrf.ru> si dhe dokumente dhe raporteve të tjera nga Avokati i Popullit rus.

<sup>274</sup> Neni 15, Ligji rus i Avokatit të Popullit, i cili u gjend në adresën e *Internet-it* <http://www.ombudsmanrf.ru/institut/fkz.shtml>.

<sup>275</sup> Shih raportin e Avokatit të Popullit në <http://www.ombudsmanrf.ru>.

“Sipas vlerësimeve të eksperteve, numri i përgjithshëm i emigrantëve të paligjshëm që qëndrojnë në mënyrë të përhershme në Rusi, varion nga 5 deri në 10 milionë dhe ka tendencë të vazhdueshme për rritjen e kësaj shifre. Problemi është i dukshëm. Thelbi...qëndron gjithashtu në faktin se, duke mos patur status të rregullt ligjor, atyre u mohohen të drejtat e tyre dhe si rezultat i nënshtrohen si shfrytëzimit të dukshëm, ashtu edhe punës së detyruar. Pasojat negative të kësaj situatë janë shumë të mëdha. Në shoqërinë ruse, toleranca ndaj formave të ashpra të shfrytëzimit të emigrantëve po rritet. Përfaqësuesit e autoriteteve, dhe në radhë të parë, përfaqësuesit e strukturave që zbatojnë ligjet, marrin ryshfete nga “të jashtëligjshmit” (нелегалы) dhe vendosin ndëshkime të paligjshme. Punëdhënësit i gënjejnë ata.”<sup>276</sup>

Në të njëjtin raport, Avokati i Popullit deklaroi se në vitin 2006, zyrat për të drejtat e njeriut në Rusi morën 10 përqind më shumë ankesa nga refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit, emigrantët dhe rusët që jetojnë jashtë, por raporti nuk specifikoi se sa prej tyre ishin emigrantë dhe se për çfarë lloj ankesash bëhej fjalë.

Siç u përmend më lart, ka një numër OJF-sh që ndihmojnë grupe të veçanta viktimash, të tilla si punëtorët emigrantë, gratë/vajzat e trafikuar, viktimat femra të dhunës, viktimat e terrorizmit, etj. OJF-të po ofrojnë ndihmë novatore për emigrantët rusë dhe personat e trafikuar. Megjithatë, ato nuk kanë burime financiare të mjaftueshme dhe thonë se pakësojnë punën që lidhet me ndihmën ligjore.<sup>277</sup>

### **5.5.3 Përfundime për Federatën Ruse**

Ashtu siç u shpjegua në pjesën e mëparshme, ka një mungesë besimi tek sistemi i përgjithshëm i shtetit të së drejtës, veçanërisht në lidhje me mundësinë që personat e trafikuar të marrin dëmshpërblim ose zhdëmtim nëpërmjet proceseve penale. Kjo reflektohet nga qëndrimet e OJF-ve dhe të individëve ndaj sistemit gjyqësor dhe minon dobinë e ligjeve dhe procedurave ekzistuese, që nuk përdoren. Është e dobishme që prokurorët dhe hetuesit detyrohen të informojnë viktimat për të drejtat e tyre për të kërkuar dëmshpërblim, por në realitet kjo nuk do të thotë se e drejta mund të përdoret në të vërtetë. Viktimat nuk përfitojnë ndihmë ligjore dhe përfaqësim falas, dhe nuk dinë si bëhet dhe si

---

<sup>276</sup> Përkthim jozyrtar. Për citim në gjuhën origjinale (rusisht) shih <http://www.ombudsmanrf.ru/doc/ezdoc/o6.shtml>

<sup>277</sup> Informacion nga Elena Tyuryukanova.

ndiqet padia dhe si merren provat, pra, si pasojë asnjë padi nuk ngrihet. Nuk relatohet asnjë rast dëmshpërblimi i dhënë gjatë procedimit penal të ndonjë çështjeje trafikimi.

Skema e financuar nga shteti për viktimat e krimeve të dhunshme apo në veçanti për personat e trafikuar nuk ekziston. Gjithsesi, ka pasur disa raste të suksesshme, lidhur me marrjen e pagave të papaguara prej punëdhënësve që kanë shfrytëzuar punëmarrësit, dhe kjo është arritur nëpërmjet ndërmjetësimit të OJF-ve dhe të sindikatave.

#### **5.5.4 Praktika e mirë në Federatën Ruse**

- Grupet e OJF-ve dhe të shoqërisë civile po mbështesin në mënyrë aktive një numër të madh njerëzish të trafikuar dhe të shfrytëzuar;
- Përpjekjet e sindikatave dhe të OJF-ve për të negociuar dëmshpërblim dhe zhdëmtim nga trafikantët/shfrytëzuesit janë zgjidhje origjinale;
- Gjyqtarët kanë kompetencë të përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë pronat e sekuestruara për të paguar paditësit civilë në procedimet civile; dhe
- Është e disponueshme një mekanizëm e pavarur ku mund të ankohesh. Zyra e Avokatit të Popullit mund të përdoret për të nxitur ndryshime pozitive për të drejtat e viktimave si dhe për të nxjerrë në pah çështje të lidhura me raste individuale.

## **5.6 UKRAINA**

### **5.6.1 Kuadri ligjor dhe institucional**

Ukraina është palë në konventat kryesore ndërkombëtare në lidhje me trafikimin dhe punën e detyruar. Ajo ka nënshkruar gjithashtu dhe Konventat Evropiane për Trafikimin dhe Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme.<sup>278</sup> Ajo nuk është anëtare e Bashkimit Evropian, por ka filluar negociatat për një “marrëveshje të zgjeruar.”<sup>279</sup>

---

<sup>278</sup> Shih tabelën e ratifikimit në Shtojcën V.

<sup>279</sup> "EU-Ukraine start negotiations on new Enhanced Agreement" ("BE-Ukraina fillojnë negociatat për Marrëveshjen e "zgjeruar"), deklaratë për shtyp të Bashkimit Evropian, 2 mars 2007, <http://europa.eu/rapid/pressReleasesAction.do?reference=IP/07/275&format=HTML&aged=0&language=En&guiLanguage=en>.

Qeveria ka miratuar Programin Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për periudhën deri në vitin 2010.<sup>280</sup> Përpjekjet e qeverisë kundër trafikimit bashkërendohen nga Këshilli i Koordinimit Ndërinstitucional. Në vitin 2005, brenda policisë u krijua Sektori kundër Trafikimit. Këto agjenci, si dhe agjencitë e ndryshme joqeveritare<sup>281</sup> që ekzistojnë për t'u dhënë ndihmë, strehë dhe mbështetje personave të trafikuar, mbështeten nga disa organizata ndërkombëtare dhe donatorë. Aktualisht, ka shtatë strehëza rajonale për personat e trafikuar. Pritet që shpejt të hapet dhe një strehëz tjetër në Lugansk.

Sistemi ligjor i Ukrainës bazohet në kodet civile, të ndikuara nga sistemi sovjetik. Trafikimi për shfrytëzim seksual dhe të punës u cilësua si vepër penale në vitin 1998, dhe ndryshime janë bërë në 2001<sup>282</sup> dhe në 2006<sup>283</sup> me miratimin e ligjit “Për disa ndryshime në Kodin Penal të Ukrainës për rritjen e përgjegjësisë mbi trafikimin njerëzor apo shfrytëzimin e njerëzve për prostitucion.” Gjithashtu, për të rregulluar agjencitë private të punësimit janë marrë masa të ndryshme ligjore dhe institucionale.<sup>284</sup>

Me anë të dekretit presidencial më 28 dhjetor 2004, është miratuar edhe një strategji për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave dhe interesave legjitime të viktimave të krimit.

## **5.6.2 Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve**

### **5.6.2.1. Skemat shtetërore të dëmshpërblimit**

Ukraina po bën përpjekje për të harmonizuar legjislacionin e saj kombëtar me zotimet ndërkombëtare aktuale dhe të parashikuara në lidhje me viktimat e krimit. Aktualisht, ka dy projektligje të reja për dëmshpërblimin e viktimave të krimit në Ukrainë.

Njëri prej tyre, projektligji për dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunshme, u përgatit nga Ministria e Drejtësisë dhe mbetet ende në fazën përgatitore, pasi nuk është miratuar nga Kabineti i Ministrave. OSBE/ODIHR-i e ka komentuar gjerësisht këtë projekt. Projektligji parashikon sistem shtetëror për “sigurimin e pagesës” së dëmshpërblimit kur në

---

<sup>280</sup> E miratuar nga Kabineti i Ministrave në mars 2007.

<sup>281</sup> IOM-i përmend 32 OJF të ndryshme në *Statistikat për 2007*, dhe pesë prej tyre që janë më aktive përsa i përket referimit të IOM-it në lidhje me integrimin dhe ndihmën e viktimave janë Rilindja e Kombit (Ternopil), Besimi, Shpresa dhe Dashuria (Odesa), Rruga drejt Jetës (Kharkiv), Gratë e Donbasit (Lugansk) dhe Perspektivat e Volinit (Luck).

<sup>282</sup> I miratuar nga *Verhovna Rada* (parlamenti i Ukrainës) më 5 prill 2001, dhe hyri në fuqi më 2 shtator 2001.

<sup>283</sup> Trafikimi i qenieve njerëzore është parashikuar në nenin 149 të Kodit Penal.

<sup>284</sup> T. Kiryan dhe M. van der Linden, *Trafficking of migrant workers from Ukraine: issues of labour and sexual exploitation* (Trafikimi i punonjësve emigrantë nga Ukraina: çështje të punës dhe të shfrytëzimit seksual) (ILO, 2005), f. 45.

territorin e Ukrainës është kryer një krim i qëllimshëm dhune, i cili shkakton vdekje ose cenim të shëndetit.<sup>285</sup> Parashikohet që shteti do t'i paguajë dëmshpërblim viktimës, pavarësisht nga fakti nëse autori i krimit është identifikuar dhe po ndiqet penalisht ose është në kërkim. Kurdo të jetë e mundur, shteti mund të ngrejë padinë civile ndaj autorit të krimit për dëmshpërblimin që i është “parapaguar” viktimës.<sup>286</sup>

Parashikohet që skema të drejtohet nga komisione të krijuara nga Ministria e Punës dhe të Politikës Shoqërore.<sup>287</sup> E drejta për dëmshpërblim kufizohet për: nënshtetasit e Ukrainës, personat pa shtetësi që kanë banim të përhershëm në Ukrainë, rezidentë të përhershëm në Ukrainë që janë nënshtetas të një shteti anëtar të Këshillit të Evropës, shtet i cili ka një skemë dëmshpërblimi, ose nënshtetas të një shteti palë të KEDVKDh-së.<sup>288</sup>

Për realizimin e së drejtës për dëmshpërblim, viktimë ose kërkuesi duhet ta ketë denoncuar krimin brenda 48 orëve nga pasja e “mundësisë reale” për ta bërë këtë gjë, dhe në rastin e hetimit penal duhet t'i kryejë me përkushtim detyrimet procedurale.<sup>289</sup> (Midis provave e tjera shkresore kërkohet<sup>290</sup> edhe kopja e vendimit që jep statusin e viktimës). Arsyet për refuzimin e dëmshpërblimit përfshijnë: rrethanat, kur personi me vetëdije e pranoi rrezikun e dëmtimit ose të vdekjes; rastet e plagosjes ose vdekjes së shkaktuar vetë; ose kur viktimë i pëson dëmet si rrjedhojë e marrjes pjesë në një konflikt politik ose ushtarak.<sup>291</sup> Dëmet do të përfshinin humbje të të ardhurave, shpenzime mjekësore, spitalore dhe shëndetësore, shpenzime për varrimin dhe mjetet e jetesës për personat në ngarkim. Megjithëse dëmet morale nuk mbulohen, ligji e lejon shprehimisht viktimën që ta padisë të pandehurin, duke ngritur pretendime të tjera, përveç atyre të paraqitura në padinë ekzistuese.<sup>292</sup>

Edhe kur nuk ka asnjë të pandehur të identifikueshëm, ky ligj paraqet mundësinë e dëmshpërblimit të personave të trafikuar, gjë që nuk ndodhte më parë. Ekziston gjithashtu edhe garancia e pagesës nga shteti. Në raste të tjera, ligji e sheh shtetin thjesht si ndërmjetës në procedimet civile, duke e lehtësuar viktimën nga barra për ta ndjekur padinë civile brenda procesit penal, apo në mënyrë të pavarur prej tij, gjithashtu duke siguruar pagesën për viktimën. Viktimat mund të kërkojnë edhe dëme të tjera që nuk mbulohen nga dëmshpërblimi shtetëror nëse ata e ndjekin vetë kërkesën, nëpërmjet prokurorit apo avokatit

---

<sup>285</sup> Neni 2 i projektligjit për dëmshpërblimin e viktimave të krimeve të dhunshme.

<sup>286</sup> Po aty, neni 22.

<sup>287</sup> Po aty, neni 12.

<sup>288</sup> Po aty, neni 4.

<sup>289</sup> Po aty, neni 5.

<sup>290</sup> Po aty, neni 8.

<sup>291</sup> Po aty, neni 11.

<sup>292</sup> Po aty, neni 6.

të tyre (shih më poshtë). Gjithsesi, në atë rast ato do t'u nënshtroheshin dy procedurave stresuese – njëres procedurë me gjykatën dhe tjetrës me komisionin – ndërkohë që shteti do t'i "garantonte" shpërblimin për dëmet materiale.

Projektligji i dytë është propozuar nga tre deputetë, dhe është quajtur projektligji "Për dëmshpërblim me shpenzime të shtetit të dëmeve materiale që u janë shkaktuar qytetarëve që kanë vuajtur nga krimi." Komisioni Parlamentar për Mbështetje Legjislative për Zbatimin e Ligjeve rekomandoi rrëzimin e këtij projektligji dhe rekomandimi u konfirmua nga parlamenti në vendimin e datës 19 prill 2007.

### **5.6.2.2. Dëmshpërblimi që jepet nga gjykatat civile, penale dhe të punës**

#### *Procedurat penale dhe civile*

Sipas neni 28 të Kodit të Procedurës Penale, personi që ka pësuar dëme materiale ose morale si pasojë e një krimi, ka të drejtë të ngrëjë padinë civile gjatë procesit penal kundër të akuzuarit, i cili duhet të mbajë përgjegjësi materiale për veprimet e tij. Kur viktimja ka vdekur, padia mund të ngrihet prej një ndër personave të listës së të afërmeve, dhe në rastet kur viktimja është i mitur, padia duhet të ngrihet nga prindi ose kujdestari i caktuar nga gjykata. Gjyqtari e shqyrton padinë civile së bashku me akuzat penale. Shuma e dëmeve bazohet në provat e paraqitura gjatë gjykimit. Duhet që kërkesa të depozitohet para hetimit gjyqësor, edhe pse ka jurisprudencë se ajo nuk duhet të rrëzohet nëse paraqitet gjatë hetimit gjyqësor.<sup>293</sup> Gjithashtu, është e mundur që padia e veçantë civile të ngrihet pas përfundimit të çështjes penale, duke përdorur dispozitat procedurale civile, për aq kohë sa çështja nuk është pushuar gjatë procedimit penal.

Prokurori detyrohet t'i paraqesë gjykatës faktet dhe provat për kërkesën dhe gjyqtari në çështjen penale duhet të arrijë në përfundim në lidhje me të, duke dhënë motive të arsyetuara mirë për vendimin e tij. I vetmi përjashtim është kur viktimja nuk paraqitet në seancë gjyqësore ose kur i pandehuri deklarohet i pafajshëm.<sup>294</sup>

---

<sup>293</sup> "Gjykata nuk mund të rrëzojë padinë civile të depozituar nga personi që ka pësuar dëme material ose morale si rezultat i krimit të kryer kundër tij ose saj vetëm për shkak se padia është depozituar gjatë hetimeve gjyqësore." (Rezolutë e Bordit të Gjyqtarëve në Dhomën Gjyqësore për Çështje Penale të Gjykatës Supreme të Ukrainës më 12 tetor 2004), cituar në N. Ahtirskaja, *Trafikimi i personave në Ukrainë: Evidentimi i Praktikës Gjyqësore* (Akademia Ukrainase e Gjyqtarëve, 2006).

<sup>294</sup> Paragrafi 3, Vendimi 3 i Seancës Plenare të Gjykatës Supreme të Ukrainës, më 31 mars 1989: "Për praktikën e zbatimit nga gjykatat e Ukrainës të legjislacionit për dëmshpërblimin e dëmeve materiale të krijuara nga krim dhe kthimi i pronës së marrë pabazë."



Dëmet që mund të merren nga viktimat përfshijnë dëmet materiale të përkufizuara në nenin 22 të Kodit Civil si më poshtë:

- “1) Humbjet që i shkaktohen personit si pasojë e shkatërrimit ose dëmit të një prone, dhe shpenzimet që i janë shkaktuar personit ose që do t'i shkaktohen personit për të rivendosur të drejtat e tij të shkelura (dëmet reale);
- 2) Të ardhurat që mund të kishte marrë personi në rrethana normale nëse nuk do t'i ishin cenuar të drejtat e tij (fitimi i humbur);”

si dhe dëme morale të përkufizuara në nenin 23(3) të Kodit Civil:

- “1) Dhimbjet dhe vuajtjet fizike që i shkaktohen personit fizik si pasojë e paaftësisë ose dëmtimeve të tjera për shëndetin;
- 2) Vuajtjet mendore që i shkaktohen personit fizik si pasojë e veprimeve të paligjshme kundër personit, anëtarëve të familjes së tij dhe të afërmeve të ngushtë;
- 3) Vuajtjet mendore që i shkaktohen personit fizik si pasojë e prishjes ose dëmtimit të pasurive të tij;
- 4) Cënimin e nderit dhe dinjitetit ose të reputacionit tregtar të personit fizik ose juridik.”<sup>295</sup>

Shuma e shpërblimit financiar për dëme morale përcaktohet nga gjykata në varësi të llojit të veprës, të nivelit të vuajtjes fizike dhe mendore, të keqësimit të aftësive të viktimës dhe të mohimit të mundësive për përdorimin e tyre, të shkallës së fajësisë së personit që ka shkaktuar dëm moral, nëse faji mund të konsiderohet si shkak dëmshpërblimi, si dhe duke marrë parasysh rrethanat e tjera që lidhen me rastin. Dëmet morale kompensohen pavarësisht nga dëmet materiale për të cilat mund të kërkohet dëmshpërblim.

---

<sup>295</sup> Shih dhe Paragrafin 3, Vendimi 4 të Seancës Plenare të Gjykatës Supreme të Ukrainës më 31 mars 1989 “Për Praktikën Gjyqësore në Çështjet e Shpërblimit të Dëmeve Morale (të Paprekshme), i ndryshuar”: “dëmi moral përkufizohet si humbje e paprekshme e shkaktuar nga vuajtje morale ose fizike ose diçka tjetër negative që ka ndodhur ndaj personit fizik ose juridik nëpërmjet akteve të paligjshme ose mosveprimeve të personave të tjerë.” Sipas kreut 8, J. Strekalov, *Ukrainian Legislation Against Trafficking in Human Beings* (Legjislacioni ukrainas kundër trafikimit të qenieve njerëzore (OSBE, 2006): “Në përputhje me legjislacionin në fuqi, dëmi moral mund të përfshijë cënimin e nderit dhe të dinjitetit, dëm të prestigjit ose të reputacionit tregtar, vuajtje morale të shkaktuar nga dëmtimi i shëndetit, shkeljen e të drejtave të pronës (duke përfshirë pronësinë intelektuale), të drejtat e konsumatorit dhe të drejta të tjera civile; hetimet ose procedurat gjyqësore të paligjshme, ndërprerjen e marrëdhënieve normale shoqërore për shkak të pamundësisë për të ndjekur aktivitete shoqërore në mënyrë aktive, ndërprerjen e marrëdhënieve me njerëz të tjerë dhe pasojat e tjera negative.”

Sipas një studimi të vitit 2006, mbështetur nga Koordinatori i Projektit të OSBE-së në Ukrainë (PCU), vetëm 45 prej 198 individësh kanë bërë padinë civile, dhe nga këto, gjykatat shpesh nuk kanë dhënë arsye për rrëzimin e kërkesave ose nuk kanë vendosur dhënien e shumave që duhet të ktheheshin, në kundërshtim me detyrimet e tyre ligjore.<sup>296</sup> Në një studim tjetër të mbështetur financiarisht nga OSCE PCU, nga 51 çështje penale të trafikimit për shfrytëzim seksual në Ukrainë, vetëm 20 padi për dëmshpërblim janë bërë nga viktimat.<sup>297</sup> Për të gjitha këto çështje, janë urdhëruar të paktën pagesa të pjesshme. Arsyeja kryesore e mosbërjes së padisë ishte mungesa e ndërgjegjësimit për shtrirjen e plotë të së drejtës. Personat ose nuk ishin të informuar, ose nuk ishin plotësisht të informuar për të drejtën e tyre (p.sh., nuk e dinin se mund të kërkonin dëmshpërblim moral). Gjithsesi, ata cituan dhe mungesën e besimit në sistem për marrjen e dëmshpërblimit dhe mungesën e dëshirës për t'u marrë me burokracinë, frikën e hakmarrjes dhe mungesën e provave për humbjet materiale, si arsye të tjera për mosndjekjen e kërkesave për dëmshpërblim.<sup>298</sup>

Një numër i vogël viktimash janë këshilluar që të mos ndjekin rrugën e padisë, me arsyetimin se kjo gjë do të kishte reflektim negativ mbi ta në gjykime, pasi gjyqtarët mund të mendonin se ata po dëshmojnë vetëm për qëllime fitimi. Në disa raste punonjësit e zbatimit të ligjeve nuk mund të gjenin asnjë arsye tjetër për refuzimin e viktimës të dëshmojë, sesa supozimi që trafikantët duhet t'u kishin dhënë para viktimave për t'i bindur ato të mos dëshmojnë në gjykatë.<sup>299</sup>

Në rastet kur janë ngritur paditë në gjykatë, studiuesit kanë vënë re se puna e bërë nga hetuesit nuk ishte profesionale, shumat e kërkuara ishin shumë të larta e të paarsyeshme dhe ishin të pabazuara në dokumentacion.<sup>300</sup> Cilësia e punës ishte më e mirë kur ajo ishte bërë nga avokatë. Çështjet përqendroheshin kryesisht në dëmet morale, pasi viktimat ose nuk kishin pësuar dëme materiale ose nuk i kishin ruajtur provat, për shkak të kohës së gjatë që kishte kaluar që kur kishte ndodhur krimi (5 kërkesa nga 20 përfshinin dëme materiale). Pesë nga kërkesat u pranuan plotësisht, por pjesa më e madhe e tyre u pranuan vetëm pjesërisht, p.sh.:

---

<sup>296</sup> Po aty, Strekalov, kreu 8.

<sup>297</sup> Inna Shvab, *Issues of pre-trial and judicial investigation into human trafficking cases: An analysis of selected cases* (Çështje të hetimeve përpara gjykimit dhe hetimeve gjyqësore në çështje të trafikimit të qenieve njerëzore: Analizë e çështjeve të përzgjedhura. (2007).

<sup>298</sup> Po aty, f. 116-117 të versionit të botuar në Ukrainë.

<sup>299</sup> Po aty, f. 71 të versionit të botuar në Ukrainë.

<sup>300</sup> Po aty, f. 119 të versionit të botuar në Ukrainë.

- Nga kërkesat për dëmshpërblime morale në shumën 50 000 UAH (*‘hryvnia’*, monedha ukrainase) dhe për dëmshpërblime materiale në shumën 17 000 UAH, vendimi u dha për 2 000 UAH (përafërsisht 300 EUR);<sup>301</sup>
- Kërkesat për dëmshpërblime morale në shumën 10 000 UAH dhe për ato materiale në shumën 4 000 UAH u zbritën në 2 000 UAH për secilën shumë (përafërsisht 300 EUR secila)<sup>302</sup>;
- Në dy çështje, kërkesa për 50 000 UAH secilës iu dha shuma prej 20 000 UAH (përafërsisht 3 000 EUR).<sup>303</sup>

Është konstatuar se shumat e dëmshpërblimit ndryshonin për një sërë arsyesh: provat e pamjaftueshme të dëmit moral; mungesa e normave ligjore të vendosura mirë për “matjen” e dëmeve morale; rrethanat e të pandehurit; fakti që shumat shumë e larta kërkoheshin si kompensim; sjelljet e pahijshme të viktimave në sallën e gjyqit; dhe pati edhe një rast kur kërkesa ishte hartuar keq (me mangësi dhe në mënyrë të paafte).<sup>304</sup> Megjithatë, e rëndësishme është se, pavarësisht nga vendimi i dhënë, askush nga viktimat nuk e ka marrë deri tani dëmshpërblimin,. Arsyet për këtë përfshijnë procedurat komplekse dhe të gjata që nevojiten për konfiskimin e pasurive, mungesën e pasurive që mund të konfiskohen, si dhe vështirësitë e përgjithshme në Ukrainë me ekzekutimin e vendimeve dhe me sistemin e përmbarimit.<sup>305</sup>

---

<sup>301</sup> Po aty, f. 120, Rajoni i Dnipropetrovskut; Informacion mbi çështjen nga OSBE PCU: një grua nga Dnipropetrovsku e cila vizitoi Emiratet e Bashkuara Arabe i kërkoi të bijës në Ukrainë që të kërkonte vajza të varfra dhe t’u ofronte atyre punë si kamariere, kujdestare fëmijësh ose prostituta. Në total u punësuan 6-7 vajza (njëra prej viktimave ishte 11 vjeç). Të gjitha detajet e udhëtimit (duke përfshirë martesat të rrema për të marrë vizat) ishin bërë nga trafikantët. Pasi arritën, të gjitha vajzat u detyruan që të prostituonin dhe të gjitha fitimet u morën nga trafikantët. Kur u kthyen në Ukrainë, dy prej viktimave u paraqitën në polici. Trafikanti u përpoq të ndikonte mbi viktimat, duke u ofruar atyre “shpërblimin.” Më vonë, një prej viktimave refuzoi të vazhdonte çështjen, gjoja sepse ajo kishte marrë paratë nga trafikanti. Dënimi i gjykatës ishte 5 vjet burgim dhe 3 vjet lirim me kusht. Dënimi ishte “i lehtë” për shumë arsye, por kryesisht u vu re se qëndrimi negativ i gjykatës u ndikua nga sjellja e viktimave – ato filluan të ziheshin me njëra-tjetrën. Gjithashtu, nga menyra se si ishte hartuar padia prej hetuesit, dukej sikur ato e dinin se do të shkonin të punonin për shërbimet seksuale dhe se po kërkonin paratë që u ishin premtuar në vend të përdorimit të ndonjë argumenti ligjor për dëmshpërblim moral.

<sup>302</sup> Po aty, raporti i Shvabit, rajoni Luhansk, f. 120.

<sup>303</sup> Po aty, rajoni Zhitomir, f. 120 (Informacion mbi çështjen nga OSBE PCU: gjatë periudhës 2001-2004 tre burra nga Zhitomiri, në bazë të marrëveshjes së mëparshme të bërë me dy gra ruse, gënjen për të rekrutuar tri vajza të mitura nga një fshat i rajonit për të punuar si “kamariere me rroga të larta” në një kafene në Moskë, që zotërohej nga motra e njërit prej rekrutuesve. Në Moskë të miturat u kërcënuan dhe u detyruan që të ofronin shërbime seksuale për burrat. Viktimat vuajtën nga dhuna fizike dhe u mbajtën për shkak të borxhit. Brenda ca kohësh, viktimat arritën që të largoheshin dhe të ktheheshin në rajonin e Zhitomirit. Gjykata i shpalli fajtorë autorët për trafikimin dhe i dënoi me tetë, gjashtë dhe tri vjet heqje lirie, përkatësisht, dhe urdhëroi dëmshpërblim për viktimat për dëmet morale).

<sup>304</sup> Po aty, f. 121.

<sup>305</sup> Po aty, f. 122.

Nga vendimet e çështjeve, del e qartë se gjyqtarët i mbështesin gjetjet e tyre për dëmshpërblim në varësi të mendimit që krijojnë për faktin nëse viktimat po udhëtonte me vetëdije për të punuar në industrinë e seksit.

Në të paktën një rast, kërkesa u refuzua nga gjykata, pasi u vunë në dyshim karakteri dhe motivet e viktimës:

“ ... ajo shkoi me dëshirën e saj për të punuar në Republikën Çeke, pa qenë e shtrënguar. Ajo e dinte se çfarë pune do të bënte. Ajo kishte rënë dakord për ndarjen e të ardhurave ndërmjet saj dhe të pandehurit. Ajo nuk kishte paraqitur ndonjë pretendim për dëmshpërblim material para se të merrej në pyetje nga Departamenti për Luftën Kundër Krimin të Organizuar (OBOP).”<sup>306</sup>

Ky rast është i pazakontë, pasi duket se viktimat e kishte provuar se ishte viktimë e trafikimit dhe u ishte nënshtruar “gjobave” dhe rrahjeve të pajustificueshme ndërsa punonte si prostitutë në kufirin Çeki-Gjermani. Gjithsesi, edhe në këto kushte, është shumë e qartë se gjyqtari nuk ishte i prirur që ta shihte viktimën si dikë që meritonte dëmshpërblim, për shkak se nuk kishte qenë e shtrënguar në rekrutimin e saj fillestar. Në një çështje tjetër, në vendimin e gjykatës thuhet:

“Gjykata pranon pjesërisht padinë civile të viktimës B. Gjykata vlerëson se veprimet e kombinuara të të pandehurit i kanë shkaktuar dëme morale viktimës, duke e shitur atë për shfrytëzim seksual. Në të njëjtën kohë, viktimat ra dakord dhe shkoi me vullnetin e lirë të saj në Moskë, ku u mor me prostitucion, pra, duke e vënë veten e saj në pozicionin e një objekti për shitje.”<sup>307</sup>

Në studimin *Ukrainian Legislation Against Trafficking in Human Beings* (Legjislacioni ukrainas kundër trafikimit të qenieve njerëzore), flitet për një çështje ku dy viktimave të trafikuar në Turqi për shfrytëzim seksual u ishin dhënë 20 000 UAH dhe 15 000 UAH. Në një çështje tjetër, shumica e dëmshpërblimit për dëme morale u ul pasi gjyqtari konstatoi se viktimat kishin rënë dakord të punonte si prostitutë:

“Në caktimin e shumës së dëmshpërblimit për dëmet morale, Gjykata nuk ishte dakord me shumën prej 10 000 UAH për person, të pretenduar nga viktimat L. dhe Ye. dhe deklaroi se vetëm 1 200 UAH mund të jepen si dëmshpërblim,

---

<sup>306</sup> Vendimi i 26 gushtit 2004 i cituar në v. cit., shënimi 293, Ahtirskaya, f. 47-48.

<sup>307</sup> Vendim i 10 nëntor 2004, gjykata e Kharkivit, i cituar në po aty, f. 49.

meqenëse viktimat nuk arritën të provonin se dëmi i shkaktuar ishte i një shume më të madhe, pasi ato kishin rënë dakord që të punonin si prostituta dhe u arrestuan në kufirin shtetëror.”<sup>308</sup>

Niveli më i lartë i dëmshpërblimit nga çështjet e botuara në këtë raport ishte 20 000 UAH (3000 EUR), shumë e cila u dha në dy çështje. Shuma disi më të vogla, konkretisht 10 000 UAH (1500 EUR), iu dhanë 3 viktimave në një çështje të veçantë. Niveli më i ulët i dëmshpërblimit moral, 1000 UAH (150 EUR), iu dha viktimës në një tjetër çështje.<sup>309</sup>

### *Procedurat sipas së drejtës së punës*

Në thelb, e drejta e punës në Ukrainë nuk i rregullon çështjet e “shfrytëzimit,” sepse sipas së drejtës sovjetike të punës, “shfrytëzimi” konsiderohej si fenomen i dalë jashtë përdorimit. Projekti i ri i Kodit të Punës është debatuar gjatë, për disa vite me radhë, brenda parlamentit dhe gjatë, dhe ka marrë ndihmën e specializuar të IOM-it, por ende mbetet një projektligj shumë i kontestuar. Gjithashtu, nuk ka gjykata të veçanta pune, por shkeljet e së drejtës së punës do të trajtoheshin nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata administrative, në varësi të shkaqeve për të cilat është ngritur padia.

Neni 173 i Kodit Penal dënon shkeljet e rënda të marrëveshjes së punës, ndërkohë që rendit si një shkelje të mundshme shtrëngimin e viktimës për të kryer punë që nuk përmendet në marrëveshjen e punës. I njëjti krim ekziston dhe në lidhje me marrëveshjet e punës për të punuar jashtë shtetit.

### **5.6.2.3 Sekuestrimi i pasurisë**

Sipas nenit 29 të Kodit të Procedurës Penale, policia dhe prokuroria detyrohen që të marrin masa për të garantuar mundësinë e konfiskimit të pasurive të të akuzuarve, në rastet kur dënimi mund të përmbajë konfiskimin (duke përfshirë edhe trafikimin). Gjithsesi, sipas studimit, në mjaft raste trafikimi, kjo gjë nuk është bërë, ose për shkak se të akuzuarit nuk kanë shuma të mëdha parash si të ardhura nga krimet e tyre (duke qenë kryesisht rekrutues) dhe, si rezultat, nuk kanë fituar pasuri, ose pasuritë u nevojiten personave që kanë të pandehurit në ngarkim (p.sh. fëmijëve të tyre), ose i pandehuri ka bërë përgatitjet dhe i ka

---

<sup>308</sup> V. cit., shënimi 295, Strekalov, Kreu 8.

<sup>309</sup> Po aty.

regjistruar pasuritë në emër të një shoku ose një të afërmi, apo duke i zhdukur ato me shpejtësi menjëherë kur kanë filluar hetimet.<sup>310</sup>

Nëse gjatë proceseve penale, mund të provohet se pasuritë janë përfituar nëpërmjet mjeteve kriminale, atëherë ato mund të përdoren për dëmshpërblim, pavarësisht nga fakti nëse pasuria është në bashkëpronësi me një individ tjetër. Sipas nenit 125 të Kodit të Procedurës Penale, çdo pasuri e një kriminelit mund të përdoret për dëmshpërblim, nëse konfiskimi është një ndër sanksionet e mundshme për krimin në fjalë.

OJF-të kanë sugjeruar krijimin e fondit të pasurive të sekuestruara, të cilat do të shërbenin për dëmshpërblim si dhe për pagesën e shpenzimeve ligjore.

#### **5.6.2.4 Ndhimja për viktimat**

Hetuesit e policisë detyrohen që të informojnë viktimat për të drejtat e tyre, duke përfshirë dhe të drejtën për të bërë padinë civile.<sup>311</sup> Për më tepër, sipas vendimit nr. 13 të datës 02.07.2004 të Plenumit të Gjykatës Supreme të Ukrainës, gjykatat kanë detyrim të vazhdueshëm për të siguruar që të drejtat e viktimës të zbatohen dhe të respektohen. Gjykata Supreme dekretoi:

“1. T’u tërheqë vëmendjen gjykatave për faktin se përputhshmëria e plotë si dhe konsekuente në të gjitha fazat e proceseve penale me dispozitat e legjislacionit të procedurës penale të Ukrainës, që parashikojnë të drejtat e viktimave të krimit, është një ndër parakushtet më të rëndësishme për përmbushjen e të drejtave të qytetarëve për të qenë të mbrojtur nga gjykata, në rastet e ndërhyrjeve të paligjshme, siç parashikohet në nenin 55 të Kushtetutës së Ukrainës.”

Dhënia e statusit të “viktimës” i jep viktimës së trafikimit disa të drejta,<sup>312</sup> duke përfshirë të drejtën e përfaqësimit, që mund të realizohet me anë të një avokati, një shoku ose një të

---

<sup>310</sup> V. cit., shënimi 297, Shvab, f. 122-123 të versionit të botuar në Ukrainë.

<sup>311</sup> Neni 122 i Kodit të Procedurës Penale (KPP), procedurat e njoftimit të viktimës për të drejtat e saj. Hetuesi që dallon se personi është viktimë krimi duhet t’i shpjegojë atij të drejtat e parashikuara në nenin 49 të Kodit dhe ta shënojë këtë në një memorandum që do të konfirmohet nga nënshkrimi i viktimës. Nëse krimi i shkakton dëme materiale personit, ndërmarrjes, institucionit ose organizatës, hetuesi njofton viktimën dhe përfaqësuesin e saj mbi të drejtën për të bërë padi civile dhe duhet ta shënojë këtë në protokollin e marrjes në pyetje, ose t’i dërgojë viktimës një njoftim me shkrim; kopje e njoftimit do t’u bashkëngjitet materialeve të çështjes.

<sup>312</sup> Siç citohet në M. Wijers dhe R. Haveman, *Trafficking in human beings for the criminal justice chain in Ukraine* (Trafikimi i qenieve njerëzore për zinxhirin e drejtësisë penale në Ukrainë) (IOM, qershor 2006), Neni 49 i KPrP, Të drejtat e viktimës: “Qytetari, i njohur si viktimë krimi, ka të drejtë të dëshmojë për çështjen. Viktima dhe përfaqësuesit e tij/saj kanë këto të drejta: - të paraqesin prova,

afërmi (ose të një punonjësi social apo një përfaqësuesi nga një OJF).<sup>313</sup> Viktima propozon përfaqësuesin, ndërkohë që personi që drejton hetimet apo gjyqtari e pranon ose e rrëzon propozimin. Viktimat dhe përfaqësuesit mund të marrin pjesë në gjykatë si palë dhe përpara gjykatës gëzojnë të drejta dhe liri të barabarta në paraqitjen e provave, shqyrtimin e tyre dhe argumentimin e rëndësisë së tyre.<sup>314</sup> Si “palë civile paditëse,” viktima gëzon të drejta të tjera.<sup>315</sup>

Gjithsesi, nuk ka ndihmë ligjore falas, as lehtësi të subvencionuara nga shteti për të ndihmuar viktimat me avokatë, gjë që ndikon në mënyrë negative në zbatimin e të drejtave të tyre:

“Pa avokat, shanset e viktimës që të jetë në gjendje të mbrojë çështjen e saj janë minimale. Në teori, prokurori ka detyrim që të mbrojë interesat e viktimës; në praktikë, për ta realizuar këtë gjë viktima është shumë e varur nga avokati.”<sup>316</sup>

Në çështjet e shqyrtuara nga studimi Shvab,<sup>317</sup> më pak se gjysma e viktimave përfaqësoheshin nga avokatë. Të tjerat ose e kishin të pamundur të gjenin avokatin, apo nuk mund të paguanin tarifat, ose nuk donin të kishin avokatin e rekomanduar. Në disa raste, i njëjti avokat përfaqësonte viktimat të ndryshme. Shpesh avokatët nuk i takonin klientët para seancës gjyqësore, dhe nuk i përgatisnin viktimat për në gjyq. Në lidhje me cilësinë e përfaqësimit, ka një gamë të gjerë gjetjesh, por disa prej përfaqësuesve të viktimave konsideroheshin si pa përvojë dhe të paaftë në punën e tyre.

---

- të paraqesin kërkesa, - të shqyrtojnë të gjitha materialet e çështjes që nga momenti i përfundimit të hetimeve paraprake, ose nga momenti i transferimit të çështjes për shqyrtim në gjykatë (për çështje ku nuk përfshihen hetime paraprake); - të marrë pjesë në shqyrtimet gjyqësore; - të paraqesë mocione në lidhje me pushimin e çështjes; - të ankimojë veprimet e personit përgjegjës për hetimin, e hetuesit, të prokurorit dhe të gjykatës, si dhe të ankimojë vendimin e gjykatës ose urdhrat e gjykatës dhe rezolutat e gjyqtarit popullor; dhe të japë arsyet përkatëse – si dhe e drejta për ta patur të garantuar sigurimin e tij/saj. Në rastet e parashikuara në KPrP, viktima ka të drejtë të mbështesë akuzën gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij/saj. Viktima mund të marrë pjesë në debatet në gjykatë.”

<sup>313</sup> Neni 52.

<sup>314</sup> Neni 16(1) i KPrP.

<sup>315</sup> Siç citohet në v. cit., shënimi 312, M. Wijers dhe R. Haveman, neni 50 i KPrP, Të drejtat e paditësit civil: “një paditës civil ose përfaqësuesi i tij kanë këto të drejta: - të paraqesin prova; - të paraqesin kërkesa; - të marrin pjesë në shqyrtimet gjyqësore; - t'i drejtojnë organizmit hetimor, hetuesit ose gjykatës kërkesa për marrjen e masave në mënyrë që të sigurohet zbatimi i padive; - për të ndjekur padinë civile; - për të shqyrtuar materialet e çështjes që nga momenti i përfundimit të hetimeve paraprake, ose nga momenti i transferimit të çështjes për shqyrtim në gjykatë (për çështje në të cilat nuk përfshihen hetime paraprake) – të paraqesë mocione në lidhje me pushimin e çështjes; - të ankimojë veprimet e personit përgjegjës për hetimin, e hetuesit, e prokurorit dhe e gjykatës; si dhe të ankimojë vendimin ose urdhrat e gjykatës deri në masën e lidhjes së tyre me padinë civile; dhe të japë arsyet përkatëse; - si dhe të drejtën për të garantuar sigurimin e tij.”

<sup>316</sup> Raporti i IOM-it; shih më lart shënim 312.

<sup>317</sup> Po aty. V. cit., shënim 297, Shvab, f. 109-110, versioni i botuar në Ukrainë.

### 5.6.3 Përfundime mbi Ukrainën

Janë bërë përpjekje të mëdha për të ndërtuar strukturën juridike që zbaton të drejtat ligjore të viktimave në Ukrainë, duke përfshirë këshillat për llojet dhe shtrirjen e dëmeve që mund të kërkojnë. Ekziston edhe një propozim për skemën e dëmshpërblimit të financuar nga shteti, e cila, ndonëse do të ishte e disponueshme vetëm për viktimat e krimeve të rënda dhe do të mbulonte vetëm dëmet materiale, meriton konsideratë dhe mund të ketë ndikim të ndjeshëm në arritjen e pagesave të vendimeve për dëmshpërblim. Gjithsesi, shtetit i duhet të bëjë përpjekje të mëdha për të siguruar se komisionerët të jenë emëruar dhe të trajnohen, se ata do të kenë në dispozicion sistemin administrativ që realisht mund të përdoret, dhe se janë udhëzuar në masën e mjaftueshme për të marrë vendime konsekuente.

Nga ana tjetër, e drejta për të ngritur padi civile kundër një të akuzuari brenda procesit penal njihet mirë, ashtu si dhe e drejta për t'u informuar për të drejtat dhe për t'u përfaqësuar në proces. Ekziston gjithashtu jurisprudence e bollshme, kur dëmshpërblimi është dhënë në çështjet që janë identifikuar si çështje trafikimi për shfrytëzim seksual. Kjo vjen nga një komunitet aktiv OJF-sh dhe avokatësh që japin ndihmë dhe këshilla për personat e trafikuar, dhe e gjithë kjo ka ndihmuar në zhvillimin e praktikës gjyqësore.

Në parim, gjykatat e pranojnë se viktimat kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim, dhe se kompensimi për dëme mund të jepet. Është demonstruar se dëmet morale janë më me rëndësi se sa ato materiale, pasi personat e trafikuar në përgjithësi nuk kanë qenë në gjendje që të mbështesin me dokumentacion përkatës pretendimet për dëmet materiale. Fatkeqësisht, si në shumë juridiksione, viktimat rrallë, për të mos thënë kurrë, marrin pagesa sipas vendimeve që jepen.

Gjithsesi, praktika në gjykatat penale duket se nuk është konsekuente, kur bëhet fjalë për hartimin e padive civile, për trajtimin e tyre, për vendimmarrjen në lidhje me vlefshmërinë e tyre dhe në nivelin e shumave që jepen në vendimet. Është evidentuar se në disa raste, gjyqtarët udhëhiqen nga supozimet e tyre personale rreth trafikimit, dhe jo nga provat, kur vendosin për paditë civile. Janë evidentuar gjithashtu raste të 'shlyerjes' së viktimave nga trafikantët, për t'i bindur ato të tërhiqen nga procesi ligjor. Kjo tregon nevojën për këshillim dhe trajnim të gjyqtarëve, policëve dhe prokurorëve, në lidhje me sensibilizimin për çështjet e trafikimit dhe në lidhje me llogaritjen në mënyrë konsekuente të dëmeve që duhet shpërblyer.



E drejta e punës aktualisht nuk ofron instrumente që mund të përdorën nga viktimat, por kjo situatë mund të ndryshojë në qoftë se miratohet Kodi i ri i Punës.

#### **5.6.4 Praktika e mirë në Ukrainë**

- Po bëhen përpjekje për të krijuar fondin shtetëror për të paguar dëmshpërblim për çështje të krimeve të dhunshme. Modeli parashikon që shteti të trashëgojë mundësinë për të paditur trafikantin/shfrytëzuesin në emër të viktimës, që përmbush nevojën morale të domosdoshme që keqbërësi duhet të paguajë dhe që në të njëjtën kohë i lejon shtetit të rimarrë nga keqbërësi pagesën e bërë ose një pjesë të saj;
- Ligji kërkon që viktimat të jenë të informuara për të drejtat e tyre për të kërkuar dëmshpërblim në një etapë të hershme;
- Ekziston jurisprudencë e bollshme në lidhje me dëmshpërblim të dëmeve morale që jepet në rastet e trafikimit për shfrytëzim seksual;
- Përfaqësimi me avokatë është i disponueshëm dhe ndikon në padi në mënyrë pozitive; dhe
- Përpjekjet e grupeve të shoqërisë civile dhe puna e tyre në këshillimin e personave të trafikuar kanë pasur ndikim shumë të madh në zhvillimin e parimit të dhënies së dëmshpërblimit.

### **5.7 MBRETËRIA E BASHKUAR**

#### **5.7.1. Kuadri ligjor dhe institucional**

Mbretëria e Bashkuar është palë në KKBKON dhe në protokollin e trafikimit si dhe në Konventën Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme. Ajo ka ratifikuar gjithashtu Konventat e ILO-s që lidhen me Punën e Detyruar, por vetëm njëra prej tyre që lidhen me Mbrojtjen e Emigrantëve (ILO C97). Qeveria ka nënshkruar së fundmi Konventën e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit dhe ka nisur ndërmarrjen e masave për të zbatuar kërkesat e Konventës.<sup>318</sup>

---

<sup>318</sup> Shih “*New Deal for Trafficking Victims*,” (Ofertë e re për viktimat e trafikimit), 24 mars 2007; gazeta *The Guardian*, <http://www.guardian.co.uk/immigration/story/0,,2041718,00.html>. Duhet pasur parasysh se, pas prillit të vitit 2007, ka pasur shumë iniciativa në Mbretërinë e Bashkuar në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Ato nuk janë përditësuar, me përjashtim të rasteve kur lidhen në mënyrë specifike me çështjet e dëmshpërblimit.

Mbretëria e Bashkuar ka traditë juridike *common law*. Ligjet kombëtare që bëjnë trafikimin veprë penale janë seksionet 57 - 60 të Aktit të Veprave Penale Seksuale 2003 (trafikimit për shfrytëzim seksual) dhe seksioni 4 të Aktit të Azilit dhe të Emigracionit (Trajtimi i Kërkuesve) i vitit 2004 (trafikimi për shfrytëzimin e punës). Ka disa masa të tjera legislative që lidhen me trafikimin, si për shembull, Akti i Rekrutuesve që Gjejnë Punëtorëve Joformalë (ang. *Gangmasters*) (Akti i Liçencimit) 2004, krijimi i Autoritetit për rregullimin e rekrutuesve të punëtorëve joformalë, dhe Akti për Produktet e Krimit 2002; ky i fundit trajton pastrimin e parave dhe çështjet e sekuestrimit të pasurive.

Mbretëria e Bashkuar nuk ka në mënyrë institucionale raportues ose koordinator kombëtar për trafikimin; megjithatë, qeveria ka botuar së fundmi Planin Kombëtar të Veprimit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore.<sup>319</sup> Ka një grup ministror për trafikimin dhe një grup këshillimor të të interesuarve, krijuar në vitin 2005 nën mbikëqyrjen e *Home Office*-it (dikasteri i qeverisë angleze analoge me Ministrinë e Brendshme) (Nënsekretari për Policimin, Sigurimin dhe Sigurinë e Komuniteteve), por që përfshin edhe organe të tjera përkatëse. Ka gjithashtu një Grup të të Interesuarve për Ata që Punojnë Ilegalisht, drejtuar nga Ministri për Emigracionin, Nënshetësinë dhe Kombësinë të *Home Office*-it. Qendra e Trafikimit të Qenieve Njerëzore e Mbretërisë së Bashkuar është hapur në vitin 2006 dhe ka si qëllim bashkërendimin e veprimeve të organeve që zbatojnë ligjet.<sup>320</sup> Për më tepër, në Londër është krijuar një partneritet ndërmjet policisë, shërbimit të emigracionit dhe OJF-ve në formën e Projektit *Poppy* për të bërë identifikimin e viktimave dhe për të dhënë ndihmë për një numër të kufizuar viktimash të shfrytëzimit seksual.<sup>321</sup>

Qeveria është kritikuar për pozicionimin e saj lidhur me trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, duke iu referuar më tepër ligjeve të emigracionit sesa të drejtave themelore të njeriut,<sup>322</sup> ndërkohë që kohët e fundit janë raportuar probleme në lidhje me rekrutuesit të liçensuar të punëtorëve joformalë (*gangmasters*).<sup>323</sup>

---

<sup>319</sup> Shih dokumentet në faqen e *Internet*-it [http://www.londoncb.gov.uk/files/resources/trafficking/uk\\_action\\_plan\\_on\\_tackling\\_human\\_trafficking.pdf](http://www.londoncb.gov.uk/files/resources/trafficking/uk_action_plan_on_tackling_human_trafficking.pdf).

<sup>320</sup> Shih <http://www.ukhtc.org>

<sup>321</sup> [http://www.eaves4women.co.uk/POPPY\\_Project/POPPY\\_Project.php](http://www.eaves4women.co.uk/POPPY_Project/POPPY_Project.php)

<sup>322</sup> Letër/parashtrim i *Solicitors International Human Rights Law Group* (Grupit Ndërkombëtar të Avokatëve për të Drejtat e Njeriut) dërguar tek *Home Office*, 19 mars 2007.

<sup>323</sup> “*Migrants ‘deceived and exploited’*” (Emigrantët ‘të mashtruar dhe të shfrytëzuar’) dhe “*Joining the Immigrant Underclass*” (Të bashkohesh me shtresën e ulët të emigrantëve), Lajme BBC, 25 prill 2007; mund të gjendet në [http://news.bbc.co.uk/2/low/uk\\_news/6593321.stm](http://news.bbc.co.uk/2/low/uk_news/6593321.stm).

## 5.7.2 Skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve

### 5.7.2.1 Skemat e dëmshpërblimit shtetëror

Autoriteti për Dëmshpërblimin e Dëmtimeve Kriminale (CICA) administron skemën e financuar nga shteti, që u jep dëmshpërblim viktimeve të krimeve të dhunshme, të cilat kanë pësuar dëme fizike ose psikologjike që nuk janë “plotësisht pa rëndësi.” Krimi duhet të ketë ndodhur brenda Anglisë, Skocisë ose Uellsit,<sup>324</sup> dhe ankesa duhet të ngrihet brenda dy vjetësh nga ndodhja e krimit.<sup>325</sup> Skema mund të përdoret gjithashtu për të kompensuar të afërm të një personi që ka vdekur si pasojë e krimit, si dhe persona që kanë marrëdhënie të ngushta me viktimën e që kanë pësuar dëm psikologjik, si rezultat i pranisë së tyre në vendndodhjen e krimit ose të përfshirjes së tyre të ngushtë menjëherë pas ndodhjes së krimit. Llojet e disponueshme të dëmshpërblimit përfshijnë si dëmet morale, ashtu edhe ato materiale:

**a) Shpërblimi për dhimbje dhe vuajtje** të shkaktuar nga dëmtimet fizike ose mendore. Shuma aktuale për këtë është e fiksuar me anë të një “tarife” që ka 25 nivele dëmshpërblimi për dëmet, të cilat shkojnë nga 1 000 – 250 000 GBP<sup>326</sup> (për shembull 27 000 GBP<sup>327</sup> për humbjen e njërit sy, 1 000 – 33 000 GBP<sup>328</sup> për abuzim seksual, dhe 8 200 GBP<sup>329</sup> për sëmundje mendore dhe ankth të përkohshëm mendor, që zgjasin nga 2 deri në 5 vjet, të konfirmuar nga diagnoza psikiatrike).<sup>330</sup> Tarifat aktuale u përcaktuan nga Parlamenti në vitin 2001.

**b) Shpërblimi për vdekjen** mund t’i jepet prindit, fëmijës, bashkëshortit ose partnerit. Shuma është e palëvizshme, 11 000 GBP<sup>331</sup> nëse vetëm një person që mund të përfitojë nga shpërblimi, 5 500 GBP secili, nëse ka më shumë se një person. Shpërblimi mund t’i jepet dhe atij personi i cili ishte në ngarkim të të ndjerit.

---

<sup>324</sup> Për Irlandën e Veriut ka skemë të veçantë.

<sup>325</sup> Me përjashtim të rasteve kur ka rrethana të veçanta.

<sup>326</sup> Afërsisht 1 400 EUR – 351 830 EUR.

<sup>327</sup> Përafërsisht 38 000 EUR.

<sup>328</sup> Përafërsisht 1 400 – 46 438 EUR.

<sup>329</sup> Përafërsisht 11 539 EUR.

<sup>330</sup> Shih përlogaritjen e tarifave në adresin e *Internet-it*

<http://www.cica.gov.uk/Documents/publications/Criminal%20Injuries%20Compensation%20Scheme%202008.pdf>

<sup>331</sup> Përafërsisht 15 480 EUR.

**c) Shpenzime të veçanta:** Mund të pretendohen edhe shpenzime varrimi dhe shpenzime për trajtime apo pajisje mjekësore të specializuara.

**ç) Humbja e të ardhurave:** dëmshpërblimi mund të jepet vetëm nëse viktimi nuk është në gjendje të punojë për 28 javë me radhë nga data e dëmtimit. Kjo kërkon raporte me shkrim nga punëdhënësi dhe nga mjeku.

Humbja e të ardhurave dhe shpenzimet e veçanta (shkronjat c dhe ç më sipër) paguhen deri në maksimumin prej 250 000 GBP, kështu që shuma maksimale e kombinuar që paguhet sipas skemës është 500 000 GBP për një dëmtim të vetëm.<sup>332</sup> Në rast se janë shkaktuar disa dëme, kompensohen vetëm tri dëmet më serioze, në shumën 100% të tarifës për dëmin, që llogaritet më i larti; plus 30% e shumës së tarifës për dëmin e vlerësuar si të dytin; plus 15% e shumës së tarifës për dëmin e tretë në listë.

Dëmshpërblimi mund të kërkohet edhe në qoftë se nuk ka pasur dënim në procesin penal. Gjithsesi, viktimi duhet ta ketë denoncuar veprën në polici në kohën e duhur dhe duhet të zotërojë prova mjekësore. Viktimat duhet të jenë gjithashtu të gatshme që të bashkëpunojnë dhe të ndihmojnë në hetime dhe ndjekje penale (në vitet 2004 - 2005, 30% të pretendimeve u refuzuan për shkak të vonesës në denoncim ose të “mosbashkëpunimit.”)<sup>333</sup> Për më tepër, CICA mund ta refuzojë ose ta ulë shumën nëse viktimi ka qenë e përfshirë në aktivitetin kriminal ose nëse viktimi e ka provokuar dhunën, duke u sjellë në mënyrë agresive ose duke filluar një përleshje. (Në vitet 2004 - 2005, pak më pak sesa 21% të pretendimeve u refuzuan për këto arsye).<sup>334</sup> Kriteri tjetër kufizues që mund të ketë ndikim mbi viktimat e trafikimit është fakti se viktimi nuk duhet të bashkëjetojë me keqbërësin ose të jetë e lidhur me të në kohën e aplikimit, me përjashtim të rasteve kur keqbërësi është dënuar në fakt për krimin. Arsyeja për këtë është që të parandalohet shkelësi i ligjit për të përfituar shpërblim.

Viktimi mund t'i drejtojë kërkesën CICA-s, e cila autorizon atë që të marrë informacion konfidencial nga policia, doktorët, spitalet, etj. Secilës çështjeje i caktohet një nëpunës përgjegjës, i cili përpunon çështjen me synimin për të marrë vendimin brenda një viti. Zakonisht përpara se të marrë vendimin, CICA pret përfundimin e çështjes penale, në rast se çështja është akoma në gjykim. Çështjet me llogaritjen komplekse të dëmeve mund të kërkojnë më shumë kohë. Nëse pala kërkuese nuk është e kënaqur, atëherë ajo mund të

---

<sup>332</sup> Përafërsisht 351 830 EUR, d.m.th., pretendimi maksimal është pak më lart sesa 700 000 EUR për një dëmtim.

<sup>333</sup> Shih Raportin Vjetor dhe Llogaritë të CICA-s 2004/5, f.6, të disponueshme në faqen e *Internet-it*. [http://www.cica.gov.uk/Documents/previous\\_schemes/CICA%20Annual%20Report%20and%20Accounts%2004-05.pdf](http://www.cica.gov.uk/Documents/previous_schemes/CICA%20Annual%20Report%20and%20Accounts%2004-05.pdf)

<sup>334</sup> Po aty.

kërkojë rishqyrtimin e brendshëm të vendimit. Nëse ky proces nuk mjafton, atëherë ajo mund ta ankimojë vendimin pranë organit të pavarur të quajtur Bordi i Apeleve të CICA-s.

Ndërkohë që informacioni dhe kërkesat për skemën gjenden në faqen e *Internet-it*, CICA publikon, në po atë faqe, botime udhëzuese në shumë gjuhë të pakicave.<sup>335</sup> Për administrimin e pretendimeve të ngritura nga kërkuesit që gjenden në vende të tjera brenda BE-së, CICA përdor Rregulloret e vitit 2005 (të përafuara me Direktivat e Bashkimit Evropian) për Viktimat e Krimeve të Dhunshme të Kryer me Dashje, të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 korrik 2006, por që nuk zbatohen për kërkuesit, dëmtimet e të cilëve kanë ardhur si pasojë e krimeve të kryera përpara kësaj date.

CICA ofron shërbime relativisht të thjeshta për viktimat në krahasim me procesin civil. Shërbimi është më i shpejtë dhe më pak burokratik sesa procedurat në një gjykatë civile. Një përfitim tjetër është heqje e të pandehurit nga ekuacioni, gjë që mund të jetë tërheqëse për shumë viktimë, edhe pse, në të njëjtën kohë, kjo e zhvesh keqbërësin nga përgjegjësia morale. Nga ana tjetër, dëmshpërblimi jepet vetëm atëherë kur plotësohen kriteret e përcaktuara. Gjithashtu, përderisa bëhet fjalë për tarifa fikse, shpërblimi mund të mos jetë aq i lartë sesa shpërblimi i dhënë nëpërmjet vendimit në procesin civil. D.m.th., ka të ngjarë që shpërblimi të jetë më i vogël, por merret më lehtësisht se në procesin civil. PAGESA jepet drejtpërsëdrejti nga shteti, dhe nuk varet nga ekzekutimi i vendimit ndaj të paditurit. Megjithatë, duke pasur parasysh kohën që duhet për marrën e vendimit dhe kriteret e rrepta për pranimin e kërkesave nga CICA, procedura mund të plotësohet më me vështirësi në krahasim me urdhrin e dëmshpërblimit që jepet në procesin penal (shih më poshtë). CICA mund të japë dëmshpërblim edhe në rastet kur janë dhënë vendime në procese të llojeve të tjera, por shumat përkatëse do të zbriten.

Kostoja e përgjithshme e funksionimit të skemës së CICA-s, për sa i përket administrimit dhe stafit, në vitet 2004/2005 ishte 19 milionë GBP, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe gjenin zgjidhje 67 000 çështje. Për më tepër, 321 milionë GBP janë shpenzuar vetëm për pagesat e dëmshpërblimit.<sup>336</sup> Krahasimi i këtyre shumave drejtpërsëdrejti me buxhetet e shteteve të tjera të OSBE-së nuk është i përshtatshëm, për shkak të dallimeve në paga/kosto jetese, në popullsi dhe në sasinë e kërkesave, etj. Shifrat jepen për të ilustruar nivelin e angazhimit të shtetit.

---

<sup>335</sup> <http://www.cica.gov.uk/>

<sup>336</sup> Shih v. cit., shënimi 333, f. 10. Në vitet 2004/2005 u dhanë 35 446 shpërblime sipas tarifave; në 56%, u morën vetëm 1 000 – 2 000 GBP në shenjë njohjeje të dhimbjes dhe të vuajtjes së viktimave. Në gjashtë raste, u morën 250 000 GBP, tarifën maksimale, dhe në dhjetë raste, shpërblimi maksimal prej 500 000 GBP, duke përfshirë të ardhurat e humbura dhe shpenzimet e veçanta.

Kriteri sipas të cilit viktimës kërkohet të ketë pësuar nga krimi i dhunshëm dëmin që nuk është “plotësisht pa rëndësi” mund të përbëjë një pengesë për viktimat e trafikuar për të përfituar nga skema, në rastet kur atyre u është ushtruar dhuna psikologjike. Kufizimet e vendosura për pranimin në skemë janë përdorur tashmë për viktimat e shfrytëzuara për punë (të cilat u konsideruan, gjithashtu, si viktimat trafikimi), mbështetur në përfundimin se ato ishin përfshirë në mënyrë të vullnetshme në veprimin e paligjshëm, duke hyrë pa të drejtë në Mbretërinë e Bashkuar. Kështu, ato nuk e kaluan testin e pranimin në skemë për “shkaqe karakteri.” Duket se të afërmit të 21 kinezëve që vdiqën duke mbledhur midhje të vogla (ang. *cockles*) në baticat e Gjirit Morecambe (në veriperëndim të Anglisë) në vitin 2004 iu është mohuar dëmshpërblimi nga skema, pavarësisht se shfrytëzuesit e tyre u dënuan penalisht për vrasje (ang. *manslaughter*, një lloj vrasjeje sipas së drejtës angleze, pa paramendim dhe pa ligësi), duke shtrembëruar rrjedhën e drejtësisë dhe vepra penale që lidhen me emigracionin.<sup>337</sup> Për arsye të njëjta, janë refuzuar edhe viktimat e trafikimit për shfrytëzim seksual.<sup>338</sup> Megjithëse, për sa u përket parashikimeve të KEDVKDh-së, ky kufizim nga përfitimi është legjitim, ai nuk është as në frymën e Protokollit të Trafikimit dhe as në atë të Konventës Evropiane kundër Trafikimit, të cilat parashikojnë identifikimin e duhur të viktimave të trafikimit si pjesë të reagimit të integruar ndaj problemit, duke përfshirë dhënien e dëmshpërblimit.

Duke marrë parasysh se Mbretëria e Bashkuar ka dështuar në marrjen e hapave për të identifikuar viktimat e trafikimit, mbetet për t’u diskutuar nëse vendimi për të mos i dëmshpërblyer ato i pasqyron siç duhet detyrimet ndërkombëtare të Mbretërisë së Bashkuar. Kur viktimat vriten gjatë shfrytëzimit që mund të ketë qenë i lidhur me trafikimin, atëherë identifikimi i viktimave të trafikimit bëhet më i vështirë. Gjithsesi, autoritetet mund të kishin bërë prezumim për trafikimin në këndvështrim të rrethanave dhe mund të kishin përdorur diskrecionin për të dhënë dëmshpërblim. Për rastin e punëtorëve kinezë që mblidhnin midhje, pretendohet se autoritetet e emigracionit ishin në dijeni të shfrytëzimit të kinezëve në fjalë para se të vdisnin, si dhe të rrezikut me të cilin ata përballeshin në punë, por nuk

---

<sup>337</sup> Për detaje të çështjes dhe për dënimet e dhëna shih [http://www.cps.gov.uk/news/press\\_releases/117\\_0](http://www.cps.gov.uk/news/press_releases/117_0) . Shih gjithashtu “*Are Chinese Lives Cheaper?*” (A janë më të lira jetët e kinezëve?), 8 korrik 2004 <http://www.irr.org.uk/2004/july/ak000009.html> për informacion rreth kërkesës për dëmshpërblim. Shih Mark Ryan, avokat për familjet. “... kërkesat e familjeve janë kundërshtuar pasi viktimat “u angazhuan vullnetarisht” në një “akt të paligjshëm.” Ata ishin qenie njerëzore dhe meritojnë të trajtohen si të tilla ...”, *Socialist Worker* (Punëtori Socialist) *online*, 24 korrik 2004, <http://www.socialistworker.co.uk/art.php?id=1020> . Duke kërkuar konfirmim për këtë, pyetje u janë dërguar avokatëve që përfaqësojnë grupin. Megjithatë, nuk është marrë ende asnjë përgjigje, kështu që raportet janë të pakonfirmuara. Ka mundësi, që vendimi i apelit akoma pritet.

<sup>338</sup> Informacion nga Deirde O’Leary, Nëndrejtuese e njësisë *pro bono* (shërbime ligjore falas) në zyrën e avokatisë *Lovells*.

ndërmorën masa parandaluese.<sup>339</sup> Si rezultat, ka mundësi që edhe e drejta e viktimave për të jetuar ishte dhunuar. Me fjalë të tjera, zbatimi i ngushtë të skemës CICA rezulton më i orientuar drejt politikës për emigracionin, se sa drejt identifikimit dhe dëmshpërblimit të rasteve të trafikimit.

Probleme të tjera të dokumentuara me të cilat janë përballur viktimat individuale në kërkimin e dëmshpërblimit, përfshijnë kthimin e parakohshëm të viktimave në vendin e tyre të origjinës. Kjo do të thotë se kur janë filluar tashmë kërkesat e tyre, avokatët e kanë të vështirë të komunikojnë me viktimat si dhe të marrin prova për dëmet e tyre fizike dhe psikologjike, si dhe të marrin informacion nga autoritetet e vendeve të tyre.<sup>340</sup> Kur klientët nuk e kanë filluar ende procesin e kërkimit të dëmshpërblimit përpara se të largohen nga territori dhe kur kërkojnë këshillim ligjor nga avokatët në Mbretërinë e Bashkuar, zyrat e avokatisë mund të pengohen t'i përfaqësojnë ata, për shkak të detyrimit (që del nga legjislacioni i pastrimit të parave) për ta parë fizikisht klientin dhe për të kontrolluar identitetin dhe detajet e adresës së tij.<sup>341</sup>

Që prej majit 2007, Projekti *Poppy* kishte përcjellë tek avokatët 12 raste të mundshme të pretendimeve për dëmshpërblim. Prej tyre, shtatë kërkesa i ishin paraqitur CICA-s, ndërkohë që vendimet për to u pritën. Në korrik të vitit 2007, CICA dha dëmshpërblimin e parë për viktimat e trafikimit.<sup>342</sup>

“Dy gra të reja me origjinë rumune u trafikuan në Mbretërinë e Bashkuar për qëllime të shfrytëzimit seksual. Gjatë viteve ato iu nënshtruan persekutimit në formën e skllavërisë, prostitucionit të detyruar, përdhunimeve të shumëfishta dhe rrahjeve. Ato u arratisën nga trafikanti i tyre në janar të vitit 2006, dhe iu përcollën Projektit *Poppy*. Gratë dëshmuar në çështjen penale kundër trafikantëve, të cilët u dënuar me 21 vjet burgim. Trafikantët nuk u dënuar për trafikim, por për përdhunim dhe zotërim prostitucioni (mesa duket në atë kohë ligji i trafikimit mund të mos ketë qenë në fuqi). Megjithatë, ato u identifikuan si viktima të trafikimit nga Projekti *Poppy*. Me ndihmën e avokatëve që punonin *pro bono* (pa pagesë), ato iu drejtuan CICA-s me arsyetimin se u takonte të

---

<sup>339</sup> “MP meets Ministers over cocklers” (Deputeti takon Ministrin për njerëzit që mblidhnin midhje), lajmet BBC, 12 shkurt 2004, <http://cdnedge.bbc.co.uk/1/hi/england/lancashire/3480979.stm>, “The Scandal of Morecambe” (Skandali i gjirit Morecambe) Revista *Daily Telegraph*, 13 shkurt 2004, <http://www.telegraph.co.uk/opinion/main.jhtml?xml=/opinion/2004/02/13/dl1302.xml>.

<sup>340</sup> Informacion nga Projekti *Poppy*, 19 prill 2007.

<sup>341</sup> Intervistë me Znj. Bronwen Byrnes të SIHRG-së, 26 prill 2007.

<sup>342</sup> Informacion i dhënë nga shoqata *Anti-slavery International* dhe Parosha Chandran, avokat për gjyqe, nëntor 2007.

merrnin dëmshpërblim për abuzim seksual dhe dëmshpërblim për humbjen e mundësive/të të ardhurave për periudhën disavjeçare, gjatë së cilës u mbajtën në izolim nga trafikantët. Pas një periudhe komunikimi ndërmjet avokatëve dhe CICA-s, një prej kërkuesve mori nga CICA një shpërblim prej 66 000 GBP,<sup>343</sup> mbi bazën si vijon:

a) Për **abuzim seksual** prej më shumë se tri vitesh, 22 000 GBP. Kjo është shuma që jepet sipas tarifës standarde të CICA-s për çështje të abuzimit seksual për tri vjet.

b) Për **humbje të të ardhurave/të mundësive**, 40 000 GBP. Kjo shumë është tarifa që i lihet në diskrecion CICA-s për ta vendosur shumën, e cila ishte përlllogaritur si 10 000 GBP në vit për periudhën gjatë së cilës viktimja është mbajtur kundër dëshirës së saj.

c) Kërkueses së dytë iu dha 36 500 GBP<sup>344</sup> në bazë të përlllogaritjes së përafërt, si vijon: 16 500 GBP për abuzim seksual të përsëritur deri në tre vjet, dhe shpërblimi diskrecional prej 20 000 GBP për humbjen e mundësive. Shpërblimi i fundit është më i ulët pasi viktimja e dytë ishte më e re në moshë në atë kohë, kështu që mundësia e saj për të fituar ishte më e ulët, si dhe pasi ajo nuk ishte mbajtur nga trafikanti për aq kohë sa ishte mbajtur viktimja e parë.”

Shuma e dhënë tregon se me ndihmën aktive të avokatëve, gratë e reja ia arritën të bindnin CICA-n se ato duhet të merrnin para për t’u shpërblyer për ato që mund të kishin fituar gjatë periudhës përkatëse, nëse nuk do të ishin trafikuar. Duket se kjo bazohet në shuma ekuivalente me kapacitetin e tyre për të fituar të ardhurat në ekonominë formale. Mbetet ende për t’u parë nëse CICA do të pranojë pretendime të tilla dhe lloje të njëjta të argumentimit, atëherë kur çështja nuk mbështetet prej vendimi të dhënë nga gjykata penale.

Në dhjetor të vitit 2007, u raportua se CICA do të ndryshonte interpretimin e udhëzimeve të saj, për t’u bërë të mundur viktimave të prostitucionit të detyruar dhe të heqjes së paligjshme të lirisë, me qëllim që kërkesat për dëmshpërblim të jenë më të lehta për t’ju përdorur nga personat e trafikuar që janë shfrytëzuar seksualisht.<sup>345</sup>

---

<sup>343</sup> Përafërsisht 93 000 EUR.

<sup>344</sup> Përafërsisht 51 000 EUR.

<sup>345</sup> “Sex slaves” win cash in landmark legal deal (“Skllavët që përdoren për seks” fitojnë para nga marrëveshje historike ligjore), gazeta *The Observer*, 16 dhjetor 2007.



### 5.7.2.2. Dëmshpërblimi i dhënë nga gjykatat civile, penale dhe të punës

Përderisa Mbretëria e Bashkuar ka një traditë ligjore *common law*, viktimat nuk legjitimohen në proceset penale, dhe as nuk mund të bëhen palë në procesin civil ose të kenë përfaqësim. Nuk ka dispozita të posaçme që t'u garantojnë viktimave të trafikimit masa të veçanta në lidhje me përfaqësimin ose dëmshpërblimin të ndryshme nga dispozitat për viktimat e zakonshme të krimit (ndryshe nga situata në SHBA). Ka disa procedura të kufizuara që janë "miqësore për viktimën," të cilat janë përfshirë së fundmi në praktikën gjyqësore (shih më poshtë proceset penale). Ka gjithashtu dispozita dëmshpërblimi që mund të urdhërohen në një çështje penale, dhe viktimat ka gjithnjë dorë të lirë të ndjekë një çështje civile për dëmshpërblim në kushtet të veçanta (shih më poshtë paditë civile). Procesi civil mund të përdoret pavarësisht nga ekzistenca e dënimit në çështjen penale.

Çështjet e lidhura me të drejtat e punës zakonisht u drejtohen gjykatave të veçanta jashtë sistemit të zakonshëm gjyqësor, të specializuara për punësimin (ang. '*employment tribunals*').

#### *Proceset penale*

E drejta penale parashikon mundësi si për kthimin e sendeve, ashtu edhe për dëmshpërblimin nga humbjet. Nëse viktimës i janë mohuar gjatë kryerjes së krimit sendet në mënyrë të paligjshme, atëherë, sipas s. 28 të Aktit të Vjedhjes 1968, gjykata mund të urdhërojë sekuestrimin dhe kthimin e atyre sendeve. Kjo njihet si "kthim" (*restitution*) në të drejtën penale të Mbretërisë së Bashkuar, dhe mbulon sende konkrete si, për shembull, sendet që i përkasin viktimës, pasaportën, etj. që, si pasojë e krimit, kanë qenë në zotërim të të dënuarit.

Gjithashtu, kur autori i krimit dënohet, gjykata duhet të marrë në konsideratë nxjerrjen ndaj tij e një urdhri dëmshpërblimi:

"për t'i paguar dëmshpërblim [viktimës] për dëme personale, humbje ose dëme të shkaktuara nga vepra ose çdo vepër tjetër penale që është marrë në konsideratë nga gjykata gjatë caktimit të dënimit."<sup>346</sup>

Dëmshpërblimi mund të paguhet për

---

<sup>346</sup> S. 130, Akti i Kompetencave të Gjykatave Penale 2000.

“dëmet personale, humbjet nëpërmjet vjedhjes, ose dëmtimit të pronës, humbjet nëpërmjet mashtrimit, humbjet e të ardhurave kur [viktima] mungon në punë, shpenzimet mjekësore, shpenzimet e udhëtimit, dhimbje dhe vuajtje...”.<sup>347</sup>

Pagat e papaguara ose të nënpaguara, që burojnë nga vetë vepra, do të përjashtoheshin nga urdhra të tillë dëmshpërblimi, me përjashtim të rasteve kur mund të argumentohet, se ato bëjnë pjesë në kategorinë e “humbjeve përmes mashtrimit” ose kur gjykata është e gatshme për të përdorur diskrecionin e saj. Gjykatat e magistratëve (ang. “*Magistrates’ Courts*,” të cilat janë, në Mbretërinë e Bashkuar dhe në disa vende të tjera *common law*, gjykatat më të ulëta, që trajtojnë vepra më pak të rënda) mund të japin si maksimum 5 000 GBP dëmshpërblimi, ndërkohë në Gjykatat mbretërore (ang. “*Crown Courts*”), nuk ka kufi.

Në praktikë, dëmshpërblimi që jepet nga gjykata nuk reflekton të gjithë masën e humbjes dhe të dëmeve, siç do të llogariteshin në procesin civil. Gjykatat mund të hezitojnë të shpërblejnë dëmtime aty ku natyra e dëmit ose e humbjes nuk është e mirëpërcaktuar, por dëmi është rezultat i traumës psikologjike. Në këtë rast, dëmshpërblimi mund të jetë vetëm një shumë simbolike, sidomos kur i pandehuri është dënuar me burgim dhe pasuritë e tij nuk janë sekuestruar (shih tabelën më poshtë për më shumë detaje lidhur me masën e dëmshpërblimit). Në përfllogaritjen e shumës së dëmshpërblimit, merren parasysh pasuritë e autorit, por nuk ka udhëzime të tjera për llogaritjen e dëmeve. I pandehuri ka të drejtë t’i paguajë shumat në këste, dhe ia bën pagesën gjykatës, e cila nga ana e saj paguan viktimën.

Në Mbretërinë e Bashkuar, viktima nuk përfaqësohet në procese penale dhe nuk mund të bëjë kërkesë për dëmshpërblim dretpërsëdrejti në gjykatë. Si rezultat, kërkohet që viktima të mbështetet tek policia, prokurorët dhe gjyqtarët në procesin gjyqësor, në qoftë se kërkesa për dëmshpërblim do të shqyrtohet. Sipas Projektit *Poppy*, strukturat që zbatojnë ligjet ngurrojnë të ndihmojnë viktimat të në marrjen e dëmshpërblimit, me sa duket duke pasur frikë se mundësia e dëmshpërblimit do të shfrytëzohej nga avokatët e mbrojtjes me argumentin se janë “joshur” gratë që të japin dëshmi kundër trafikantëve të tyre.<sup>348</sup> Policia duhet të marrë detaje për humbjet dhe dëmet nëpërmjet “Deklaratës Personale të Viktimës.” Më pas, prokurori duhet ta njohë gjykatën me humbjet dhe dëmet. Gjithsesi, ligji nuk është i qartë për detyrimet e prokurorit për ta parashtruar kërkesën në gjykatë në seancën kur jepet dënimi. Sipas ligjit, kur nuk jepet dëmshpërblimi në rastet e vdekjes, plagosjes, humbjes ose dëmtimeve, atëherë, për këtë gjykata duhet të japë arsyet.

---

<sup>347</sup> <http://www.cjsonline.gov.uk/victim/compensation.index.html>.

<sup>348</sup> Shih Grupi Ndërkombëtar i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut në komunikatë me *Home Office* të Mbretërisë së Bashkuar, 19 mars 2007, shënim 322.

Udhëzimet e Shërbimit Mbretëror të Prokurorisë thonë:

“Prokurori mund të tërheqë vëmendjen e gjykatës për kompetencat e saj për të dhënë dëmshpërblim dhe të ftojë atë të nxjerrë urdhra të tilla, aty ku shihet me vend.”<sup>349</sup>

Do të ishte mirë, që ky udhëzim për prokurorët të formulohet më me forcë dhe të jetë bazuar në ligj, për t’u siguruar se do të merret parasysh dëmshpërblimi dhe se informacioni i nevojshëm për të mbështetur kërkesën, do të përgatitet përpara seancës gjyqësore.<sup>350</sup> Udhëzimi vijon më tej:

“Viktimat mund të kenë vuajtur nga stresi i madh, mund të kenë pësuar dëmtime të trupit ose humbje financiare dhe u takon t’ia paraqesin këto fakte si dhe kërkesa për dëmshpërblim gjykatës. Gjykatat i japin shumë rëndësi nxjerrjes së urdhrave të dëmshpërblimit dhe janë të detyruara të japin arsytet kur ato refuzojnë lëshimin e urdhrave të tillë. Prokurorët duhet të mbajnë shënim se çfarë dëmshpërblimi u kërkua, çfarë urdhrash u dhanë dhe çfarë komentesh mund të ketë bërë gjykata në dhënien e shpërblimit ose në uljen e shumës së kërkuar.”<sup>351</sup>

Kodi i Praktikës për Viktimat e Krimit,<sup>352</sup> që i detyron shumë struktura të drejtësisë penale (duke përfshirë Shërbimin e Prokurorisë Mbretëror, policinë, gjykatat, shërbimin e provës, etj.) të plotësojnë një tërësi detyrash për viktimat e krimit, nuk përmend detyrimin për të informuar viktimat për të drejtat e tyre për dëmshpërblim në gjykatat penale apo për të ndjekur ecurinë e pretendimeve të tyre.

Më 30 prill 2007, Këshilli Konsultativ për Dënimet nxori udhëzime për gjyqtarët dhe magjistratët, për të gjitha aspektet e dënimit në rastet e trafikimit. Udhëzimet nxirren në bazë të vendimeve të mëparshme të gjykatave, të politikës së qeverisë, të këshillave të hollësishme nga avokatë dhe akademikë, si dhe të konsultimeve me të gjitha grupet e

<sup>349</sup> [http://cps.gov.uk/legal/section15/chapter\\_c.html#10](http://cps.gov.uk/legal/section15/chapter_c.html#10).

<sup>350</sup> Broshura “*The Prosecutor’s Pledge*” (Premtime të prokurorit), e botuar në 2005, u bën disa “premtime” viktimave të krimit, ndërmjet të cilave: “PREMTIM: Pas dënimit, aplikoni për urdhrin përkatës të dëmshpërblimit, kthimit ose mbrojtjes në të ardhmen për viktimën. Prokurori do të shqyrtojë gjithmonë nëse duhet të bëhet kërkesë për dëmshpërblim ose kthim në emrin tuaj. Në rrethanat e duhura, prokurori mund të inkurajojë gjithashtu gjykatën të vendosë urdhër shtrëngues për të garantuar sigurinë tuaj në të ardhmen. Për këtë, ata do të marrin parasysh çdo gjë që thatë në Deklaratën Personale të Viktimës.”

<sup>351</sup> [http://www.cps.gov.uk/publications/prosecution/prosecutor\\_pledge.html](http://www.cps.gov.uk/publications/prosecution/prosecutor_pledge.html).

<sup>352</sup> Tetor 2005. E disponueshme në faqen e Internet-it <http://www.cjsonline.gov.uk/downloads/application/pdf/2009-07-29Guideforvictims.pdf>

interesit.<sup>353</sup> Në lidhje me dëmshpërblimin, në to thuhet se në të gjitha çështjet e shfrytëzimit, duke përfshirë dhe trafikimin:

“6.9. Urdhrat e konfiskimit dhe të dëmshpërblimit kanë vend të veçantë në kuadrin e veprave të shfrytëzimit, ku ka shumë të ngjarë të ketë pasuri të autorit të krimit për t’u sekuestruar, dhe gjithashtu se viktimave të shfrytëzuara t’u jetë shkaktuar një shkallë dëmi që mund të meritojë dëmshpërblim.”<sup>354</sup>

Ky paragraf lidh në mënyrë të shprehur dëmshpërblimin me aftësinë për të marrë pasuri nga autori i veprës (për më shumë detaje shih më poshtë, pjesën mbi sekuestrimin e pasurive). Në lidhje me trafikimin, udhëzimet vazhdojnë se:

“10. Kur autori i krimit ka përfituar nga përfshirja e tij në prostituimin e të tjerëve, gjykata duhet të marrë në konsideratë nxjerrjen e urdhrit të konfiskimit<sup>355</sup> për shumën për afërsisht të barabartë me përfitimet e nxjerra.”<sup>356</sup>

Statistikat e mëposhtme janë ato më të përditësuara të disponueshme në lidhje me numrin e urdhrave të dëmshpërblimit të dhëna në çështjet penale dhe shumat e dhëna. Përqindja e çështjeve në të cilat është dhënë dëmshpërblimi është shumë e ulët, në veçanti për vepra seksuale. Kjo mund të reflektojë faktin, që gjyqtarët nuk kanë qenë të gatshëm të japin në të njëjtën kohë urdhra dëmshpërblimi dhe dënim më burgim. Ato mund të tregojnë gjithashtu, se mendohet që të pandehurit nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar dëmshpërblim; kompetencat për sekuestrimin e pronave janë forcuar vetëm kohët e fundit. Në të njëjtën mënyrë, vendimet aktuale janë shumë të ulëta. Mund të arrihet në përfundim se pagimi i më pak se 700 GBP për një akt të dhunshëm ose seksual, ka të ngjarë të perceptohet nga viktima më tepër si ofendim sesa veprim drejtësie.

---

<sup>353</sup> Sipas seksionit 172 të Aktit të Drejtësisë Penale 2003, gjykata është e detyruar të “ketë parasysh” udhëzimin përkatës, dhe seksioni 174(2) i të njëjtit Akt i kërkon gjykatës të japë arsye kur merr vendimin për një lloj dëmi, që nuk përcaktohet në udhëzimet. Gjithsesi, kjo u referohet kryesisht dënimeve, që nuk përfshihen në rrethe të gjera të dënimeve të propozuara nga Udhëzimet, p.sh., shërbim në komunitet ose lirim me kusht brenda komunitetit, në vend të burgimit. Çështje të tilla si mospagimi i dëmshpërblimit dhe konfiskimi ka më pak të ngjarë të apelohe mbi bazën e mosndjekjes së Udhëzimeve, por apelimi nuk është i pamundur, në veçanti pasi Udhëzimet për këtë çështje janë forcuar kohët e fundit.

<sup>354</sup> Akti i Këshillit për Udhëzimet e Dënimeve për Vepra Seksuale 2003, Udhëzime definitive, pjesa 6, faqe 105, paragrafi 6.9, gjendet në faqen e Internet-it [http://www.sentencing-guidelines.gov.uk/docs/0000\\_SexualOffencesAct1.pdf](http://www.sentencing-guidelines.gov.uk/docs/0000_SexualOffencesAct1.pdf).

<sup>355</sup> Sipas Aktit për Produktet e Krimeve 2002 – shih më poshtë.

<sup>356</sup> V. cit., shënimi 354, Udhëzimet e Dënimeve, f. 130, paragrafi 10, [http://www.sentencingcouncil.org.uk/docs/web\\_SexualOffencesAct\\_2003.pdf](http://www.sentencingcouncil.org.uk/docs/web_SexualOffencesAct_2003.pdf).

Urdhurat e dëmshpërblimit në proceset penale:

2005	Gjykata mbretërore		Gjykata e magjistratëve	
	Përqindja e rasteve kur jepet dëmshpërblimi	Shuma mesatare e dëmshpërblimit	Përqindja e rasteve kur jepet dëmshpërblimi	Shuma mesatare e dëmshpërblimit
<b>Të gjitha krimet*</b>	7%	1576 GBP	17%	158 GBP
<b>Krime seksuale+</b>	1%	654 GBP	25%	193 GBP
<b>Krime+</b>	15%	655 GBP	32%	252 GBP
<b>Mashtrim/falsifikimi+</b>	8%	8092 GBP	28%	424 GBP
<b>Dëm kriminal+</b>	15%	660 GBP	49%	212 GBP

E marrë nga Buletini i Statistikave të *Home Office*-it, Statistikat e dënimeve 2005, Anglia dhe Uells<sup>357</sup>

\* Përfshin vepra të rënda dhe kundërvajtje për shkak të nivelit të tyre të ulët, kërkojnë procedura penale të thjeshtëzuar, por jo vepra penale që lidhen me trafikun rrugor

+ Përfshin vetëm vepra të rënda, d.m.th. ato vepra të cilat mund të trajtoheshin nga Gjykatë Mbretërore (“*Crown Courts*”)

Në vitin 2005, nuk ka pasur urdhra dëmshpërblimi për rastet e trafikimit për shfrytëzim seksual, edhe pse 12 individë u ndëshkuan dhe u dënuan me burgim të menjëhershëm.<sup>358</sup> Gjatë kryerjes së këtij studimi nuk u identifikua asnjë rast dëmshpërblimi dhënë viktimave të trafikimit. Po kështu, prokurorët e intervistuar në kuadrin e studimit të ODIHR-it për MKR-në Mbretërinë e Bashkuar, nuk e dinin nëse ishte dhënë ndonjë dëmshpërblim në çështjet e trafikimit. Ata deklaruan se përparësitë e tyre ishin sigurimi i dënimeve penale dhe sekuestrimi i pasurive të autorëve të krimeve, në mënyrë që të ndërpritej aktiviteti kriminal.<sup>359</sup>

Nëse i pandehuri nuk paguan dëmshpërblimin që i detyrohet viktimës, atëherë gjykata (jo viktima) ka të drejtë të zbatojë urdhrin. Çdo vendim për zbatimin e urdhrin i takon gjykatës, në varësi të rrethanave të çështjes. Gjykata mund të urdhërojë që të bëhen zbritje nga të ardhurat e fituara nga personi, në qoftë se është i punësuar, ose, nëse autori është i papunë, nga përfitime të caktura shtetërore. Gjykata mund të nxjerrë edhe urdhër të posaçëm (ang. *warrant of distress*), që udhëron përmbaruesin që të sekuestrojë dhe të shesë sendet që i përkasin autorit të krimit, deri në vlerën e caktuar nga urdhri i dëmshpërblimit, si dhe të mbulojë shpenzimet përkatëse. Dy metoda të tjera të mëtejshme zbatimi janë “vënia e kllapave” makinës së autorit dhe përfshirja e urdhrin të dëmshpërblimit të papaguar në

<sup>357</sup> F. 97.

<sup>358</sup> Po ashtu, asnjë urdhër dëmshpërblimi u dha për personat që janë deklaruar fajtorë për “prostituim për qëllime përfitimi” (ekuivalenti i Mbretërisë së Bashkuar për shfrytëzimin e prostitucionit) në 2005. Shih Statistikat Penale 2005, Angli dhe Uells (*Home Office*), tabelat shtesë, vëll. 2.

<sup>359</sup> Projekt-raporti i MKR-së, në dosjet e autores. Shih çështjen *R. v. Dulghieru and others*, ku të pandehurit u dënuan për lehtësimin e emigracionit të paligjshëm, trafikim dhe pastrim parash në lidhje me gratë nga Evropa lindore të trafikuar për qëllime prostitucioni, e cila po pret akoma seancën gjyqësore në lidhje me konfiskimin e pasurive dhe me dëmshpërblim.

regjistrin e gjobave dhe gjykimeve, që është i hapur për publikun, gjë që mund të ndikojë në mundësinë e autorit të krimit për të marrë kredi ose strehim, si dhe për të përfituar shërbime të tjera. Sanksioni përfundimtar është mbajtja e autorit nën arrest për mospagim.<sup>360</sup> Çdo pagesë e marrë nga viktima zbritet nga shuma e dëmshpërblimeve civile që mund të merret, edhe pse nuk merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të dëmeve civile.

Të paktën një OJF, Grupi Ndërkombëtar i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, ka bërë lobim në qeveri për rritjen e përdorimit të kësaj kompetence për të dhënë dëmshpërblim në çështjet penale, me arsyetimin se e shmang nevojën që viktima e trafikuar, në rastet kur ka një dënim penal, të marrë me dy palë procedurash. Ata arrijnë gjithashtu në përfundimin se për shkak se viktimat riatdhesohen brenda një kohe të shkurtër pas çështjeve penale, ato do të kenë më shumë shanse në ndjekjen e kërkesës për dëmshpërblim në çështjen penale, sesa kur të veprojnë nëpërmjet CICA-s. Ata sugjerojnë gjithashtu se sistemi i urdhrave të dëmshpërblimit duhet të rishikohet, për të arrijë “interpretimin më të gjerë” të nocionit të humbjes dhe dëmeve dhe për të reflektuar nivele të ngjashme të dëmshpërblimit me ato të paguara nga CICA. Ata sugjerojnë gjithashtu, se një fond shtetëror i përbërë nga pasuritë që u janë konfiskuar kriminelëve mund të përdoret për të paguar urdhra të tillë, në rastet kur i pandehuri nuk ka pasuri të mjaftueshme që mund të përdoren.<sup>361</sup>

#### *Paditë civile kundër trafikantëve*

Paditë kundër trafikantëve në gjykatat civile janë të mundura për pretendime mbi bazën e shkaqeve të ndryshme për ngritjen e padive, si për shembull kërcënim apo tentativë për të përdorur dhunë (“*assault*”) ose heqje e paligjshme e lirisë. Pretendimet mund të ngrihen për lloje të ndryshme dëmsh, duke përfshirë:

- a) Dëme “të përgjithshme,” të tilla si ankth emocional, dhimbje dhe vuajtje, humbje të komoditetit (d.m.th., dëme morale);
- b) Dëme “të veçanta,” (d.m.th., dëme materiale), si për shembull, humbje të të ardhurave ose të mundësisë për promovim, kostoja e kujdesit, strehim (për shembull, në përshtatjen e shtëpisë për kushtet e paaftësisë), pajisje të veçanta, shpenzime të udhëtimit (duke përfshirë dhe kostot e të afërmeve që vizitonin kërkuesin në spital) dhe shpenzimet mjekësore. Në rastin e viktimave të trafikuar, kjo mund të shtrihet dhe në pagat e papaguara ose të nënpaguara,

---

<sup>360</sup> Informacion nga *Her Majesty's Court Service* (Shërbimi Gjyqësor Mbretëror (HMCS)), <http://www.hmcourts-service.gov.uk/infoabout/attend/witness/compensation.htm>.

<sup>361</sup> Letër e Grupit Ndërkombëtar të Avokatëve për të Drejtat e Njeriut dërguar te *Home Office* në lidhje me Planin Kombëtar të Veprimit, 19 mars 2007, shih shënim 322.

“kostot e agjencive të rekrutimit,” ose taksa të tjera të rrema që u paguhen trafikantëve, provat e të cilave duhet t’i jepen gjykatës;

- c) Dëme që mund të pësohen në të ardhmen: në më të shumtën e rasteve, këto janë dëme të veçanta që pritet se do të vijnë në vitet e ardhshme, që janë shumë komplekse për t’u përlogaritur (p.sh., humbje të të ardhurave gjatë jetës të shkaktuar nga paaftësia e përhershme); dhe
- ç) Humbje e një të afërmi (shumë fikse prej 10 000 GBP) dhe dëmet e njerëzve në ngarkim, në rastin e vdekjes së viktimës.

Këto procese civile mund të ndiqen veçmas nga proceset penale, sipas procedurës civile dhe me nismën e viktimës. Standardi i provës është më i ulët se në çështjen penale, d.m.th., “më i mundshmi.” dhe jo “përtej dyshimit të arsyeshëm.” Në rastin e autorit që tashmë është dënuar penalisht, gjykata nuk duhet të trajtojë çështjen e fajit, por vetëm të trajtojë humbjet dhe dëmet.

Megjithëse dëmshpërblimet përfundimtare mund të jenë më të mëdha se sa shpërblimi i dhënë nga CICA ose të urdhrit të dëmshpërblimit, kërkohen këshillimi ligjor dhe përfaqësimi për të arritur rezultate më të mira në padinë civile.

Ndjekja e kërkesave civile nga individit privat përfshin paraqitjen e kërkesës në gjykatë për disa kompetenca që duhet të mundësohen si dhe të ushtrohen, si për shembull, përdorimi i përmbaruesve për të sekuestruar sendet ose të ardhurat. Procedurat aktualisht janë të vështira dhe të shtrenjta, megjithëse ka propozime të qeverisë për t’i modernizuar dhe thjeshtëzuar ato siç parashikohet në projektligjin “Për Gjykatat, Organizmat Gjysmëgjyqësore si dhe për Zbatimin,” aktualisht në parlament.<sup>362</sup>

Gjatë kryerjes së këtij studimi, në Mbretërinë e Bashkuar nuk është gjetur asnjë rast i padisë civile për trafikim, dhe besohet se asnjë padi e tillë nuk është bërë.

### *Procese sipas së drejtës së punës*

Paditë kundër trafikantëve sipas neneve të ndryshme të përkufizuara nga e drejta e punës (prishja e kontratës, paga të papaguara ose të nënpaguara, mohimi i të drejtave të tilla si, p.sh., pushime me raport mjekësore ose shkeljet e rregulloreve shëndetësore ose të sigurisë në punë) mund t’u drejtohen trupave të veçantë të specializuar për të drejtën e punësimit, gjysmëgjyqësore (ang. *employment tribunals*, më poshtë ‘gjykatat e punës’). Gjithsesi, për

<sup>362</sup> Për projektligje, debate dhe detaje të programit të parlamentit anglez, shih <http://www.dca.gov.uk/legist/tribenforce/htm#lp>

këtë gjë ka probleme serioze në praktikë për personat e trafikuar, pasi detyrohet që paditë të ngrihen brenda periudhës së përcaktuar 11 javore pas ngjarjes, dhe emigrantët mund të mos kenë fare mundësi për të përdorur këto gjykata.

Nëse punëmarrësi e dinte, ose duhet ta kishte ditur, se kontrata ishte e paligjshme (p.sh., nuk kishte status ligjor për të punuar, ose zotëronte dokumente fallco, etj.), ai nuk ka të drejtë të ngrejë padi dhe mund të hetohet (duke përfshirë nga autoritetet e emigracionit).<sup>363</sup> Gjykata e punës në të shkuarën ka refuzuar të shqyrtojë çështje që lidhen me punëtorët që nuk kanë dokumente, me arsyetimin se kontrata<sup>364</sup> është nënshkruar në mënyrë abuzive. Në një tjetër rast, në bazë të politikave publike, gjykata i rrëzoi paditë që u ankuan se për emigrantët e parregullt nuk u aplikua paga minimale.<sup>365</sup> Kongresit të Sindikatave Tregtare (TUC) iu dha vendimin nga gjykata në favor të një punëtori portugez, që kish punuar në kushtet e punës së detyruar. Por, shoqëria tregtare u zhdruk dhe kështu vendimi nuk mund të zbatohet.

Sipas së drejtës së punës të Mbretërisë së Bashkuar, punëtorët shtëpiakë në përgjithësi konsiderohen si “punonjës” ose të paktën “punëtorë” në varësi të rregullimeve specifike kontraktuale që janë në fuqi. Si rrjedhim, ata gëzojnë të gjithë të drejtat e punësimit, duke përfshirë edhe dispozitat për shëndetin dhe sigurinë, pagën minimale kombëtare dhe parashikimet e tjera të Rregullores së Kohës së Punës 1998. Edhe në këto raste, punëtorët mund të kenë probleme në ngritjen e padisë, pasi paraqitja e provave është kusht kryesor. Në të shumtën e rasteve, nuk ka të dhëna se sa orë kanë punuar ata ose, nëse janë paguar me para në dorë, sa janë paguar. Ekziston tendenca në përgjithësi që ata të mos besohen, përballë provave të dhëna nga punëdhënësve. Shpesh, punëdhënësit janë njerëz “me reputacion të lartë,” si për shembull doktorë ose njerëz nga familje të pasura.<sup>366</sup>

Sipas Planit të Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore të *Home Office*-it (në faqen 24), punëtorët shtëpiakë nuk do të konsiderohen më “punëtorë emigrantë,” por “njerëz që

---

<sup>363</sup> Qëndrimi në çdo rast të veçantë ka të ngjarë të varet nga rëndësia e veprës së kundraligjshme si dhe nga fakti se deri në çfarë mase punëmarrësi ka bashkëpunuar me punëdhënësin për ta lejuar veprën të ndodhte. Në qoftë se do të rezultonte se punëmarrësi nuk e dinte se kontrata e punës ishte e paligjshme, ai do të kishte mundësi të kërkonte të gjitha të drejtat e punës, si për shembull paga minimale, pushimet gjatë punës, moslejimin e zbritjeve të paligjshme nga paga (p.sh., kur janë zbritur paratë nga rroga për të paguar strehimin pa pëlqimin e punonjësit) dhe shkeljet e rregulloreve për shëndetin dhe të sigurimint. (Informacion nga korrespondenca me *e-mail* me Znj. Bronwyn Byrnes, Grupi i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, maj 2007).

<sup>364</sup> UK/EAT/0565/03/RN. “Sjellja e paligjshme i përkiste e tëra Kërkuesit, ndërkohë që punëdhënësi ishte pjesëmarrësi i pafajshëm në një kontratë e cila ishte në fakt e paligjshme,” në lidhje me rastin në të cilën azil-kërkuesi kërkonte zhdëmtim për diskriminim.

<sup>365</sup> Çështja *Saharma v. Hindu Temple*, cituar në v. cit. shënim 18, PICUM.

<sup>366</sup> Informacion nga Znj. Bronwyn Byrnes, avokate, maj 2007 dhe OJF-ja Kalayaan, shih <http://www.kalayaan.org.uk>.



janë zakonisht të punësuar dhe me banim *jashtë Mbretërisë së Bashkuar*.” Kjo mund t’i përjashtojë nga të drejtat e punës në Mbretërinë e Bashkuar. Akumulimi i këtyre të drejtave varet nga statusi i vizës së punëtorit shtëpiak dhe kohëzgjatja e punësimit në Mbretërinë e Bashkuar, krahasuar me kohën e shpenzuar me vende të tjera, gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve punësimi në tërësi. Një periudhë e shkurtër punësimi në Mbretërinë e Bashkuar, krahasuar me atë në vendin e origjinës, do të çonte fortë në përfundimin se e drejta e punës së Mbretërisë së Bashkuar nuk zbatohet për marrëdhënien në fjalë.<sup>367</sup> Për më tepër, të drejtat e paqarta ligjore të punëtorit shtëpiak mund të jenë shkak që flet kundër ngritjes së padisë, edhe kur duket se çështja e punëtorit ka shkaqe të forta për sukses.

Propozimet e qeverisë, që përfshihen në dokumentin “Vënia e Emigracionit në Efiçensë për Punë në Britaninë,” të nxjerra në mars të vitit 2006, synojnë të rikthejnë kufizimin lidhur me vizat e punëtorëve shtëpiakë, që ka ekzistuar më parë. Ata u ndaluan të ndryshonin punëdhënës gjatë kohës së qëndrimit në Mbretërinë e Bashkuar. Grupet e interesit janë të shqetësuara se kjo mund të çojë në shfrytëzimin e punëtorëve, të cilët do ta kenë të pamundur t’u largohen situatave abuzive, pa rrezikuar qëndrimin në Mbretërinë e Bashkuar. Ky kufizim ishte hequr më parë, pas një fushate prej shumë vitesh mbi çështjen.

Në rastet kur veprojnë rekrutuesit e punëtorëve joformalë (*‘gangmasters’*), ku subjekte të ndryshme paguajnë paga dhe mbikëqyrin punën, njëri prej subjekteve mund të argumentojë se nuk ka kontratë punësimi, pasi punëtorët janë “kontraktorë të pavarur.” Në qoftë se argumenti pranohet, këta punonjës të “pavarur” do të gëzonin vetëm disa të drejta pune, por jo të gjitha të drejtat e “punonjësve.” Për shembull, vetëm punonjësit mund të ngrenë padinë kundër punëdhënësit për shkarkimin e padrejtë nga puna (pas 12 muajsh pune), por të gjithë punëtorët gëzojnë të drejtën e pagës minimale, të pushimeve të shkurtra dhe ditëve të pushimit sipas Rregulloreve të Kohës së Punës 1998.

Kur ka fakte për diskriminim të padrejtë, të gjithë punëtorët kanë të drejtë për të ndërmarrë veprime, por në përgjithësi do t’u nevojitet përfaqësim dhe këshillim ligjor të një cilësie të lartë.<sup>368</sup>

Doganat dhe Akcizat Mbretërore (*HM Customs and Excise*) kanë gjithashtu kompetenca për zbatimin e legjislacionit të pagës kombëtare minimale nëpërmjet “Ekipeve të

---

<sup>367</sup> Po aty.

<sup>368</sup> Për informacione të tjerë shih faqet e mëposhtme të Internet-it:  
[http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/politics/6580917.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/politics/6580917.stm)  
[http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/politics/6424377.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/politics/6424377.stm)  
<http://news.independent.co.uk/politics/article2338402.ece>.

Përputhshmërisë.”<sup>369</sup> Kërkesat mund të ndiqen paralelisht me paditë që individët u drejtojnë gjykatave të punës. Ankimi mund të bëhet nga individi (p.sh., me anë të postës, *online*, ose duke përdorur linjë telefonike qeveritare të ndihmës), dhe duhet të trajtohet në mënyrë konfidenciale.<sup>370</sup> Në atë rast, inspektorët e përputhshmërisë kanë të drejtën të inspektojnë punëdhënësin, të vendosin gjoba dhe të japin urdhra për t’ua dhënë pagat e papaguara punëtorëve dhe, në disa raste, edhe ish-punëtorëve. Kur punëdhënësit nuk i bindin kërkesës së inspektorëve, ekipet mund të vendosin urdhra të mëtejshëm dhe të kërkojnë zbatimin e urdhrave të tyre nëpërmjet procesit civile (e përdorur gjithashtu për të zbatuar vendimet e gjykatës së punës).<sup>371</sup> Gjithsesi, praktika e zbatimit është e gjatë dhe komplekse, dhe ekipet nuk mund t’i marrin pagesat në emër të punëtorëve. Kjo do të thotë që identitetet e ankimuesve mund t’i bëhen të njohura punëdhënësit. Ka edhe kufizime për dobishmërinë e punës së agjencisë, duke qenë se sipas tyre, paga minimale zbatohet vetëm për ata që janë të punësuar në mënyrë të ligjshme, ndërkohë që ekipet nuk kanë trajnim të duhur për të identifikuar rastet e trafikimit ose të shfrytëzimit, në mënyrë që viktimave t’u jepen referime për ndihmë.

Një organ i ngjashëm ekziston për individët që punojnë në sektorin bujqësor: Ekipi i Pagave në Bujqësi zbaton Urdhrin për Pagat Bujqësore në Angli dhe në Uells.<sup>372</sup> Puna zbatuese të tyre ndërmerret në përgjigje të ankesave specifike dhe paraprihet nga arbitrazhi informal, që synon që t’i sjellë palët në marrëveshjen miqësore. Inspektimet formalë i borderove të pagave të bëra nga punëdhënësit realizohen nga Inspektorët e Pagave Bujqësore. Kur inspektori arrin në përfundimin se punëtori nuk është paguar sa duhet, ai mund të nxjerrë Njoftim Ekzekutimi.<sup>373</sup>

Në udhëzimet që u jepen punëtorëve bujqësorë në lidhje me të drejtat e tyre si dhe me kompetencat ekzekutimi thuhet se, edhe pse ankesa mund të ndiqet pasi është marrë në mënyrë anonime nga ana e individit, anonimiteti nuk mund të ruhet pas daljes të Urdhrit

---

<sup>369</sup> Ka 16 ekipe në Mbretërinë e Bashkuar.

<http://www.cipd.co.uk/subjects/pay/minimumwage/nmw.htm?IsSrchRes=1www.hmrc.gov.uk/manuals/dmbmanual/DMBM570060.htm>

<sup>370</sup> Shih <http://www.hmrc.gov.uk/nmw/complaint.htm>.

<sup>371</sup> Për udhëzime të detajuara që u janë dhënë inspektorëve shih

<http://www.hmrc.gov.uk/manuals/dmbmanual/DMBM570060.htm>; për punonjësit shih Udhëzimet e Politikës Kombëtare të Pagës Minimale; persa u përket gjobave, shih

<http://www.dti.gov.uk/files/file36381.pdf>

<sup>372</sup> Në emër të Sekretarit të Shtetit për Mjedisin, Ushqimin dhe Çështjet Rurale, duke përdorur kompetenca të përfshira në Aktin e Pagave Bujqësore 1948 nga Akti i Pagave Minimale Kombëtare 1998.

<sup>373</sup> Shih faqen zyrtare të *Internet-it*:

<http://www.defra.gov.uk/foodfarm/farmmanage/working/agwages/documents/awo-minwage.pdf>.

Ekzekutimi.<sup>374</sup> Procedimet e ekzekutimit janë shumë të ngjashme me procedimet e përdorura nga ekipet e përputhshmërisë për forma të tjera pune.

Informacioni në lidhje me pagën minimale dhe zbatimin e tij është i disponueshëm në anglisht, lituanisht, letonisht dhe polonisht, në faqet qeveritare të *Internet-it*. Gjithsesi, informacioni nuk gjendet lehtësisht *online* dhe duhet kërkim i thellë.

Qeveria ka organin e pavarur këshillimor, i cili quhet Komisioni i Pagave të Ulëta, mandati i të cilit është:

“Monitorimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i Pagës Minimale Kombëtare dhe ndikimin e saj, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ... efektit mbi grupet e ndryshme të punëtorëve, duke përfshirë...punëtorët emigrantë;”<sup>375</sup>

Raporti i këtij organi për vitin 2007 rishikon me mjaft hollësi ndikimin e legjislacionit tek punëtorët emigrantë dhe punëtorët e agjencive, si dhe bën disa rekomandime, duke përfshirë këtu edhe përmirësimin e zbatimit të ligjeve në lidhje me punëtorët emigrantë:

“Ndërkohë që mund të kuptojmë qëndrimin e Qeverisë, besojmë se provat për shfrytëzimin e punëtorëve emigrantë janë bindëse. Kjo ka rritur besimin tonë, se problemi duhet të trajtohet si përparësi. Për këtë arsye, rekomandojmë që qeveria, si pjesë e programit zbatues së saj, në vitet 2007-2008 duhet të zgjedhë një sektor me paga të ulëta që ka përqëndrimin e lartë të punëtorëve emigrantë.”<sup>376</sup>

### 5.7.2.3 Sekuestrimi i pasurive

Në të drejtën e Mbretërisë së Bashkuar, ka shumë ligje dhe dispozita që lidhen me sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive. Ato ndryshojnë në varësi të faktit nëse janë ndërmarrë sipas procedurave civile apo penale.

---

<sup>374</sup> *Minimum Wages for Agricultural Workers: Agricultural Workers – Your Rights and How You Can Expect Them to be Enforced* (Pagat Minimale për Punëtorët Bujqësorë: Punëtorët Bujqësorë – Të drejtat tuaja dhe si mund të prisni që ato të zbatohen),

<http://www.defra.gov.uk/foodfarm/farmmanage/working/agwages/documents/awo-minwage.pdf> .

<sup>375</sup> Termat e Referencës së Komisionit të Pagave të Ulëta 2008

<http://www.lowpay.gov.uk/lowpay/TOR.doc>

<sup>376</sup> Paragrafi 6.44, Raporti i Komisionit të Pagave të Ulëta në lidhje me pagat minimale kombëtare 2007, f. 230, gjendet në faqen e *Internet-it* [http://www.lowpay.gov.uk/lowpay/report/pdf/6828-DTi-Low\\_Pay\\_Complete.pdf](http://www.lowpay.gov.uk/lowpay/report/pdf/6828-DTi-Low_Pay_Complete.pdf) .

Në çështjen penale, gjykata mund të përdorë kompetenca të parashikuara në Aktin për Kompetencat e Gjykatës Penale (Dënimet) 2000, në lidhje me çdo pasuri që i është sekuestruar autorit të krimit që nga ndalimi i tij. Këto kompetenca mund t'ia heqin autorit pasuritë e tilla, nëse ato ishin përdorur ose synohet të përdoren për të kryer ose për të ndihmuar në kryerjen e *çdo veprë penale* (dhe jo domosdoshmërisht veprën për të cilën është dënuar personi).<sup>377</sup> Të ardhurat që dalin nga disponimi i këtyre pasurive mund t'i jepen viktimës “kur vepra penale ka çuar në dëmtim personal, humbje ose dëm” (s.145 (1) (a)) dhe kur gjykata çmon se mjetet e autorit të krimit janë të pamjaftueshme për të justifikuar urdhrin e dëmshpërblimit (s. 145(2)). Sipas udhëzimeve të Shërbimit Mbretëror të Prokurorisë, prokurori është përgjegjës “për t'i kërkuar gjykatës të shqyrtojë mundësinë e urdhrit të heqjes së pasurive sipas legjislacionit përkatës.”<sup>378</sup> Gjithashtu, “gjykata nuk duhet të lëshojë urdhrin, me përjashtim të rasteve kur ka prova të mjaftueshme mbështetëse dhe, si rrjedhojë, çdo aplikim duhet të përgatitet në mënyrë të plotë.”<sup>379</sup>

Akti për Produktet e Krimit 2002 rregullon kompetencat e shtetit për të sekuestruar dhe për të konfiskuar pasuritë e krijuara nga aktivitetet kriminale, kryesisht për vepra më të rënda, nëpërmjet padisë civile. Kjo mund të bëhet aktualisht nga Agjencia për Rimarrjen e Pasurive, duke përdorur mundësi civile veçmas nga ndjekja penale (edhe kur nuk ka asnjë ndjekje penale) ose nga Gjykata Mbretërore, paralelisht me ndjekjen penale. Gjithsesi, kohët e fundit u deklarua se për shkakun e problemeve të hasura nga Agjencia në sekuestrimin e pasurive të nevojshme për të justifikuar funksionimin e saj, ajo do të pushojë së ekzistuari brenda vitit 2008, dhe kompetencat e saj do t'iu kalohen Agjencisë së Krimeve të Rënda të Organizuara dhe Shërbimit Mbretëror të Prokurorisë.<sup>380</sup> Mbetet ende për t'u parë nëse këto agjenci do të kenë më shumë fat në sekuestrimin e pasurive kriminale nëpërmjet çështjeve civile ose nëse vështirësitë janë të pakapërcyeshme, duke u nisur nga natyra e detyrës së ngarkuar. Policia gjithashtu ka kompetenca të veçanta civile që lidhen me sekuestrimin e të hollave që burojnë nga vepra kriminale.

Akti zbatohet në çështjen penale, atëherë kur gjykata krijon bindjen se autori i krimit ka “mënyrë kriminale të jetesës” dhe se ka përfituar nga “sjellja e përgjithshme kriminale e tij.” (Pjesa 2, s. 6). Autori i krimit ka një “stil kriminal të jetesës.” atëherë kur vepra në fjalë është “vepër penale e mënyrës së jetesës,” prej atyre që radhitën në tabelën 2 të Aktit, ku

---

<sup>377</sup> S. 143.

<sup>378</sup> [http://cps.gov.uk/legal/section15/chapter\\_c.html#11](http://cps.gov.uk/legal/section15/chapter_c.html#11)

<sup>379</sup> Çështja *R. v. Pemberton* (1982), 4 Cr. App. R. (S) 328.

<sup>380</sup> Shih *Assets Recovery Agency Abolished* (Shkrihet Agjencia për Rimarrjen e Pasurive), lajmet BBC, 11 janar 2007, [http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/6251339.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/6251339.stm), dhe “*Proposed merger*” (Shkrirja e propozuar) në faqen e Internet-it të agjencisë <http://assetsrecovery.gov.uk/AboutARA>

përfshihen trafikim droge, pastrim parash, trafikim për shfrytëzim seksual ose të punës, veprime si tutor prostitutash ose administrimi i një shtëpie publike.

Akti për Produktet e Krimin në vetvete sugjeron se fondet e konfiskuara duhet të mbahen të disponueshme për pretendime që mund të paraqiten nga viktimat në rrugë civile. Nëse gjykata beson se ndonjë viktimë “ka filluar ose ka ndërmend të fillojë procese kundër të pandehurit në lidhje me humbjet, dëmtimet ose dëmet,” ajo ka detyrim më të madh të lëshojë urdhrin e konfiskimit për produktet e krimin të të pandehurit (Pjesa 2, s. 6(6).) Fatkeqësisht, kjo kompetencë ligjore nuk theksohet në udhëzimet për prokurorët, kështu që atyre nuk u thuhet që duhet të marrin masa specifike për të zbuluar synimin e viktimës në lidhje me padinë civile. As nuk ka lidhje të qartë ligjore ndërmjet pasurive të konfiskuara dhe pagimit të urdhrin të dëmshpërblimit të nxjerrë në çështjen penale sipas Aktit të Kompetencave të Gjykatës Penale (Dënimet) 2000, (pavarësisht nga deklaratimet në udhëzimet për dënimet – shih proceset penale).

Në përgjithësi, duket se u kushtohet shumë më shumë vëmendje policisë dhe prokurorëve që të përdorin kompetencat e tyre të reja për t'i bllokuar dhe për t'i sekuestruar pasuritë, sesa për viktimën, që ajo të marrë dëmshpërblim nga produktet e krimin që janë konfiskuar. Do të ishte me vlerë që të ndryshoheshin Udhëzimet për Prokurorët e Shërbimit Mbretëror të Prokurorisë, për të përfshirë shqetësimet e viktimës për dëmshpërblim kur trajtohen çështjet e konfiskimit, duke qenë se prokurori është forca shtytëse që nxit aplikimin për ndalimin e pasurive dhe konfiskimin.

Në çështjet civile, individi privat nuk ka shumë mënyra kërkimi për të vërtetuar pasuritë e të paditurit civil. Gjithsesi, gjykata mund ta bëjë këtë, pas kërkesës nga paditësi. Në të njëjtën mënyrë, pala paditëse mund të aplikojë për urdhrin e bllokimit të pasurive të palës së paditur, deri në vlerën e dëmeve të pretenduara (urdhri mund të zbatohet dhe në nivel ndërkombëtar sipas një Urdhri Mbarëbotëror Bllokimi). Për të marrë një urdhër të tillë, kërkuesi duhet të ketë pretendime civile të arsyetuar mirë; duhet të ketë “mundësinë e mirëfilltë” që pasuritë gjenden brenda juridiksionit, si dhe duhet të ketë rrezikun serioz të zhdukjes së tyre. Dobishmëria dhe suksesi i këtyre procedurave në çështjet e trafikimit varen nga shpejtësia me të cilën vepohet në çështjen në fjalë. Për shembull, nëse çështja civile fillon pas përfundimit të çështjes penale, atëherë efektet do të jenë të kufizuara, pasi ka të ngjarë që pasuritë të jenë shpenzuar, të fshehura ose të sekuestruara më parë. Gjithsesi, nëse përdoren shpejt kundër palës së paditur me “xhepa relativisht të plota,” dhe nëse pasuritë mund të gjenden lehtësisht, procedurat mund të hyjnë në punë. Në të tilla raste, përfaqësimi

ligjor është i nevojshëm, me qëllim që të merren hapat përkatës, ndërkohë që shpenzimet ka të ngjarë që të jenë shumë të larta.

#### **5.7.2.4 Ndhimja për viktimat**

Disa prej viktimave të trafikimit kanë marrë viza të përkohshme qëndrimi mbi bazën e pjesëmarrjes së tyre në Projektin *Poppy*, por kjo lehtësi i jepet vetëm një kategorie të kufizuar viktimash të trafikimit për shfrytëzim seksual. Pjesa më e madhe e viktimave janë kthyer në vendet e tyre të origjinës. Viktima e trafikimit që janë të identifikuara aktualisht kanë të drejtë të aplikojnë për vizë për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar për arsye humanitare ose në bazë të së drejtës së azilit. Lehtësia nuk është vetëm për viktimat e trafikimit, por vizat janë dhënë në një numër të kufizuar të rasteve të trafikimit. Nënshitetasit e vendeve të reja të Bashkimit Evropian kanë të drejtë të qëndrojnë në Mbretërinë e Bashkuar, por nuk lejohen “të marrin fonde publike” gjatë dy viteve të para të qëndrimit të tyre. Ashtu siç vihet re në seksionet e mëparshme, mungesa e regjimit të përcaktuar të vizave për viktimat e trafikimit, duke përfshirë kohën për reflektim dhe rekuperim, si dhe kohën për t’u marrë me procedurat ligjore, ka krijuar pengesa për viktimat e trafikimit për të marrë ndihmë në formën e dëmshpërblimit.

Në varësi të situatës së veçantë në të cilën ndodhen, viktimat mund të jenë ose të mos jenë në dijeni për mundësitë e dëmshpërblimit. Me përjashtim të rasteve kur viktima merret në pyetje nga policia dhe identifikohet si dëshmitare në procesin penal, ka shumë të ngjarë që nuk do të informohet nga policia për urdhrat e mundshme të dëmshpërblimit ose për ekszitencën e CICA-s. Duke qenë se viktimat nuk përfaqësohen veçmas nga avokatë në proceset penale, këshillimi dhe përfaqësimi për të kërkuar urdhër dëmshpërblimi do të duhej të vinte nga policia dhe prokurori i çështjes, nga një OJF si *Victim Support* (Mbështetje për Viktimat) ose nga një punonjës i gjykatës që i vjen në ndihmë dëshmitarit. Ka mundësi, që viktimat të njihen me të drejtën për të ngritur padinë civile ose kërkesë drejtuar CICA-s vetëm nëpërmjet këshillimit me avokatin që merret me statusin e tyre të emigracionit, me një organizatë joqeveritare që i ndihmon ata, p.sh., organizata kombëtare siç është Mbështetje për Viktimat, ose me një shërbim të specializuar antitrafikimi, siç është Projekti *Poppy*.

Ndjekja e kërkesës drejtuar CICA-s është e mundur pa këshillim ligjor si dhe pa përfaqësim ligjor, por në mënyrë që të jepen argumentet më të mira mbështetëse, dhe në mënyrë që provat të jenë sa më të plota që të jetë e mundur, gjithmonë është më mirë që të përdoret një avokat me përvojë, në veçanti kur viktima ka njohje të kufizuara të gjuhës angleze. Ndhimja

ligjore nuk është e disponueshme në raste të tilla dhe mund të ofrohet vetëm nëpërmjet Qendrave Ligjore, Byrove Këshillimore të Qytetarëve ose avokatëve që punojnë *pro bono* (falas).

Për të paraqitur padinë civile apo procesin sipas së drejtës së punës, viktima së pari duhet të jetë në gjendje të marrë këshillim fillestar ligjor, për të ditur nëse trafikanti/shfrytëzuesi mund të paditet në mënyrë të suksesshme (p.sh., nëse ka një shkak për të ngritur padi, sa të forta janë argumentet e saj, nëse i padituri mund të gjendet dhe a mund t'i dorëzohen atij kërkesëpadi dhe dokumente të tjera të çështjes, si dhe nëse mund të ekzekutohen urdhrat e gjykatës dhe të bëhet pagesa nga i padituri) si dhe për t'u informuar mbi natyrën dhe kohëzgjatjen e procesit. Avokatët që punojnë me Shërbimin Ligjor Bashkiak (duke dhënë ndihmën ligjore), *pro bono*, ose për një sindikatë ose për agjenci këshillimi jofitimprurëse, mund të jenë në gjendje që t'ia ofrojnë këtë lloj këshillimi fillestar klientit.

Në çështjet sipas së drejtës së punës, nuk ka ndihmë ligjore të disponueshme për të mbuluar shpenzimet e përfaqësimit përpara gjykatës së punës, dhe ndihma ligjore ose do të duhej të ofrohet pa pagesë, ose duke paguar tarifën privatisht ose duke paguar tarifën vetëm në rast se çështja fitohet. Tjetër problem është fakti se që prej 1 prillit të vitit 2007, pas ndryshimeve në rregulloret e Shërbimit Ligjor Bashkiak, avokatët për çështjet e punës kufizohen me tarifën shumë të ulët fikse në çështjet në të cilat jepet ndihmë ligjore. Kjo do të thotë që ata marrin të njëjtën shumë pavarësisht nga puna e kryer në lidhje me çështjen.<sup>381</sup> Si rezultat, shumë zyra avokatie mund të vendosin që të mos ofrojnë shërbime të ndihmës ligjore për klientët në çështje të së drejtës së punës, por do të merren vetëm me klientët që paguajnë privatisht.

Në çështjet civile, avokati ose organizata do të mund të ofronte shërbime të përfaqësimit nëpërmjet ndihmës ligjore të dhënë nga Shërbimi Ligjor Bashkiak. Kjo ndihmë varet nga kriteret financiare shumë strikte si dhe nga vlerësimi i avokatit për shanset e suksesit të padisë. Në çështjet civile nuk ka ndihmë ligjore për pretendimet për dëmtim vetiak, përveç rasteve në të cilat ka “dëmtim të qëllimshëm.” Paditë e ngritura në lidhje me trafikimin mund të mos preken nga ky kufizim, me përjashtim të rasteve të pakujdesisë, d.m.th., pretendime që bazohen në detyrimet e punëdhënësve për shëndetin dhe sigurimin e punëtorëve, të cilat ndiqen në gjykatat civile.

Kufizimet për mundësinë e përfitimit të ndihmës ligjore falas do të thonë se përfaqësimi është i mundur vetëm në rastet kur avokati ofron shërbime falas ose në bazë të një

---

<sup>381</sup> Disa çështje që janë jashtëzakonisht të kushtueshme paguhen plotësisht, por kjo nuk është praktika e zakonshme.

marrëveshjeje sipas së cilës, nëse çështja nuk fitohet, nuk ka pagesë. Për çështjet civile, marrëveshja në bazë të së cilës nuk ka pagesë, nëse çështja nuk fitohet, do të kërkonte blerjen e policës së siguracionit, që të mbulojë kostot e palës kundërshtare në rast humbjeje.

Aktualisht, puna e këshillimit ligjor për të gjitha llojet e kërkesave për dëmshpërblim dhe për paditë civile po merret përsipër nga agjenci të ndryshme jofitimprurëse të mbingarkuara me punë (si për shembull Qendrat Ligjore, Zyrat Këshillimore të Qytetarëve, etj.) si dhe sindikata dhe avokatë që punojnë në shumicën e rasteve falas.<sup>382</sup> Ka dhe disa agjenci të specializuara, p.sh., *Kalayaan*, që punojnë në emër të shërbëtorëve shtëpiakë. Pavarësisht nga përpjekjet e tyre, dispozitat ligjore ende janë të pamjaftueshme, duke pasur parasysh kompleksitetin e çështjeve dhe vulnerabilitetin e njerëzve të trafikuar. Shumë emigrantë të shfrytëzuar kanë vështirësi për të gjetur këshilla dhe shërbime drejtësie si pasojë e vështirësive me gjuhën, të frikës rreth statusit të tyre të emigracionit ose të kërcënimeve nga trafikantët apo edhe nga ata me të cilët punojnë.

### **5.7.3 Përfundime për Mbretërinë e Bashkuar**

Fakti që Mbretëria e Bashkuar ka një skemë të financuar nga shteti në përmasa të konsiderueshme, e cila shërben për të paguar edhe dëmet materiale, edhe dëmet morale, është diçka pozitive. Ajo ka treguar deri diku elasticitet në lidhje me llojet e dëmeve që u janë paguar viktimave të trafikimit. Gjithsesi, kufizimet e saj paraqesin probleme për viktimat e trafikimit, në veçanti në lidhje me kriteret kufizuese të pranimit dhe kategoritë dhe shumat e kufizuara të dëmeve që jepen. Gjithashtu, skema shtetërore kufizohet me krimet e dhunës që shkaktojnë dëme fizike, të cilat jo gjithmonë përfshijnë viktimat të cilat vuajnë nga “dhuna psikologjike.” Skema ka nevojë për rishikim, për t’u siguruar që të gjitha viktimat e trafikimit të kenë mundësi të përfitojnë nga ajo. Është e mundur që një fond i veçantë i ngritur brenda skemës së CICA-s (mundësisht i krijuar me pasuritë e vëna nga veprat kriminale) mund të trajtojë në mënyrë të veçantë çështjet e trafikimit. Kjo do të thotë se kriteret e pranimit dhe të gjitha llojet e dëmeve do të mund të rishikohin dhe të përshtaten, në varësi të specifikave të çështjeve të këtij lloji.<sup>383</sup>

Personeli i CICA-s dhe njerëzit që marrin vendime për kërkesat mund të merrnin trajnim të përqendruar në ngritjen e një skeme të tillë dhe për trajtimin e kërkesave. Këto kërkesa, gjithashtu, mund të trajtonin më shpejt sesa çështjet e tjera. Skema e veçantë nuk do të zvogëlonte nevojën, që çdo çështje në vlerësohet duke marrë në konsideratë specifikat e veta.

<sup>382</sup> Shih fushatën e përbashkët për mundësitë e viktimave për t’u drejtuar organeve të drejtësisë, <http://www.accessjusticealliance.org.uk>.

<sup>383</sup> Falenderojmë znj. Bronwen Byrnes dhe avokatët e SIHRG-së për këtë sugjerim.



Kompetenca për të urdhëruar dëmshpërblim nga gjykata penale është pozitive, në veçanti në kushtet e pamundësisë për të “bashkëngjitur” padinë civile, por hapat janë të pamjaftueshëm, që po ndërmarrin prokurorët dhe gjyqtarët për të garantuar se urdhra të tilla merren në konsideratë dhe që ato jepen nga gjykata. Ka më shumë të ngjarë që urdhra të tillë të paguhen, si dhe janë më të lehta për t’u zbatuar. Gjithsesi, shumat që jepen aktualisht janë kaq të ulëta, sa ekziston rreziku për poshtërimin e mëtejshëm të viktimës. Udhëzimet për gjyqtarët mbi dhënien e dëmshpërblimit duhet të përmirësohen, me qëllim që të garantohet përfshirja e të gjitha llojeve dhe shkallëve të dëmeve. Si policia, si prokurorët, duhet të marrin hapa aktivë për të sekuestruar pasuritë e trafikantëve të dyshuar. Pasuritë e sekuestruara nëpërmjet procedurave të Aktit për Produktet e Krimin duhet t’u vihen në dispozicion viktimave të trafikimit, ndërkohë që duhet të bëhet më e qartë lidhja ndërmjet kompetencave për konfiskimin dhe kompetencave të gjykatës penale për të përdorur pasuritë për pagimin e dëmshpërblimit të viktimave. Interesat e viktimave mbeten të përfaqësuara nën nivelin e duhur në procedurat penale, ndërsa respektimi dhe vënia në jetë e të drejtave të tyre, nuk kërkohet detyrimisht dhe as nuk parashikohen me ligj të shkruar.<sup>384</sup>

Kufizimet për t’iu drejtuar gjykatave civile dhe për zbatimin e të drejtave sipas së drejtës së punës ilustrohen nga fakti që kërkesat, të cilat u paraqiten gjykatave civile ose gjykatave të punës, nuk janë të shumta për sa u përket çështjeve të trafikimit dhe shfrytëzimit. Kjo mund të rezultojë për disa arsye të lidhura me procedurën e përgjithshme civile në Mbretërinë e Bashkuar, duke përfshirë mungesën ose pakësimin e ndihmës ligjore, si dhe për faktin që nuk është praktike për viktimën e trafikimit (e cila mund të dëshirojë ose mund t’i duhet të largohet prej juridiksionit) të ndërmarrë procesin e veçantë dhe e gjatë.

Çështja e zbatimit të pretendimeve që burojnë nga e drejta e punës është veçanërisht e rëndësishme për çështjet e shfrytëzimit në punë. Edhe pse vendimet e çështjeve në këtë fushë nuk kanë kufizuar plotësisht këto të drejta, zbatimi përsëri mbetet i kufizuar, ndërkohë që qeveria mund të ndërmarrë masa të tjera në kufizimin e mëtejshëm të këtyre të drejtave. Mundësia për t’i ndjekur këto pretendime tashmë kufizohet përmes pengesave praktike sidomos për emigrantët e paligjshëm që përjetojnë frikën e dëbimit (pavarësisht nga fakti sesa i egër është shfrytëzimi), ndërkohë që pengesat aktuale ligjore e përkeqësojnë këtë situatë.

---

<sup>384</sup> Probleme dhe rekomandime të shumta janë bërë në raportin e Komisionit Kombëtar të Auditimit: *Victims and Witnesses: Providing Better Support* (Viktimat dhe Dëshmitarët; Ofrimi i mbështetjes më të mirë), 2 dhjetor 2003, <http://www.audit-commission.gov.uk/nationalstudies/communitysafety/Pages/victimsandwitnesses.aspx>

Inspektoriatet e pagave, që merren me pagën kombëtare minimale, duhet të forcohen, dhe informacioni rreth kompetencave të tyre duhet sa më i lehtë për t'u gjetur nga punëtorët, në veçanti nga emigrantët. Për punëtorët e trafikuar duhet të zbatohet paga kombëtare minimale, dhe në situata shfrytëzimi ata duhet të kenë mundësi për mjete mbrojtëse. Inspektorëve gjatë punës së tyre duhet t'u jepen kompetenca për të identifikuar situatat e trafikimit.

Informacioni, ndihma ligjore dhe materialet në dispozicion të personave të trafikuar nuk janë të mjaftueshme për t'u siguruar që ata të njihen me të drejtat e tyre për dëmshpërblim as edhe për t'i mundësuar ata t'ua japin informacionin e nevojshëm personave që po u ofrojnë ndihmë. Statusi i tyre i pasigurt i qëndrimit ose mundësia e dëbimit është pengesë tjetër, që dekurajon kërkesat për dëmshpërblim. Skema e lejeve qëndrimi si dhe mundësia më e mirë për t'u këshilluar dhe për t'u përfaqësuar ligjërisht, janë të nevojshme. Prokurorët dhe policia duhet të kenë për detyrë që të sigurohet që viktimat këshillohen mbi të drejtat e tyre dhe se pikëpamjet e tyre përfaqësohen në gjykatë. Gjyqtarët duhet të ndërgjegjësohen për kompetencat e tyre për të dhënë urdhra dëmshpërblimi pa kërkesë dhe duhet të jenë më kërkues në përdorimin e kësaj kompetence, në kombinim me dënimin me burgim.

Veprimtaria e OJF-ve në procesin e identifikimit dhe ndihmës për viktimat e trafikimit nuk shkon më tej sesa financimi afatshkurtër i një OJF-je të vetme me seli në Londër. Megjithëse kjo përbën hap pozitiv, nevojitet një rrjet më i gjerë agjencish këshillimore dhe mbështetëse për t'u marrë me një gamë më të madhe të personave të trafikuar dhe në shifra më të mëdha.

Problemet me skemat aktuale të dëmshpërblimit në Mbretërinë e Bashkuar ndoshta tregohen më mirë nga fakti se është identifikuar vetëm një rast dëmshpërblimi gjatë këtij studimi, dhe se vendimet e gjykatave për dëmshpërblim janë veçanërisht të kufizuara në të gjitha fushat ligjore.

#### **5.7.4 Praktika e mirë në Mbretërinë e Bashkuar**

- Ekzistenca e skemës efikase të financimit shtetërorë, e lehtë për t'u përdorur, që paguan si dëmet materiale ashtu dhe ato moralet;
- Aftësia e gjykatave penale në dhënien e urdhrave për dëmshpërblim me kompetencë për zbatimin e tyre;
- Ekzistenca e një Plani Kombëtar Zbatimi;

- Shërbimet falas nga avokatët dhe e drejta për ta marrë ndihmën ligjore falas për disa çështje;
- Ndihma praktike e dhënë nga shumë OJF-të e specializuara; dhe
- Legjislacioni për pagën minimale kombëtare dhe strukturat për zbatimin e tij.

## 5.8 SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

### 5.8.1. Kuadri ligjor dhe institucional

#### 5.8.1.1 Detyrimet ndërkombëtare

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë palë në Konventën e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollin e saj të Trafikimi. As nuk kanë ratifikuar Konventën e ILO-s për Punën e Detyruar (K 29) ose Konventën për Punëtorët Emigrantë, por kanë ratifikuar Konventën e ILO-s për Zhdukjen e Punës së Detyruar (K 105) si dhe Konventën e ILO-s për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve (K 182).

#### 5.8.1.2. Kuadri ligjor dhe institucional<sup>385</sup>

Ligjet më të vjetra kundër skllavërisë në Shtetet e Bashkuara datojnë në periudhën menjëherë pas Luftës Civile.<sup>386</sup> Për një pjesë të mirë të shekullit 20, format bashkëkohore të shfaqjes së skllavërisë dhe të shërbimeve të detyruara u ndoqën penalisht sipas 18 U.S.C. § 1584 (shërbimet e detyruara) ose 18 U.S.C. § 1581 (zgjedha).<sup>387</sup> Kjo situatë u ndryshua në tetor të vitit 2000, kur hyri në fuqi Akti për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit (TVPA).<sup>388</sup> Ky Akt u miratua nga Kongresi në përgjigje të çështjes *US v. Kozminski*, 487 U.S. 931 (1988).

<sup>385</sup> Shënim mbi terminologjinë: Dispozitat e ligjeve penale kodifikohen në Titullin 18 të Kodit të Shteteve të Bashkuara. Dispozitat në përgjithësi u referohen me emër ose në bazë të numrave të seksioneve (të dhëna me simbolin § pas identifikimit të Titullit 18). P.sh., mënyra e zakonshme e citimit të dispozitës për shërbimet e detyruara është “18 U.S.C. § 1584.” Pjesa e veçantë e legjislacionit, e njohur zakonisht me termin “Akt” (ang. *act*), mund të përmbajë shumë dispozita të veçanta, secila prej të cilave përfaqësohet nga një numër i veçantë seksioni. Brenda Titullit 18, dispozitat penale që lidhen me të njëjtën çështje grupohen në “krerë.” Pra, të gjitha dispozitat e lidhura me trafikimin përfshihen në Kreun 77 (të titulluar “Zgjedha, skllavëria dhe trafikimi i qenieve njerëzore”). Akti i Mbrojtjes së Viktimave të Trafikimit shtoi disa dispozita në Kreun 77 të Titullit 18. Çdo dispozitë ka numrin e vet të seksionit.

<sup>386</sup> Ligji i Tregtisë me Skllavët, siç ishte ndryshuar në vitin 1909, më parë 18 U.S.C. § 423 (1940 red. i Kodit) dhe Ligji “Padrone” i vitit 1874, më parë 18 U.S.C. § 446 (1940 red.)

<sup>387</sup> Shih çështjen *US v. Kozminski*, 487 U.S. 931, 945 (1988) (që përshkruan § 1584 si konsolidim i dy dispozitave të mëparshme). Ndërsa § 1584 penalizon “shërbimet e detyruara” (jovullnetare), § 1581 penalizon “zgjedhën” (ang. *peonage*), e cili është një pozitë ose një kusht shërbimi i detyruar i cili bazohet në një borxh real ose të pretenduar. Për shkak se § 1581 kërkon që qeveria të provojë të gjitha elementet e § 1584, plus elementet shtesë të borxhit, § 1584 u bë mjete i preferuar i prokurorëve.

<sup>388</sup> L. Pub. (*Ligj publik*) Nr. 106-386, 114 Stat. 1464 (i nënshkruar nga President më 28 tetor 2000).

Në çështjen *Kozminski*, Gjykata e Lartë e interpretoi ngushtë ligjin e shërbimeve të detyruara, duke u shprehur që ligji trajtoi vetëm raste “kur është përfshirë shtrëngimi për të shërbyer me anë të përdorimit të forcës fizike ose ligjore.”<sup>389</sup> Ndër të tjera, për shkak të faktit se interpretimi i Gjykatës së Lartë për ligjin e shërbimeve të detyruara nuk trajtoi raste të shtrëngimit psikologjik, Kongresi u mor me këtë çështje kur miratoi TVPA-në.

Ligjet e reja kriminalizuan punën e detyruar; trafikimin në lidhje me zgjedhën, skllavërinë, shërbimet e detyruara ose punën e detyruar; trafikimin seksual të fëmijëve ose me dhunë, mashtrim ose shtrëngim; sjelljen e paligjshme në lidhje me dokumentet për të çuar më tej trafikimin (mbajtja ose asgjësimi i pasaportave etj., e cila njihet në anglisht si *dokument servitude*); si dhe tentativat për të shkelur këto dispozita.<sup>390</sup> Për më tepër, TVPA-ja parashikoi kthimin e detyrueshëm për viktimat, si dhe konfiskimin penal dhe civil të pasurive.<sup>391</sup> Në vitin 2003, Akti i Riautorizimit të Mbrojtjes për Viktimat e Trafikimit (TVPRA) krijoi një shkak për të ngritur padi civile lidhur me shkeljen e §§ 1589, 1590 dhe 1591.<sup>392</sup> TVPRA-ja e vitit 2005, e cila u bë ligj në vitin 2006, i zgjeroi më tej programet e ndihmës për viktimat. TVPA-ja dhe TVPRA-ja do të diskutohen më poshtë në detaje.

Në aspektin institucional, nuk ka relator ose koordinator për trafikimin në SHBA. Përgjegjësitë për parandalimin e trafikimit, mbrojtjen e viktimave dhe ndjekjen e të pandehurve të akuzuar për trafikim janë të shpërndara midis agjencive të ndryshme në nivel federal. Ka një grup pune me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të agjencive të ndryshme, i quajtur Grupi i Lartë Operativ i Politikave (SPOG), që drejtohet nga Drejtori i Zyrës së Departamentit të Shtetit për të Monitoruar dhe për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, i cili raporton tek *Task Force-i* Ndërinstitucional i Presidentit për të Monitoruar dhe për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Ai përbëhet prej zyrtarëve të lartë nga 10 agjenci federale.<sup>393</sup>

Në mënyrë të përmbledhur, Departamenti i Shëndetësisë dhe i Shërbimeve Njerëzore (HHS) vërteton viktimat e “formës së rëndë të trafikimit” të cilat janë të rriturit me nënshtetësi të

---

<sup>389</sup> Në çështjen *Kozminski*, Gjykata e Lartë vendosi që § 1584 të “kufizohej në çështje ku bëhet fjalë për kryerjen e detyruar të shërbimeve nëpërmjet përdorimit të shtrëngimeve fizike ose ligjore apo kërcënimit për përdorimit të tyre.” Po aty, f. 948. Me miratimin e TVPA-së, Kongresi shprehu në mënyrë të qartë dëshirën që çështjet e shtrëngimit psikologjik të përfshiheshin

<sup>390</sup> 18 U.S.C §§ 1589-1592, § 1594(a).

<sup>391</sup> 18 U.S.C §§ 1593, 1594(b) dhe (c).

<sup>392</sup> L. pub. nr. 108-193, 117 stat. 2875 (2003) (i nënshkruar nga Presidenti më 19 dhjetor 2003)

<sup>393</sup> Për përshkrimin e aktiviteteve të SPOG-ut, shih Raportin e Prokurorit të Përgjithshëm për Kongresin mbi Përpjekjet e Qeverisë së SHBA-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, viti financiar 2006 (maj 2007), [http://www.justice.gov/olp/human\\_trafficking.htm](http://www.justice.gov/olp/human_trafficking.htm); Raporti i Aktiviteteve për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore, vitet financiarë 2001-2005, f. 5-7, [www.usdoj.gov/crt/crim/trafficking\\_report\\_2006](http://www.usdoj.gov/crt/crim/trafficking_report_2006).

huaj, duke u lejuar atyre të marrin ndihmë në para në të holla, ndihmë mjekësore, kuponët për të marrë ushqime falas, dhe strehim.<sup>394</sup> Departamenti i Sigurisë së Atdheut heton çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore dhe u ofron lehtësimin nga rregullat e emigracionit atyre që nuk janë qytetarë, por që vërtetohen të jenë viktime të formës së rëndë të trafikimit. Departamenti i Drejtësisë ndjek të pandehurit që akuzohen për trafikim. Për më tepër, Departamenti i Punës si dhe Komisioni i Mundësive të Barabarta për Punësim (EEOC) shqyrton paditë për abuzimin e punëtorëve dhe diskriminimin e tyre, si dhe mund të ngrejë padi civile në emër të punëtorëve. Gjithashtu, shumë shtete kanë legjislacion kundër trafikimit.<sup>395</sup> Ka 42 grupe pune (“*task forces*”) të përbashkët federale-shtetërore, qëllimi i të cilave është koordinimi i sektorëve të zbatimit të ligjeve dhe sektorëve të shërbimeve social,<sup>396</sup> ndërkohë që komuniteti i OJF-ve që luftojnë trafikimin është shumë aktiv.

### 5.8.1.3 Hyrje për skemat e dëmshpërblimit dhe të dëmeve

Ka tri mjete nëpërmjet të cilave viktime trafikimi mund të rimëkëmbet financiarisht. Këto mjete mund të përdoren në të njëjtën kohë, dhe shpesh kjo ndodh. Statusi i emigracionit nuk përbën pengesë ligjore për asnjërin nga këto tri mjete rimëkëmbjeje. Gjithashtu, për të marrë dëmshpërblim, punëtorit të abuzuar ose të shfrytëzuar nuk i kërkohet vërtetimi se është viktimë e formës së rëndë të trafikimit. Vërtetimi është një hap administrativ që sjell përfitime nga emigracioni dhe përfitime të tjera, dhe nuk përbën kusht as për dëmshpërblimin penal dhe as për dëmshpërblimin civil, as për të aplikuar për dëmshpërblim në fond shtetëror. Vërtetimi trajtohet në pjesën 5.8.6.3 (Të drejtat e viktimave të trafikimit).

Së pari, viktime e krimit mund të aplikojë për dëmshpërblim nga një fond shtetëror për të rimbursuar humbjet financiare që lidhen drejtpërsëdrejti me krimin. Megjithëse specifikat e programeve ndryshojnë nga një shtet në tjetrin, viktimat zakonisht mund të zhdëmtohen për “dëme materiale” – kujdes mjekësor dhe spitalor, kujdes dentar, këshillim për shëndetin mendor, të ardhurat e humbura si rezultat i dëmtimeve të lidhura me krimin, humbje mbështetjeje për personat në ngarkim të një viktime që ka vdekur, si dhe shpenzime funerali

---

<sup>394</sup> Vërtetimi si viktimë e formës së ashpër të trafikimit është procesi administrativ që nuk prek aftësinë e viktimës për të ngritur padinë civile, për të aplikuar për dëmshpërblim shtetëror, ose për t’u identifikuar si viktimë e veprës penale. Shih pjesën 5.8.6 më poshtë (Ndihma për viktimat) për diskutim më të plotë të procesit të vërtetimit.

<sup>395</sup> Tridhjetë e katër shtete të SHBA-së kanë ligjet e tyre të antitrafikimit. Shih ligjet e këtyre shteteve në [http://www.centerwomenpolicy.org/programs/trafficking/map/default\\_flash.asp](http://www.centerwomenpolicy.org/programs/trafficking/map/default_flash.asp).

<sup>396</sup> Çdo *task force* përbëhet nga anëtarë nga zyra rajonale e prokuroreve federalë, agjenci të ndryshme federale si dhe lokale që merren me zbatimin e ligjeve; si dhe përfaqësues të OJF-ve që ofrojnë shërbim në këtë fushë. Shih *Legal Options to Stop Human Trafficking* (Mundësitë ligjore për të ndaluar trafikimin e qenieve njerëzore, Deklaratë e Grace Chung Becker, Zëvendës Asistent Prokurorë e Përgjithshme, divizioni i të drejtave civile, e mbajtur para nënkomisionit për të drejtat e njeriut dhe të drejtën, Komisioni i Gjyqësorit, Senati i SHBA-së (26 mars 2007).

dhe varrimi.<sup>397</sup> Vini re se “të ardhurat e humbura si pasojë e dëmtimeve të lidhura me krimin” nuk përfshijnë humbjet financiare që pëson viktima e trafikimit e cila thjesht nuk është paguar ose është paguar keq për punën e saj të detyruar. Termi ka më shumë si synim që të zbatohet për ato viktima që nuk janë të gjendje të punojnë si pasojë e dëmtimeve të shkaktuara nga vetë sjellja kriminale. Aplikimi për fondin e dëmshpërblimit është mjaft i thjeshtë dhe nuk kërkon përfaqësim ligjor, por ka agjenci shtetërore dhe vendore që mund të ndihmojnë me procedurat. Nëse viktima përdor avokat, disa shtetet rimburojnë një pjesë të tarifës ligjore.<sup>398</sup> Procesi përfshin paraqitjen e kërkesave për shpenzimet, duke përfshirë fatura dhe prova të tjera, por nuk duhet të kërkojë dëshmi me gojë.

Së dyti, viktima e identifikuar në çështjen penale pothuajse gjithnjë do të ketë të drejtë të marrë një urdhër për kthimin e dëmit. Termi “kthim i dëmit” u referohet parave që gjykata vendos që duhet t’i paguhen viktimës apo viktimave të veprës penale nga i pandehuri i dënuar. Ai është i njëjtë me termin “dëmshpërblim penal.” Urdhri i kthimit të dëmit lëshohet nga gjykata kur i pandehuri dënohet. Kthimi i dëmit është i detyrueshëm për të gjitha veprat e trafikimit dhe për të gjitha krimet e dhunës. Kështu, padia penale e ngritur nga viktima e trafikimit nuk ka nevojë që të përmbajë akuza trafikimi në fakt, si kusht për urdhrin e kthimit të dëmit. Humbjet që mbulohen nga kthimi i dëmit diskutohen më në hollësi më poshtë.

Për shkak se viktima nuk e ngre vetë çështjen penale dhe nuk është palë në të, urdhri i kthimit të dëmit në një çështje trafikimi do të lëshohet pavarësisht nga fakti se viktima përfaqësohet ose jo ligjërisht. Përfaqësimi ligjor duhet të ndihmojë viktimën të identifikojë dhe të sqarojë humbjet, dhe në këtë mënyrë duhet të çojë në një shumë më të madhe kthimi. Në praktikë, të gjithë ose pothuajse të gjithë personat që emërohen si viktima në çështjet penale kanë përfaqësim ligjor.<sup>399</sup> Nëse viktima në një çështje penale nuk përfaqësohet, zyra e prokurorit mund ta ndihmojë atë, duke e referuar atë tek avokatët që merren me çështje civile.

Së treti, viktima mund të ngrejë padi civile për dëme. Termi “dëme” u referohet parave që urdhërohen nga gjykata në padi. Shpërblimi i dëmit nga gjykata civile është më i madh se urdhri për kthim të dëmit nga gjykata penale, pasi në gjykatën civile, dëmet përfshijnë

---

<sup>397</sup> Shih FAQ (shkurtim në anglisht për pyetjet që pyetën shpesh): *Benefits* (Përfitimet), <http://www.nacvcb.org/index.asp?sid=4> .

<sup>398</sup> Shih *New York State Crime Victims Board Application* (model i kërkesës përpara Bordit të shtetit New York për viktimat e krimit), [www.cvb.state.ny.us](http://www.cvb.state.ny.us) .

<sup>399</sup> Fakti që viktima e identifikuar në çështjen penale ka avokatin e saj ligjor nuk do të thotë se viktima është palë në çështje. Avokati i viktimës e ndihmon atë në shumë drejtime, përfshirë emigracionin dhe përfitime të tjera, por nuk e mbron viktimën para gjykatës në çështjen penale.

humbje jofinanciare si dhe financiare. Palët paditëse në çështjet civile mund të ngrenë gjithashtu edhe “padi në emër të grupit” ose “padi kolektive” (“*class actions*”) në emër të viktimave që nuk njihen ose nuk janë të zbuluara. Procesi civil është e vetmja mundësi dëmshpërblimi që kërkon përfaqësim ligjor të viktimës. Ka disa organizata të ndihmës ligjore, pjesërisht të financuara nga qeveria, dhe organizata joqeveritare që ndihmojnë viktimat e trafikimit.

Si çështjet civile, ashtu edhe ato penalet shpesh zgjidhen me marrëveshje përpara gjyqit. Kjo do të thotë se palët bien dakord për zgjidhjen. Në çështjet civile kjo quhet zgjidhja me marrëveshje (“*settlement*”), ndërsa në çështjet penale, marrëveshje në lidhje me pranimin e fajit (“*plea agreement*”). Kur palët në çështjen civile bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, zakonisht i pandehuri paguan një shumë parash më të vogël sesa shuma që ai mendon se do të përcaktohej nga gjykata për t’u paguar prej tij në fund të procesit civil. Marrëveshje të tilla shpesh përfshijnë edhe urdhra gjyqësorë të veçantë, që quhen “masa urdhëruese” (*injunctive relief*), për t’u siguruar se palët nuk do t’i përsërisin praktikrat e kundërligjshme.

Kur palët në çështjen penale arrijnë marrëveshje në lidhje me pranimin e fajit, i pandehuri bie dakord që të deklarohet fajtor për veprat penale që janë më pak në numër ose mbase më pak të rënda se veprat për të cilët ai mendon se do të dënohej nga gjykata në fund të procesit penal. Pala e paditur dënohet sipas ligjit, por dënimi rezulton nga pranimi i fajit dhe jo nga procesi gjyqësor.

Marrëveshjet me pranimin e fajit ose marrëveshjet civile shpesh janë të dobishme për viktimat e trafikimit, pasi marrëveshjet ndihmojnë për të garantuar se viktimat marrin kthimin e caktuar të dëmit ose dëmshpërblime të caktuara civile. Të pandehurit që pranon fajin i kërkohet të paguajë kthimin e dëmit para se ai të dënohet përfundimisht. Për më tepër, shuma e kthimit, e negociuar nëpërmjet procedurave të pranimit të fajit në çështjen penale, mund të jetë më e lartë se shuma e llogaritur nga gjykata. Në lidhje me pranimin e fajit, i pandehuri mund të bjerë dakord për një shumë të kthimit të dëmit që është më e lartë se ajo që parashikohet nga ligji.

### **5.8.2 Skemat e dëmshpërblimit për viktimat e krimit**

Dëmshpërblimi për viktimat e krimit parashikohet nga skemat e dëmshpërblimit të krimit të administruara nga shtetet. Secili nga të 50 shtetet e SHBA-së, si dhe rajoni federal *District of Columbia* dhe territoret *Puerto Rico* dhe *Virgin Islands*, kanë një skemë dëmshpërblimi për

viktimat e krimit. Qeveria federale i financon këto skema pjesërisht me anë të Fondit për Viktimat e Krimit, por nuk ka një skemë federale të drejtpërdrejtë dëmshpërblimi.<sup>400</sup> Pjesa tjetër e financimit për programet shtetërore të dëmshpërblimit të viktimave të krimit vjen nga tarifat dhe gjokat që u vihen autorëve të krimeve. Megjithëse programet e shteteve të ndryshme ndryshojnë nga njëri tjetri, ka shumë tipare të përbashkëta për shkak të kërkesave ligjore të Ligjit të Viktimave të Krimit (VOCA). VOCA kërkon që shtetet të ofrojnë dëmshpërblim për viktimat dhe trashëgimtarët e viktimave të dhunës kriminale. Viktimat e trafikimit gëzojnë të drejtën e marrjes së këtij dëmshpërblimi në të njëjtën masë dhe në të njëjtën mënyrë sikurse viktimat e tjera të krimit.

Nga një lexim i faqeve të *Internet*-it të bordeve shtetërore të dëmshpërblimit, shihet se zakonisht nuk ka asnjë kriter në lidhje me nënshtetësinë.<sup>401</sup> Për të përfituar dëmshpërblimin, viktimat duhet (1) ta raportojnë krimin menjëherë; (2) të bashkëpunojnë me agjencitë e zbatimit të ligjeve; (3) të bëjnë aplikimin në kohën e kërkuar; (4) të mos kenë kryer veprën penale; dhe (5) të kenë pësuar shpenzime ose humbje që nuk mbulohe nga siguracioni ose nga programet e tjera publike të përfitimeve. Nuk është e nevojshme hapja e çështjes penale. Për më tepër, Zyra Federale për Viktimat e Krimit (OVC), e cila nxjerr rregulloret dhe udhëzimet për dëmshpërbimin nga fondet shtetërore, thekson faktin që duhet të merren parasysh pengesat e mundshme për bashkëpunimin me agjencitë e zbatimit të ligjeve, si për shembull moshën, dallimet kulturore ose gjuhësore, faktorët psikologjikë dhe turpin ose traumën.<sup>402</sup>

Sipas VOCA-s, skemat shtetërore të dëmshpërblimit duhet të mbulojnë shpenzimet mjekësore, këshillimin për shëndetin mendor dhe pagat e humbura, nëse ato lidhen me dëmtime fizike të shkaktuara nga krimi, si dhe shpenzimet e varrimit. Disa shtete mbulojnë humbje të tjera, si për shembull shpërbim për “dhimbje dhe vuajtje” (të quajtura gjithashtu “dëme morale”), por shtetet ndalohen nga VOCA për të përdorur fondet federale për dëme që lidhen me pronën. Shtetet mund të caktojnë tavane për shumat e rimbursimit për shërbime mjekësore ose të lidhura me çështjet mjekësore dhe shërbime që lidhen me këshillimin dhe me shëndetin mendor.

---

<sup>400</sup> Sipas Bordit të Shoqatës Kombëtare të Dëmshpërblimit për Viktimat e Krimit (NACVCB), vetë shtetet financojnë rreth 60% të dëmshpërblimeve për viktimat. Shih <http://www.nacvcb.org>

<sup>401</sup> Alabama është përjashtim për faktin se nuk i kërkon viktimës të jetë ligjshmërisht i pranishëm në Shtetet e Bashkuara, duke shtuar se personi i certifikuar nga qeveria federale si viktimë trafikimi pranohet në çdo rast.

<sup>402</sup> Shih 66 *Fed. Reg.* (Regjistri federal i SHBA-së) 27158 (16 maj 2001) (Udhëzime Përfundimtare të Programit VOCA për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimit)



Përderisa kthimi i dëmit, nëse paguhet, merret shpesh gjatë një periudhe të zgjeruar kohe, “skemat e dëmshpërblimit shpesh bëjnë paraprakisht pagesat dhe nuk e lënë viktimën që të presë për të marrë kthimin e dëmit.”<sup>403</sup> Për këtë arsye, faqja e *Internet-it* të Bordit të Viktimave të Krimit të shtetit New York deklaroi se pranimi i dëmshpërblimit të viktimës nga Bordi “krijon detyrim si garanci pagese në favor të shtetit që mund të merret nga çdo kthim të dëmit të urdhëruar nga gjykata. Detyrimi është i vlefshëm nëse kthimi i dëmit është urdhëruar për të zhdëmtuar palën paditëse për të njëjtat shpenzime të shpërblyera nga Bordi.”<sup>404</sup> Ligji i shtetit të Californisë krijon një detyrim të ngjashëm ligjor në rastin e shumave që viktima merr nga ndonjë palë e tretë.<sup>405</sup> Shtete të tjera kanë dispozita ligjore të ngjashme.

Dëmshpërblimet maksimale zakonisht variojnë nga 10 000 USD deri në 30 000 USD (7 514 EUR deri në 22 542 EUR), por disa shtete kanë kufij më të lartë.<sup>406</sup> Çdo skemë dëmshpërblimi ka faqen e saj të *Internet-it*, dhe formularët për dëmshpërblim mund të gjenden atje.<sup>407</sup> Shumë prej formularëve janë tani të disponueshëm edhe në spanjisht. Në rastin e rrëzimit të kërkesës, ka procedura apelimi. Çdo shtet ka agjenci për ndihmën e viktimave, dhe pothuajse në çdo zyrë prokurorie ose zyrë për zbatimin e ligjeve, ka koordinatorë për viktimat, për të ndihmuar ato në procesin e aplikimit. Ka dhe fonde për situata urgjente për të ndihmuar viktimat që kanë vështirësi të menjëhershme financiare që lidhen drejtpërsëdrejti me krimin. Sipas një analize mbarëkombëtare për programet shtetërore të dëmshpërblimit për vitin financiar 2005,<sup>408</sup> 158 588 kërkesa u shqyrtuan dhe u pranuan, ndërsa 56 155 të tjera u rrëzuan, duke u konsideruar si të papranueshme ose të mbyllura. Pjesa më e madhe e pagesave shkoi për shërbime mjekësore/dentare.

Dy ndër OJF-ve kryesore për antitrafikimin, *Safe Horizon* (Horizonti i Sigurt) (me seli në qytetin New York) dhe *Coalition to Abolish Slavery and Trafficking* (Koalicioni për zhdukjen e skllavërisë dhe trafikimit) (CAST) (me seli në qytetin Los Angeles) raportuan se ata në mënyrë të zakonshme bëjnë kërkesa për fonde për dëmshpërblimin e viktimave të

---

<sup>403</sup> *Crime Victim Compensation: an Overview* (Dëmshpërblim i Viktimave të Krimit: Pasqyrim), <http://www.nacvcb.org/index.asp?bid=14>.

<sup>404</sup> Shih Informacion për Avokatët, <http://cvb.state.ny.us/attorney>.

<sup>405</sup> Shih FAQ, <http://www.vcgcb.ca.gov/Victims>.

<sup>406</sup> Në shtetin e Californisë, për shembull, totali i të gjitha përfitimeve për krimet që kanë ndodhur më 1 janar 2001 dhe më pas nuk mund ta tejkalojnë shumën prej 70 000 USD (51 731 EUR). Shih <http://www.vcgcb.ca.gov>.

<sup>407</sup> Shih <http://www.nacvcb.org/index.asp?sid=6> për listën e plotë të bordeve të dëmshpërblimit të të gjitha shteteve.

<sup>408</sup> Viti financiar federal (FY) i referohet periudhës nga 1 tetori deri në 30 shtator të vitit pasardhës. FY 2005 fillon në vitin 2004 dhe përfundon në vitin 2005.

krimit në emër të klientëve të tyre<sup>409</sup> dhe i sigurojnë këto fonde. Ka një ligj në shtetin California që parashikon se viktimat e trafikimit në të vërtete kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblim si viktimat e krimit dhe se bordi i dëmshpërblimit nuk mund të mos e pranojë kërkesën sepse mungon raporti të policisë. Në shtetin New York, bordi i viktimave të krimit ka qenë i hapur në pritjen e dokumentacionit përveç raporteve të policisë.

Përparësia e pagesës nga bordi dëmshpërblimi për viktimat e krimit është fakti që kërkesat deri diku janë të shkurtra dhe të thjeshta dhe nuk kërkohet përfaqësim ligjor. Problemi është se humbjet e mbuluara nga borde të tilla dëmshpërblimi janë të kufizuara në shpenzime të përballuara drejtpërdrejt nga viktimat për shkak të veprës dhe, si rezultat, shumat nuk janë të mëdha. Për viktimën e trafikimit, humbja e saj më e madhe financiare mund të shkaktohet nga javët, muajt ose vitet pa paga ose me paga shumë të ulëta. Skemat shtetërore për dëmshpërblimin e viktimave të krimit thjesht nuk dëmshpërblejnë viktimat për natyrën ekonomike të veprës penale të trafikimit.

### **5.8.3 Dëmshpërblimi i dhënë në çështjet penale dhe civile**

#### **5.8.3.1 “Kthimi i dëmit” në çështjet penale**

Nëse trafikanti dënohet për një veprë trafikimi ose krim dhune, atëherë gjykatës i kërkohet të nxjerrë urdhrin e kthimit të dëmit (dëmshpërblimi) për viktimat. Kjo për shkak të zbatimit të dy ligjeve, të Aktit të Kthimit të Detyrueshëm të Dëmit për Viktimat (MVRA) dhe të TVPA-së. TVPA-ja është ligji më gjithëpërfshirës, por procedurat e mbledhjes dhe zbatimit të të gjitha urdhrave të kthimit gjenden në MVRA-në. Në mënyrë që të kuptohet si funksionon kthimi i dëmit për viktimën e trafikimit, është e nevojshme që të kuptohet në përgjithësi kthimi.

#### ***Kthimi i detyrueshëm të dëmit për krimet e dhunshme***

Në Shtetet e Bashkuara, “kthimi i dëmit” u referohet parave që i paguhen viktimës së veprës penale nga ai që dënohet si rezultat i vendimit të gjykatës.<sup>410</sup> Dënimet pas gjyqit penal ose me

---

<sup>409</sup> *E-mail*-i nga Charles Song, Drejtor i Shërbimeve Ligjore, Koalicioni për Zhdukjen e Skllavërisë dhe Trafikimit, më 11 prill 2007, *e-mail*-i nga Florrie Burke, Drejtori i Lartë i Programeve Ndërkombëtare, Programi Anti-Trafikimi, Horizont i Sigurtë, më 11 prill 2007.

<sup>410</sup> Ekziston ndryshim ndërmjet termit “kthim” në kuptimin specifik të “së drejtës së begatimit pa shkak” dhe kthimit të dëmit si pjesë e dënimit në çështjen penale. Andrew Kull, *Restitution's Outlaws* (Kriminalët e Kthimit), 78 Chi. Kent L. Rev. 17 (2003). Megjithëse kthimi i dëmit në origjinë rrënjët i ka në të drejtën e begatimit pa shkak, koncepti ka ndryshuar. “Pas përfshirjes së ligjeve mbi kthimin e dëmit ndaj viktimave të krimeve të dhunshme në strukturën federale të dënimit në vitin 1982, shpërblimi i dëmeve dhe kthimi nuk qëndrojnë më si parime të pavarura ... Dëmshpërblimi, në thelb,

anë të pranimit të fajit ligjërisht janë e njëjta gjë, dhe të dyja çojnë në konstatimin e fajësisë si edhe vendimin gjyqësor të dënimit. Parimi i kthimit është që “keqbërësit i kërkohet që të kthejë viktimën në gjendjen e saj të mëparshme të mirëqenies deri në masën maksimale të mundshme.”<sup>411</sup> Kështu, parimi i dëmeve civile është importuar në sistemin e drejtësisë penale amerikane. Kthimi i dëmit ka si synim të zhdëmtojë viktimën për humbje të shkaktuara nga vepra penale, megjithëse llojet e humbjeve që mund të zhdëmtohen janë të kufizuar me ligj.

Kthimi i dëmit nuk ka qenë një tipar tradicional i sistemit gjyqësor amerikan. Deri në vitin 1982, gjykatat jepnin vendim për kthimin e dëmit vetëm si kusht të dënimit të lirimit me kusht. Por lëvizja e të drejtave të viktimave e viteve '70 dhe '80 ushtroi trysni për pranimin e kthimit të dëmit si mënyrë për të njohur dëmet që i janë shkaktuar viktimës.<sup>412</sup> Duke filluar nga viti 1982, hap pas hapi Kongresi zgjeroi të drejtën e kthimit të dëmit, së pari duke u dhënë gjykatave diskrecion për të marrë vendim kthimi dhe më pas duke e bërë kthimin të dëmit të detyrueshëm për lloje të caktuara krimesh. Në vitin 1996, kur miratoi MVRA-në Kongres e bëri kthimin e dëmit të detyrueshëm për të gjitha krimet e dhunës dhe për pothuajse të gjitha veprat penale kundër pasurisë.<sup>413</sup>

Vendimi për të urdhëruar kthimin e dëmit në çështjet që nuk i plotësojnë kërkesat për kthim të detyrueshëm, lihet në vlerësimin e gjykatës.<sup>414</sup> Kur lëshon urdhrin diskrecional kthimi, gjykata është e detyruar që të shqyrtojë edhe dëmet që i janë shkaktuar viktimës së veprës si dhe burimet financiare të palës së paditur. Në çështjen *US v. Calimlim*, të pandehurit, të cilët ishin dënuar për shkeljen e 18 U.S.C. § 1589 (Punë e Detyruar) për mbajtjen e shërbëtorit shtëpiak në kushtet e punës së detyruar për 19 vjet, pretenduan se ligji i kthimit të

---

nuk ekziston më vetëm për kthimin e dëmit të urdhëruar nga gjykata në një çështje civile; ai ka hyrë dhe në procese penale në formën e kthimit të dëmit për viktimën.” Linda Trang, *Note, The Taxation of Crime Victim Restitution: An Unjust Penalty on the Victim* (Shënim, Tatimi mbi kthimin e dëmit të marrë nga viktimat e krimit: Një ndëshkim i padrejtë për viktimën, 35 Loy. LA L. Rev. 1319, 1320 (2002).

<sup>411</sup> *US v. Webb*, 30. F. 3d 687, 689 (6 Cir. 1994) (citim i historisë legislative të Aktit të Mbrojtjes së Dëshmitarëve Viktima, S. Rep. No. 532, Kongresi i 97-të, Sesioni 1, 30 (1982), i ribotuar në 1982 USCCAN 2515, 2536)..

<sup>412</sup> Shih Kleinhaus, Brian, *Note: Serving Two Masters: Evaluating the Criminal or Civil Nature of the VWPA and MVRA, Through the Lens of the Ex Post Facto Clause, the Abatement Doctrine and the Sixth Amendment* (Shënim, Në shërbim të dy zotërinjve: Vlerësimi i natyrës civile dhe penale të VWPA-së dhe të MVRA-së nëpërmjet lenteve të klauzolës *Ex Post Facto*, doktrina e zbritjes, dhe Amendamenti i Gjashtë), 73 Fordham L. Rev. 2711, 2719-20 (maj 2005) (përshkrimi i qëllimeve të lëvizjes për të drejtat e viktimave); shih gjithashtu *Crime Victims' Rights in America: A Historical Overview* (Të drejtat e viktimave të krimit në Amerikë: Pasqyrim historik), [http://www.ncjrs.gov/ovc\\_archives/ncvrv/2005/pg4b.html](http://www.ncjrs.gov/ovc_archives/ncvrv/2005/pg4b.html) (përshkrimi i historisë së lëvizjes për të drejtat e viktimave të krimit që nga viti 1965 deri në vitin 2005).

<sup>413</sup> L. pub. no. 104-132, 110 Stat. 1214 (1996).

<sup>414</sup> Shih 18 U.S.C § 3663 (ligji i kthimit diskrecional të dëmit.)

detyrueshëm të dëmit nuk mbulonte afatin kohor para hyrjes në fuqi të TVPA-së.<sup>415</sup> Gjykata refuzoi të shqyrtonte çështjen nëse ligji i kthimit të dëmit kufizonte atë në periudhën pas miratimit të TVPA-së “pasi faktet e kësaj çështjeje japin shumë justifikime për Gjykatën që të ushtrojë diskrecion të saj... për të urdhëruar dëmshpërblim për të gjithë periudhën.” Gjykata llogariti që viktimës i takonte kthimi prej 916 635 USD (685 533 EUR).

Edhe kur kthimi i dëmit nuk është i detyrueshëm, marrëveshja që vjen me pranim të fajit mund të kërkojë të i pandehuri do të paguajë kthimin. Kthimi i dëmit të parashikuar në marrëveshje mund të përfshijë humbjet që nuk kërkohen nga kthimi i dëmit sipas ligjit. Për shembull, në çështjen *US v. Boehm* (D. Alaska 2004), i pandehuri pranoi fajin për krimin e trafikimit seksual të fëmijëve në bashkëpunim. Ra dakord për të paguar 1.2 milionë USD (897 462 EUR) në një fond të veçantë të dedikuar në favor të viktimave. Në deklaratën për shtyp të zyrës së prokurorit thuhej: “Fondi i dedikuar mund të përdoret për të paguar shpenzimet arsimore dhe të trajnimit profesional për viktimat, pagesa e cila nuk do të ishte e mundshme sipas ligjeve federale, nëse Boehmi do të ishte dënuar nga gjykata pas gjyqit.”<sup>416</sup> Gjithashtu, ai u dënua me 11 vjet dhe 3 muaj burgim.<sup>417</sup>

### ***Kthimi i dëmit për viktimat e trafikimit***

TVPA e bëri kthimin e dëmit të detyrueshëm për të gjitha viktimat e trafikimit.<sup>418</sup> 18 U.S.C. § 1593 parashikon se, përveç dënimeve të tjera penale ose civile të autorizuara nga ligji, “gjykata urdhëron kthimin e dëmit për çdo vepër tjetër të parashikuar në këtë kapitull.” Urdhri i kthimit duhet të mbulojë “të gjitha humbjet e viktimës.” Kjo do të thotë që edhe nëse vepra penale e trafikimit nuk përfshinte dhunën, dhe si rezultat nuk do të binte në kategorinë e dispozitave të ligjit për kthim të dëmit të detyrueshëm, megjithatë viktimat e trafikimit përsëri duhet ta përfitojnë kthimin.

---

<sup>415</sup> 2007 WL 527481 (E.D. Wisc. 2007)

<sup>416</sup> Zyra e Prokurorit Federal (D. Alaska) (rreth i shtetit Alaska), Deklaratë për Shtyp (22 nëntor 2004)

<sup>417</sup> Raporti Vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm drejtuar Kongresit (FY 2005)

<sup>418</sup> Termi “viktimë” përdoret këtu për t’iu referuar personit të dëmtuar nga vepra penale. Ai nuk do të thotë që personi detyrohet të vërtetojë se është viktimë e një forme të rëndë të trafikimit njerëzor nga Departamenti i Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore (HHS). Çertifikimi nga HHS-ja është një hap administrativ që i lejon viktimës të marrë shërbime dhe përfitime. Ai nuk kryhet nga prokurorët apo nga gjykata. Shih *Fact Sheet: Certification for Victims of Trafficking* (Fletën e Faktit: Certifikimi për Viktimat e Trafikimit), [http://www.acf.hhs.gov/trafficking/about/cert\\_victims.html](http://www.acf.hhs.gov/trafficking/about/cert_victims.html). Certifikimi nuk është kërkesë për ndjekjen e çështjes penale. Gjithsesi, si për çështje penale edhe për certifikim kërkohet që viktima të jetë e gatshme të bashkëpunojë me kërkesat e arsyeshme në zbatim të ligjit. Në praktikë, një çështja penale nuk mund të ndiqet pa bashkëpunimin e viktimës, pasi këto çështje varen shumë nga dëshmia dhe besueshmëria e viktimës.

“Viktima” përkufizohet si “individ i dëmtuar si rezultat i një prej krimeve të parashikuara në këtë kapitull” ose kujdestari ose përfaqësuesi i tij (nëse viktima është e mitur ose është me aftësi të kufizuara).<sup>419</sup> “Shuma e plotë e humbjeve të viktimës” përkufizohet si të gjitha shpenzimet e viktimës për çdo zë të dhënë më poshtë:

- (1) Shërbime mjekësore që lidhen me kujdesin fizik, psikiatrik ose psikologjik;
- (2) Terapi ose rehabilitim fizik apo terapi që lidhet me punë;
- (3) Transport i nevojshëm, strehim i përkohshëm dhe shpenzimet për kujdesin e fëmijëve;
- (4) Të ardhurat e humbura;<sup>420</sup>
- (5) Tarifat e avokateve si dhe kosto të tjera; dhe
- (6) Humbje të tjera që i shkaktohen viktimës, si rezultat i veprës penale.<sup>421</sup>

Në raste të trafikimit, kthimi i të ardhurave të humbura përfshin:

“Shumën më të lartë të të ardhurave bruto ose të vlerës së shërbimeve dhe të punës për të pandehurin që ka kryer viktima ose të vlerës të punës së viktimës, siç garantohet nga Akti e Standardeve të Drejta të Punës (*Fair Labor Standards Act*) në garancitë për pagën minimale dhe për punën jashtë orarit.”

Arsyeja për dy teoritë e të ardhurave të humbura është e tillë që viktima e përfshirë në veprimtaritë e paligjshme, si për shembull prostitucion, mund të përfitojë kthim për vlerën e punës së kryer për të pandehurin. Në shënimet shpjeguese që shoqërojnë Ligjin Model Shtetëror të tij të Antitrafikimit, Departamenti i Drejtësisë shpjegoi:

“Masa e parë e kthimit, vlera e shërbimeve ose e punës që viktima ka kryer për të pandehurin, jo vetëm parandalon që trafikantët të përfitojnë nga krimi i tyre,

---

<sup>419</sup> 18 U.S.C § 1593(c).

<sup>420</sup> Çështja e humbjes së të ardhurave në të ardhmen del ose kur viktima është bërë me aftësi të kufizuara nga dëmtime të lidhura me krimin dhe nuk është në gjendje të punojë ose kur krimi ka shkaktuar vdekjen e viktimës dhe pasardhësit e saj kërkojnë të zhëmtohen për të ardhurat e viktimës që humbasin për të ardhmen. Nëse, për shembull, viktima e trafikimit është dëmtuar nga një i pandehur dhe është bërë me aftësi të kufizuara në mënyrë të përhershme ose të përkohshme, ajo mund të kërkojë që të kompensohet për humbjet e të ardhurave për të ardhmen. Kjo nuk është bërë ende në kuadrin e trafikimit. Nëse shprehja në ligj “të ardhura të munguara” përfshin të ardhura që do të mungojnë në të ardhmen, përbën çështje për diskutim. Të paktën dy gjykata federale të shkallës së dytë kanë vendosur që “të ardhurat e munguara” të përfshijnë të ardhura që do të mungojnë në të ardhmen. Çështja *US v. Cienfuegos*, 462 F. 3d 1160 (9 Cir. 2006) (duke interpretuar MVRA-në); *US v. Oslund*, 453, F. 3d 1048 (8 Cir. 2006) (duke interpretuar MVRA-në). Gjykata tjetër federale e shkallës së dytë (7 Circuit ose Qarkorja e Shtatë), gjithsesi, ka përfunduar se të ardhurat e munguara nuk mbulohen. Çështja *US v. Fountain*, 768, F. 2 790 (7 Cir. 1985).

<sup>421</sup> 18 U.S.C. § 2259(b)(3). Gjykatat ndonjëherë kanë përfshirë tarifën e avokatit si pjesë të shumës së kthimit të dëmit.

por dhe shmang situatën e pakëndshme të përcaktimit të vlerës së një page për rastet e prostituimit të detyruar.”<sup>422</sup>

Në çështjen *US v. Cadena*, gra dhe vajza meksikane ishin joshur të shkonin në Shtetet e Bashkuara nga individë që u kishin premtuar punë të ligjshme, por në fakt u detyruan për të punuar si prostituta në kampet në shtetin Florida ku rimorkiot përdoren për strehim. Kur drejtuesi i rrjetit dhe gjashtë burra të tjerë u dënuan në fund të gjyqit penal në vitin 1999, të pandehurit kundërshtuan kthimin me argumentin se “përveç të ardhurave të paligjshme nga prostituimi, viktimat nuk kanë pësuar asnjë humbje financiare dhe, si rezultat, kthimi i dëmit nuk duhet të urdhërohet. Prokurori federal u përgjigj se kthimi nuk shpërbleh viktimat për veprimtarinë e paligjshme, por u mohon të pandehurve “fitimin e pamërituar nga puna e detyruar e grave.” Duke vendosur se të pandehurit kishin përgjegjësi të përbashkët, gjykata vendosi kthimin me vlerë afërsisht 1 milion USD (747 950 EUR) për të 17 viktimat.<sup>423</sup> Çështja *Cadena* u vendos para hyrjes në fuqi të TVPA-së. Dispozita e TVPA-së për kthim të dëmit bën të qartë pozicionin e qeverisë, shprehur në çështjen *Cadena*, se është e detyrueshme që viktimat e trafikimit të dëmshpërblehen për vlerën e punës së tyre, edhe në rast se puna ka qenë e paligjshme.

Ka pasur kthime të tjera të dëmit në përmasa të konsiderueshme për viktimat e trafikimit për shfrytëzim seksual. Për shembull, në çështjen *US v. Jimenez Calderon* (D.N.J.), gjykata u dha 135 000 USD (100 990 EUR) katër vajzave meksikane të mbajtura të ngujuara në një shtëpi publike. Në çështjen *US v. Babaev*, i pandehuri pranoi fajin për trafikim për qëllime seksuale, sepse solli gratë nga Azerbajxhani në Shtetet e Bashkuara për të punuar si prostituta; ai u dënua me 10 vjet burgim dhe u urdhërua që të paguante 325 000 USD (243 126 EUR) si kthim të dëmit. Në çështjen *US v. Valle-Maldonado et al.*, pala e paditur pranoi fajin për pjesëmarrje në bashkëpunim në trafikim për qëllime seksuale dhe u urdhërua që t’u paguante viktimave 135 000 USD (100 991 EUR). Në çështjen *US v. Trakhtenberg* (D.N.J. 2005), i pandehuri pranoi fajin për bashkëpunimin në kryerjen e punës së detyruar dhe u urdhërua që të paguante si kthim 66 380 USD (48 996 EUR).

Për shkak se kthimi nuk zhdëmton dhimbjen dhe vuajtjen, disa kritikë kanë vënë re se shumatat e urdhëruara nuk janë të mjaftueshme për të kompensuar me të vërtetë viktimat për vuajtjen që kanë pasur. “Shumat e kthimit, të cilat përjashtojnë dëmet për dëmtime

---

<sup>422</sup> Gjendet në faqen e *Internet*-it [http://www.justice.gov/crt/crim/model\\_state\\_law.pdf](http://www.justice.gov/crt/crim/model_state_law.pdf) .

<sup>423</sup> *Member of Mexican Trafficking Ring Sentenced on Involuntary Servitude Charges* (Anëtar i rrjetit të trafikimit meksikan dënohet në bazë të akuzave për shërbimet e detyruara), Deklaratë për shtyp e Departamentit të Drejtësisë (22 nëntor 2002) [http://www.justice.gov/opa/pr/2002/November/02\\_crt\\_689.htm](http://www.justice.gov/opa/pr/2002/November/02_crt_689.htm)

emocionale dhe fizike si dhe dëme ndëshkimore, në tejkalim të dëmeve të pësuarra, në fakt (*punitive*), i nënvleftësojnë shumë dëmet e përjetuara nga viktimat.”<sup>424</sup>

### ***Procedurat që zbatohen për të gjithë urdhrat e kthimit***

Urdhrat e kthimit të dëmit sipas TVPA-së nxirren dhe zbatohen në mënyrën e parashikuar në MVRA. Ligji i fundit parashikon se prokurori duhet të këshillohet me viktimat e identifikuarra dhe t'i japë gjykatës një listë shumash që duhen zhdëmtuar si kthim.<sup>425</sup> Është e detyrueshme që çdo viktimë e identifikuar të njoftohet dhe që secilës viktimë t'i jepet mundësia të paraqesë dëshmi në shkrim të noterizuar, në lidhje me shumën e humbjeve të saj që duhet dhënë si kthim.

Qeveria ka barrën e provës në gjykatë për sa i përket shumës së humbjeve, por standardi është “më i mundshmi,” që është standard më i ulët sesa standardi “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm” që duhet arritur për dënimin penal. Gjykata mund të kërkojë dokumente shtesë dhe mund të dëgjojë dëshmi gojore. Nëse humbjet e viktimës nuk mund të përcaktohen brenda datës së dënimit, gjykata mund të caktojë një datë të mëvonshme për përcaktimin përfundimtar të humbjeve të viktimës. Nëse nuk ka informacion të saktë rreth shumës së humbjeve, gjykatës i detyrohet vetëm të bëjë një vlerësim të arsyeshëm të përmasave të tyre. Nëse viktima zbulon humbje të tjera më vonë, ajo duhet të kërkojë urdhrin e ndryshuar të kthimit.

Në çdo urdhër për kthimin e dëmit, gjykata urdhëron kthimin për secilën viktimë në shumën e plotë të humbjeve të saj, siç përcaktohen nga gjykata dhe pa marrë parasysh rrethanat ekonomike të të pandehurit.<sup>426</sup> Fakti që viktima ka marrë ose ka të drejtë të marrë dëmshpërblim nga siguracione ose nga burime të tjera, nuk merret parasysh në përcaktimin e shumës së kthimit.<sup>427</sup> Gjithsesi, gjykata mund të urdhërojë pagimin e kthimit të dëmit për subjektin që ka paguar dha dëmshpërblim të tillë. Të gjitha viktimat duhet të pagohen para pagimit të ndonjë shoqërie siguracioni. Nëse më pas viktima merr dëmshpërblim për të njëjtën humbje në procesin civil, shuma e paguar në bazë të urdhrit të kthimit duhet të

---

<sup>424</sup> Note, *Remedying the Injustices of Human Trafficking Through Tort Law* (Shënim, Ndreqja e padrejtësive të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet së drejtës për dëme jashtëkontraktore), 119 Harv. L. Rev 2574, 2583 (2006).

<sup>425</sup> Në praktikë, prokurori i jep informacion të tillë Zyrës së Provës së Shteteve të Bashkuara, zyrë e cila është përgjegjëse për llogaritjen e dënimeve të rekomanduara dhe të gjobave dhe për dërgimin e informacionit në gjykatë.

<sup>426</sup> 18 U.S.C. § 3664(f)(1)(A).

<sup>427</sup> 18 U.S.C. § 3664(f)(1)(B).

zvogëlohet.<sup>428</sup> Gjithsesi, i padituri mban barrën e provës për të provuar faktin se vendimi për dëmet civile është për të njëjtat dëme si edhe urdhri i kthimit.<sup>429</sup>

Urdhri i kthimit të dëmit ekzekutohet nga qeveria federale.<sup>430</sup> Nëse personi vuan masën e dënimit me burgim, vendimi mund të zbatohet nga Byroja e Burgjeve. Në qoftë se ka periudhë mbikëqyrjeje pas burgimit, ai mund të zbatohet nga Oficeri i Provës. Pas periudhës së provës, ai mund të zbatohet nga Njësia e Çështjeve Financiare e Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara që ka ndjekur penalisht të paditurin. Edhe viktima mund të zbatojë urdhër kthimi. MVRA-ja parashikon se viktima e përmendur në urdhrin e kthimit mund të marrë kopjen e urdhrin nga nëpunësi i gjykatës që dha dënimin për të pandehurin. Më pas viktima mund të regjistrojë urdhrin si detyrim mbi pronën e të pandehurit, që garanton pagimin.<sup>431</sup>

Përveç ligjeve federale të kthimit, çdo shtet u ka dhënë gjykatave të tyre diskrecion për të urdhëruar kthim. Në disa shtete, ligjet parashikojnë kthim të detyrueshëm.<sup>432</sup> Nëntë shtete kanë ligje antitrafikim që përmbajnë gjithashtu dhe dispozita të detyrueshme kthimi.<sup>433</sup>

### **5.8.3.2 Shkaqet që mund të ngrihen për paditë në procesin civil<sup>434</sup>**

Viktima trafikimi mund të ngrejë padinë civile. E drejta për padinë ekziston pavarësisht nga kthimi i urdhëruar nëpërmjet procesit penal.

Nuk kërkohet që padia penale të paraprijë padinë civile. As nuk kërkohet që viktima të jetë vërtetuar nga qeveria si e tillë, megjithëse mungesa e statusit të sigurt, për sa i përket emigracionit dhe autorizimit për punë, mund të krijojë vështirësi administrative për paditësin. Si paditë civile, ashtu edhe ato penale dëgjoen në gjykatat e rretheve federale,

---

<sup>428</sup> 18 U.S.C. § 3664(j)(2); mund të mendohet se ndëshkimi në tejkallim të dëmeve të pësuar në fakt (*punitive damages*) nuk do të ketë ndikim mbi shumën e kthyer, megjithëse është e vështirë të imagjinohet që gjykata do të jepte vendim për atë ndëshkim *punitive* pa dhënë në të njëjtën kohë vendim për shpërblimin e dëmeve të pësuar.

<sup>429</sup> Shih Catharine Goodwin, *Imposition and Enforcement of Restitution* (Detyrimi dhe Zbatimi i Kthimit), *Federal Probation* (Revista Shërbimi Federal i Provës), 62-72 (qershor 2000); *US v. Manzer*, 69 F. 3d 222, 230 (8 Cir. 1995) (ku gjykata vendosi se pala e paditur nuk ia kishte arritur të tregonte se e njëjta sjellje ishte bazë si për gjykimin civil si dhe për urdhrin e kthimit).

<sup>430</sup> Shih 18 U.S.C § 3613.

<sup>431</sup> Shih 18 U.S.C § 3664(m)(1)(B).

<sup>432</sup> Shih *Ordering Restitution to the Crime Victim* (Urdhërimin e kthimit të dëmit për viktimën e krimit), *Legal Series Bulletin* (Buletini Ligjor) 6, nëntor 2002 (Zyra e Viktimave të Krimit).

<sup>433</sup> Këto shtete janë Arizona, California, Illinois, Indiana, Mississippi, Missouri, New Jersey, Pennsylvania dhe Rhode Island. Shih [http://www.centerwomenpolicy.org/programs/trafficking/map/default\\_flash.asp](http://www.centerwomenpolicy.org/programs/trafficking/map/default_flash.asp).

<sup>434</sup> Në këtë pjesë autorja përfitoi shumë nga diskutimet e mbajtura me juristët Kathleen Kim, Dan Werner dhe Kent Felty, të cilët punojnë në këtë fushë.



dhe të dyja mund të gjykoen përpara jurisë ose, me pëlqimin e palëve, vetëm përpara gjyqtarit. Standardi i provës për çështjen penale është “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm,” ndërsa standardi i provës në çështjen civile është më i ulët, d.m.th. “më i mundshmi.” Standardi i fundit do të thotë se paditësi detyrohet të tregojë vetëm se ka më shumë të ngjarë që pretendimet e tij të jenë të vërteta sesa të pavërteta. Për shkak se periudhat e parashkrimit në çështjet civile në shumicën e rasteve janë më të shkurtra sesa ato penale, ka mundësi që viktimës do t’i duhet të fillojë padinë e saj civile përpara përfundimit të çështjes penale. Gjithsesi, padia civile zakonisht pezullohet nga gjykata, deri në përfundim të çështjes penale.

Dëmet në çështjen civile jepen për të kompensuar humbje ose vuajtje. Këtu përfshihen zhvendime të humbjeve financiare (dëme materiale) të së shkuarës ose të së ardhmes, si dhe humbje jomateriale (dëme morale), si për shembull dëmtime emocionale, dhimbje dhe vuajtje, shqetësimet ose ankth mendor. Shuma në tejkalim të dëmeve të pësuar në fakt (*punitive damages*) mund të jepen për të ndëshkuar të pandehurin dhe për ta dekurajuar sjelljen e tillë të paligjshme në të ardhmen. Në padinë civile, pala paditëse përcakton llojin e dëmtimeve që kërkon të dëmshpërblehen – në shumicën e rasteve, janë të tria llojet – ndërsa përcaktimi i shumës së saktë shpesh lihet për gjyqin. Zhdëmtimi nëpërmjet proceseve civile ka mundësi të jetë shumë më i madh sesa ai nëpërmjet urdhrit të kthimit, pasi vendimet civile, sipas traditës, kompensojnë për më shumë lloje të dëmeve. Për më tepër disa ligje përcaktojnë, se vendimet për dëmet duhet të jenë të barabarta me dyfishin ose trefishin e shumës së humbjeve materiale të provuara.

Viktima trafikimi ka shumë mundësi, për sa u përket shkaqeve për të ngritur padinë civile për dëmet, si në bazë të dispozitave ligjore dhe në bazë të vendimeve të mëparshme gjyqësore (*common law*). Edhe përpara miratimit të TVPRA-së në dhjetor të vitit 2003, avokatët civilë që përfaqësonin viktimat e trafikimit kishin ngritur paditë në gjykatat federale, duke u bazuar në një shumëllojshmërie teorish ligjore.<sup>435</sup> (Megjithëse viktimat e trafikimit në këto procese vinin nga grupe të ndryshme punëtorësh, duke përfshirë punëtorët shtëpiakë, punonjës emigrantë të bujqësisë, punonjës të fabrikave me kushte shumë të këqija ku shfrytëzohej puna e njerëzve, autorët nuk janë në dijeni të padive civile në emër të viktimave të trafikimit për qëllime shfrytëzimi seksual, mbase si rezultat i shkallës së lartë të turp-it ose ndrojtjes që mund të përjetojnë viktimat të tilla).

---

<sup>435</sup> Para hyrjes në fuqi të TVPRA-së, avokatët civilë u detyruan të bazoheshin në disa ligje të të drejtës së punës dhe të të drejtave qytetare (*civil rights*) të hartuara për të trajtuar rastet e zakonshme të keqtrajtimit dhe shfrytëzimit të punonjësve dhe jo punën e detyruar dhe skllavërinë.

Shkaqet e përdorura në ngritjen e padive përfshinin ligje të ndryshme të të drejtave të punëtorëve, ligje mbi antidiskriminimin, pjesën civil të ligjit RICO (Akti kundër organizatave kriminale dhe të korruptuara), të drejtën jashtëkontraktore dhe të drejtën kontraktore, Ligji mbi Padi të e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore (*Alien Tort Claims Act*) (ATCA) si dhe Amendamentin 13 të Kushtetutës.<sup>436</sup>

Çështjet e shfrytëzimit të punës që përfshijnë shumë punëtorë mund të ngihen në formën e “padi në grup” (*class action*) ose të “padi kolektive.” Këta mekanizma lejojnë një numër deri diku të ulët të paditësve që të ngrenë padinë në emër të çdo individi, i cili ka pretendime të njëjta ndaj të pandehurit. Ky mund të jetë një mjet i fuqishëm në rastet kur është e vështirë që të përcaktohet vendndodhja e viktimave ose kur viktimat hezitojnë të marrin pjesë në proces gjyqësor për shkak të shqetësimeve për sigurinë.

Para miratimit të TVPRA-së, OJF-të për trafikimin dhe njerëzit e interesuar kanë bërë lobim me forcë që të lejohet një shkak për ngritjen e padive civile, në mënyrë që dëmi që u ishte shkaktuar personave të trafikuar të mund të identifikohet dhe të kompensohet në mënyrë të saktë. Ata menduan që shkaqet ekzistuese kishin vlerë të kufizuar. “Përcaktimi i marrëdhënies së trafikantit me viktimën e trafikuar, si marrëdhënie ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, nënkupton një dëm më të vogël, që mund të korrigjohet me anë të përlllogaritjes së thjeshtë page. Kjo bën pak në drejtim të mbrojtjes së të drejtës së personit të trafikuar të jetë i lirë nga skllavëria.”<sup>437</sup> Pas miratimit të TVPRA-së, viktimës trafikimi i është dhënë mundësia të ngrejë padinë civile për trafikim. TVPRA-ja dhe shkaqe të tjera padish si dhe çështje përkatëse janë trajtuar më poshtë.<sup>438</sup>

---

<sup>436</sup> Amendamenti 13 i Kushtetutës Amerikane e ndalon skllavërinë dhe shërbimet e detyrueshme. Përderisa TVPRA krijoi mundësinë e shprehur për padinë civile, mund të përfundohet se nuk është më e nevojshme për të mbështetur padi në një të drejtë të nënkuptuar, sipas Amendamentit 13 dhe dispozitës së Kodit të SHBA-së që vë Amendamentin në jetë, 18 U.S.C. § 1584. Gjykatat e SHBA-së hezitojnë të krijojnë mundësitë e nënkuptuara për padi dhe Gjykata e Lartë ka thënë “në mënyrë të përsëritur se vendimi për të krijuar një mundësi private si shkak për ngritjen e padi më mirë t’i lihet në dorë legjislaturës.” Çështja *Sosa v. Alvarez-Machain*, 542 U.S. 692 (2004). Megjithatë, për diskutimin interesant se përse ekziston një e drejtë e tillë, shih çështjen *Manliguez v. Joseph*, 226 F. Supp. 2, 377, 384 (E.D.N.Y 2002) (duke vënë re se “njohja e mundësisë për padinë civile private për shkakun e shërbimeve të detyruara do të ishte në përputhje me qëllimin legjislativ të § 1584, pasi ajo do t’i jepte viktimës mjete direkte dhe efikase për të mbrojtur të drejtat e tij ose të saj si dhe për të penguar shkelës të mundshëm të ligjit nga kryerja e veprimeve për ndalimin e të cilave u hartua ligji.”)

<sup>437</sup> Kathleen Kim dhe Kusia Hreshchshyn, *Human Trafficking Private Right of Action: Civil Rights for Trafficked Persons in the United States* (E drejta për padinë civile në rastet e trafikimit: Të drejtat qytetare për personat e trafikuar në Shtetet e Bashkuara), 16 *Hastings Women’s L. J.* 1, 25 (2004).

<sup>438</sup> Për një rishikim të kuptimit për shkaqet e padive që janë të disponueshme për gratë e trafikuar, shih Kathleen Kim dhe Daniel Werner, *Civil Litigation on Behalf of Victims of Human Trafficking* (Proceset civile në emër të viktimave të trafikimit të personave (2005) (në vijim, Manuali i Proceseve Civile).

## TVPRA

TVPRA-ja e krijoi 18 U.S.C. § 1595. Ky seksion parashikon se individi që është viktimë sipas § 1589 (punës së detyruar), § 1590 (trafikim në lidhje me skllavëri, zgjedhë (*peonage*), shërbime të detyruara ose punë të detyruar) apo § 1591 (trafikim seksual) mund të ngrejë padi civile kundër autorit të veprës penale dhe mund të dëmshpërblehet për dëmet dhe për tarifat e arsyeshme të avokatëve.<sup>439</sup>

Përderisa § 1595 u shtua në dhjetor të vitit 2003, pothuajse nuk ka pasur vendime gjyqësore për ta interpretuar atë.<sup>440</sup> Megjithëse është përfshirë në disa çështje në të cilat bëjnë pjesë viktimat e trafikimit, ato raste ose janë zgjidhur përpara se të shkojnë në gjyq ose gjykata nuk ka nxjerrë ende vendim përfundimtar. Për këtë arsye, interpretimi i “dëmeve” sipas § 1595 është spekulativ, por avokatët kanë mendimin se fjala përfshin si dëmet e pësura në fakt dhe dëmet ndëshkuese në tejkallim të këtyre (*punitive damages*). Ekziston dhe mendimi i përgjithshëm se Kongresi nuk kishte synim që § 1595 të ketë efekt prapaveprues.<sup>441</sup>

Ka një vendim gjyqësor të kohëve të fundit në një çështje që nuk është gjykuar ende deri në përfundim. Palët paditëse ngritën padi për shkeljen e FLSA-së, TVPRA-së, pjesën civile të RICO-s, ligjeve shtetërore për përcaktimin e pagave, si dhe shkeljen e kontratës, heqje të paligjshme të lirisë, sjelljen skandaloze dhe ndalimin ligjor të palëve të paditura për të mohuar pretendimet e paditësit, sepse premtime të rrema ishin bërë nga të paditurit (“*promissory estoppel*,” një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm). Paditësit kërkuan 3.2 milionë USD për dëmet që u ishin shkaktuar.

Në një vendim të ndërmjetëm në janar të vitit 2007, gjykata e rrëzoi kërkesën e të pandehurve për pushimin e çështjes për shkaqet e ndryshme, duke përfshirë dhe argumentin se TVPRA-ja nuk mund të shërbente për ngritjen e padisë. Të pandehurit argumentuan se pjesa e padisë së bazuar në TVPRA duhej të rrëzohej, pasi paditësit nuk kishin pretenduar se ata ishin kërcënuar me dhunë fizike ose se ishin dëmtuar fizikisht. Gjykata nuk ishte dakord. “Mjafton për padinë për shkelje të TVPRA-së, nëse pretendohet se paditësit detyroheshin të punonin si rezultat i abuzimeve të kërcënuara me ligjin ose me procesin ligjor.” Gjykata

---

<sup>439</sup> Edhe § 1595 kodifikon praktikën rutinë të vonimit të padisë civile deri në kryerjen e proceseve përkatëse penale.

<sup>440</sup> Një përjashtim është çështja *Roy Abraham et al v. B. J. Singh et al*, çështja nr 2:04-CV-0044 (E.D. Louisiana, 5 korrik, 2005). Atje gjykata vendosi që § 1595 nuk mund të zbatohet me efekt prapaveprues, d.m.th. para hyrjes së saj në fuqi. Kjo pjesë e opinionit të gjykatës së distriktit nuk u apeluar.

<sup>441</sup> Parashkrimi nuk përcaktohet në TVPRA-në. Parashkrimi prej 10 vjetësh parashikohet në legjislacionin që është akoma projekt.

vlerësoi se përderisa në padi pretendohet se paditësit ishin kërcënuar se do të dëboheshin, kjo ishte e mjaftueshme për ngritjen e padisë. Çështja *Catalan v. Vermillion Ranch Limited Partnership*, 2007 WL 38135 (D. Colo 2007). Pra, gjykata vendosi se kërcënimet për dëbim, nëse do të ishin të provuar gjatë gjykimit, përbënin abuzim me ligji ose me procesin ligjor.

Përveç § 1595, pothuajse gjysma e shteteve kanë miratuar ligje antitrafikimi, dhe në disa shtete të tjera ka projekte për ligje të tilla. Të paktën shtatë shtete parashikojnë shkaqet e ndryshme lidhur me trafikim për ngritjen e padisë civile.<sup>442</sup> Disa prej këtyre ligjeve përmbajnë më shumë hollësi në lidhje me dëmet që mund t'i paguhen paditësit të trafikuar. Për shembull, ligji i shtetit Connecticut parashikon se paditësi mund të marrë dëmet e pësuar në fakt si dhe dëmet sipas ligjit “në masën jo më të lartë se sa 1 000 USD për çdo ditë që personi ishte vënë nën shtrëngim nga një person tjetër” si dhe tarifat e avokatëve. Ligji i shtetit Florida parashikon se paditësi mund të marrë ose trefishin e dëmeve ose trefishin e përfitimeve të marra nga i pandehuri, si dhe tarifat e avokatëve, dhe shpenzimet gjyqësore. Këto ligje janë të kohëve të fundit dhe autorët nuk janë në dijeni të çështjeve që mund të jenë dërguar në gjykatë si rezultat i këtyre shkaqeve për ngritjen e padisë civile në nivel shteti.<sup>443</sup> Gjithashtu ligjet model të antitrafikimit të shteteve përfshijnë shkaqet për

---

<sup>442</sup> Shih projektet nga shtetet amerikane California (AL 22), Connecticut (SB 153), Florida (SB 250), Illinois (HB 1299, i kufizuar në viktimat e trafikimit seksual), Kentucky (SB 43, i kufizuar në viktimat e mitura të trafikimit seksual), Oregon (SB 578) dhe Washington (HB 1175).

<sup>443</sup> Megjithëse deri tani nuk ka pasur çështje të viktimave të trafikimit të ngritura në bazë të këtyre shkaqeve për ngritjen e padisë civile në shtetin e Californisë, janë ngritur padi të tjera sipas ligjit të atij shteti, i cili ka një dispozitë ligjore shumë të favorshme për sa u përket dëmeve. Një OJF e quajtur “Komiteti i Juristëve për të Drejtat Qytetare në Zonën e Gjirit të Qytetit San Francisco” ka qenë aktiv në përfaqësimin e viktimave të trafikimit dhe ka ngritur shumë padi për shkeljen e ligjeve të punës të shtetit të Californisë, si dhe padi për zhduktimin e dëmeve jashtëkontraktore, si për shembull për mashtrim ose stres emocional. Këto çështje u zgjidhën me marrëveshje para se të çoheshin në gjyq. Gjithashtu, një punëtorë shtëpiake filipinase, me emrin Nena Ruiz, ngriti padi kundër punëdhënësve të saj, duke pretenduar se ata e kishin mbajtur kundër dëshirës së saj dhe se i kishin paguar vetëm 300 USD për një vit pune. Ajo fitoi 850 000 USD (627 550 EUR) (551 000 USD si shpërblim i dëmeve të pësuar dhe 275 000 USD dollarë si dëme shtese ose *punitive*) në gjykatën e shtetit të Californisë në gusht të vitit 2004, pas gjyqit përpara jurisë (ang. *jury*). Ajo pretendoi shërbimet e detyruara, heqjen e paligjshme të lirisë, cenim të jetës private, neglizhencë, mashtrim dhe shkelje të ligjeve të shtetit mbi pagat dhe orët e punës. Ajo u ndihmua nga OJF-ja *Coalition to Abolish Slavery and Trafficking* (Koalicioni për Zhdukjen e Skllavërisë dhe të Trafikimit) (CAST). Dëmshpërblimi u dyfishua sipas një dispozite ligjore të shtetit të Californisë që parashikon dyfishimin e shpërblimit kur punëdhënësi e ka bindur punonjësën nëpërmjet mashtrimit për të ndryshuar vendbanimin e tij. Shih Kodin e Punës të shtetit të Californisë, § 972 (që parashikon dyfishimin e dëmshpërblimeve për shkelje të § 970 (Joshja e punonjësve nëpërmjet deklaratave të rrema). Është miratuar § 970 fillimisht për të mbrojtur punëtorët emigrantë. Shteti i Washingtonit ka një dispozitë të ngjashme për dyfishimin e shpërblimeve për mospagim me dashje të pagave. Shih RCW (ligjet e shtetit Washington) 49.52.070. Pas padisë civile të punëtorësh Nena Ruiz, Departamenti i Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara (DOJ) ngriti padi penale kundër çiftit që e punësoi atë. *Tacoma Couple Indicted on Forced Labor Charges* (Padia penale kundër çiftit nga qyteti Tacoma për akuzat e punës së detyruar). DOJ, Deklaratë për Shtyp (14 shtator 2006).

ngritjen e padive civile.<sup>444</sup> Për sa u përket llojeve të dëmit të mbuluara dhe parashkrimeve, mjaft prej këtyre modeleve janë edhe më të detajuara se sa TVPRA-ja.

***Ligjet e të drejtave të punëtorëve: Ligji i Standardeve të Drejta të Punës (FLSA) dhe Ligji i Mbrojtjes së Emigrantëve dhe Punëtorëve Sezonal në Bujqësi (MSPA)***

FLSA-ja<sup>445</sup> përcakton pagën minimale dhe pagimin për punën jashtë orarit për punonjësit me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Ajo kërkon pagesën e orëve jashtë orarit në raportin një me një e gjysmë të pagesës së rregullt për orë në rastet kur është punuar më shumë se 40 orë pune në javë, përveç rasteve kur zbatohen disa përjashtime. FLSA-ja mbulon të gjithë punëtorët, pavarësisht nga fakti se punëtori është nënshtruar apo i huaj pa dokumente.<sup>446</sup>

FLSA-ja parashikon edhe shpërblimet që kompensojnë dëmet si dhe shumat e paracaktuara nga dispozitat e ligjit ose të kontratës (*liquidated damages*).<sup>447</sup> Shpërblimet që kompensojnë dëmet përfshijnë pagat e papaguara si dhe dëmshpërblim për kohën jashtë orarit të papaguar. Shumat të dhëna sipas këtij ligji janë të barabarta me shumën e pagave të papaguara që u ishin mohuar ose u kishin humbur viktimave për shkak të shkeljes së ligjit. Synimi i tyre është “kompensimi për mbajtjen e pagës së punëtorit,” e cila mund të çojë në dëme shumë të paqarta dhe të vështira për t’u provuar me përlogaritje të saktë përveç se me llogariten në bazë të dëmeve sipas ligjit.<sup>448</sup> Ato konsiderohen si kompensuese në natyrë, pasi mendohet që kompensojnë humbjet që u janë shkaktuar punëtorëve me mosmarrjen e pagave të tyre të ligjshme.<sup>449</sup> Tarifat e avokatëve dhe shpenzimet gjyqësore gjithashtu mund të merren.

---

<sup>444</sup> Për shembuj të legjislacionit model të shteteve, shih Ligjin Model të Shtetit në <http://www.polarisproject.org/> dhe *Trafficking Resource Guide (Udhëzuesi për Burimet në Rastet e Trafikimit)*, në <http://www.centerwomenpolicy.org>.

<sup>445</sup> 29 U.S.C § 201-219.

<sup>446</sup> Fleta e të Dhënave të Departamentit të Punës 48: *Application of U.S. Labor Laws to Immigrant Workers: Effect of Hoffman Plastics decision on laws enforced by the Wage and Hours Division* (Aplikim i ligjeve të punës së Shteteve të Bashkuara për punonjësit emigrantë: Ndikimi i vendimit në çështjen *Hoffman Plastics* në ligjet e zbatuara nga Seksioni për Pagat dhe Orët), që përshkruan mënyrën sesi Departamenti i Punës zbaton ligjet për të drejtat e punëtorëve pa marrë parasysh nënshtrësinë e punëtorit ose statusin e tij).

<sup>447</sup> I vetmi përjashtim nga parashikimi i FLSA-së për dëmet e paracaktuara sipas ligjit, është situata kur punëdhënësi ka vepruar në “mirëbesim” dhe ka patur “arsye të bazuar për të besuar” se ai nuk po shkelte ligjin. Shih 29 U.S.C. § 260.

<sup>448</sup> Çështja *Brooklyn Savings Bank v. O’Neil*, 324 U.S. 697, 707 (1945).

<sup>449</sup> Çështja *EEOC v. First Citizens Bank of Billings*, 758 F. 2 397, 403 (9 Cir. 1985).

Paditë sipas FLSA-së parashkruhen pas dy vjetësh, por afati mund të shkojë deri në tre vjet për shkelje të qëllimshme ose të përsëritur.<sup>450</sup> Nëse paditësi pengohet nga veprimet e punëdhënësit të tij të ngrejë padinë në bazë të FLSA-së, atëherë për arsye të drejtësisë gjykatat në përgjithësi e pezullojnë parashkrimin. Në çështjen e një punonjësi shtëpiak, ku paditësi pretendonte shkelje të FLSA-së si dhe bashkëpunim me qëllim mohimin e të drejtave të tij në shkelje të Amendamentit 13 të Kushtetutës, gjykata konstatoi se pezullimi i afatit të parashkrimit për arsye të drejtësisë ishte i përshtatshëm, kur paditësja pretendonte se sa herë që ajo i kërkonte punëdhënësit pagën, të paditurit i jepnin përgjigje të rrema dhe mashtruese, duke i thënë, ndër të tjera, se ata po ia mbajnë paratë e saj, në mënyrë që ajo t'i kishte ato gati kur do të kthehej në vendin e saj të origjinës.<sup>451</sup> Në çështjen që u ngrit nga fabrika e shtetit California, *El Monte*, ku kushtet ishin shumë të këqija (“*sweatshop*”), më shumë se 100 punonjës tajlandezë dhe latinë ngritën padi për shkelje të FLSA-së, të ligjeve të punës së shtetit California dhe pjesën civile të ligjit federal RICO, si dhe pretendime të tjera në lidhje me marrëdhëniet jashtëkontraktore të së drejtës *common law*. Gjykata e rrëzoi kërkesën e të pandehurve për pushimin e çështjes bazuar në parashkrim, duke theksuar se paditësit nuk mund të vepronin brenda afatit të parashkrimit, gjatë kohës kur ata ishin fizikisht të kufizuar brenda fabrikës.<sup>452</sup>

MSPA-ja përcakton standarde punësimi lidhur me pagat, strehimin, transportin, dhënien e informacionit dhe regjistrimin e punonjësve bujqësorë dhe u kërkon kontraktorëve të punës bujqësore të regjistrohen në Departamentin Federal të Punës. Ligji kërkon që sipërmarrësit e punës bujqësore, punëmarrësit e sektorit të bujqësisë dhe shoqatat e bujqësisë t'u japin informacion punonjësve rreth pagave, orëve dhe kushteve të punës si dhe të pajisin punonjësit me deklarata në shkrim të të ardhurave të fituara dhe të zbritjeve. Nëse ofrohet strehim, ai duhet të plotësojë standardet e sigurisë dhe të shëndetit. Sipas MSPA-së, paditësi privat mund të kërkojë shpërblimin e dëmeve të pësuar në fakt ose dëmet ligjore deri në 500 USD për secilën shkelje të ligjit.<sup>453</sup> Megjithatë, MSPA-ja nuk lejon pagesën e tarifave të avokatëve të palëve paditëse.

---

<sup>450</sup> 29 U.S.C. § 225(a).

<sup>451</sup> Shih çështjen *Deressa v. Gobena*, 2006 WL 335629 (E.D. Va. 2006) (duke rrëzuar kërkesën e të pandehurve për pushimin e padisë). (Paditësi pretendoi thyerje të kontratës, shkelje të ligjeve për dëmet jashtëkontraktore si dhe të FLSA-së dhe veprime kriminale në bashkëpunim për ta mbajtur atë në shërbime të detyruara, në kundërshtim me Amendamentin 13 të Kushtetutës dhe me 18 U.S.C. § 1585, por për arsye që nuk dihen, paditësi nuk ndoqi pretendimin për shkelje të § 1595).

<sup>452</sup> Çështja *Bureerong v. Uvawas*, 922 F. Supp. 1450, 1463 (C.D. Cal. 1996). Kjo çështje u zgjidh me marrëveshje në vitin 1997 për 2 milionë USD (1 476 478 EUR). Çështja penale rezultoi në dënime për veprime në bashkëpunim, shërbime të detyruara dhe dhënie strehe për emigrantët e paligjshëm.

<sup>453</sup> Seksioni 504(c)(1) i MSPA-së. Mbani parasysh se shumë shkelje të një dispozite të vetme të këtij ligji “përbëjnë vetëm një shkelje për efekte të përcaktimit të shumës së dëmshpërblimit sipas ligjit.”

Zbatimi i MSPA-së si dhe i FLSA-së kontrollohet nga Departamenti i Punës, i cili ka të drejtë të imponojë gjobat financiare civile si dhe të ngrejë padi kundër individëve. Sipas Departamentit të Punës, në vitin financiar 2007, më tepër se 220 milionë USD në vlerë pagash të papaguara janë mbledhur për mbi 314 000 punonjës. Pjesa më e madhe rezultoi nga veprime administrative në përputhje me FLSA-në. Në vitin 2007, janë bërë 24 950 ankesa dhe u deshën mesatarisht 97 ditë për të zgjidhur secilën prej ankesave.<sup>454</sup>

Për më tepër, individët privatë mund të ngrenë padi për shkelje të të drejtave të parashikuara nga MSPA-ja ose nga FLSA-ja. Gjatë dekadës së fundit, në veçanti janë rritur shumë paditë e ngritura sipas FLSA-së, dhe disa gjykata u kanë dhënë mbi 100 milionë USD punëtorëve për dëmet që u janë shkaktuar.<sup>455</sup> Departamenti i Punës ka ndjekur disa çështje të rëndësishme të shfrytëzimit të punonjësve. Në gusht të vitit 2004, ai arriti një marrëveshje sipas të cilës një firmë që kontraktoi pastrues ra dakord që t'u paguante 775 punëtorëve 1.9 milionë USD (1 422 155 EUR) për të shlyer pagat e papaguara sipas FLSA-së.<sup>456</sup>

Sipas MSPA-së dhe FLSA-së, punëdhënësit e përbashkët përgjigjen veç e veç dhe, si rezultat, secili prej tyre mund të jetë përgjegjës për shkeljet.<sup>457</sup> Kjo do të thotë që një punëdhënës i madh që merr në punë punonjës nëpërmjet ndërmjetësve, si për shembull kontraktor i punëtorëve bujqësorë ose agjenci punësimi, nuk mund t'i shmanget përgjegjësisë për keqtrajtimin e punëtorëve. Testi për punësimin e përbashkët, i zbatuar zakonisht nga gjykatat, lidhet me faktin nëse punëtori është i varur nga më shumë se një person si çështje të realitetit ekonomik.

Në çështjen *Flores v. Albertsons* (C. D. Cal. 2002), punonjësit pa dokumente hodhën në gjyq tri grupe të mëdha supermarketesh për shkelje të FLSA-së. Të pandehurit pretenduan se punonjësit ishin sipërmarrës të pavarur, të punësuar nëpërmjet një shoqërie tregtare që furnizoi shërbime pastrimi. Që prej asaj kohe shoqëria e pastrimit kishte falimentuar, duke lënë vetëm të pandehurit e supermarketeve si burime të mundshme për shpërbimin e dëmit. Gjykata hodhi poshtë kërkesat për vendimin paraprak të pushimit, mbi faktet siç janë ("summary judgment"), duke konstatuar se kishte shumë pyetje në lidhje me faktin nëse

---

<sup>454</sup> Shih Fletën e të Dhënave Statistikore të vitit 2007, në faqen e Internet-it <http://www.dol.gov/whd/statistics/200712.htm>.

<sup>455</sup> Shih "Wage Wars" (Luftra e Pagave), revista *Business Week* (Java e Biznesit) (1 tetor 2007).

<sup>456</sup> *Janitorial Firm Pays 1.9 Million \$ in Back Wages for Overtime* (Firma për pastruesit paguan 1.9 milionë USD paga të papaguara për punën jashtë orarit), Departamenti i Punës, Divizioni i Pagave dhe i Orëve, Deklaratë për shtyp (25 gusht 2004).

<sup>457</sup> Doktrina e punësimit të përbashkët të FLSA-së u miratua në MSPA-në; shih 29 CFR 500.20(h) (përkufizime); shih gjithashtu Fletën e Fakteve të Departamentit të Punës (DOL) 35 ("Mosofrimi i mbrojtjes së kërkuar rezulton në detyrimin e përbashkët për të gjithë të punësuarit të përbashkët.")

supermarketet drejtuan veprimtaritë e pastruesve ndërkohë që ata punonin në supermarkete. Më në fund, çështja u zgjidh për 22.4 milionë USD (16 533 194 EUR).<sup>458</sup>

Në çështjen civile *Bureerong v. Uvawas*, pala e paditur përbëhej nga tetë shoqëri veshjesh, ku punëtorët punuan si rrobaqepës. Në këtë mënyrë, padia civile e zgjeronte përgjegjësinë përtej çështjes penale, e cila kishte efekt vetëm mbi operatorët e drejtpërdrejtë të fabrikës El Monte, ndërmarrjen e prodhimit të rrobave.<sup>459</sup> Paditësit pretendonin se shoqëritë e veshjeve funksiononin si “punëdhënësit e përbashkët” pasi ato “drejtonin punën e kryer nga punëmarrësit në mënyrë të ndjeshme.”<sup>460</sup> Ndërkohë që pranoi faktin se shitësit me pakicë “qartë se ishin larguar nga procesi i mirëfilltë i prodhimit të rrobave që ndodhte në fabrikën El Monte,” dhe se nuk kishte marrëdhënie pune “në mënyrë tradicionale,” gjykata konstatoi se FLSA-ja kishte si synim që të interpretohej në mënyrë liberale dhe se përcaktimi i punëdhënësve të përbashkët kërkonte shqyrtimin e “realitetit ekonomik në marrëdhënien ndërmjet palëve.”<sup>461</sup> Gjykata çmoi se pretendimet e palës paditëse ishin të mjaftueshme për sa i përket ekzistencës së marrëdhënies punësimi në kuptimin e FLSA-së, në mënyrë që të mos pushohej kërkesa. Ky vendim jo vetëm përshpejtoi zgjidhje me marrëveshje të çështjes në të cilën shitësit me pakicë ranë dakord për t’u paguar paditësve 2 milionë USD (1 476 178 EUR), por ishte shumë e rëndësishme për palën paditëse, pasi në atë çast të pandehurit individualë ishin pa burime financiare të ndjeshme.<sup>462</sup>

Mbase vendimi më i madh sipas FLSA-së pas gjyqit ishte çështja e cila përfshinte punëtorë kinezë dhe vietnamezë, që shfrytëzoheshin në territorin Samoa Amerikane (shih kutinë më poshtë). Çështja paraqet gjithashtu faktin sesi mund të zhvillohen njëkohësisht proceset civile, administrative dhe penale.

---

<sup>458</sup> James S. Petrie, *\$22.4 Million FLSA Settlement for Contract Janitors* (Zgjidhja jashtegjyqësore prej 22.4 milionë USD për pastruesit me kontratë), 25 Labor Law (E drejta e punës), 1 shkurt 2005).

<sup>459</sup> Shih çështjen *US v. Manasurangkun* (C.D. Cal, e depozituar në gjykatë më 9 nëntor 1995). Është interesant fakti se disa shtete kanë qenë të gatshme të shtrijnë përgjegjësinë penale shumë më tej se sa e drejta federale. Në shtetin e Arkansasit përfitimi financiarisht nga trafikimi është krim i rëndë. Shih Arkansas HB 2979. Në shtetin e Floridas, është krim i rëndë që të merret ndonjë gjë me vlerë duke marrë pjesë në një sipërmarrje që u ka nënshtruar personave punën e detyruar. Shih Florida SB 250. Në shtetin e Georgias, shoqëritë tregtare mund të ndiqet penalisht nëse një agjent i saj vepron brenda kompetencave të tij të punës dhe veprimi sanksionohet nga shoqëria ose është pjesë e aktiviteteve të vazhdueshme të paligjshme. Shih Georgia SB 529. Autorët nuk janë në dijeni të ndjekjeve penale sipas këtyre ligjeve.

<sup>460</sup> 922 F. Supp. 1460.

<sup>461</sup> Po aty, f. 1468.

<sup>462</sup> Në çështjen penale, qeveria sekuestroi nga të paditurit që u lidhen me *El Monte*-n, dhe u shpërndanë viktimave, më shumë se 1 milionë USD në mars të vitit 1996. Kur u nxorrën në ankand pasuritë personale të mbetura, qeveria shpërndau shumën shtesë prej 202 887 USD në nëntor të vitit 1997. Shih *Personal Assets of El Monte Slavery Perpetrators Produce More Back Wages for Employees* (Pasuritë personale të autorëve të skllavërisë tek El Monte sigurojnë më shumë paga të prapambetura për punëtorët), [www.dir.ca.gov/DIRNews/1997/ir97-57.html](http://www.dir.ca.gov/DIRNews/1997/ir97-57.html).



Pas shumë vitesh keqtrajtimi, punonjësit e fabrikës Daewoosa ngritën padinë kolektive në Gjykatën e Lartë të Samoas Amerikane, ku akuzonin punëdhënësin për mospagim pagash dhe shkelje të kontratës. Gjatë zhvillimit të procesit, pronari i fabrikës Kil-Soo Lee u hakmorr ndaj punëtorëve të përfshirë në proces, dhe në këtë moment u përfshi Departamenti i Punës. Departamenti i Punës i vuri shoqërisë gjobën prej 213 000 USD (157 212 EUR) dhe mori 367 000 USD (270 878 EUR) për pagat e prapambetura për 213 punonjës. “Në rastet kur ish punonjësit e shoqërisë Daewoosa ishin kthyer në shtëpitë e tyre në vende të tjera, Departamenti i Punës rregulloi pagesën në vendet përkatëse, nëpërmjet ambasadave të tyre.”<sup>463</sup> Por ndërsa çeqet e pagave urdhëruara nga Departamenti i Punës po u shpërndaheshin të gjithë punëtorëve që ishin ende në fabrikën Daewoosa, Kil-Soo Lee po ushtronte presion dhe po i kërcënonte ata për t’ia kthyer përsëri çeqet atij, duke i kundërfirmosur.<sup>464</sup> Punëtorët që refuzonin të kundërfirmosin çeqet dhe të kthenin ata u dorëzoheshin autoriteteve për dëbim.

Ndërsa procesi civil vazhdonte, prokurorët federalë filluan të hetonin Kil-Doo Leen. Në vitin 2001, ai u arrestua dhe ndaj tij u ngritën shumë akuza penale, duke përfshirë shërbimet e detyruara dhe punën e detyruar.

Ndërkohë, çështja civile u gjykua. Në prill të vitit 2002, Gjykata e Lartë e Samoas Amerikane vendosi se Daewoosa, Kil-Soo Lee dhe dy agjenci punësimi të qeverisë së Vietnamit ishin bashkërisht përgjegjëse për shumën prej 3.5 milionë USD (2 583 311 EUR), që u detyroheshin punonjësve për pagesat e prapambetura dhe dëme të paracaktuara sipas FLSA-së.<sup>465</sup> Secilit nga 270 punëtorëve i takonte shuma prej rreth 13 000 USD (9 595 EUR). Në gjykimin penal, Lee u dënua në shkurt të vitit 2003. Në qershor të vitit 2005, ai u dënua me dyzet vjet burgim, dhe gjykata urdhëroi që ai të paguante 1.8 milionë USD (1 328 364 EUR) kthimi të dëmit për viktimat, të cilat gjykata i cilësoi si paditësit në çështjen civile. Për shkak se Lee tani pretendon se ka falimentuar, punëtorët dhe avokatët e tyre po përpiqen t’i ushtrojnë presion qeverisë së Vietnamit që të paguajnë 3.5 milionë USD për vendimin e kthimit.<sup>466</sup>

---

<sup>463</sup> Deklaratë për Shtyp e Divizionit të Pagave dhe Orëve të Departamentit të Punës (22 qershor 2000).

<sup>464</sup> Memorandumi për gjykatë nga kërkuesi SHBA, f. 11-12.

<sup>465</sup> Çështja *Nguyen Thi Nga et al. v. Daewoosa Samoa Ltd., Kil Soo Lee, Tourism Company 12 and IMS*, CA nr. 68-99 dhe CA nr. 133-99, Gjykata e Lartë e Samoas Amerikane.

<sup>466</sup> Brad Wong, *Largest US Human Trafficking Case Leads to 40 Year Sentence* (Çështja më e madhe e trafikimit të qenieve njerëzore në SHBA çon në dënimin me burgim prej 40 vjetësh), gazeta *Seattle Post-Intelligencer Reporter* (29 qershor 2005); Dëshmi e Dr. Nguyen Dinh Thang para Nënkomisionit për Afrikën e Dhomës së Përfaqësuesve të SHBA, të Drejtat e Njeriut në Shkallë

Mbrojtja e këtyre dy ligjeve për të drejtat e punëtorëve duhet të shtrihet për të gjithë punëtorët, pavarësisht nga nënshtetësia ose statusi i emigracionit, por një çështje e kohëve të fundit në Gjykatën e Lartë ka çuar në rezultat që të pandehurit tani paraqesin argumente sipas të cilave, statusi i emigracionit në të vërtetë ka rëndësi. Këto argumente në përgjithësi nuk kanë pasur sukses.

Në çështjen e vitit 2002, *Hoffman Plastics*, Gjykata e Lartë vendosi se Bordi Kombëtar për Marrëdhëniet e Punës (*National Labor Relations Board ose NLRB*) nuk mund të nxirrte vendim për pagat e prapambetura të punonjësit pa autorizimin e punës për periudhën e kohës pasi ai ishte shkaktuar nga puna pa të drejtë, sepse kishte përpjekur të organizonte një sindikatë.<sup>467</sup> Duke arritur në përfundimin se vendimi nga bordi administrativ ishte në kundërshtim me politikën federale të emigracionit, Gjykata e Lartë vendosi se pagesa nuk mund të bëhej për “vitet e punës që nuk ishte realizuar, për pagat që nuk mund të ishin fituar në mënyrë të ligjshme dhe për vendin e punës së fituar fillimisht si rezultat i mashtrimit kriminal.”<sup>468</sup> Që prej çështjes *Hoffman Plastics*, gjykatat e niveleve më të ulëta e kanë kufizuar vendimin në kuadrin e tij faktual – një vendim nga një agjenci administrative për pagesën për punë që në fakt nuk është kryer kurrë.<sup>469</sup>

Pas vendimit në çështjen *Hoffman Plastics*, Departamenti i Punës nxori një “fletë të fakteve” ku shpjegonte se do të “vazhdonte të zbatonte FLSA-në dhe MSPA-në, pavarësisht nëse punëtori ishte me dokumente ose jo.”<sup>470</sup> Departamenti theksoi se sipas FLSA-së dhe MSPA-së, Departamenti ose paditësi individual kërkon pagesën për orët që ai ka punuar në fakt,

---

Botërore dhe Operacionet Ndërkombëtare (20 qershor 2005). E disponueshme në <http://foreignaffairs.house.gov/archives/109/21973.pdf>

<sup>467</sup> Çështja *Hoffman Plastic Compounds, Inc. v. NLRB*, 535 U.S. 137 (2002).

<sup>468</sup> 522 U.S., f. 149.

<sup>469</sup> Shih çështjen *Flores v. Lawton Limehouse, Sr.* (D.S.C. 2006) (ku u vendos se statusi i emigrantit nuk kishte lidhje me pagat e papaguara sipas FLSA-së ose pretendimeve që bazoheshin në ligjin *RICO*); *Flores v. Albertsons, Inc.* (C.D. Cal., 9 prill 2002) (që nuk pranoi kërkesën e palëve të paditura për zbulimin e statusit të emigrantit për palët paditëse, duke e konsideruar atë si të palidhur me pretendimet sipas FLSA-së) (padi që përfshinte 2 100 pastrues me kontratë, të cilët ishin emigrantë të paligjshëm; padia u zgjidh më vonë me marrëveshjen për të paguar 22.4 milionë USD); çështja *Liu v. Donna Karan Int'l*, 207 F. Supp. 2d 191 (S.D.N.Y. 2002) (e njëjta); çështja *Trejo et al. v. Broadway Plaza Hotel* (S.D.N.Y. 2004) (ku paditësit pretendonin shkelje të FLSA-së, të 18 U.S.C. § 1589, dhe të ligjeve të shtetit për punë, dhe gjykata nuk lejoi zbulimin e statusit si emigrant). Shih në përgjithësi Christopher Ho dhe Jennifer Chang, *Drawing the Line after Hoffman Plastic Compounds v. NLRB: Strategies for Protecting Undocumented Workers in the Title VII Context and Beyond* (Vija ndarëse pas çështjes *Hoffman Plastics*: Strategjitë për mbrojtjen e punëtorëve të padokumentuar në kontekstin e Titullit VII e më tej), 22 Hofstra Labour & Empl. L. J. 473 (2005).

<sup>470</sup> Departamenti i Punës së SHBA-së, Administrata e Standardeve të Punësimit, Divizioni i Pagave dhe i Orëve; Fleta e Faktit nr. 48 (*Application of US Labor Laws to Immigrant Workers: Effect of Hoffman Plastics decision on laws enforced by the Wage and Hour Division*) (Aplikimi i ligjeve të punës së SHBA-së për punëtorët emigrantë: Ndikimi i vendimit *Hoffman Plastics* mbi ligjet e zbatuara nga Divizioni i Pagave dhe i Orëve).

sipas ligjeve që parashikojnë pagesën për punën e tillë.”<sup>471</sup> Fleta e fakteve u bë e disponueshme në gjuhët kineze, koreane, tajlandeze, vietnameze dhe spanjolle.

### ***Ligjet mbi të drejtat qytetare: Titulli VII i Aktit të të Drejtave Qytetare i vitit 1964 dhe Akti i të Drejtave Qytetare i vitit 1991***

Dy ligje kryesore mbi të drejtat qytetare u njohin të gjithë punëtorëve, pavarësisht nga nënshtetësia, mbrojtje kundër diskriminimit. Së pari, Titulli VII i Aktit të të Drejtave qytetare i vitit 1964<sup>472</sup> e ndalon diskriminimin mbi bazën e racës, të ngjyrës, të fesë, të origjinës kombëtarë, të gjinisë si dhe të shtatzënisë. Sipas Titullit VII, dëmet e pësuar si dhe shumica ndëshkuese që tejkalojnë dëmet e pësuar në fakt (*punitive damages*) mund të jepen, me tavane sipas aktit, duke u varur nga numri i punëmarrësve që ka punëdhënësi. Së dyti, Akti i të Drejtave Qytetare i vitit 1991 e ndalon diskriminimin mbi bazën e racës dhe, në disa raste, edhe mbi bazën e origjinës kombëtare, në kontratat e punësimit. Seksioni 1981 i Titullit 42 të Kodit të Shteteve të Bashkuara (42 U.S.C. § 1981) lejon zhdëmtimin për dëmet e pësuar në fakt si dhe dëmet *punitive* (që tejkalojnë dëmet e pësuar, me qëllim ndëshkimi) pa kufi, dhe gjithashtu, periudha përpara parashkrimit është më e gjatë sesa ajo e Titullit VII. Të dyja llojet e padive të bazuara mbi të drejtat qytetare, shkurt njihen brenda bashkësisë juridike si “paditë e Titullit VII dhe paditë e § 1981.”

Në mënyrë që padia të mund të ngrihet në përputhje me Titullin VII për diskriminimin në punë, paditësi së pari duhet të kishte bërë ankesë pranë Komisionit të Mundësive të Barabarta për Punësim (EEOC). Me rëndësi për viktimat e trafikimi, faqja e *Internet*-it të EEOC-së thotë se ligjet e saj zbatohen për të gjithë punëtorët pavarësisht nga nënshtetësia e tyre.<sup>473</sup> EEOC-ja mund të nxjerrë letrën që konfirmon “të drejtën për të ngritur padi,” ose

---

<sup>471</sup> 42 U.S.C. § 2000e-2: Praktikant e paligjshme të punësimit përkufizohen, pjesërisht, se ndalojnë diskriminimin e “çdo individ në lidhje me shpërblimin, dispozitat dhe kushtet ose përfitimet e punësimit, për shkak të racës, të ngjyrës, të fesë, të gjinisë ose origjinës kombëtare.” § 2000e-2(a)(1).

<sup>472</sup> 42 U.S.C § 1981. Akti i të Drejtave Qytetare të vitit 1991 ka modifikuar Aktin e të Drejtave Qytetare të vitit 1866, i cili ishte legjislacioni i parë gjithëpërfshirës për të drejtat qytetare. Ishte miratuar nga Kongresi për të vënë në jetë Amendamentin 13 të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara. Amendamenti 13 e ndaloi skllavërinë. Në formën e saj aktuale § 1981 deklaroi në pjesën përkatëse: “Të gjithë personat brenda juridiksionit të Shteteve të Bashkuara kanë të drejta të njëjta... për të bërë dhe për të zbatuar kontrata, për të ngritur padi, për të qenë palë, për të dhënë prova dhe për të përfituar në mënyrën e plotë dhe të barabartë nga të gjitha ligjet dhe procedurat për sigurimin e personave dhe të pronës siç gëzohet nga nënshtetasit e bardhë.” Bërja dhe zbatimi i kontratave përkufizohet si proces që përfshin “të gjitha përfitimet, privilegjet, dispozitat dhe kushtet e marrëdhënies kontraktuale.” § 1981(b).

<sup>473</sup> “Ndërkohë që ligji federal i ndalon punëdhënësit nga punësimi i individëve që nuk kanë autorizim pune, ata që gjithsesi i punësojnë punëtorët pa dokumente ndalohen nga diskriminimi kundër këtyre punëtorëve. Shih seksionin 13: Diskriminimi i bazuar në origjinën kombëtare, në Manualin e Përputhshmërisë së EEOC-së (*EEOC Compliance Manual*), në [www.eeoc.gov/policy/docs/national-origin.html](http://www.eeoc.gov/policy/docs/national-origin.html). Gjithsesi, EEOC-ja në përgjithësi nuk kërkon paga pas përfundimit të punës për

vetë mund të ngrejë padinë në gjykatën federale. Kohët e fundit, EEOC-ja është përfshirë në dy raste të njohura, ku bëhej fjalë për trafikim.<sup>474</sup> Njëra çështje, *Chellen v. Pickle*, diskutohet më poshtë (shih kutinë). Në çështjen tjetër, *EEOC v. Trans Bay Steel*, EEOC-ja ngriti padi sipas Titullit VII, ku pretendonte se punëtorët tajlandezë që kishin leje pune të rregullta, ishin diskriminuar dhe shfrytëzuar nga shoqëria, ishin mbajtur kundër vullnetit të tyre, u ishin konfiskuar pasaportat dhe u ishin kufizuar lëvizjet e tyre, si dhe ishin detyruar që të punonin pa pagesë. Çështja u zgjidh me marrëveshje të dëmshpërblimit prej 1 milion USD (737 980 EUR).<sup>475</sup>

### *Çështja Chellen kundër Pickle*

*Chellen v. Pickle* është çështja më domethënëse deri më sot e lidhur me trafikimin që bazohet mbi padi për të drejtat qytetare ose civile.<sup>476</sup> Në *Chellen*, më shumë se 50 burra erdhën nga India për të punuar në qytetin Tulsa, të shtetit Oklahoma, në shoqërinë tregtare me emrin John Pickle Company. Ata kishin viza që autorizonin hyrjen e tyre në Shtetet e Bashkuara për qëllime trajnimi në atë shoqëri. Në vitin 2002, 52 prej këtyre punëtorëve ngritën padi kundër shoqërisë si dhe kundër John Pickle si individ, me pretendime kundër tyre për shkelje të Aktit të Standardeve të Drejta të Punës; diskriminim racor sipas 42 U.S.C. § 1981; mashtrim; heqje të paligjshme të lirisë dhe shkaktim të qëllimshëm të vuajtjes mendore. Komisioni i Mundësive të Barabarta për Punësim (EEOC) pastaj ngriti padi në emër të punëtorëve për shkelje të Titullit VII dhe § 1981. Sipas padive, shoqëria kishte kufizuar lëvizjen e punëtorëve, komunikimin, jetën e tyre private, të drejtën e ushtrimit të besimit fetar dhe mundësitë për shërbime shëndetësore; u kishin konfiskuar pasaportat, vizat dhe biletat e udhëtimit, si dhe shoqëria i kishte kërcënuar ata se do të raportoheshin tek organet

---

punëtorët pa dokumente, megjithëse vazhdon të kërkojë shpërblim për dëme të tjera pavarësisht nga statusi i emigracionit. Mbetet ende çështja e hapur nëse Gjykata e Lartë në çështjen *Hoffman Plastics* do të çonte në ndalimin e vendimit që urdhëron pagat pas punësimit në një çështje kur bëhet fjalë për diskriminimin.

<sup>474</sup> Megjithëse në asnjërën prej çështjeve nuk u ngritën padi penale për trafikimin, dhe megjithëse paditë civile nuk pretenduan për trafikimin, përsëkrimet e kushteve për çdo grup punëtorësh dukeshin si shembuj të fakteve tipikë të trafikimit. Gjithsesi, nuk u evidentua asnjë konstatim ligjor për trafikimin.

<sup>475</sup> *EEOC Resolves Slavery and Human Trafficking Suit against Trans Bay Steel for an Estimated \$1 Million* (EEOC-ja zgjidh çështjen për skllavëri dhe trafikim të qenieve njerëzore kundër *Trans Bay Steel* për shumën prej 1 milion USD), Njoftim për Shtyp i EEOC-së (8 dhjetor 2006).

<sup>476</sup> Vetë EEOC-ja e përshkroi atë si çështje trafikimi, megjithëse nuk u ngritën kurrë akuza penale për trafikimin. Shih *Judge Orders John Pickle Co. to Pay \$1.24 Million to 52 Foreign Workers in Human Trafficking Case* (Gjyqtari urdhëron shoqërinë *John Pickle* për të paguar 1.24 milionë USD për 52 punëtorë të huaj në çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore,) Njoftim për Shtyp i EEOC-së (26 maj 2006).

e zbatimit të ligjeve nëse do të largoheshin pa leje prej mjediseve të shoqërisë; si dhe kishte marrë në punë rojë të armatosur për të ndaluar largimet e tyre të paautorizuara.<sup>477</sup>

Pas gjyqit pa juri, të ndarë në dy pjesë,<sup>478</sup> gjykata pranoi të gjitha pretendimet e paditësve, duke marrë vendim që të njiheshin dëmet si më poshtë:

- (1) Pagesën e pagave të papaguara si dhe dëmet sipas ligjit (liquidated damages) të barabarta me shumën e plotë të pagave të humbura nga shkeljet e qëllimshme të FLSA-së;
- (2) Dëmshpërblim sipas § 1981 për vuajtjen mendore dhe emocionale (1,000 USD për secilin paditës);
- (3) Dëme ndëshkuese në tejkalim të dëmeve të pësuar në fakt, për shkak të natyrës jashtëzakonisht të rëndë të sjelljes (1 000 USD për secilin paditës);
- (4) Kamata për periudhën para vendimi;
- (5) Dëmet për veprën e mashtrimit (pagat për periudhën 10 mujore, kur atyre iu tha se do të kishin punë, por nga sjellja pa të drejtë e të pandehurit, iu mohua mundësia për të punuar); dhe
- (6) Dëmet për veprën e heqjes së paligjshme të lirisë (1 000 USD për secilin paditës).

Totali i dëmeve të dhëna për shpërblim ishte më shume se 1.2 milionë USD (897 464 EUR) për 52 paditësit.

*Chellen* duhet të jetë sinjal të qartë se viktimat e trafikimit mund të bazohen në ligjet tradicionale të antidiskriminimit si dhe tek ligjet e antitrafikimit dhe të mbrojtjes së punëtorëve. Ashtu siç tha avokati i EEOC-së që drejtoi çështjen:

“Presim që një vendim i tillë, i cili përdor ligjet e të drejtave qytetare të Titullit VII dhe § 1981 për problemin në rritje në vend të trafikimit të qenieve njerëzore, do të shërbejë si precedent i vlefshëm dhe i përdorshëm, dhe do të pajisë qeverinë me një tjetër armë për të luftuar shfrytëzimin dhe punën e detyruar.”<sup>479</sup>

---

<sup>477</sup> Ky përshkrim është marrë nga çështja *Chellen v. John Pickle Co. and John Pickle Jr.*, 446 F. Supp. 2d 1247 (N.D. Oklahoma 2006).

<sup>478</sup> Në fazën e parë, gjyqi pa juri përcaktoi se paditësit ishin punëtorë dhe jo “njerëz në trajnim” sipas parashikimeve të FLSA-së. Shih *Chellen v. John Pickle Co.*, 344 F. Supp. 1278 (N.D. Okla. 2004) (*Chellen* 1). Më pas Gjykata kombinoi fazat e përgjegjësive dhe të dëmeve për të gjitha pretendimet dhe organizoi një gjykim të dytë pa juri në mars të vitit 2005.

<sup>479</sup> *Judge Orders John Pickle Co. To Pay \$1.24 Million to 52 Foreign Workers in Human Trafficking Case* (Gjyqtari e urdhëron John Pickle Co. t’u paguajë 1.24 milionë USD 52 punëtorëve të huaj në çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore), Njoftim për Shtyp i EEOC-së (26 maj 2006).

## ***Akti kundër organizatave kriminale dhe të korruptuara (RICO)***

Sipas Aktit kundër Organizatave Kriminale dhe të Korruptuara (RICO), është e paligjshme për çdo person të punësuar nga një ndërmarrje që ka ndikim në tregtinë ndërshtetërore të ushtrijë veprimtaritë të ndërmarrjes “nëpërmjet veprimeve të jashtëligjshme të përsëritura ose mbledhjes së huave të paligjshme.”<sup>480</sup> Veprimet e jashtëligjshme në fjalë (në anglisht, *racketeering activity*) përkufizohen si sjellje që cenon ligje të tjera të posaçme. Mashtrimi me anë të postës dhe me anë të mjeteve elektronike, mashtrimi në lidhje me dokumentet e identifikimit, keqpërdorimi i vizave dhe importimi i një të huaji për qëllime të pamoralshme, të gjitha këto cilësohen si veprimtari kriminale të mbuluara nga ligji RICO, dhe TVPRA shtoi si vepra penale të mbuluara sipas RICO-s veprat e trafikimit siç përkufizohen nga TVPA-ja.<sup>481</sup> “Përsëritja” e veprimtarive në kuptim të RICO-s (fjala anglishte që përdoret është “*pattern*”) kërkon të paktën dy veprime kriminale të tilla.

Padia civile në bazë të RICO-s është armë e fuqishme kundër trafikantëve, pasi RICO-ja përmban kërcënimin e dëmeve të trefishta, që do të thotë se dëmet e pësuar në fakt shumëzohen me tre. Dëmet janë të disponueshme vetëm për dëmet ndaj biznesit ose pronës, sasia e të cilave mund të përcaktohet, jo për lloje të tjera dëmsh, dhe vetëm për dëme që shkaktohen drejtpërdrejt nga aktivitetet kriminale dhe jo për sjellje të tjera të padrejta.<sup>482</sup> Gjithsesi, fakti që punëtori nuk paguhet nga punëdhënësi, duhet të interpretohet se përbën dëm për biznesin, dhe fakti që kërkesëpapia mund të përfshijë dhe dëmtime personale, nuk “shuan legjitimitimin bazuar në humbjet ekonomike të pretenduara.”<sup>483</sup>

Pretendimet e ngritura në bazë të RICO-s ndonjëherë kanë vazhduar të gjykohen në rastet kur akuzat për trafikim ose skllavëri nuk janë pranuar. Në çështjen *Does I v. The Gap*, paditësit ishin punëtorë të fabrikës së veshjeve që pretendonin se fabrikat në Saipan dhe shitësit me pakicë që blinin veshjet e prodhuara prej tyre kishin shkelur FLSA-në, pjesën civile të RICO-s dhe ligje të tjera të punës.<sup>484</sup> Megjithëse gjykata e shkallës së parë vërejti se pala paditëse nuk kishte parashtruar në mënyrë të mjaftueshme kërkesën për shërbime të detyruara ose zgjedhën (*peonage*) sipas së drejtës *common law*, si vepra penale mbi bazën e

---

<sup>480</sup> 18 U.S.C. § 1962(c).

<sup>481</sup> Para miratimit të TVPRA-së, përkufizimi i aktiviteteve në organizatat kriminale sipas RICO-s nuk përfshinte § 1589, § 1590 ose § 1591.

<sup>482</sup> 18 U.S.C. § 1964(c); shih gjithashtu çështjen *City of Huntsville v. Proliance Energy* (N.D. Alabama 2005); (“Dispozita nuk mund të interpretohet se autorizon, aq më pak se kërkon, trefishimin e dëmeve të pësuar për shkaqe të tjera”); *Anza v. Ideal Steel Supply Corp.*, 547 U.S. 451 (2006) (dëmet nuk u kompensuan kur nuk shkaktoheshin drejtpërdrejtë nga aktivitete të organizatave kriminale).

<sup>483</sup> Shih çështjen *Doe I v. Reddy*, 2003 WL 23893010 (N.D. Cal.) (dëmet e kërkuara në pronë ose biznes mund të kompensohen kur paditësit pretenduan se u detyruan të punojnë pa pagesë me orar të zgjatur).

<sup>484</sup> 2002 WL 1000068 (D. N. Mar. I).

të cilave padia civile sipas RICO-s mund të ngrihet, dhe as nuk kishin pretenduar në mënyrë të vlefshme shkelje të Ligjit mbi Paditë e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore, çështje vijoi në bazë të veprave penale të tjera të përfshirë në përkufizimin e RICO-s.

Në fund të fundit, paditësit arritën në ujdin me prodhuesit e veshjeve dhe shitësit me pakicë, për shumën prej 20 milionë USD (14 756 339 EUR) për t'u paguar pagat e prapambetura 30 000 punëtorëve dhe për të zhvilluar sistemin të pavarur monitorimi për t'u dhënë fund abuzimeve tepër të rënda në kushtet e punës.<sup>485</sup> Pavarësisht nga ky rezultat, i cili në dukje ishte premtues, një gazetar në pranverë të vitit 2006 raportoi se “vetëm 5.8 milionë USD ishin caktuar për pagesën e drejtpërdrejtë për punëtorët, dhe deri tani vetëm një pjesë shumë e vogël e kësaj shume është paguar.”<sup>486</sup>

### ***Paditë të bazuara jo mbi ligjet e veçanta: E drejta për shpërblim për dëmet jashtëkontraktore dhe sipas kontratës***

Avokatët që përfaqësojnë viktimat e trafikimit zakonisht në paditë civile kanë përfshirë një ose më shumë pretendime për zhdëmtimin e dëmeve jashtëkontraktore sipas së drejtës *common law*. E drejta për zhdëmtimin e këtyre dëmeve (të cilat quhen *torts* në anglisht) lejon dhënien e dëmeve të pësuar, si dhe ato ndëshkuese në tejkallim të dëmeve të pësuar në fakt. Kjo e drejtë varion nga një shtet tek tjetri, por në çështjet e trafikimit ose të ngjashme, janë përfshirë shkaqet e mëposhtme për ngritjen e padisë: heqje e paligjshme e lirisë, cenim i jetës private, shkaktim i qëllimshëm ose me anë të pakujdesisë së vuajtjes emocionale, kërcënim apo tentativë për të përdorur dhunë si dhe përdorim i dhunës (“*assault and battery*”), mashtrim, mbikëqyrje e pakujdesshme dhe paraqitje e gabuar me anë mashtrimi (“*fraudulent misrepresentation*”). Për shkak se dëmet jashtëkontraktore nuk rregullohen nga dispozita të ligjeve, ka mundësi që e drejta e tyre të jetë më pak e ngurtë dhe që gjykatat të jenë në gjendje të trajtojnë më me drejtësi dëmet e veçanta të trafikimit, sipas së drejtës për zhdëmtimin e dëmeve jashtëkontraktore.<sup>487</sup> Për më tepër, shkeljet për heqjen e paligjshme të lirisë dhe për cenim të jetës private mund të mbulohen nga disa policë të

<sup>485</sup> Për përshkrimin e plotë, shih <http://www.globalexchange.org/campaigns/sweatshops/saipan> “*The Saipan Victory*” (Fitorja e Saipanit).

<sup>486</sup> Rebecca Clarren, *Paradise Lost: Greed, Sex Slavery, Forced Abortions and Right-Wing Moralists* (Parajsa e humbur: babëzia, skllavëri seksuale, aborte të detyruara dhe moralistët e krahut të djathtë), revista *Ms. Magazine* (pranverë 2006).

<sup>487</sup> Shih *Note: Remediating the Injustices of Human Trafficking Through Tort Law* (Shënim: Ndreqja e padrejtësive të trafikimit të qenieve njerëzore me anë të së drejtës jashtëkontraktore), 119 *Harv. L. Rev.* 2589 (“Ndërsa gjykatat mund të hezitohen të ndërhyjnë në parametrat e të drejtave të përcaktuara me anë të organeve legjislative, ato kanë udhëzuar tradicionalisht zhvillimin e padive për dëmet jashtëkontraktore nëpërmjet “*common law*,” dhe për këtë arsye ka më shumë të ngjarë që ata të pranojnë paditë kundër trafikantëve për këto dëme.”)

siguracionit shtëpiak. Megjithëse këta policë zakonisht nuk përfshijnë veprime të qëllimshme, dëmet për heqjen e paligjshme të lirisë dhe të cenimit të jetës private mund të arrihen nëpërmjet sjelljes neglizhente ose jo të qëllimshme.<sup>488</sup> Kur punëtori shtëpiak ka qenë shfrytëzuar në shtëpinë e punëdhënësit, ekzistenca e policit të figuracionit, i rrit ndjeshëm në favor të viktimës mundësitë e pagesës pas vendimit gjyqësor.

Viktimat e trafikimit gjithashtu mund të kenë pretendime kontraktore (shkelje e kontratës) ose gjysmëkontraktore (begatimi pa shkak), por në shumë shtete, në qoftë se jepen dëme kontraktore në gjykatë, dëmet jashtëkontraktore nuk mund të jepen.<sup>489</sup>

### ***Ligji mbi Paditë e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore***

Një tjetër bazë e mundshme për të ngritur padi është Ligji mbi Paditë e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore (*Alien Tort Claims Act* ose ATCA), ligj i vitit 1789 që parashikon se gjykatat federale të Shteteve të Bashkuara kanë juridiksion fillestar për çdo padi civile të ngritur nga një i huaj për shkelje të marrëdhënieve jashtëkontraktore të kryer në shkelje të së drejtës së kombeve (*ius gentium*) ose të një traktati të Shteteve të Bashkuara.<sup>490</sup> ATCA-ja është bërë mjet për procese të të drejtave të njeriut në Shtetet e Bashkuara, zakonisht në lidhje me shkeljet e kryera jashtë territorit. Në këto raste, gjykatat kanë dhënë vendime si për dëmet e pësuar në fakt, si për ato ndëshkuese (në tejkalim të atyre të pësuar). Së fundi është përdorur gjithashtu në paditë ku përfshihet trafikimi.

Një çështje e suksesshme ishte *Jane Doe v. Lakireddy Bali Reddy*, 2003 WL 23893010 (N.D. Cal.). Njëmbëdhjetë paditëse, të gjithë gra dhe vajza te reja indiane, ngritën padi kundër Lakireddy Bali Reddy dhe anëtarëve të familjes së tij, duke i akuzuar ata për zgjedhë, shërbime të detyruara, punë në kushtet e skllavërisë, shkelje të Ligjit mbi Paditë e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore, pjesën civile të RICO-s, Amendamentin 13 të Kushtetutës si dhe disa pretendime të tjera në bazë të së drejtës për dëmet jashtëkontraktore, si për shembull kërcënim apo tentativë për të përdorur dhunë si dhe përdorim i dhunës, mashtrim, vuajtje emocional dhe neglizhencë. Gjykata e shkallës së parë federale vendosi se

---

<sup>488</sup> Siguracioni standard kundër përgjegjësive ("*liability insurance*") nuk mbulon aktet e qëllimshme dhe përjashton mbulimin " në situatat në të cilat i siguruari e dinte ose duhet ta kishte ditur deri në një shkallë të lartë probabiliteti, se prej atij veprimi do të shkaktonte dëm." Tom Baker, *Reconsidering Insurance for Punitive Damages* (Rishqyrtimi i siguracionit për dëme ndëshkuese në tejkalim të dëmeve të pësuar), 1998 Wisc. L. Rev. 101. Për një diskutim më të plotë të politikave të siguracionit për pronarët e shtëpive, shih Della Bahan dhe Puja Batra, *Seeking Justice for Trafficked Domestic Workers in American Courts* (Kërkimi i drejtësisë për punëtorët e trafikuar që punojnë si shtëpiakë), f. 8, ligjerata e paraqitur në Konferencën Vjetore Ndërkombëtare Nr. 8 për Kërkimin e Politikave për Gratë (qershor 2005),

<sup>489</sup> *Civil Litigation Manual* (Manuali i proceseve civile), f. 50-52.

<sup>490</sup> 28 U.S.C. § 1350.



mund të vazhdonte procedimi i ngritur në bazë të padisë sipas ATCA-së, pasi “forma moderne të skllavërisë cenojnë normat *ius cogens* të së drejtës ndërkombëtare jo më pak se tregtia historike e skllavërisë.” Në fund të fundit, çështja u zgjidh me marrëveshje për 8.9 milionë USD.<sup>491</sup>

### ***Komente për paditë civile***

Viktimat e trafikimit mund të ngrenë disa lloje padish. Rishikimi i çështjeve të fundit civile të trafikimit nxjerr në pah se pjesa më e madhe e padive janë ngritur secila mbi shkaqe të ndryshme. Zhdëmtim sipas disa ligjeve, si për shembull dëmet e paracaktuara nga ligji (*liquidated damages*) sipas FLSA-së dhe dispozita mbi trefishimin e dëmeve sipas RICO-s, mund të jenë më efikase se zhdëmtimi sipas dispozitave të papërcaktuara mbi dëmet në TVPRA-në. FLSA-ja, pjesa civile e RICO-s, e drejta e kontratave dhe e drejta e dëmeve jashtëkontraktore duket se përdoren me shpesh, por ka dhe padi të ngritura mbi shkelje të Ligjit mbi Paditë e të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktor. Çështjet përfshijnë disa lloje punëtorësh - punëtorë shtëpiakë, punëtorë emigrantë në bujqësi dhe punëtorë me viza të rregullta pune, megjithëse të gjithë nuk janë shtetas amerikanë. Nuk janë zbuluar raste që përfshijnë prostitutat, ndoshta për shkak të stigmës që lidhet me ngritjen e padive të tilla. Për shkak se në të gjitha paditë që janë ngritur kohët e fundit, në asnjë çështje nuk është marrë vendimi përfundimtar, dhe nuk kemi informacion në lidhje me vendime për dëmshpërblim.

Në një numër të madh çështjesh, pala paditëse përfaqësohet nga një organizatë që financohet nga Korporata e Shërbimeve Ligjore (LSC). Për shembull, organizatat e ndihmës ligjore në shtetet Colorado dhe North Carolina kanë ngritur së fundmi padi në emër të punëtorëve të fermave blegtorale dhe punëtorëve të bujqësisë, përkatësisht. Vetë Korporata për Shërbimet Ligjore financohet nga qeveria federale, dhe ligjet federale mbi trafikimin thonë shprehimisht se një organizatë e ndihmës ligjore mund të përfaqësojë individin që është vërtetuar nga qeveria si viktimë e formës së rëndë trafikimi, pavarësisht nga statusi i

---

<sup>491</sup> Shih Mathew Artz, *Reddy Victims Sue Their Own Lawyers* (Viktimat e Reddy-it ngrenë paditë kundër avokatëve të tyre), gazeta *Berkeley Daily Planet* (28 qershor 2008). Në çështje penale përkatëse, Reddy ishte një njeri i cili pranoi fajin për konspirim dhe transportim të të miturve për aktivitet seksuale të jashtëligjshëm dhe pagoi 2 milionë USD për t’ua kthyer katër viktimave në vitin 2001. Shih *California Man Admits He Brought Indian Girls to US for Sexual Exploitation, Pleads Guilty to Federal Charges* (Burri nga shteti i Californisë pranon se ka sjellë vajzat indiane në Shtetet e Bashkuara për shfrytëzim seksual, dhe shpallet fajtor në çështjen federale), Njoftim për shtyp i Departamentit të Drejtësisë (7 mars 2001). (Çështja e tij parapriu hyrjen në fuqi të TVPA-së, që parashikon trafikimin seksual si krim). Sipas raporteve, Reddy ka paguar shpërblim prej 2 milion USD “brenda pak ditësh pas dënimit.” “*Civil Lawsuit Settled in Reddy Sex-Slave Case* (Zgjidhet me marrëveshje padia civile në çështjen e skllavërisë seksuale të Reddy-it,” gazeta *Berkeley Daily Planet* (9 prill 2004).

emigracionit.<sup>492</sup> Çështjet e tjera janë ngritur nga klinikat e fakulteteve të drejtësisë, zyra të vogla avokatie si dhe OJF-të.

Një avokat civil që ka ngritur padi në emër të viktimave të trafikimit thotë, se çështjet ku përfshihen shumë viktima ose shumë të pandehur, janë të vështira për t'u menaxhuar nga OJF-të e vogla.<sup>493</sup> Burimet që kërkohen vetëm për nxjerrjen e dokumenteve mund të mos jenë të përballueshme. Në disa raste OJF-të kanë krijuar partneritete me avokatë pranë studiosh të mëdha avokatie. Për shembull, studioja e madhe e avokatisë në qytetin New York, *Kaye, Scholer*, i bashkoi forcat me dy OJF të vogla, *Farmworker Legal Services* (Shërbimet Ligjore të Punëtorëve Bujqësorë) dhe *Workers' Rights Law Center* (Qendër e të Drejtave Ligjore të Punëtorëve) për të përfaqësuar emigrantët meksikanë në një çështje ku, ndër të tjera, pretendohet shkelja e FLSA-së, e MSPA-së, e Amendamentit 13, të Ligjit mbi Padi të të Huajve për Zhdëmtimin e Dëmeve Jashtëkontraktore dhe pjesën civile e RICO-s.<sup>494</sup> Në çështjen *Chellen v. Pickle*, avokati që përfaqësonte paditësit, i cili punonte si i vetmi, u ndihmua shumë kur avokatët e EEOC-së u futën në lojë.

Ndërsa Shtetet e Bashkuara duket se kanë një numër të madh OJF-sh që punojnë në fushën e antitrafikimit dhe janë të gatshme për të dhënë përfaqësim ligjor, si dhe OJF-të që merren me çështjet më tradicionale të të drejtave qytetare, të drejtave të emigrantëve dhe me dhunën në familje, të cilët i janë bashkuar lëvizjes antitrafikim, sigurimi i ndihmës ligjore varet shumë nga fakti, nëse punëtori i shfrytëzuar është vërtetuar nga qeveria federale si viktima e formës së rëndë të trafikimit. Megjithëse OJF-të, ndryshe nga organizatat e ndihmës ligjore të financuara nga Korporata e Shërbimeve Ligjore, nuk ndalohen nga përfaqësimi i paditësve të cilët nuk janë vërtetuar si viktima, statusi i pasigurt i emigracionit të paditësit, dhe mungesa e autorizimit për punë, mund ta bëjnë të vështirë nga ana e logjistikës ndjekjen e padisë. Pjesa më e madhe e OJF-ve që përfaqësojnë viktimat e shfrytëzimit të punës që janë emigrantë, gjithsesi, janë përgatitur që të përballen me këto sfida.

Një tjetër realitet i proceseve civile në Shtetet e Bashkuara është që kostot e mbrojtjes së padisë janë shumë të larta. Nëse i pandehuri edhe ndiqet penalisht dhe ndaj tij zhvillohet gjithashtu proces civil, ai mund të humbë çdo pasuri financiare kur proceset përfundojnë. Për shembull, në çështjen *Ruiz v. Jackson*, çështja e ngritur nga një punëtorë shtëpiake

---

<sup>492</sup> Organizatat e ndihmës ligjore gjithashtu mund të përfaqësojnë individët në etapën para çertifikimit, por detyrohen të heqin dorë nga përfaqësimi, nëse individi është pa dokumente dhe nëse atij i mohohet çertifikimi. Shih Letër e Programit LSC 05-2.

<sup>493</sup> Biseda me Drejtorin Ligjor Dan Werner, Qendra e të Drejtave të Punëtorëve, mars 2007.

<sup>494</sup> Çështja *Javier H. v. Garcia-Botello et al.*, Çështja nr. 02-CV-523S (W.D.N.Y.).

kundër ish punëdhënësve të saj, të pandehurit deklaruan falimentimin në fillim të procesit.<sup>495</sup>

Së fundmi, një ndër pengesat më të mëdha është thjesht kohëzgjatja e proceseve. Ka çështje të ndërlikuara të cilat kërkojnë vite të përfundojnë. Gjykatat janë të mbingarkuara, dhe avokatët mbrojtës shpesh janë mjeshtra në përdorimin e taktikave për të vonuar çështjet. Me kalimin e kohës dhe harresën që vjen duke u rritur, bëhet më e vështirë për paditësit për të provuar faktet që janë të nevojshme. Zvarritje të tilla janë në veçanti shumë zhgënjyese për vetë paditësit dhe i demoralizojnë ata.

### **5.8.3.3 Komete përfundimtare për dëmshpërblim në çështjet penale dhe civile**

Që prej miratimit të TVPRA-së në dhjetor të vitit 2003, janë të regjistruara shumë pak padi të ngritura sipas këtij ligji. Pjesa më e madhe e përfaqësimit ligjor në emër të viktimave të trafikimit është përqendruar në përfitimet e emigracionit. Një pjesë e madhe e organizatave të shërbimeve sociale që kanë traditë në ndihmën e viktimave, nuk mendojnë se procesi ligjor është mjet për të arritur zhdëmtimin.

Avokatët civilë do të përfitonin nga konferencat dhe seminarët për proceset civile në emër të viktimave të trafikimit, në mënyrë që të ishin në gjendje të ndanin teoritë e përgjegjesisë, të shpërndanin kopje të kërkesëpadive, si dhe të diskutonin strategjitë për proceset ligjore. Ndërkohë në *Internet* mund të krijohet një bazë qendrore të dhënash për kërkesat dhe mocionet. Përderisa qeveria financon shumë shërbime për viktimat e trafikimit, dhe ka përkrahur punën e organizatave që financohen nga Korporata e Shërbimeve Ligjore në emër të viktimave të trafikimit, dhe përderisa Manuali i Proceseve Civile (*Civil Litigation Manual*) ishte financuar nga HHS-ja, do të ishte kuptimplotë që mbështetja e qeverisë të shtrihej në këtë fushë të rëndësishme. Mjaft nga teoritë që lidhen me proceset civile në emër të viktimave të trafikimit mund të testoheshin kështu në gjykatë. Dhënia e rëndësisë më të madhe proceseve civile mund të shërbejë për tërheqjen e firmave private të avokatisë që të luajnë një rol *pro bono*, i cili është veçanërisht i rëndësishëm në çështjet ku përfshihen një numër i madh viktimash.

---

<sup>495</sup> *Woman Forced into Slavery Wins Jury Verdict Against California Couple* (Gruaja e detyruar të punojë në skllavëri fiton çështjen nga juria kundër çiftit nga shteti i Californisë), revista *Law Reporter* (Raportuesi Ligjor) (nëntor 2004).

#### 5.8.4. Zbatimi i vendimeve gjyqësore për kthimin e dëmit dhe zbatimi i vendimeve civile

Ekziston një problem i dokumentuar mirë në lidhje me mbledhjen e kthimit të urdhëruar nga gjykata për viktimat e krimit në përgjithësi. Në një studim të vitit 2005 për pesë raste të mashtrimit financiar, Zyra e Auditit të Qeverisë (*General Accounting Office* ose GAO) konstatoi se vetëm rreth 7 përqind të shumave të urdhëruara nga gjykatat për kthimin e dëmit, ishin mbledhur.<sup>496</sup> GAO-ja vuri re më tej se Njësitë e Departamentit të Drejtësisë për Proceset Gjyqësore Financiare, që janë përgjegjëse për mbledhjen e kthimit, pengoheshin nga periudhat e gjata kohore nga kryerja e veprës penale deri te vendimi përfundimtar, si dhe nga fakti se kishte pak “pasoja të dukshme negative për ata autorë të veprave penale që nuk paguanin shumat e kthimit.”<sup>497</sup> GAO-ja kishte arritur më parë në përfundimin se disa faktorë që ndikonin në rritjen e borxhit penal të prapambetur – që përbëhej nga gjoba penale si dhe nga kthim – kishin ardhur si rezultat i procedurave të pamjaftueshme të mbledhjes së borxheve.<sup>498</sup> Rritja e madhe të borxheve të papaguara filloi në vitin 1996, që është edhe viti në të cilin kthimi i dëmit sipas MVRA-së u bë i detyrueshëm.<sup>499</sup> Projektligjet në të dy dhomat e Kongresit (Dhoma e Përfaqësuesve dhe Senati) kanë si qëllim përmirësimin e mbledhjes së borxheve dhe të kthimit penal të dëmit të urdhëruara nga gjykatat.<sup>500</sup>

Nuk ka ende asnjë studim për mbledhjen e shumave të kthimit të dëmit për viktimat e trafikimit, por të dhënat sporadike sugjerojnë se viktimat e trafikimit mund të ndeshin probleme të ngjashme në marrjen në fakt të dëmeve civile dhe të kthimit penal të dëmit të urdhëruara nga gjykata. Kur viktimave në çështjen *Cadena* u dha me vendim gjykate 1 milionë USD si kthim dëmi, një prej avokatëve mbrojtës deklaroi: “Kjo është shuma fiktive. Ata [familja Cadena] nuk kanë asgjë për të dhënë sido që të jetë.”<sup>501</sup> Viktimat në çështjen *Kil-*

---

<sup>496</sup> *Court-Ordered Restitution Amounts Far Exceed Likely Collections for the Crime Victims in Selected Financial Fraud Cases* (Shuma e urdhëruar nga gjykatat për kthim i tejkalon shumë mbledhjet për viktimat e krimit në çështje të caktuara të mashtrimit financiar), GAO-05-80.

<sup>497</sup> Po aty.

<sup>498</sup> *Actions Still Needed to Address Deficiencies in Justice's Collection Processes* (Ka nevojë ende për veprime për të trajtuar mangësitë në proceset e mbledhjes nga Departamenti i Drejtësisë), GAO-04-338 (mars 2004).

<sup>499</sup> Po aty. Kthimi i dëmit në çështjet jofederale është kthimi që u duhet paguar individëve private, jo qeverisë.

<sup>500</sup> H.R. 845, Akti i Përmirësimit të Kthimit të Dëmit në Çështjet Penale të vitit 2007, depozituar në Kongres më 6 shkurt 2007, ndërmjet të tjerash, do t'u kërkonte gjykatave që të nxjerrin urdhra që kërkojnë pagimin e menjëhershëm të kthimit të plotë, do t'u kërkonte gjykatave që të nxjerrin urdhra mbrojtës për të ruajtur pasuri që janë të disponueshme për kthim, si dhe do të ndalonte përfundimin e lirimit me kusht për të dënuarit me urdhra të pashlyera për kthim. S. 973, depozituar në Kongres më 22 mars 2007, përmban dispozita të ngjashme.

<sup>501</sup> Stephanie Smith, *Women Smuggled into US Forced into Prostitution Try to Recoup \$1 M* (Gra të trafikuar në SHBA dhe të detyruara të ushtrojnë prostitucion, përpiqen të marrin 1 milion USD si zhdëmtim), gazeta *Palm Beach Daily Business Review* (8 prill 1999).

*Soo Lee* ende nuk kanë marrë as dëmshpërblimin e vendosur nga gjykata civile ose kthimin e dëmit sipas vendimit penal.

Tani që kthimi i detyrueshëm i dëmit është tipar i hetimit penal të trafikimit, do të ishte shumë e dobishme që të ekzistonte një mënyrë sistematike për të monitoruar marrjen e dëmeve nga viktimat në fakt.<sup>502</sup> Njësitë për Proceset Gjyqësore Financiare, që janë përgjegjëse për ekzekutimin e urdhrave të kthimit, duhet të japin informacion mbi nivelet e mbledhjes së dëmeve në çështjet e trafikimit. Ky informacion do të jetë me vlerë pasi niveli i mirëfilltë i mbledhjes duhet të merret parasysh në vendimin e prokurorit, nëse pranimi i fajit me marrëveshje që përfshin pagesën e menjëhershme të kthimit të dëmit për viktimat, është mënyra më e mirë për të vepruar. Pranime të tilla të fajit kanë përfshirë shumatat e mëdha si kthim të dëmit.<sup>503</sup>

Njohuritë në lidhje me nivelin e ekzekutimit të urdhrave të kthimit gjithashtu duhet t'i nxisë prokurorët që të kërkojnë sekuestrimin e pasurive përpara ngritjes së akuzës, si dhe të sigurojnë se pasuritë e sekuestruara u janë vënë në dispozicion viktimave nëpërmjet procedimeve restauruese për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive.<sup>504</sup> Kjo do të shmangë problemin e vënë re në studimin e GAO-s, sipas të cilit autorët e veprave penale i kalojnë pasuritë në emër të anëtarëve të familjes ose të personave të tjerë, ose i transferojnë ato në llogari jashtë vendit.

### **5.8.5 Sekuestrimi i pasurisë**

TVPA-ja parashikon konfiskimin penal dhe civil të pasurive të luajshme dhe të paluajshme që lehtësojnë veprën penale të trafikimit, ose që janë produkt i një veprë trafikimi.<sup>505</sup> Konfiskimi është instrument vetëm i qeverisë, dhe pasuritë e konfiskuara kalojnë në pronësi të qeverisë, por ka procedura të caktuara për t'ua kaluar ato viktimave.

---

<sup>502</sup> Përderisa viktimat mund të rikuperojnë gjithashtu zhdëmtim me anë të çështjes civile, do të ishte e dobishme gjithashtu që të mblidhej informacion mbi suksesin e marrjes së parave të dhëna si dëmshpërblim. Nëse shkalla e suksesit është e ulët, ajo mund t'i bindë palët paditëse që të bien në ujdi me të paditurit. Por për shkak se ky proces është jashtë përgjegjësisë së qeverisë së Shteteve të Bashkuara, varet tek avokatët individë të mbledhin informacion dhe ta ndajnë atë me të tjerët.

<sup>503</sup> Shih çështjet *Doe v. Reddy* dhe *US v. Boehm*; shih gjithashtu *US v. Ibrahim* (i pandehuri pranoi fajin për punë të detyruar, shërbime të detyruara dhe bashkëpunim për këto veprime, dhe ra dakord si pjesë e marrëveshjes për t'u paguar 78 000 USD si zhdëmtim për viktimat përpara dhënies së dënimit); çështja *US v. Aronov* (E.D. Mich. 2005) (është rënë dakord si pjesë e pranimit të fajit për të dhënë të paktën 537 043 USD zhdëmtimi).

<sup>504</sup> E diskutuar në pjesën 5.8.5 më poshtë (Sekuestrimi i pasurisë).

<sup>505</sup> 18 U.S.C. § 1594 (b); për më tepër, § 1594 (c) përmban dispozita për konfiskimin civil.

Në procedimet për konfiskimin, gjykata është e detyruar që të përcaktojë nëse qeveria ka provuar lidhjen e nevojshme ndërmjet pasurisë dhe veprës penale. Kërkesat për konfiskim shqyrtohen nga gjykata sipas standardit të “më i mundshmit” (d.m.th., është më e mundshme që pasuritë janë produkt i krimit). Për shkak se konfiskimi është pjesë e dënimit për kryerjen e veprës penale, është e domosdoshme që i pandehuri të jetë fajtor në çështjen penale, si dhe që ai të dënohet.

Në pjesën më të madhe të rasteve, pasuritë subjekt sekuestrimi mbeten në zotërim të të pandehurit deri në momentin kur gjykata lëshon urdhër paraprak konfiskimi.<sup>506</sup> Gjithsesi, qeveria mund të kërkojë nxjerrjen e urdhrit për bllokimin e pasurisë edhe përpara seancës gjyqësore, ose me anë të ngritjes së akuzës për kryerjen e veprës penale për të cilën konfiskimi mund të kërkohej, ose edhe përpara ngritjes së akuzës, nëse gjykata vendos se ka “mundësi të lartë” që padia penale e qeverisë do të ketë sukses dhe që mosnxjerrja e urdhrit do të çonte në “shkatërrimin” e pasurisë ose “zhdukjen [e saj] nga juridiksioni i gjykatës,” ose në ndonjë mënyrë tjetër do të bëhej e padisponueshme për konfiskim.<sup>507</sup> Në rrethana të caktuara mund të lëshohet urdhri i përkohshëm bllokimi i pasurive, pa lajmëruar palët ose pa u dhënë mundësinë që të dëgjohen.<sup>508</sup>

Pasi konfiskohet pasuria, ka tri procedura me anë të të cilave ajo mund t’u transferohet viktimave: (1) me anë të peticioni për kthim të dëmit që depozitohet nga viktimia pranë Seksionit të Konfiskimit të Pasurive dhe të Pastrimit të Parave të Departamentit të Drejtësisë; (2) më anë të kërkesës për kthim të dëmit të depozituar nga prokurori federal në emër të viktimës; dhe (3) në përfundim të procedurave të konfiskimit përpara se gjykata të nxjerrë urdhër përfundimtar konfiskimi, me nxjerrjen, në këtë rast, të urdhrit në favor të viktimës.<sup>509</sup>

Në procese penale ndaj të pandehurve për trafikim, konfiskimi i pasurive është përfshirë në disa raste si pjesë e marrëveshjeve në lidhje me pranimin e fajit. Për shembull, në çështjen *US v. Zavala and Ibanez*, çifti pranoi faj për shfrytëzim për punë të detyruar të kryer në bashkëpunim si dhe për shkelje të ligjeve të emigracionit. Si pjesë e marrëveshjes, ata ranë dakord që të konfiskohet shtëpia e tyre, me vlerë 220 000 USD (162 499 EUR), si dhe 30

---

<sup>506</sup> Rregulli Federal i Procedurës Penale 32.3 trajton konfiskimin penal. Rregulli 32.2(b) parashikon se gjykata detyrohet të nxjerrë urdhër paraprak konfiskimi sapo të jetë e mundur praktikisht pas vendimit të fajësisë ose të pranimit të fajit, dhe se nxjerrja e urdhrit paraprak e autorizon Prokurorin e Përgjithshëm që të sekuestrojë pasuritë e caktuara. Pas sekuestrimit, mund të mbahet procesi anësor për interesat e palëve të treta mbi pasuritë në fjalë.

<sup>507</sup> 21 U.S.C. § 585(e)(1)(B)(i).

<sup>508</sup> 21 U.S.C. § 853(e)(2).

<sup>509</sup> “Termi viktimë i referohet personit që ka pësuar dëm material si rezultat i drejtpërdrejtë i kryerjes së një vepre penale nga e cila rrjedh konfiskimi.” 28 C.F.R. § 9.2(v).

000 USD në të holla (22 159 EUR). I pandehuri kryesor gjithashtu u dënua me 15 vjet heqje lirie.<sup>510</sup> Në çështjen *US v. Maksimekos*, një i pandehur i akuzuar për kryerjen e veprës penale të skllavërimin në bashkëpunim, pranoi fajin dhe ra dakord t'i konfiskoheshin pasuritë me vlerë mbi 500 000 USD (369 317 EUR).<sup>511</sup>

Megjithëse është politika e qeverisë që pasuritë e konfiskuara të përdoren për të shlyer urdhrat e kthimit të dëmit në çështjet e trafikimit, procedurat janë përdorur shumë pak për këtë qëllim.<sup>512</sup> Arsyeja për këtë gjë nuk dihet. Një shkak mund të jetë se ka pasur pasuri të mjaftueshme për të paguar kthimin e dëmit pa qenë nevoja që të përdoren pasuritë e konfiskuara, se prokurorët ishin neglizhentë dhe nuk sekuestruan pasuritë, ose se të pandehurit nuk patën pasuri as për t'u sekuestruar dhe as për t'i kthyer. Në shembullin që mund të jetë i pari i kësaj natyre, në çështjen *Maksimenko*, prokurorët morën urdhër për konfiskim civil prej 570 000 USD dhe do të paraqisnin kërkesë për kthim të dëmit, në mënyrë që fondet dhe pasuritë e konfiskuara të mund t'u jepeshin viktimave.<sup>513</sup> Më 25 qershor 2007, i pandehuri kryesor Aleksandër Maksimenko u dënua me 14 vjet heqje lirie dhe me 1.5 milionë USD si kthim dëmi për rolin e tij si drejtues i rrjetit të bashkëpunëtorëve.<sup>514</sup> Në dënimin e saj, gjykata vendosi që më shumë se 500 000 USD në të holla, të sekuestruara nga shtëpia e Maksimenkos dhe nga llogaritë bankare, si dhe bizhuteritë me vlerë rreth 30 000 USD të përdroreshin për të shlyer pjesërisht urdhrin e kthimit.

Përveç konfiskimit të pasurive, palët private edhe mund t'u drejtohen disa procedurave me qëllim parandalimin e shpërndarjes së pasurive përpara përfundimit të çështjes civile. Këto procedura përcaktohen nga ligjet e secilit prej 50 shteteve. Pjesa më e madhe e shteteve kanë legjislacion që autorizon sekuestrimin e përkohshëm përpara gjyqit kur paditësi akuzon të pandehurin për dëme financiare. Gjithsesi, shtetet i kufizojnë mundësinë e sekuestrimit paraprake vetëm për çështje të caktuara, p.sh. padi për kontratat dhe asnjë padi tjetër; shtete

---

<sup>510</sup> *Suffolk Country Woman Sentenced for her Role in Forced Labor and Alien Smuggling Scheme* (Gruaja nga rrethi Suffolk dënohet për rolin e saj në skemën e punës së detyruar dhe të trafikimit të të huajve), Njoftim për Shtyp i Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara e datës 9 nëntor 2005.

<sup>511</sup> *Attorney General's Annual Report on US Government Activities to Combat Trafficking in Persons* (Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për aktivitetet e qeverisë së Shteteve të Bashkuara në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore) (FY 2005).

<sup>512</sup> *E-mail*-i nga Seksioni i Konfiskimit të Pasurive nga Pastrimi i Parave, Departamenti Amerikan i Drejtësisë, 24 prill 2007.

<sup>513</sup> *E-mail*-i nga Peter Ziedas, prokuror asistent i Shteteve të Bashkuara, datë 27 prill 2006.

<sup>514</sup> *Livonia Man Sentenced to 14 Years in Prison and \$1.5 Million in Restitution for Forcing Eastern European Women to Work at Detroit Area Strip Clubs* (Burri nga qyteti i Livonias dënohet me 14 vjet heqje lirie dhe 1.5 milionë USD për dëmshpërblim për gratë nga Evropa Lindore të detyruara të punojnë në klubet e striptizës në zonën e qytetit Detroitit), Njoftim për Shtyp i Zyrës së Prokurorit të Shteteve të Bashkuara, 25 qershor 2007.

të tjera kanë kufizime që lidhen me vendbanimin e të pandehurit.<sup>545</sup> Pasuritë që gjenden jashtë shtetit nuk mund të sekuestrohen paraprakisht. Si rezultat, në proceset civile ka pasur përdorim shumë të vogël të sekuestrimit paraprak në emër të viktimave të trafikimit, si dhe në lidhje me të drejtat e punëtorëve në përgjithësi.

## 5.8.6 Ndhma për viktimat

### 5.8.6.1 Të drejtat e të gjitha viktimave të krimit

Viktima e krimit sipas ligjit ka disa garanci në lidhje me të drejtën për t'u dëgjuar, për t'u informuar në mënyrë të vazhdueshme për të qenë e sigurt dhe për të pasur siguri. Akti i të Drejtave të Viktimave të Krimit (CVRA) parashikon disa të drejta specifike për viktimat e krimit si dhe mjetet për t'i zbatuar ato.

CVRA-ja parashikon që viktima krimi ka:

- “ (1) Të drejtën për t'u mbrojtur në mënyrë të arsyeshme nga i akuzuari;
- (2) Të drejtën për njoftim të arsyeshëm, të saktë dhe në kohë të seancave gjyqësore publike, si dhe të çdo procesi lidhur me lirimin me kusht, që lidhet me krimin ose lirim ose largim të të akuzuarit;
- (3) Të drejtën për të mos u përjashtuar nga proceset gjyqësore publike, me përjashtim të rasteve kur gjykata, pas marrjes së provave të qarta dhe bindëse, përcakton se dëshmia e viktimës do të ndikohej materialisht, nëse viktima do të dëgjonte dëshmi të tjera në atë proces;
- (4) Të drejtën për t'u dëgjuar në mënyrë të arsyeshme në çdo procedim publik në gjykatën e shkallës së parë në lidhje me lirimin, pranimin e fajit, dënimin ose çdo procese të lidhur me lirimin me kusht;
- (5) Të drejtën e arsyeshme që të konsultohet me avokatin e qeverisë në çështjen përkatëse;
- (6) Të drejtën e kthimit të plotë dhe në kohë, siç parashikohet në ligj;
- (7) Të drejtën e zhvillimit të seancave gjyqësore pa vonesa të paarsyeshme;

---

<sup>545</sup> Shih Rhonda Wasserman, *Equity Renewed: Preliminary Injunctions to Secure Potential Money Judgments* (Rinovimi i drejtësisë: Masat paraprake për sigurimin e vendimeve të mundshme të dëmshpërblimit), 67 Wash. L. Rev. 257 (1992) (që përshkruan kufizimet gjeografike si dhe kufizimet lëndore për sekuestrim); Lars E. Johansson, *The Mareva Injunction: A Remedy in the Pursuit of the Errant Defendant* (Masa sigurimi Mareva: Instrument në ndjekje të të paditurit të arratur), 31 U.C. Davis L. Rev. 1091 (1998) (përshkrim i hezitimit të gjykatave amerikane për të dhënë masa paraprake që lehtësojnë paditësit dhe i “boshllëkut” në ligjet amerikane për sekuestrimin e pasurive përpara vendimit përfundimtar të gjykatës).



(8) Të drejtën për t'u trajtuar me drejtësi, duke respektuar dinjitetin dhe jetën private të saj.”<sup>516</sup>

Viktimat duhet të informohen nga zyrtarët përgjegjës të caktuar – konkretisht, oficerë të zbatimit të ligjeve, gjatë fazës së hetimeve, dhe prokurorët, pas ngritjes së akuzave në gjykatë – rreth këtyre të drejtave si dhe vendeve ku mund të marrin shërbime të menjëhershme mjekësore dhe sociale, disponueshmërinë e kthimit të dëmit ose të ndonjë mase lehtësuese tjetër, duke përfshirë programet për dëmshpërblimin e viktimave të krimit nga të cilat mund të përfitojë viktimat, si dhe programe publike dhe private që janë të disponueshme për këshillim, trajtim dhe mbështetje të tjera. Viktimat duhet të njoftohen gjithashtu për mbrojtjen ligjore dhe masat mbrojtëse (duke përfshirë urdhrat e mbrojtjes), që janë të disponueshme për të parandaluar kërcënimet dhe ngacmimet.<sup>517</sup>

Çdo nëpunës i Departamentit të Drejtësisë detyrohet t'i nënshtrohet trajnimit të detyrueshëm për të drejtat e viktimave. Për mosrespektimin e qëllimshëm ose të tejskajshëm të dispozitave të ligjeve federale që lidhen me trajtimin e viktimave të krimit, merren masa disiplinore, duke përfshirë pezullimin ose shkarkimin nga puna.<sup>518</sup> Në maj të vitit 2005, Prokurori i Përgjithshëm ka nxjerrë udhëzime për Aktin e Drejtësisë për të Gjithë.<sup>519</sup>

#### **5.8.6.2 Viktimat fëmijë**

Ka një sërë dispozitash të veçanta që lidhen me viktimat fëmijë dhe çështje të tilla si mbrojtja e jetës private të tyre dhe identitetit. Gjykata mund të caktojë kujdestar *ad litem* (për çështjen në gjykim) për të mbrojtur interesat më të larta të fëmijës që ishte viktimë krimi, ose dëshmitar në një krim ku përfshihet abuzime ose shfrytëzimi.<sup>520</sup> Kujdestari *ad litem* është kujdestar ligjor i caktuar për palën që është e paaftë për të vepruar, si për shembull një fëmijë. Sipas Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurorët duhet të shqyrtojnë gjithashtu nëse është e përshtatshme, që të kërkohet caktimi i kujdestarit *ad litem* në rastet kur viktimat e krimit ose dëshmitari është fëmijë.

Në disa raste të trafikimit të fëmijëve, zyrat e prokurorëve kanë gjetur strehim afatgjatë, këshillim, arsimim dhe trajnim në punë.

---

<sup>516</sup> 18 U.S.C. § 3771 (a) (“Të Drejtat e Viktimave të Krimit”).

<sup>517</sup> 42 U.S.C. § 10607(b) dhe (c) (Identifikimi i Viktimave dhe Përshkrimet e Shërbimeve).

<sup>518</sup> Shih 18 U.S.C. § 3771(f)(1) dhe (2)(C).

<sup>519</sup> Shih *Attorney General Guidelines for Victim and Witness Assistance* (Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm për Viktimat dhe Ndihmën e Dëshmitarëve) në [http://www.justice.gov/olp/pdf/ag\\_guidelines.pdf](http://www.justice.gov/olp/pdf/ag_guidelines.pdf) .

<sup>520</sup> 18 U.S.C. § 3509(h)(1).

### 5.8.6.3 Të drejtat e viktimave të trafikimit

Përveç të drejtave të përgjithshme për të gjitha llojet e viktimave, të cilat u diskutuan më lart, individët që janë vërtetuar nga qeveria federale si viktimat e formës së rëndë trafikimi kanë disa të drejta të posaçme. “Forma e rëndë e trafikimit të qenieve njerëzore” përkufizohet në aktet ligjore si:

“(A). Trafikimi seksual ku një akt seksual tregtar është realizuar me dhunë, mashtrim, ose shtrëngim ose në të cilin personi i detyruar për të kryer aktin, nuk ka mbushur 18 vjeç; ose (B) rekrutimi, dhënie strehe, transportimi, dhënia ose mbajtja e një personi për punë ose shërbime, nëpërmjet përdorimit të dhunës, mashtrimit ose shtrëngimit për qëllime të nënshtrimit për shërbimet e detyruara, zgjedhën, heqja e lirisë për shkakun e borxheve (*debt bondage*) ose skllavëri.”<sup>521</sup>

Kështu procesi i vërtetimit bëhet një pengesë e madhe për punëtorët e shfrytëzuar, në veçanti për sa i përket statusit ligjor, autorizimit të punës si dhe mundësitë për të përfituar nga shërbimet ligjore, megjithëse viktimat e krimit të cilat nuk vërtetohen si të tilla kanë ende të drejta për përfitimet standarde të viktimave. Viktimat e trafikimit të vërtetuara si të tilla kanë të drejtë të përfitojnë shërbime të posaçme, pavarësisht nga ngritja eventuale të padisë penale ose jo, ose nga fakti nëse paditë e ngritura përfshijnë akuza trafikimi ose jo. Disa shërbime, gjithsesi, mund të mos jenë në dispozicion të viktimave që janë nënshtrimit amerikanë, pasi ato lidhen vetëm me statusin e emigracionit. Shërbimet dhe të drejtat janë si më poshtë:

- (1) Mosndalimi – deri në masën e mundshme dhe të lejuar nga ligji, viktimat e formës së rëndë të trafikimit nuk duhet të mbahen të ndaluara në mënyrë formale;<sup>522</sup>
- (2) Informacioni – viktimat e trafikimit duhet të marrin informacion rreth shërbimeve ligjore, përfitimeve të emigracionit, organizatave të shërbimeve shoqërore, programet e ndihmës së viktimave dhe të dëmshpërblimit të tyre, kthimin e dëmit dhe shërbimet mjekësore të disponueshme;<sup>523</sup>
- (3) Shërbimet e përkthimit – viktimat e trafikimit do të kenë akses të arsyeshëm për shërbimet e përkthimit me shkrim/gojë nëse nuk janë në gjendje të komunikojnë në anglisht ose janë analfabete në gjuhën e tyre;<sup>524</sup>

---

<sup>521</sup> 22 U.S.C. § 7102(8).

<sup>522</sup> Shih 28 C.F.R. § 1100.31. Shih në përgjithësi Udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm, f. 68-72.

<sup>523</sup> Shih 28 C.F.R. § 1100.33.

<sup>524</sup> Shih 28 C.F.R. § 1100.33.

- (4) Përfitimet e emigracionit – nëse viktima vërtetohet si viktimë e formës së rëndë trafikimi dhe plotëson kërkesat e tjera të përcaktuara më poshtë, ajo ka të drejtë të marrë dy forma lehtësimi për sa i përket emigracionit: (1) qëndrim të vazhdueshëm (*continued presence*)<sup>525</sup> dhe (2) statusin “T” joemigrant (që shpesh quhet si “Viza T.”)
- Qëndrim i vazhdueshëm” është termi i veçantë që përdoret për t’i dhënë viktimës së trafikimit status të përkohshëm ligjor në Shtetet e Bashkuara, edhe në rast se personi ka hyrë në vend në mënyrë të paligjshme. Qëndrimi i vazhdueshëm u jepet viktimave të formës së rëndë të trafikimit, të cilat janë dëshmitarë të mundshëm në hetimin ose ndjekjen penale. Kur individ i merr të drejtën e qëndrimit të vazhdueshëm, merr gjithashtu autorizim pune. Është e detyrueshme, që qëndrimi i vazhdueshëm të kërkohet nga punonjësi i organeve të zbatimit të ligjeve.
  - Viza T është vizë jo për emigrantët që i jepet viktimës së formës së rëndë trafikimi që ka përmbushur kërkesat e arsyeshme për ndihmë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale për trafikimin dhe e cila do të pësonte vuajtje të skajshme në rast se do të largohej.<sup>526</sup> Pas tri vitesh qëndrimi të vazhdueshëm fizik në Shtetet e Bashkuara me status jo-emigrant T, mbajtës i vizës T mund të aplikojë për qëndrim të përhershëm. Që të përfitojë rregullimin e statusit si banor i përhershëm i ligjshëm, aplikuesi duhet të japë prova se ka pasur karakter të lartë moral dhe, ose ka plotësuar çdo kërkesë të arsyeshme për të dhënë ndihmë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale të veprës së trafikimit, ose se largimi nga Shtetet e Bashkuara do të sillte si pasojë vuajtje të skajshme, duke përfshirë dëme të rënda dhe të pazakonta me largim nga Shtetet e Bashkuara. Viktima mund të aplikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë për vizën T dhe, pas tri vitesh, për rregullimin e statusit. Mbajtësit e vizës T joemigrantë dhe aplikuesit për rregullimin e statusit kanë të drejtë të marrin autorizim për punë.

Numri i njerëzve që nuk janë shtetas që mund të marrin viza T çdo vit është 5,000 në maksimum, dhe numri i njerëzve me viza T joemigrantë të cilëve

---

<sup>525</sup> 22 U.S.C. § 7105(c)(3).

<sup>526</sup> Viktimave të mitur nuk u kërkohet të plotësojnë kërkesat e bashkëpunimit me organet e zbatimit të ligjeve, dhe as viktimave të rritura që nuk janë në gjendje të ndihmojnë si rezultat i traumave psikologjike dhe fizike.

mund të jepet rregullimi i statusit çdo vit, është gjithashtu 5,000 në maksimum. Shifrat maksimale nuk përfshijnë bashkëshortët, fëmijët, vëllezërit dhe motrat ose prindërit e viktimave, në qoftë se, sipas ligjit, ata mund të përfitojnë nga programi. Në vitin financiar 2005, ka pasur 160 kërkesa për qëndrim të vazhdueshëm nga të cilat u miratuan 158. Gjithashtu, në vitin financiar 2005, për viza T aplikuan 229 individë dhe prej tyre u miratuan 112 aplikime.<sup>527</sup>

- (5) Përfitimet në natyrë të përfitimeve për refugjatët – viktimat e formës së rëndë trafikimi ka të drejtë për përfitimet që secili shtet u ofron refugjatëve. Përfitime të tilla përfshijnë ndihmë në të holla, ndihmë mjekësore, kuponët që lejojnë marrjen e ushqimeve falas, dhe strehim.<sup>528</sup>
- (6) Korporata e Shërbimeve Ligjore (LSC) – LSC është shoqëri private, jofitimprurëse e krijuar nga Kongresi, e cila financo programet e ndihmës ligjore në të gjithë vendin për të ndihmuar të varfrit. TVPA-ja ngarkon LSC-në të ofrojë ndihmë ligjore për viktimat e trafikimit, pavarësisht nga statusi i emigracionit. Organizatat e financuara nga LSC-ja mund të ndihmojnë viktimat duke u kërkuar vërtetim të statusit dhe përfitime të tjera të emigracionit, dhe mund të ngrenë padi civile në emër të tyre. Nëse viktimat i mohohet përfundimisht vërtetimi i statusit, gjithsesi, përfaqësimi ndërpritet. TVPRA-ja ngarkon LSC-në që të ofrojë ndihmë

---

<sup>527</sup> *Attorney General's Annual Report to Congress* (Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për Kongresin) f. 11-12 (FY 2005). Në raport thuhet se numri i lartë i refuzimeve për vitin financiar 2005 ka ardhur si rezultat i një çështjeje, në të cilën 170 aplikantët u refuzuan sepse "ishte përcaktuar se aplikantët nuk ishin viktimat e trafikimit siç ishte përcaktuar në TVPA-në." Programi i TVPA-së për lehtësimin e emigracionit ka qenë epiqendra e kritikave të shumta nga OJF-të që punojnë kundër trafikimit, dhe nga komentatorët që theksojnë se kërkesat e dyfishta të të qenit viktimë e një "forme të rëndë trafikimi" dhe bashkëpunimi me agjencitë e zbatimit të ligjeve nuk i mbrojnë ashtu siç duhet viktimat. Shih *Note, Remediating the Injustices of Human Trafficking through Tort Law* (Shënim, Ndreqja e padrejtësive të trafikimit të qenieve njerëzore nëpërmjet së drejtës jashtëkontraktore), 119 *Harv. L. Rev.* 2574, 2581 (2006), Kathleen Kim dhe Kusia Hreshchshyn, *Human Trafficking Private Right of Action: Civil Rights for Trafficked Persons in the United States* (E drejta për padinë civile në rastet e trafikimit: Të drejtat qytetare për personat e trafikuar në Shtetet e Bashkuara, 16 *Hastings Women's L. J.* 1, 14 – 15 (Dimër 2004).

<sup>528</sup> Një OJF vë në dukje se këto përfitime, të cilat ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin, janë mjaft modeste. "Në shtetin e Californisë, për shembull, viktimat marrin ndihmë si refugjatë për tetë muaj. Kjo ndihmë përbëhet prej 300 USD në dorë në muaj si ndihmë, 120 USD në muaj për kuponat me të cilat blihet ushqimi, si dhe shërbime mjekësore gjatë kësaj periudhe." *Hidden Slaves: Forced Labor in the United States* (Sklevërit e fshehur: Puna e detyruar në Shtetet e Bashkuara), 23 *Berkeley J. Int'l L.* 47, shënim 83.

ligjore edhe për anëtarët e familjes.<sup>529</sup> Në vitin 2005, 11 organizatat e financuara nga LSC-ja ndihmuan 141 viktimat trafikimi.<sup>530</sup>

Nëpërmjet Departamentit të Shëndetësisë dhe Shërbimeve Njerëzore (HHS), qeveria federale financoi organizatat joqeveritare që u ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta viktimave të trafikimit si edhe organizatave që ofrojnë trajnim dhe asistencë teknike. (Nëpërmjet fondit federal është financuar pjesërisht Manuali i Proceseve Civile në mbrojtje të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore). Në vitin 2005, iu dhanë rreth 3.2 milionë USD organizatave që ofronin shërbime të drejtpërdrejta.<sup>531</sup> Gjithashtu, në vitin 2005 Zyra e Departamentit të Drejtësisë për Viktimat e Krimit financoi 25 projekte të ndryshme të shërbimeve të drejtpërdrejta për viktimat, si dhe një projekt që u ofroi asistencë teknike organizatave të shërbimeve dhe një program që u përqendrua në ndërtimin e strehëzave për viktimat e trafikimit.

Të gjitha këto përfitime për viktimat e trafikimit varen nga vërtetimi i statusit që qeveria i jep viktimës së formës së rëndë të trafikimit. Për të marrë statusin, jo vetëm që duhet të jetë viktimë e një prej veprave penale të përcaktuara në aktet ligjore, por në të njëjtën kohë viktimat duhet të jetë “e gatshme që të ndihmojë në çdo mënyrë të arsyeshme në hetimin dhe ndjekjen” e veprës së kryer, dhe në të njëjtën kohë ose duhet të ketë aplikuar për vizën T, ose duhet të jetë person “qëndrimi i vazhdueshëm” i të cilit është i nevojshëm për ndjekjen penale.<sup>532</sup> Pa vërtetim të statusit, viktimat pa dokumente nuk ka asnjë të drejtë ligjore të rrijë në Shtetet e Bashkuara, dhe as nuk ka autorizim për të punuar. (Shënim: viktimat e mitura nuk kërkohen të bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjeve për marrjen e letrës nga HHS-ja, që lejon atyre të marrin të gjitha përfitimet dhe shërbimet që bëhen të disponueshme nëpërmjet vërtetimit të statusit).

Kështu, procesi i vërtetimit të statusit paraqet dy pengesa të menjëhershme dhe të dukshme. Së pari, personi mund të jetë punëtor i shfrytëzuar dhe i abuzuar, i papaguar ose i nënpaguar dhe i keqtrajtuar rëndë, dhe megjithatë veprimet në fjalë nuk shkelin asnjë prej ligjeve penale të trafikimit. Së dyti, personi mund ketë aq shumë frikë në lidhje me organet zbatuese të ligjeve ose me trafikantin, se nuk do të jetë i gatshëm që të bashkëpunojë gjatë hetimit dhe ndjekjes penale të çështjes. Avokatët kanë vënë në dukje, se “nga perspektiva e personave të

---

<sup>529</sup> “Ri-autorizimi i vitit 2003 e zgjeron përfaqësimin e lejuar nga ata që marrin financime nga LSC-ja për të përfshirë anëtarë të familjes së viktimave të trafikimit.” Letër e Programit të LSC-së 05-2 (6 tetor 2005).

<sup>530</sup> Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për Kongresin, f. 10 (FY 2005).

<sup>531</sup> Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm për Kongresin, f. 7 (FY 2005). Nuk përfshihen shumatat e dhëna në vitin financiar (FY) 2006 për organizatat me qëllim marrëdhëniet me publikun. Po aty, f. 37.

<sup>532</sup> 22 U.S.C. § 7102(E)(i).

trafikuar, duke qenë se ligji vë theksin tek ndjekja penale, përfitimet varen nga proceset e prokurorisë dhe në këtë mënyrë krijojnë pengesa të ndjeshme për zhdëmtimin e plotë.”<sup>533</sup>

Për viktimat e shfrytëzimit të punës që nuk përbën veprë penale të trafikimit, nuk do të ketë përfitime sipas TVPRA-së, nuk do të ketë status qëndrimi të qëndrueshëm dhe nuk do të ketë as mbështetje ligjore nga organizatat e ndihmës ligjore që financohen nga qeveria. Çështjet që mund t’u përkasin, por nuk u përkasin qartë këtyre kategorive, mund të shpërfillen. Gjithsesi, në Shtetet e Bashkuara, ka disa organizata që u janë kushtuar të drejtave të punëtorëve dhe të emigrantëve, dhe organizata të tilla prej kohësh kanë përfaqësuar punëtorët emigrantë pa dokumente, ndonjëherë duke fituar beteja të rëndësishme gjyqësore.

Mungesa e përfitimeve sipas regjimit të TVPA-së nuk do të thotë domosdoshmërisht se punëtori e ka të pamundur që të fitojë dëmshpërblimin nëpërmjet padisë civile, por është e qartë se sfidat janë shumë më të mëdha.

### **5.8.7 Përfundime për Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

Në Shtetet e Bashkuara, ka sistem ligjor të zhvilluar mirë, i cili parashikon si dëmet penale si dhe dëmet civile. Për më tepër, skemat shtetërore të dëmshpërblimit rimburojnë të gjitha viktimat e krimit për shpenzimet e tyre vetjake të paguara nga ato në lidhje me veprën penale. Kështu që, viktimat e trafikimit ka të paktën mundësi për të marrë të ardhurat e humbura, ose nëpërmjet kthimit penal të dëmit ose nëpërmjet dëmshpërblimit civil, si dhe dëmshpërblim për dhimbjen dhe vuajtjen emocionale, dhe gjithashtu dëmet ndëshkuese që tejkalojnë dëmet e pësuar në fakt (*punitive damages*), të cilat kanë si qëllim shmangien e veprimeve shumë të rënda në të ardhmen. Megjithatë e drejta individuale për të ngritur padi sipas TVPRA-së është paprovuar, avokatët civile tashmë kanë ngritur padi kundër trafikantëve, duke përdorur shumë teori ligjore, dhe kanë fituar çështje të rëndësishme gjyqësore me dëmshpërblim të mëdha të urdhëruara me vendimet e gjykatës.

Tani që ka një shkak tjetër për të ngritur padi civile në rastin e kryerjes së veprës penale të trafikimit, e drejta civile, me çështjet gjyqësore të saj, duhet të zhvillojë substancën e të drejtave të mbrojtura nga këto ligje penale. Në një kontekst analog, çështjet sipas ligjit civil “Mohimi i të Drejtave”<sup>534</sup> kontribuan në zhvillimin e së drejtës sipas ligjit penal shoqëruar “Mohimi i të Drejtave duke Keqpërdorur Ligjit,”<sup>535</sup> dhe gjykatat shpesh nxjerrin shembuj nga

---

<sup>533</sup> Kathleen Kim dhe Kusia Hreshchyshyn, *Human Trafficking Private Right of Action* (E drejta për padinë civile në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore), 16 *Hastings Women’s L. J.*, f. 14.

<sup>534</sup> 42 U.S.C. § 1983. Paditë referohen shpesh si “paditë sipas § 1983” (“§ 1983 suits”).

<sup>535</sup> 18 U.S.C. § 242.

çështjet civile për të kuptuar dhe për të trajtuar më mirë çështjet penale. Për shkak se juristët civilë mund të jenë më të prirur në zgjerimin e koncepteve të tyre – si në lidhje me atë çfarë përbën punën e detyruar ose trafikimin për qëllime shfrytëzimi seksual, si dhe në lidhje me përcaktimin e njerëzve që mbajnë përgjegjësisë kundrejt viktimës/paditësit – në fund të fundit, çështjet civile mund të zgjerojnë fushën e përgjegjësisë penale. Me fjalë të tjera, në një çështje penale trafikimi, ka mundësi që gjykata të marrë parasysh faktin se situata e ngjashme ishte baza e konstatimit të përgjegjësisë sipas legjislacionit civil të trafikimit. Me analogji, gjykata mund të arsyetojë se veprimet që përbëjnë “trafikim” në të drejtën civile, përbëjnë dhe “trafikim” sipas së drejtës penale. Për shkak të faktit se në krahasim me prokurorët, avokatët civilë shpesh janë më të guximshëm, paditë e tyre do të ndihmojnë në përcaktimin e koncepteve ligjore të trafikimit.

### **5.8.8 Praktikrat e mira në Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

- Kthimi i dëmit (dëmshpërblimi) është i detyrueshëm për të gjitha viktimat e krimeve të dhunshme dhe të gjitha viktimat e veprave të trafikimit, pavarësisht nga fakti nëse vepra e trafikimit plotëson përkufizimin e krimit të dhunshëm;
- Skemat shtetërore të dëmshpërblimit ndihmojnë viktimat e krimit që kanë pësuar humbje materiale, pa kufizime në bazë të nënshtetësisë ose statusit ligjor dhe pa qenë i nevojshëm identifikimi apo ndalimi i të pandehurit. Këto skema ofrojnë gjithashtu financim për raste urgjente.
- Në nivelin administrativ, Departamenti i Punës monitoron punëdhënësit në zbatimin e legjislacionit mbi të drejtat e punëtorëve, si dhe mund të vendosë gjopa dhe t'u sigurojë punëtorëve pagesën e pagave të prapambetura. Komisioni për Mundësi të Barabarta për Punësim (EEOC) kryen një funksion të ngjashëm në lidhje me legjislacionin për të drejtat civile;
- TVPRA-ja parashikon një shkak të shprehur për ngritjen e padisë civile. Megjithëse dispozita për dëmet është e papërcaktuar, mund të mendohet që ajo do të shtjellohet mbi bazën e çështjeve gjyqësore të vendosura sipas FLSA-së dhe sipas ligjeve të të drejtave qytetare që mundësojnë dëmshpërblim për pagat e papaguara, dhimbjen dhe vuajtjet si dhe dëmet ndëshkuese shtesë, tarifat e avokatëve, dhe shpenzimet gjyqësore. Me zhvillimin e jurisprudencës me vendimet gjyqësore sipas TVPRA-së, gjykatat do të ndihmohen gjithashtu në vlerësimin e ndjekjeve penale për trafikimin.

- Qeveria federale financon Korporatën e Shërbimeve Ligjore, e cila, nga ana e saj financon disa organizata për ndihmë ligjore, që kanë ndihmuar viktimat e trafikimit;
- Viktimat e trafikimit përfitojnë si rezultat i lëvizjes së fortë për të drejtat e viktimave dhe të kulturës për respektimin e të gjitha viktimave të krimit. Megjithëse viktimat nuk janë palë në procesin penal, ato kanë të drejta ligjore dhe mbrojtjen sipas ligjit;
- Zbatimi i detyrave në lidhje me viktimat të zyrtarëve përgjegjës, ku përfshihen strukturat e zbatimit të ligjeve, prokurorët dhe gjykatat, mund të kërkohet në gjykatë nga viktimat, në mënyrë që të garantohet se të drejtat e tyre nuk shpërfillen;
- Shoqëria civile është shumë aktive dhe janë shumëfishuar OJF-të që ofrojnë shërbime, duke përfshirë përfaqësim ligjor, për viktimat e trafikimit. Kjo do të thotë që është duke u rritur numri i padive civile që ngrihen ndaj trafikantëve; dhe
- TVPA-ja krijon një regjim vizash që u lejon viktimave të vërtetuara të trafikimit të kenë statusin e qëndrueshëm për qëndrim, autorizim për punë dhe mundësi të aplikojnë për qëndrim të përhershëm.



## 6. Përfundime dhe Rekomandime

E drejta për dëmshpërblim përbëhet kryesisht nga e drejta për të marrë shpërblim nga autori i veprës penale, që nënkupton se shteti është i detyruar që të sigurojë se ka mekanizma ligjore dhe procedurale për të ndjekur padi dhe për t'i zbatuar vendimet eventuale të gjykatave për dëmshpërblim. Ekziston gjithashtu norma, në lindje e sipër, sipas së cilës dëmshpërblimi duhet të paguhet nga shteti për viktimat e krimeve të dhunshme që shkaktojnë dëmtim fizik ose psikologjik. Për disa shtete (p.sh., shtetet palë të KEDVKDh-së), ky është detyrim. Gjithashtu, sipas standardeve bazë të punës së ILO-s, shtetet detyrohen që të ofrojnë mjete efektive për shkeljet e të drejtave të punës. Personat e trafikuar gëzojnë të drejta të tjera plotësuese që lidhen me mbrojtjen dhe ndihmën, gjë që bën të mundur që ata të kenë mjete të tjera zhdëmtimi, në veçanti për sa i përket shpërblimit të dëmeve.

Ndërkohë që të gjitha vendet në studim kanë të paktën një procedurë ligjore ekzistuese penale, civile ose të punës që bën të mundur ngritjen e padisë për dëmshpërblim kundër trafikantëve/shfrytëzuesve, pak prej tyre kanë ngritur skema shtetërore dëmshpërblimi. Mekanizmat ekzistues të dëmshpërblimit, pavarësisht nga fakti nëse parashikojnë shpërblimin nga shteti ose nga autori i veprës penale, ende paraqesin pengesa për individët në kërkimin dhe marrjen e dëmshpërblimit. Ato janë të ndërlikuara, kushtojnë shumë dhe zgjasin në kohë. Kriteret për përfitimin janë kufizuese, dhe mund të mos njihen të gjitha llojet e dëmeve të pretenduara nga viktimat. Për më tepër, pagesat e urdhëruara mund të mos kryhen, dhe vendimet e gjykatave mund të mos ekzekutohen si rezultat i vështirësive me zbatimin ose dispozitat e sekuestrimit të pasurive. Bashkëpunimi përtej kufijve dhe mungesa e shtetit të së drejtës, mund të kontribuojnë më tej në mosfunksionimin e sistemeve.

Një problem i veçantë lidhet me skemat që e urdhërojnë autorin e veprës penale që të paguajë dëmet, pasi ato paguhen rrallë; shumë pak persona të trafikuar në çdo shtet të këtij studimi kanë marrë dëmshpërblim.

Dëmshpërblimi nga skema shtetërore siguron që kërkuesi të marrë të paktën një pjesë të dëmshpërblimit, edhe pse ajo nuk mbulon të gjitha humbjet. Për këtë arsye, skemat shtetërore kanë mundësi të japin drejtësi dhe rrjedhimisht ato duhet të krijohen ose të përmirësohen nëpërmjet zgjerimit të kriterëve të përfitimit. Duke u nisur nga kufizimet buxhetore të skemave të tilla, ka rëndësi që të merret parasysh nëse skema të tilla duhet të mbulojnë veprat penale të të gjitha llojeve ose humbjet e të gjitha llojeve.

Kufizimi i llojeve të veprave do të ulte numrin e viktimave që kanë të drejtë të kërkojnë

dëmshpërblim dhe kufizimi i humbjeve të mbuluara do të çonte në uljen e masës së dëmshpërblimit që mund t'i jepet kërkuarit të suksesshëm. Të dyja këto procedura do të kushtonin më pak, se sa mbulimi i të gjitha humbjeve për të gjitha llojet e viktimave.

Personat e trafikuar preken nga faktorë specifikë që lindin nga situatat e tyre, të cilat i pengojnë ata për të përfituar dëmshpërblim, edhe në rastin kur mekanizmat e dëmshpërblimit funksionojnë mirë. Probleme të tilla si për shembull frika, pengesat e gjuhës, ndrojtja për t'u lidhur me autoritetet, ndjenja e përçmimit dhe e pasigurisë rreth statusit të tyre si emigrantë, kanë nevojë që të kapërcehen të gjitha. Për më tepër, përdorimi i mjeteve për zhdëmtim kërkon njohje dhe mbështetje. Informacioni mbi masat e drejtësisë dhe bërjen e kërkesave për dëmshpërblim është i domosdoshëm dhe kërkohet që të bëhet i disponueshëm në mënyra të ndryshme origjinale, me qëllim që personat e trafikuar të njohin të drejtat e tyre. Ndihma e pavarur ligjore dhe asistenca gjithnjë do të kenë ndikim pozitiv në mundësitë e viktimës për të siguruar urdhrin e dëmshpërblimit, por ka nevojë që ato të jenë të disponueshme pa pagesë dhe sa më shpejt të jetë e mundur, sapo viktimat të bjerë në kontakt me autoritetet ose me një agjenci mbështetëse.

Situata e fëmijëve në masën e madhe mbetet e patrajtuar në këtë raport, si rezultat i vështirësive në marrjen e informacioneve të detajuara. Gjithsesi, është e qartë se problemet e hasura nga personat e trafikuar shumëfishohen kur viktimat janë fëmijë. Për shembull, procedurat ligjore krijojnë më shumë ndrojtje për fëmijët dhe nevojitet më shumë këshillim për t'u bërë atyre të mundur të kuptojnë sistemin ligjor dhe të drejtat e tyre. Ka gjithashtu në veçanti çështje shtesë të lidhura me fëmijët që duhet të trajtohen në nivel kombëtar, si për shembull nevoja për sistemet e shërbimeve sociale dhe për kujdestarinë, me qëllim sigurimin se dhënia dhe shpenzimi i parave të dëmshpërblimit do të monitorohen dhe se fëmijët do të mbrohen nga prindërit ose kujdestarët në qoftë se veprimet e tyre nuk përkojnë me interesat më të larta të fëmijës.

Përpara faktit se vetëm një pakicë e vogël e personave të trafikuar kërkojnë dëmshpërblim dhe se akoma dhe më pak marrin pagesën e dëmshpërblimit, është e domosdoshme në kuadrin e detyrimeve ligjore ndërkombëtare që shtetet të bëjnë më shumë përpjekje për të përmirësuar sistemet e dëmshpërblimit për përfitimin e personave të trafikuar. Nuk ka një model ligjor të vetëm që të garantojë se dëmshpërblimi do t'u jepet të gjithë personave të trafikuar ose shumicës së tyre dhe ka shumë pengesa praktike të cilat mund të rezultojnë të vështira për t'u kapërcyer.

Për këtë arsye, shtetet duhet të sigurojnë që një shumëllojshmëri formash zhdëmtimi të jenë të disponueshme, me qëllim që kërkesat për dëmshpërblim nga personat e trafikuar të mund të kenë një farë shansi për sukses.

Shtetet mund të huazojnë tiparet më të mira të skemave ekzistuese në mënyrë që të krijojnë ose të përmirësojnë sistemet e tyre. Gjithsesi, kjo duhet bërë nga çdo shtet brenda zhvillimit të politikës gjithëpërfshirëse për dëmshpërblimin e personave të trafikuar. Kjo do të përfshinte konsultimet me vetë viktimat dhe me OJF-të që përfaqësojnë interesat e tyre. Shtetet duhet të eksplorojnë masa për të ndërmarrë reforma sistematike dhe ligjore në fushat e të drejtës civile, të drejtës penale dhe të drejtës së punës, në mënyrë që të rritet mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë; për të ofruar ndihmë ligjore për personat e trafikuar; për të përqendruar informacionin dhe shërbimet mbështetëse për personat e trafikuar; për të bërë të mundur rregullimin e statusit të personave të trafikuar gjatë kohëzgjatjes së procesit; për të fuqizuar kompetencat e inspektoriateve të punës dhe strukturave të tjera të ngjashme për të vënë rregulla, duke përfshirë dhënien e dëmshpërblimit; si dhe për të eksploruar sisteme jashtëgjyqësore për negocimin e pagesave të dëmshpërblimit, si p.sh. ndërmjetësimin.

OJF-të dhe sindikatat duhet të vazhdojnë gjithashtu të luajnë një rol të rëndësishëm, duke vlerësuar të drejtat penale, civile dhe të punës në vendet e tyre dhe duke zhvilluar strategji për të avancuar interesat për përmirësimin e mundësive të përfitimit të dëmshpërblimit, si dhe duke dhënë ndihmë për përpjekjet për ndërmjetësim. OJF-të që punojnë në fushën e trafikimit ndërmjet të tjerash do të përfitonin nga krijimi i rrjeteve me grupe të tjera që punojnë me viktimat e krimit, të drejtat e emigrantëve dhe të drejtat e punëtorëve. Të gjitha këto grupe ofrojnë perspektiva të dobishme në çështjen e dëmshpërblimit të personave të trafikuar.

Nga kjo analizë e tetë Shteteve anëtare të OSBE-së, janë identifikuar shumë rekomandime dhe ide praktike për të përmirësuar zbatimin e të drejtës së dëmshpërblimit, të cilat duhet të shqyrtohen në kontekste të ndryshme kombëtare.

### *Krijimi i kulturës kombëtare për të drejtat e viktimës*

- Të krijohet një strukturë e koordinuar për politikëbërjen dhe për këshillimin mbi të drejtat e personave të trafikuar dhe mundësitë e tyre për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë në nivel kombëtar.
- Të vendosen kontakte me strukturat e duhura të të drejtave në vendet përkatëse të origjinës/destinacionit për të lehtësuar të drejtat e personave të trafikuar që janë kthyer.
- Të ofrohet informacion lehtësisht i disponueshëm në lidhje me llojet e skemave të dëmshpërblimit në vendet e origjinës/destinacionit.
- Në bashkëpunim me grupet e viktimave dhe me OJF-të, të përqendrohet në zhvillimin e politikës së të drejtave të viktimës, të standardeve dhe shërbimeve që marrin parasysh nevojat e ndryshme për lloje të ndryshme viktimash (p.sh. fëmijë, emigrantë, punëtorë pa dokumente, prostituta të detyruara dhe vullnetare, punëtorët në bujqësi dhe ata që shfrytëzohen në fabrika në kushte shumë të këqija (*sweatshop workers*)).
- Të ofrohet informacion rreth të drejtave të personave të trafikuar dhe skemave të dëmshpërblimit në format të qartë dhe që mund të gjendet lehtësisht, i përkthyer, në qoftë se është e mundur, në gjuhët që përdoren më shpesh nga emigrantët dhe personat e trafikuar në atë vend dhe të shpërndahet informacioni gjerësisht në mënyrë që publiku të mund ta gjejë atë lehtësisht.
- Të përfshihen të drejtat e personave të trafikuar në të drejtën e procedurës penale dhe në të drejtën e punës, nëpërmjet ndryshimeve në ligjet përkatëse, p.sh. në ligjet e procedurave penale dhe në ligjet për ndihmën ligjore, në kompetencat dhe detyrat e zbatuesve të ligjeve, të inspektorëve të punës, të prokurorëve dhe të gjyqësorit.
- Të përfshihen praktikat e mira nga vende të tjera, në veçanti nga vende që kanë traditë ligjore të ngjashme.

### *Vlerësimi dhe monitorimi i së drejtës së dëmshpërblimit në nivelin kombëtar*

- Të ndërmerret një rishikim sistematik i mundësisë për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë në nivel kombëtar, duke përfshirë të gjithë mekanizmat e dëmshpërblimit, në veçanti ato që lidhen me personat e trafikuar.
- Të vlerësohen dhe të monitorohen periodikisht sistemet kombëtare të dëmshpërblimit, nga pikëpamja e mundësive që u jepen personave të trafikuar për të përfituar nga ato.

- Të vlerësohet dhe të monitorohet periodikisht ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe penale, për të përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë. T'i kushtohet vëmendje e veçantë nevojës së personave të trafikuar (d.m.th. për t'u siguruar se ata nuk janë të detyruar që të ndjekin vetë procedurat e ekzekutimit të vendimeve).
- Të sigurohet që kur një organ shtetëror ka përgjegjësi për bashkërendimin e çështjeve që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, statistikave që mbledhen për çështjet penale të trafikimit të përfshijnë si më poshtë: faktin nëse është bërë kërkesë për dëmshpërblim; nëse kërkesa është miratuar, masa e dëmshpërblimit dhënë, nëse është paguar dëmshpërblimi, hapat për të sekuestruar pasuritë e trafikantëve dhe kohëzgjatja e kërkuar për të ndërmarrë këto hapa.
- Të kryhet gjithashtu mbledhja nga organi shtetëror i të njëjtave kategori informacionesh në lidhje me paditë civile private dhe me zbatimin e tyre, si dhe me kërkesat që trajtohen nga organet shtetërore të tilla si inspektoriatet e punës dhe kërkesat e bëra ndaj skemave shtetërore të dëmshpërblimit.
- Të sigurohet që llojet e dëmeve që janë të disponueshme nën secilin mekanizëm dëmshpërblimi janë të plota dhe konsekuente dhe nuk i kërkojnë personit të trafikuar të bëjë kërkesë sipas më shumë se një mekanizmi, për të përfshirë të gjitha dëmet e pësuarat.

#### *Organet e zbatimit të ligjeve, avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët*

- Të forcohen detyrimet ligjore për policinë dhe prokurorinë për dhënien e informacionit personave të trafikuar në lidhje me të drejtën për dëmshpërblim, në një gjuhë të përshtatshme dhe me mjete të përshtatshme.
- Të ofrohen trajnime për të gjithë policinë, gjyqtarët dhe prokurorët për të drejtat e personave të trafikuar dhe rolin e tyre në realizimin e këtyre të drejtave (p.sh., hartimin e kërkesave për dëmshpërblim, mbledhjen e provave në lidhje me dëmet dhe sigurimin që padia po shqyrtohet siç duhet në procesin gjyqësor).
- Të përgatiten materialet praktike udhëzuese dhe mjetet për punonjësit, p.sh., fletë informacioni standarde apo pyetësorë me qëllim që të lehtësohet zbatimi i këtyre të drejtave.
- Të shmanget nxjerrja e shumë materialeve udhëzuese, statusi ligjor i të cilave është i paqartë. Një dokument i vetëm, thelbësor dhe me forcë ligjore që garanton zbatimin, është më i dobishëm dhe tërheq njësoj vëmendjen si të zyrtarëve ashtu edhe të viktimave.

- Të merret parasysh vlefshmëria e një skuadre të specializuar prokurorësh që përqendrohen në çështjet e trafikimit.
- Brenda çdo prokurorie, të përcaktohet një njësi e cila është përgjegjëse për mbështetjen e viktimave/dëshmitarëve (p.sh., koordinator i viktimës/dëshmitarit në Shtetet e Bashkuara).
- Të zhvillohen mënyra për të shkëmbyer informacion rreth zhvillimeve ligjore dhe vendimeve të gjykatave, p.sh., në lidhje me llogaritjen e dëmeve brenda dhe ndërmjet organeve (p.sh., nëpërmjet buletineve informative, takimeve të rregullta të gjyqtarëve ose dhomave të avokatëve.
- Në mënyrë që të nxitet raportimi i krimit dhe zhdëmtimi për personat e trafikuar, të sigurohet që individët me status jo të ligjshëm emigracioni, të cilët paraqiten para policisë ose prokurorisë, nuk u referohen automatikisht shërbimeve të emigracionit.
- Të forcohet më shumë bashkëpunimi nga ana e avokatëve me OJF-të dhe sindikatat që u vijnë në ndihmë personave të trafikuar, për të gjetur zgjidhje të reja dhe origjinale për kërkimin dhe marrjen e dëmshpërblimit.
- Të trajnohen avokatët për të përdorur në mënyra origjinale në të drejtën civile dhe atë të punës kur ndihmojnë personat e trafikuar, me qëllim sigurimin se kërkesat për dëmshpërblim të jenë sa më të plota; p.sh., ata duhet të trajnohen me jurisprudencën dhe praktikën e sistemeve të tjera ligjore, duhet të huazojnë argumente ligjore dhe të marrin prova nga burime të gjetura në mënyrë origjinale. Komunitetet profesionale të juristëve (p.sh. dhomat e avokatisë) duhet të jenë aktive në zhvillimin e njohurive të tyre mbi të drejtën në lidhje me dëmshpërblimin e personave të trafikuar dhe të drejtat e tyre, si në vendet e origjinës ashtu edhe në ato të destinacionit.
- Të bashkohen burimet e avokatëve dhe të shkëmbehen përvojat e tyre për çështjet e trafikimit; të ofrohet nga ana e tyre ndihmë ligjore pa pagesë kur personi i trafikuar nuk mund të përballojë tarifat.

#### *Skemat shtetërore të dëmshpërblimit*

- Të ratifikohet Konventa Evropiane për Veprime kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si dhe Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme.
- Të krijohet një skemë e financuar nga shteti ose e subvencionuar nga shteti për dëmshpërblimin e viktimave.

- Të merren në shqyrtim mundësitë për përdorimin e pasurive kriminale të konfiskuara për kontributin në skemë.
- Të hartohen kritere të qarta në lidhje me llojet e krimeve për të cilat dëmshpërblimi lejohet dhe të theksohet zbatimi i këtyre parimeve për faktet e çdo çështjeje, në vend të klasifikimit të ngurtë të krimeve (d.m.th., shmangia e situatës ku krimi i trafikimit mund të dëmshpërblehet sipas ligjit, por prokurorët, pavarësisht nga faktet shumë rrallë trajtojnë çështjen si rast trafikimi).
- Të rishqyrtohet natyra e krimeve të cilat kualifikohen për dëmshpërblim (p.sh., shtrirja e së drejtës për dëmshpërblim përtej kërkesave për dhunë fizike që shkakton dëmtim dhe shqyrtimi i mundësisë për të shtuar dhunën psikologjike), në mënyrë që të mbulohen manifestime të ndryshme të trafikimit, p.sh., kur punëtori ndalohet fizikisht që të largohet nga vendi punës, por nuk ka pësuar dhunë të mirëfilltë. Treguesit ekzistues që janë zhvilluar për të identifikuar personat e trafikuar mund të përdoren për të bërë të mundur zhvillimin e këtyre kritereve.
- Të zbuten kërkesat e karakterit apo të lejes së qëndrimit që përjashtojnë personat e trafikuar nga përfitimi i dëmshpërblimit (p.sh., hyrja e parregullt, statusi i parregullt).
- Të sigurohet që të gjitha llojet e dëmeve (morale dhe materiale) janë të disponueshme nëpërmjet skemës për personat e trafikuar.
- Të ofrohen udhëzime të qarta dhe transparente për mënyrën se si llogariten dëmet dhe si krahasohen ato me kërkesat për dëmshpërblim të bëra në çështje civile.
- Të zbuten kriteret për llojin dhe natyrën e provave që kërkohen nga personat e trafikuar për vërtetimin e humbjeve të tyre. (Kriteret mund të ndryshojnë në varësi të fakteve të çështjes).
- Të sigurohet se afati kohor për paraqitjen e aplikimit nuk është shumë i shkurtër (d.m.th., duhet disa muaj, jo ditë).
- Të rishikohet detyrimi për bashkëpunim të vazhdueshëm me policinë në hetimin penal nga ana e personave të trafikuar, p.sh., të merren parasysh në mënyrë serioze “shkaqet e arsyeshme” për mosbashkëpunim, si për shembull frika përse i përket sigurisë dhe fakti se masat mbrojtëse në dispozicion mund të mos jenë të mjaftueshme.
- Të lejohet shteti të ndjekë procesin civil ndaj keqbërësit për marrjen e dëmshpërblimit.
- Të sigurohet se mund të bëhen pagesa të menjëhershme dhe të përkohshme.

- Të krijohen procedura të shpejta, të thjeshtëzuara dhe lehtësisht të përdorueshme në procesin e pavarur të apelimit.
- Të sigurohet që kërkuesit të marrin këshillim ligjor, që i mundëson ata të bëjnë aplikimin siç duhet si dhe të kërkojnë dhe të marrin humbjet e plota.
- Të përmirësohen mundësitë për personat e trafikuar që të aplikojnë nga jashtë, p.sh., duke u kushtuar vëmendje të veçantë metodave të përshtatshme të komunikimit, ofrimit të informacionit në gjuhë të ndryshme, etj.
- Të shqyrtohen avantazhet dhe disavantazhet e krijimit të skemës së posaçme për personat e trafikuar (duke siguruar që pasuritë e sekuestruara nga trafikantët të kontribuojnë për financimin e skemës).
- Të shqyrtohen avantazhet dhe disavantazhet e krijimit të skemës shtetërore të dëmshpërblimit për shkeljet që nuk klasifikohen si krime, p.sh., dëmshpërblimi shtetëror për të rimbursuar humbjet ekonomike për punëtorët e shfrytëzuar.
- Të shqyrtohen mundësitë për zgjerimin e skemave ekzistuese për krimet e dhunës për të mbuluar të gjitha kategoritë e humbjes dhe/ose të gjitha kategoritë e trafikimit (duke përfshirë ato jo të dhunshme).

#### *Dëmshpërblimi në proceset penale dhe civile*

- Të sigurohet që vendimet për dëmshpërblim në procesin penal nuk janë për shumica aq të vogla sa të fyejnë personin e trafikuar dhe të ofrohen udhëzimet e qarta se si mund të arrihen shumatat e duhura në këto vendime.
- Të sigurohet që vendimet për dëmshpërblim në procesin penal zbatohen në mënyrë efektive dhe kanë përparësi mbi pagesa të tjera si gjokat.
- Të sigurohet që barra për ekzekutimin e urdhrave ose të vendimit për dëmshpërblim nuk bie mbi personat e trafikuar.
- Për aq sa të jetë e mundur, të sigurohet se personi i trafikuar kërkohet të ndjekë vetëm një procedurë ligjore, p.sh., duke u siguruar se të gjitha llojet e dëmeve të mund të përfshihen si dëmshpërblim nga të gjitha llojet e gjykatave. Kur kjo nuk është e mundur, të sigurohet se procesi civil është i shpejtë dhe i thjeshtëzuar dhe mund të përdoret lehtësisht dhe se nuk është e nevojshme që paditësi civil të përsërisë dëshminë me gojë të dhënë më parë në procesin penal.
- Të sigurohet se asistencë ligjore jepet falas dhe se ka përfaqësim gjatë të gjithë proceseve ligjore ku bëhet fjalë për dëmshpërblim/kthim të dëmeve.
- Të sigurohet se personat e trafikuar kanë të drejta proceduriale të parashikuara në ligj, si p.sh. të drejtën për t'u përfaqësuar në gjykatë, të drejtën për të



paraqitur prova për të mbështetur pretendimet e tyre, si dhe të drejtën për të qenë të pranishëm në çastin kur jepet vendimi.

- Të trajnohen gjyqtarët, kur të shihet e përshtatshme, për të identifikuar kategorizimet e duhura të personit të trafikuar si palë e dëmtuar që ka të drejtë të ngrejë padi në proces.
- Të ofrohen udhëzime të qarta dhe të trajnohen gjyqtarët për mënyrën e vlerësimit të padive për dëmshpërblim. Të ofrohet periodikisht informacioni i përditësuar mbi zhvillimet ligjore, jurisprudencën dhe vendimet e gjykatave për të nxitur praktikat konsekuente.
- Të sigurohet se qëndrimet personale të gjyqtarit ndaj personave të trafikuar ose bindjet personale për atë se çfarë duhet të jetë sjellje morale, nuk çojnë në zbatimin jokonsekuent të udhëzimeve për vlerësimin e dëmeve.
- Të reduktohet theksi mbi nevojën për prova të dokumentuara të humbjeve dhe të reformohen ligjet për të pranuar forma të tjera provash, duke përfshirë gatishmërinë e lartë për të marrë parasysh dëshminë e personit të trafikuar.
- Të sigurohet se gjyqtarët e shqyrtojnë gjithnjë kërkesën për dëmshpërblim në procesin penal me të njëjtin seriozitet me çështjen penale kundër të akuzuarit, dhe se japin arsyetim ligjor me shkrim për vendimin e marrë.
- Të sigurohet se personi i trafikuar mund të apelojë vendimin e marrë në lidhje me thelbin e padisë ose me shumën e urdhëruar si dëmshpërblim.
- Të shqyrtohet mundësia e përfshirjes së koncepteve të reja për dëmet, si për shembull dëmet ndëshkuese në tejkalim të dëmeve të pësuar në fakt (*punitive damages*), ose të drejtën për të kërkuar një shumë të barazvlefshme me begatimin pa shkak të trafikantit/shfrytëzuesit.
- Të përfshihet kërkesa e detyrueshme e viktimës gjatë procesit penal mbi pasojat që ajo ka pasur nga krimi.
- Të përdoren mekanizmat e ndërmjetësimit dhe të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, për të nxitur zgjidhje të negociuara.

#### *Të drejtat e punës/punësimit*

- Të miratohet dhe të zbatohet legjislacioni për të vënë në jetë standardet ndërkombëtare të punës për punën e detyruar, punën e të miturve, diskriminimin, punëtorët emigrantë, pagat, kohën e punës, shëndetin, sigurimin dhe agjencitë private të punësimit.
- Të sigurohet se punëtorët pa dokumenta nuk vuajnë nga diskriminimi në gëzimin dhe në ushtrimin të të drejtave të punës; në veçanti, të sigurohet se ata

kanë të drejtën për paga të drejta, dëmshpërblimin për aksidentet në punë, të drejtën e organizimit, si dhe të drejtën për t'i mbrojtur këto të drejta në gjykatat e punës.

- Të sigurohet se është e paligjshme që punëdhënësit të japin mallra dhe shërbime si alternativë për pagat ose të bëjnë zbritje nga pagat për mallrat dhe shërbimet e ofruara.
- Të lehtësohet barra e provës për të vërtetuar që ekziston marrëdhënie pune me punëdhënësin shfrytëzues.
- Të trajtohen ndërmjetësi dhe përdorues kryesor i shërbimeve në zinxhirët e punësimit si përgjegjës solidar për përputhshmërinë me ligjet e punës, për të rritur në maksimum mbrojtjen e personave të trafikuar.
- Të lehtësohet barra e provës për të vërtetuar padinë, p.sh., nëpërmjet procedurave të thjeshtësuara për të dëmshpërblyer pagat e papaguara, kur zbulohen raste të shfrytëzimit, duke sjellë si rezultat pagesën automatike të shumave të urdhëruara.
- Të sigurohet se gjykatat e punës nuk janë të detyruara që të referojnë tek shërbimet e emigracionit emrat e njerëzve në çështjet përpara tyre.
- Të sigurohet se kërkuesit marrin këshillim ligjor pa pagesë dhe asistencë për ngritjen e padisë.
- Të ofrohet mbështetja për sindikatat në rritjen e ndërgjegjësimit mbi të drejtat e punës dhe të mjeteve mbrojtëse për grupet që mund të preken nga trafikimi dhe shfrytëzimi.
- Të lejohet që sindikatat ose agjencitë e tjera përkatëse të mund të kërkojnë zbatimin e ligjeve të punësimit, në mënyrë të pavarur nga punëtorë individualë, kur punëtorët nuk janë në gjendje ose hezitojnë ta bëjnë këtë gjë, duke i përfaqësuar në proces këta persona.
- Të trajnohen gjykatat e punës mbi standardet ligjore për punën e detyruar dhe trafikimin e qenieve njerëzore, dhe të njihen ato me treguesit e duhur për t'u mundësuar identifikimin e një çështjeje të tillë.
- Të forcohen trajnimet dhe të ofrohen burimet për inspektoriatet e punës, në veçanti ato që mbulojnë sektorët më të prekur nga shfrytëzimi.
- Të forcohen kompetencat e inspektorëve të punës, në mënyrë që ata të mund të urdhërojnë dëmshpërblimin dhe të kenë instrumente të tjera që mund t'i përdorin, p.sh., mundësinë për të hequr lejen e veprimtarisë.
- Të jepet mbështetja për rastet e bashkëpunimit ndërmjet sindikatave, shoqërisë civile dhe agjencive shtetërore, mandati i të cilave është mbrojtja e punës duke monitoruar kushtet e punës, duke ofruar mbështetje dhe ndihmë për personat e

shfrytëzuar dhe duke ndërhyrë në sektorët e punës që janë më të prekur nga shfrytëzimi.

- Të krijohet një mekanizëm i pavarur i ankesave për punëtorët emigrantë, i cili mund të drejtohet në mënyrë anonime dhe pa frikën e referimit tek autoritetet e emigracionit dhe dëbimit nga vendi.
- Të sigurohet se organizatat e punëtorëve dhe grupet e të drejtave të emigrantëve përfshihen në hartimin e politikave mbi reformat e legjislacionit dhe të procedurave të punës.

#### *Ekzekutimi i vendimeve dhe sekuestrimi i pasurisë*

- Të vlerësohet ekzekutimi i vendimeve të gjykatave civile dhe penale dhe të përcaktohen sfidat kryesore në lidhje me ekzekutimin e vendimeve.
- Të sigurohet se përmbaruesit janë të trajnuar mirë dhe të pajisur me burimet e nevojshme.
- Të vendoset dhe të monitorohet bashkërendimi dhe komunikimi ndërmjet gjykatave, shërbimeve të provës, burgjeve, përmbaruesve dhe kërkuesve (dhe të agjencive të tjera përkatëse).
- Të sigurohet se personat e trafikuar marrin këshillim të specializuar në lidhje me ekzekutimin e vendimeve dhe mbështetjen ligjore në rastet kur ata duhet ta ndjekin vetë ekzekutimin e vendimit.
- Të shqyrtohet mundësia e vendosjes së sanksioneve penale për mospagimin e shpërblimit të vendosur nga gjykata penale.
- Të sigurohet që pagesa e dëmshpërblimit mund të bëhet me këste.
- Të vendoset lidhja ndërmjet konfiskimit të pasurive dhe pagimit të dëmeve, d.m.th., duhet të jetë e mundshme sipas ligjit për të rezervuar pasuri për pagimin e vendimeve penale dhe civile.
- Të sigurohet se viktimat e krimit kanë përparësi të lartë në listën e “kreditorëve” ndaj pasurive të vëna në rrugë kriminale.
- Të krijohen sektorët e specializuar në polici dhe në prokurori, përgjegjëse për sekuestrimin e pasurive që mund të përdoren në rastet e trafikimit.
- Të përcaktohen kompetencat për bllokimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive në çështje penale dhe civile sa më herët të jetë e mundur në proces, duke respektuar të drejtat e njeriut.
- Të krijohen mënyra efektive të gjurmimit të pasurive me anë të legjislacionit të pastrimit të parave, ligjeve efikase bankare, regjistrimit të pronave, etj.

*E drejta për t'u informuar dhe për ndihmë (shih gjithashtu "Krijimi i kulturës kombëtare për të drejtat e viktimës" më sipër)*

- Të ofrohet ndihma ligjore falas dhe e specializuar për të gjitha viktimat, pavarësisht nga statusi i tyre në procesin penal. Të shpërblehen avokatët me tarifa të barabarta me atë të avokatëve të të pandehurve, si dhe tu jepet atyre status i njëjtë.
- Të ofrohet ndihma ligjore falas për personat e trafikuar që kërkojnë këshillim në lidhje me të drejtat e tyre, përfaqësim në negociata dhe bërjen e kërkesave për kompensim.
- Të trajnohen avokatët si avokatë të viktimave, për t'u siguruar se ato njihen me ligjet për të drejtat kombëtare dhe ndërkombëtare të viktimave dhe se janë në gjendje të hartojnë padi civile për dëmshpërblim; se mund të formulojnë argumente për dëmshpërblim në rastet e llojeve të pazakonta humbjesh; se mund të mbledhin të dhëna për të mbështetur pretendimet e klienteve; dhe se do të nxisin sekuestrimin e pasurive në çështjet penale ose bllokimin e pasurive në çështjet civile.
- Të sigurohet financimi shtetëror për OJF-të që mund të japin këshillim, mbështetje dhe shërbime ligjore.
- Të sigurohet mundësia e dhënies së lejeve të qëndrimit për personat e trafikuar minimalisht për kohëzgjatjen e çështjes për dëmshpërblim, si dhe të shërbimeve mbështetëse që ofrojnë mjedise të sigurta për personat e trafikuar.
- Të hiqen tarifat administrative për ngritjen e padive për dëmshpërblim.

*Roli i OJF-ve*

- Të zgjerohen rrjetet e OJF-ve për të përfshirë organizata të ndryshme (p.sh., organizata të trafikimit ose të viktimave të krimit dhe grupet mbështetëse të punës së emigrantëve) për të shkëmbyer informacion dhe praktika në lidhje me marrjen e dëmshpërblimit nëpërmjet rrugëve të ndryshme.
- Të rritet roli i OJF-ve në organizimin e veprimeve kolektive nga personat e trafikuar, me synim arritjen e marrëveshjeve si, p.sh., për pagesën e dëmshpërblimit si dhe për të ndrequr abuzime të tjera të së drejtës së punës si p.sh., standardet e shëndetësisë dhe të sigurisë.
- Të ofrohet, nga OJF-të që merren me çështjet e trafikimit, mbështetja ligjore për personat e trafikuar, viktimat të të gjitha formave të shfrytëzimit, pa u kufizuar në forma të tjera mbështetjeje, p.sh. psiko-sociale, mjekësore, të strehimit, etj.

Po ashtu, të krijohen marrëdhënie të ngushta pune me organizata ose avokatë të tjerë që mund ta ofrojnë këtë shërbim.

- Të monitorohet dhe të raportohet mbi çështjet e dëmshpërblimit dhe çështjet e të drejtave të viktimave të lidhura me dëmshpërblimin.

#### *Roli i ONQ-ve*

- Të monitorohet dhe të vlerësohet zbatimi i standardeve ekzistuese dhe të hartohen raporte që mund të gjenden dhe mund të lexohen lehtësisht nga publiku.
- Të ndërmerren hapa proaktive për të nxitur të drejtat e personave të trafikuar.
- Të përfshihet analiza e të drejtave të viktimave dhe e çështjeve të dëmshpërblimit në veprimtaritë e monitorimit të seancave gjyqësore.
- Të mblidhen praktikantët nga vende të ndryshme për të krahasuar përvojat dhe për të ndarë praktikat e mira, p.sh., koordinatorët e viktimave/dëshmitarëve nga SHBA, OJF-të nga SHBA ose nga Franca që kanë qenë aktive në ngritjen e padive civile për klientët që janë viktimat të trafikimit.

#### *Fusha të tjera ku kërkimi i mëtejshëm është i nevojshëm*

- Çështje të së drejtës së punës, përsa i përket ndikimit mbi personat e trafikuar që pretendojnë pagat e papaguara ose të nënpaguara, shkarkimin e padrejtë nga puna, diskriminimin, humbjen e pushimeve dhe të ditëve me raport mjekësor, si dhe informacion rreth çështjeve të ngritura sipas të drejtës së punës, nga punëtorë emigrantë të shfrytëzuar.
- Informacion i detajuar për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale.
- Informacion mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim dhe të vendimeve civile dhe nëse shumata e marra u janë paguar personave të trafikuar.
- Sfidat e veçanta në lidhje me fëmijët (nën moshën 18 vjeç) që kërkojnë dëmshpërblim për shkak se kanë qenë objekt trafikimi dhe një analizë e asaj çfarë ka ndodhur me paratë e dëmshpërblimit të marra në emër të tyre.

# Shtojcat: Standardet dhe Detyrimet Ndërkombëtare

## Shtojca I: DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE LIGJËRISHT TË DETYRUESHME

### KKBKON dhe Protokoli i Trafikimit

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar<sup>536</sup> (KKBKON) është e zbatueshme vetëm në raste të krimeve të rënda ndërkombëtare.<sup>537</sup> Ajo është ratifikuar nga 134 shtete, duke përfshirë të gjitha shtetet që janë përfshirë në këtë studim dhe, rrjedhimisht, përcakton standard detyrues në lidhje me çështjet që ajo trajton.<sup>538</sup> Ajo përmban dy dispozita që lidhen me dëmshpërblimin. Së pari, neni 25 i saj, i cili trajton “ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave” përcakton se:

“2. Çdo Shtet Palë detyrohet të vendosë procedura të përshtatshme, të cilat do të sigurojnë mundësi dëmshpërblimi dhe kthimi të dëmit për viktimat e veprave penale të përfshira në këtë Konventë.

Gjithashtu Shtetet Palë janë të detyruara:

“të bëjnë të mundur që pikëpamjet dhe shqetësimet e viktimave të paraqiten dhe të merren në konsideratë në fazat e duhura të proceseve penale.<sup>539</sup>

Në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore, Konventa duhet të lexohet së bashku me Protokollin e saj mbi Parandalimin, Suprimimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokoli i Trafikimit),<sup>540</sup> i cili përmban dispozita të mëtejshme në lidhje me viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore. Këto Konventa trajtojnë trafikimin që konsiderohet si krim, d.m.th., kur rasti ka shkuar në vëmendjen e agjencive që zbatojnë ligjet dhe është përcaktuar si i tillë:

---

<sup>536</sup> I miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003.

<sup>537</sup> Siç kufizohet në nenet 2, 3, 5, 6 dhe 8 të së njëjtës Konvente.

<sup>538</sup> Më 17 korrik 2007.

<sup>539</sup> Neni 25(3).

<sup>540</sup> I miratuar më 15 nëntor 2000, hyri në fuqi më 29 shtator 2003. I ratifikuar nga të gjitha vendet që janë objekt i këtij studimi.

“Neni 6 ...

92) Çdo Shtet Palë detyrohet të sigurojë se sistemi i tij i brendshëm ligjor dhe administrativ përmban masa që u ofrojnë viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në rastet e duhura:

(a) informacion për procedurat përkatëse gjyqësore dhe administrative; ...

(6) Çdo Shtet Palë detyrohet të sigurojë se sistemi i tij i brendshëm ligjor përmban dhe u ofron viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore mundësinë për marrjen e dëmshpërblimit për dëmet e pësuarat.”

Shënimi interpretativ i Protokollit vë në dukje se kjo dispozitë duhet të zbatohet në vendin e destinacionit si dhe në vendin e origjinës së viktimës.<sup>541</sup> KKBKON-ja përcakton një detyrim pak më të fortë për shtetet për të përcaktuar procedurat e dëmshpërblimit në rast të trafikimit të organizuar ndërkombëtar se sa përcakton Protokollin për çështjet e trafikimit që nuk e kanë këtë dimension. Kjo është e dobishme për shkak të theksimit të përgjithshëm të KKBKON-it për bashkëpunimin ndërkombëtar në të gjitha çështjet që mbulon. Gjithsesi, as KKBKON as Protokollin nuk është specifik në lidhje me llojin e mekanizmit të dëmshpërblimit, llojin e dëmeve për të cilat viktimat ka të drejta dëmshpërblimi ose burimin e parashikuar për dëmshpërblim. Udhëzuesi Legjislativ i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Droge dhe Krim (UNODC), e cila synon “të ndihmojë Shtetet që kërkojnë të ratifikojnë ose të zbatojnë” Konventën dhe Protokollet e saj parashikon se:

“Protokollin nuk përcakton asnjë burim të mundshëm dëmshpërblimi, që do të thotë se secili prej opsioneve të përgjithshme të dhëna më poshtë do të ishte i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesën e Protokollit:

(a) Dispozita që u lejojnë viktimave të ngrenë padi kundër autorëve ose të tjerëve sipas dispozitave ligjore ose dispozitave për dëmet jashtëkontraktore sipas sistemit të së drejtës *common law*;

(b) Dispozita që u lejojnë gjykatave penale të japin vendime për dëmet kriminale (d.m.th., të urdhërojnë që dëmshpërblimi t’u paguhet viktimave nga të dënuarit) ose të nxjerrin urdhra për dëmshpërblim apo kthim të dëmit kundër personave të dënuar.

---

<sup>541</sup> A/55/383/add.1, Shënime interpretuese për procesverbalet e negociatave për Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollet shoqëruese. [Http://www.unodc.org/pdf/crime/final\\_instruments/383a1e.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/final_instruments/383a1e.pdf), f. 13.

(c) Dispozita që krijojnë fonde të dedikuara ose skema me anë të të cilave viktimat mund të kërkojnë dëmshpërblim nga Shteti për dëmet ose dëmtimet e pësuar si rezultat i veprës penale.”<sup>542</sup>

Duket sikur vetë ekzistenca e mundësisë për të ndjekur padi civile kundër keqbërësit (në mënyrë të pavarur ose të lidhur me procesin penal) është e mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e KKBKON-it dhe të Protokollit. I vetmi tregues në lidhje me llojet e sakta të dëmeve që viktimat mund të kërkojnë dëmshpërblim gjendet në Konventë, e cila thotë se mundësia për dëmshpërblim dhe kthim të dëmit kërkohet në raste të krimit të rëndë ndërkombëtarë që kalon kufijtë. Nga ana tjetër, përdorimi i konceptit të “kthimit të dëmit” nuk është interpretuar nga hartuesit apo nga udhëzuesi i UNODC-së, dhe si rrjedhim nuk është e qartë nëse ai mbart kuptim ligjor. Siç është përmendur edhe më parë, termi i kthimit ka një mori kuptimesh, duke përfshirë këtu edhe thjesht dëmshpërblim (shih pjesën 1.3.). Prandaj mund të supozohet se për rastet që identifikohen si çështje trafikimi, brenda procedurës penale, mund të pretendohet për dëmshpërblim të plotë për të gjitha llojet e humbjeve, duke përfshirë këtu edhe pagat e papaguara.

Mbetet për t’u diskutuar nëse thjesht ekzistenca e sistemit ligjor civil apo e skemës së kompensimit të financuar nga shteti do të thotë që, në praktikë, me të vërtetë “u ofrohet mundësi” dëmshpërblimi viktimave të trafikimit, ashtu siç kërkohet nga Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON) dhe nga Protokollit i Trafikimit, pa zbatimin e disa të drejtave ndihmëse, si p.sh., e drejta për t’u informuar (shih nenin 6(2)(a) e Protokollit të Trafikimit të përmendur më sipër) dhe e drejta për këshillim dhe ndihmë ligjore. Një studim i gjerë, i bërë së fundmi në Mbretërinë e Bashkuar, mbi mundësinë për t’iu drejtuar drejtësisë civile, ka treguar se individët që kanë ngritur padi civile duke pasur këshillim ligjor, kanë përfituar zgjidhje më të mira se sa ata të cilëve u ka munguar kjo ndihmë; ata që kanë qenë të përfaqësuar ligjorisht përpara gjykatës kishin më tepër shanse që të arrinin synimin e tyre se sa ata që nuk ishin të përfaqësuar, ndërkohë që personat të cilëve iu është dhënë ndihmë ligjore për të paguar avokatin për punën e bërë kanë ecur edhe më mirë.<sup>543</sup> Ky studim mban qëndrimin se *mundësia* për të kërkuar dëmshpërblim nuk ekziston vetëm sepse ka, p.sh., kuadër ligjor civil, penal apo të punës, por ajo ekziston vetëm

---

<sup>542</sup> Pjesa e dytë e Udhëzuesit Legjislativ të UNDOC-së për zbatimin e Protokollit mbi Parandalimin, Suprimimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar, f. 285-286,

[http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative\\_guides/03%20Legislative%20guide\\_Trafficking%20in%20Persons%20Protocol.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative_guides/03%20Legislative%20guide_Trafficking%20in%20Persons%20Protocol.pdf).

<sup>543</sup> “*Causes of Action: Civil Law and Social Justice*” (Shkaqe për të ngritur padi: E drejta civile dhe drejtësia sociale.” Profesor P. Pleasence, Qendra e Kërkimeve për Shërbime Ligjore, 23 mars 2006. Një përmbledhje është e disponueshme në:

<http://www.lsrc.org.uk/publications/summary2006english.pdf>.



atëherë kur mekanizmi i dëmshpërblimit plotësohet me informacion që e mundëson si dhe me ndihmë e përfaqësim ligjor falas ose të subvencionuar për viktimat e trafikimit.<sup>544</sup>

Nevojat psikologjike dhe fizike të viktimave të trafikimit shihen si një shqetësim i dorës së parë gjatë zhvillimit të proceseve ligjore, veçanërisht kur viktima sapo është identifikuar. Ekzistenca e ndihmës mjekësore, këshillimit, strehimit dhe e statusit të rregullt të emigrantit do të kontribuonin për t'i mundësuar viktimës arritjen e sigurisë së nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proceset ligjore (si dëshmitare, por edhe si kërkuese/paditëse). Këto të drejta nuk janë në objektin e këtij studimi, por përmenden këtu për të kujtuar lexuesin se procedurat legislative dhe shërbimet ligjore janë vetëm një pjesë e paketës më të gjerë për ta bërë dëmshpërblimin *mundësi* reale për viktimat e trafikimit, ashtu siç kërkohet edhe nga Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON) dhe nga Protokolli i saj i Trafikimit.

### **Standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës**

Standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) mbi punën e detyruar<sup>545</sup> janë ratifikuar gjerësisht nga Shtetet pjesëmarrëse në OSBE<sup>546</sup> dhe kanë të bëjnë me çështje të të drejtave të punës, të cilat, në rast se shkelen, duhet të parashikohen për tu shqyrtuar nga një gjykatë në nivel kombëtar. Edhe në vendet ku konventat e ILO-s nuk janë ratifikuar, Deklarata e ILO-s mbi Parimet Themelore dhe të Drejtat në Punë, e vitit 1998, dhe aktet e mëvonshme zbatuese të ILO-s i detyrojnë shtetet anëtare të ILO-s që të sigurojnë parime themelore të caktuara, që përfshijnë ndalimin e punës së detyruar, punën e fëmijëve dhe diskriminimin. Konventa e ILO-së mbi Punën e Detyruar, e vitit 1930, nuk merret drejtpërsëdrejti me dëmshpërblimin. Megjithatë, një studim i përgjithshëm i bërë së fundmi nga Komisioni i Ekspertëve të ILO-s mbi zbatimin e saj jep shpjegimin e mëposhtëm lidhur me nenin 25, i cili trajton masat ndëshkuese për punën e detyruar:

“Aty ku vihet re ekzistenca e ndonjë forme të punës së detyruar, personat përgjegjës duhet të ndëshkohen me efikasitet në përputhje me sanksionet penale të parashikuara me ligj. Shteti është i detyruar të sigurojë që viktimat e praktikave të tilla të kenë mundësi që të bëjnë ankesë pranë organeve

---

<sup>544</sup> Shih arsyetimin e çështjes së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në *Golder v. United Kingdom*, 21 shkurt 1975. E diskutuar gjerësisht më poshtë, nën Konventën Evropiane kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

<sup>545</sup> Konventa e ILO-s 29, e vitit 1930, dhe 105, e vitit 1957. Secila prej tyre është e ratifikuar prej më shumë se 160 shteteve.

<sup>546</sup> Me përjashtim të Shteteve të Bashkuara, që nuk e kanë ratifikuar Konventën 29, vendet e përmendura në këtë studim janë palë të këtyre konventave.

kompetente, të kenë mundësi për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë dhe të kenë mundësi për të përfituar shpërblim për dëmet që kanë pësuar.”<sup>547</sup>

Në lidhje me punën e detyruar dhe trafikimin e personave, ILO-ja deklaroi se ekzistenca e mjeteve ligjore civile, administrative dhe të punës për zhdëmtim është vendimtare (përveç atyre penale) dhe se punëtorët shpesh do të kenë nevojë për ndihmë për të paraqitur ankesat e tyre. Në veçanti, shteteve u është kërkuar që të përdorin sistemet e tyre ligjore e administrative për të mbrojtur punëtorët e huaj dhe për t'u ofruar atyre mjetet mbrojtëse ndaj shfrytëzuesve.<sup>548</sup>

Konventat e ILO-s mbi punëtorët emigrantë<sup>549</sup> përcaktojnë standarde që garantojnë respektimin e të drejtave të emigrantëve për punën e kryer. Këto standarde ndër të tjera kanë efekt për paditë e punëtorëve të shfrytëzuar emigrantë, të bazuara në të drejtën civile ose të punës, për punë të papaguar ose të paguar nën nivelin e kërkuar. Gjithashtu, ato lidhen me humbje të tjera dhe dëme të shkaktuara nga abuzimi me standardet ligjore të punësimit (si p.sh., ato të shëndetit dhe sigurisë në punë, privimi nga ditët e pushimit, orët e tejkëmbësive, etj.)<sup>550</sup> Për sa u përket punëtorëve jo të rregullt, neni 9(1) i Konventës 143, i cili synon “të garantojë që punëtorëve emigrantë të punësuar në mënyrë të jashtëligjshme të mos u mohohen të drejtat lidhur me punën që kanë kryer në të vërtetë” dhe se atyre duhet t'u takojnë të njëjtat të drejta siç u takojnë edhe emigrantëve që kanë hyrë në vend në mënyrë të ligjshme dhe që janë të punësuar në mënyrë të rregullt.<sup>551</sup> Neni 25(3) i Konventës ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Emigrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre<sup>552</sup> parashikon detyrime të ngjashme për shtetet palë. Për fat të keq, këto

---

<sup>547</sup> Shih *ILO Forced Labour Survey 2007 (Studimin e ILO-s mbi punën e detyruar, 2007)*, f. 75, paragrafi 139, e disponueshme në <http://www.ilo.org/public/english/standards/realm/ilc/ilc96/pdf/rep-iii-1b.pdf>. Shih gjithashtu kometetet e Komisionit mbi “*comfort women*” japoneze (femrat e komoditetit) ku është ngritur çështja e kompensimit ( f. 195, raporti i vitit 2007, f. 141-142) dhe gjithashtu në lidhje me Brazilin, f. 142.

<sup>548</sup> *Human Trafficking and Forced Labour Exploitation, Guidance for Legislation and Law Enforcement* (Trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi i punës së detyruar, Udhëzime për Legjislacionin dhe Zbatimin e Ligjeve) (Programi i veçantë i ILO-së për të luftuar punën e detyruar, 2005), f. 26-29.

<sup>549</sup> Konventa mbi Emigrimin për Punësimin (1949), nr.97, dhe Konventa për Punëtorët Emigrantë (dispozita shtesë) (1975), nr.143.

<sup>550</sup> Për tablonë gjithpërfshirëse të të drejtave të migrantëve pa dokumenta, shih *Undocumented Migrants have rights: an overview of the international human rights framework* (Migrantët pa dokumenta kanë të drejta: një tablo e kuadrit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut) (PICUM, mars 2007).

<sup>551</sup> Studim i Komisionit të Ekspertëve të ILO-s mbi punën e emigrantëve, 1999, paragrafet 302 dhe 303.

<sup>552</sup> E miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 45/158, 18 dhjetor 1990, hyri në fuqi në 1 korrik 2003.

konventa nuk janë ratifikuar edhe aq gjerësisht, që do të thotë se shumë shtete nuk detyrohen nga këto dispozita. Disa shtete kanë informuar Komisionin e ILO-s se:

“shkeljet e dispozitave ligjore për punësimin e të huajve shkaktojnë pavlefshmërinë e kontratës së punës. Rrjedhimisht, punëtori nuk ka baza kontraktuale për të bërë kërkesë, ndër të tjera, për paga të papaguara.”<sup>553</sup>

E drejtat e punës e personave të trafikuar që jetojnë dhe punojnë në mënyrë të ligjshme në një shtet janë më të forta se sa ato të emigrantëve të parregullt. Kjo do të thotë se personat e trafikuar të cilët në mënyrë të pavullnetshme (nëpërmjet dhunës, kërcënimeve, mashtrimit ose shtrëngimit) e gjejnë veten duke punuar në mënyrë jo të rregullt shpesh nuk gjejnë baza ligjore për të ngritur ndonjë padi sipas të drejtës së punës, p.sh., për pagat e papaguara, përveç se kur shtetet kanë ndërmarrë posaçërisht hapa për t'i garantuar atyre të njëjtat të drejta me ato të emigrantëve të rregullt, si dhe për të siguruar që gjykatat iu njohin kontratat e punës. Mangësitë e mbrojtjes së statusit të punëtorëve të parregullt emigrantë janë njohur nga ILO dhe janë trajtuar në rezolutën e Konferencës Ndërkombëtare të Punës të vitit 2004 mbi drejtësinë për punëtorët emigrantë në ekonominë globale,<sup>554</sup> e cila konstaton se:

“Si pjesë e angazhimit më të gjerë për të nxitur punën e ndershme, ILO-ja dhe anëtarët e saj bien dakord mbi dëshirën që të maksimizohen përfitimet që mund të rrjedhin për të gjithë nga: (i) nxitja e politikave që u japin prioritet rritjes ekonomike dhe punësimin; dhe (ii) inkurajimi i emigracionit të rregullt për punë. Pranohet se ky qëllim kërkon angazhimin për të adoptuar politika kombëtare që synojnë trajtimin e barabartë të punëtorëve emigrantë me vendasit, për sa i përket të drejtës vendase të punës dhe mundësisë së zbatimit të programeve të mbrojtjes shoqërore, luftës ndaj shfrytëzimit, e cila shpesh shoqërohet me emigrantë që kanë status të parregullt, dhe promovimit të të drejtave bazë të njeriut për të gjithë emigrantët.”

Zbatimi i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore vlen të citohet edhe në këtë kontekst:

“Neni 7: Shtetet Palë të këtij Pakti njohin të drejtën e secilit për të gëzuar kushte pune të drejta e të favorshme, të cilat sigurojnë sidomos:

(a) Shpërblim të atillë që, si minimum, u siguron të gjithë punëtorëve:

<sup>553</sup> Studim mbi punën e migrantëve i Komisionit të Ekspertëve të ILO-s, 1999, paragrafi 305.

<sup>554</sup> [http://www.un.org/esa/population/meetings/thirdcoord2004/ILC\\_2004\\_Resolution.pdf](http://www.un.org/esa/population/meetings/thirdcoord2004/ILC_2004_Resolution.pdf).

- i) paga të drejta dhe shpërblim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, pa kurrfarë dallimi; në veçanti, grave duhet t'u garantohen kushte pune të cilat nuk janë më të këqija se ato që i gëzojnë burrat, me shpërblim të njëjtë si burrat për punë të njëjtë;
- ii) jetesë të denjë për vete dhe për familjet e tyre, në përputhje me dispozitat e këtij Pakti;
- (b) kushte të punës që janë të sigurta dhe higjienike;
- (c) mundësi të njëjtë për secilin për t'u ngritur gjatë punësimit në detyrë në kategorinë më të lartë e të përshtatshme, duke marrë parasysh vetëm vjetërsinë dhe aftësinë;
- (ç) Pushim, kohë të lirë, kufizim të arsyeshëm të kohës së punës dhe pushime periodike të paguara, si dhe shpërblim për ditët e festave.

Standarde të tjera të ILO-s gjenden edhe në Konventën 95 “Për mbrojtjen e pagave”<sup>555</sup> dhe në Konventën 181 “Për agjencitë private të punësimit.”<sup>556</sup> Konventa 95 rregullon disa fusha me rëndësi për viktimat e trafikimit, d.m.th., pagat duhet t'i paguhen rregullisht, të plota, drejtpërsëdrejti punëtorit, pa zbritje të paarsyeshme apo kushte për mënyrën se si duhen shpenzuar, dhe nuk duhet të kenë zbritje për të paguar ndonjë ndërmjetës. Rregullimi i zbritjeve synon posaçërisht të garantojë “mjetet e jetesës për punëtorin dhe familjen e tij.”<sup>557</sup> Neni 15 i detyron shtetet palë që të sigurojnë ekzistencën e “ndëshkimeve të duhura dhe të mjeteve të tjera mbrojtëse, të përshtatshme” për shkelje të ligjeve që vënë në jetë këto dispozita. “Mjetet e përshtatshme” do të përfshinin të drejtat e garantuara nga e drejta civile apo e drejta e punës dhe/ose të drejtat për të negociuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëpërmjet sindikatës ose ndonjë përfaqësuesi të ngjashëm. Konventa 181 parashikon në mënyrë të detajuar mbrojtje për punëtorët dhe personat që kërkojnë punë nëpërmjet agjencive private të punësimit. Kjo Konventë përmban dispozita të shumta që synojnë rregullimin e këtyre agjencive me qëllim parandalimin e abuzimeve. Të drejtat që rrjedhin nga Konventa përfshijnë ndalimin e diskriminimit nga këto agjenci (neni 5), ndalimin e pagesës së tarifave ndaj agjencive nga punëtorët (neni 7), si dhe parashikojnë detyrimin e shtetit për të marrë masa rregulluese për agjencitë që rekrutojnë punëtorë emigrantë, në veçanti agjencitë që i rekrutojnë ata nëpërmjet mashtrimit (neni 8). Neni 14(3) përcakton se për shkelje të të drejtave të parashikuara nga Konventa, duhet të sigurohen “mjete mbrojtëse të përshtatshme.”

<sup>555</sup> E miratuar më 1 korrik 1949 dhe hyri në fuqi më 24 shtator 1952. E ratifikuar nga 95 vende, nga të cilat 28 janë Shtetet pjesëmarrëse në OSBE-në (17 korrik 2007).

<sup>556</sup> E miratuar më 19 qershor 1997 dhe hyri në fuqi më 10 maj 2000. E ratifikuar nga 20 vende, 13 prej të cilave janë Shtete pjesëmarrëse në OSBE-në (17 korrik 2007)

<sup>557</sup> Paragrafi 1.1, *Rekomandimi i ILO-s RO85 për Mbrojtjen e Pagave*.

Standardet e ILO-s mbi punën e detyruar, emigrantët, pagat dhe agjencitë private, të gjitha përforcojnë të drejtat e shumta të punës që u përkasin personave të trafikuar, si dhe të drejtën për zhdëmtim, përfshirë dëmshpërblimin e personave, të drejtat e të cilëve janë abuzuar. Ratifikimi dhe zbatimi efikas i këtyre konventave është i domosdoshëm për mbrojtjen e njerëzve të trafikuar, sepse do të përmirësonin të drejtat e tyre të punës dhe do të rrisnin mundësinë e marrjes së shpërblimit në zbatimin e këtyre të drejtave. Duke theksuar të drejtën për t'u zhdëmtuar me mjete efektive, këto dokumente përforcojnë të drejtën për dëmshpërblim në të drejtën ndërkombëtare, sidomos për viktimat e shfrytëzimit në punë.

## **Shtojca II: DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE POLITIKISHT TË DETYRUESHME**

Shumë dokumente ndërkombëtare politikisht detyruese (standardet “*soft law*,” jo të detyrueshme ligjërisht) burojnë nga sistemi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Vlen të përmendet veçanërisht Deklarata mbi Parimet Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe Abuzimit të Pushtetit,<sup>558</sup> e cila thotë se kthimi i dëmit dhe kompensimi ose dëmshpërblimi duhet t’i bëhen të disponueshme viktimës së krimit:

“Kthimi i dëmit.

8. Shkelësit apo palët e treta që janë të përgjegjshëm për sjelljen e tyre duhet të dëmshpërblejnë, kur është e përshtatshme, në mënyrë të drejtë, viktimat, familjet e tyre dhe personat që ato kanë në ngarkim. Kthimi duhet të përfshijë kthimin e pronës si dhe pagesën e dëmeve apo të humbjeve të pësuar, rimbursimin e shpenzimeve të kryera si pasojë e viktimizimit, furnizimin e shërbimeve dhe rivendosjen e të drejtave.

9. Qeveritë duhet të rishikojnë praktikatat e tyre, ligjet dhe aktet nënligjore me qëllim marrjen në konsideratë kthimin e dëmit si një dënim të disponueshëm për çështjet penale, si dënim shtesë përveç dënimeve të tjera penale.

10. Në rastet e dëmtimeve të konsiderueshme të mjedisit, kthimi i dëmit, nëse urdhërohet, duhet të përfshijë, për aq sa është e mundur, kthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme, rikonstruktimin e infrastrukturës, zëvendësimin e lehtësive të komunitetit dhe rimbursimin e shpenzimeve të zhvendosjes, për çdo rast kur dëmtimi ka shkaktuar çrregullime në komunitet....”.

“Dëmshpërblimi

12. Kur dëmshpërblimi nuk mund të merret plotësisht nga autori i veprës penale ose nga burime të tjera, Shtetet duhet të bëjnë përpjekje për të dhënë dëmshpërblim financiar për:

(a) viktimat që kanë pësuar dëme dhe dëmtime të shëndetit fizik dhe mendor të shkaktuara nga krime të rënda;

(b) familjet, në veçanti personat në ngarkim të atyre personave që kanë vdekur ose janë bërë të paaftë fizikisht dhe mendërisht për shkak të viktimizimit të tillë.

13. Ngritja, forcimi dhe zgjerimi i fondeve kombëtare për dëmshpërblimin e viktimave duhet inkurajuar. Ku është e përshtatshme, fonde të tjera mund të

---

<sup>558</sup> E miratuar nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/34, më 29 nëntor 1985.

ngrihen për këtë qëllim, duke përfshirë rastet ku Shteti, kombas i të cilit është viktimë, nuk është në gjendje të shpërblejë viktimën për dëmin.

Deklarata në thelb ia vë detyrimin kryesor autorit të veprës penale për t'i "kthyer dëmin" viktimës. Nëse kjo nuk ndodh, shteti duhet të ndërhyjë dhe të paguajë "dëmshpërblim," por vetëm në rastet e krimeve të rënda dhe të dëmtimeve të rënda.<sup>559</sup> Kjo njohje e të drejtës së kufizuar të dëmshpërblimit të financuar nga shteti përsëritet në standardet e Këshillit të Evropës dhe të Bashkimit Evropian (shih më poshtë). Është interesant fakti që ky moment nuk është vënë në dukje nga Protokollin e Trafikimit, edhe pse është menduar se trafikimi është domosdoshmërisht një krim i rëndë. Përfundim tjetër interesant është se mundësitë për kthim (nga autori i veprës penale) duhet të konsiderohen si dënim në të gjitha çështjet penale dhe viktimat nuk duhen kufizuar me mundësinë e ngritjes së padisë civile. Megjithatë, është e qartë se nuk mund të bazohemi tek Deklarata për të mbështetur thirrjet për kompensim financiar nga shteti për të gjitha çështjet e trafikimit, por vetëm në rast se ka ndodhur dëmtim ose çrregullim i rëndë i shëndetit fizik ose mendor.

Gjithashtu, ka rëndësi që Deklarata përmban dispozita që bëjnë detyruese edhe ndihma të tjera që u duhen dhënë viktimave, duke përfshirë këtu informimin për të drejtat e tyre për t'u dëmshpërblyer dhe për t'u ndihmuar gjatë procesit.<sup>560</sup>

Dallim i vlefshëm mes të drejtës së dëmshpërblimit dhe të kthimit të dëmit ekziston tek Parimet Themelore dhe Udhëzimet për të Drejtën e Mjeteve Mbrojtëse dhe Zhdëmtimin për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare.<sup>561</sup>

"Para. 19. Kur është e mundur, kthimi i dëmit duhet ta kthejë viktimën në situatën origjinale përpara se të ndodhnin shkeljet e mëdha të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Kthimi përfshin, sipas rastit: rivendosjen e lirisë, të gëzimit të të drejtave të njeriut, të identitetit, të jetës në familje dhe të nënshtetësisë, të kthimit në vendbanim, të rivendosjes së punës dhe të kthimit të e pronave.

---

<sup>559</sup> Ndryshimi midis koncepteve të kthimit të dëmit dhe dëmshpërblimit nuk është bërë i qartë, përveç në referimin e burimit të pagesës. Për kthimin e dëmit jepen disa detaje, por koncepti nuk është thelbësisht i ndryshëm nga dëmshpërblimi në kontekste të tjera.

<sup>560</sup> Para. 4, 5 dhe 6.

<sup>561</sup> Rezoluta 60/147 e Asamblesë së Përgjithshme, më 16 dhjetor 2005.

Para. 20. *Dëmshpërblimi* duhet të jepet për çdo dëm, vlera e të cilit mund të vlerësohet ekonomikisht, siç është në përputhje dhe në përpjestim me rëndësinë e shkeljes dhe me rrethanat e secilës çështjeje, dëm i cili është shkaktuar nga shkeljet e mëdha të së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, siç janë:

- (a) dëmtim fizik ose mendor;
- (b) shanse të humbura, duke përfshirë punësimin, arsimimin dhe përfitimet shoqërore;
- (c) dëme materiale dhe humbje e të ardhurave, duke përfshirë humbje të mundësisë për të fituar para;
- (ç) dëm moral;
- (d) shpenzime të nevojshme për ndihmë ligjore apo ndihmë nga ekspertë, shërbime mjekësore dhe ilaçe, si dhe shërbime psikologjike e sociale.”

Ky dokument zbatohet vetëm në masën e kufizuar, për viktimat e trafikimit të cilat mund të kenë pretendime se iu janë shkelur të drejtat e njeriut ose pretendime në nivelin e shkeljes të të drejtave humanitare, si p.sh., kur aktorë shtetërorë shfrytëzojnë postet e tyre duke u bërë në mënyrë sistematike përgjegjës për trafikimin e personave, ose kur trafikimi i personave civilë ndodh gjatë një konflikti të armatosur. Gjithashtu, dokumenti detajon llojet e dëmeve që parashikohen se mund të kompensohen, të cilat përfshijnë jo vetëm dëmet materiale (ose financiare), por edhe ato morale (d.m.th., humbjet joekonomike si dhimbja dhe vuajtja, humbja e reputacionit, vuajtje mendore, të cilat nuk mund të llogariten si çështje ekonomike). Në të gjitha rastet, burimi që parashikohet për të përballuar dëmshpërblimin është shteti, duke pasur parasysh përgjegjësinë e qenësishme që ka për shkeljet e të drejtave të njeriut. Këto lloje çështjesh nuk janë trajtuar në këtë raport.

Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Drejtësinë e të Miturve që janë Viktima dhe Dëshmitarë të Krimit<sup>562</sup> të cilat kanë si qëllim që të ofrojnë qasje miqësore për fëmijët në dhënien e “zhdëmtimeve,” theksojnë se procedurat duhet të jenë të lehta për t’u përdorur dhe, kur kjo të jetë e mundur, të trajtohen bashkë me çështjen penale. Gjithashtu udhëzimet marrin përsipër të paraqesin llojet e dëmshpërblimeve që një fëmijë duhet të marrë, duke u përqendruar tek shpenzimet materiale:

*“I. E drejta për zhdëmtim*

36. Kur të jetë e mundur, viktimat dhe dëshmitarët e mitur duhet të zhdëmtohen, për të arritur shpazim të plotë, riintegrimin dhe rimëkëmbjen.

---

<sup>562</sup> ECOSOC 2004/27. (*ECOSOC* është Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara).



Procedurat për marrjen dhe zbatimin e zhdëmtimit duhet të jenë të lehta për t'u përdorur dhe të ndjeshme ndaj të miturve.

37. Me kusht që proceset duhet të jenë gjithmonë të ndjeshme ndaj të miturve dhe të respektojnë këto udhëzime, duhet nxitur bashkimi i proceseve penale dhe zhdëmtuese, së bashku me procedurat e drejtësisë jo zyrtare dhe me dënime joformale jashtë burgjeve ("*community justice*"), siç janë format e drejtësisë të quajtura "*restorative justice*" (kur keqbërësit marrin përgjegjësinë për veprimet e tyre dhe riparojnë dëmet e bëra në mënyra të ndryshme).

38. Zhdëmtimi mund të përfshijë kthimin e dëmit nga ana e autorit të veprës penale të urdhëruar në çështjen penale, ndihmë nga programe shtetërore për dëmshpërblimin e viktimave si dhe dëme, pagesa e të cilave urdhërohet në çështjen civile. Ku është e mundur, duhen të trajtohen edhe kostot e riintegritimit arsimor dhe shoqëror, të kujdesit mjekësor, të kujdesit për shëndetin mendor dhe të tarifave të avokatëve. Duhet parashikuar procedura të cilat sigurojnë zbatimin automatik të urdhrave për zhdëmtim dhe pagimin e zhdëmtimit, përpara se të aplikohen gjoba."

*Udhëzuesi i Referencave i UNICEF-it për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, Viktima të Trafikimit, në Evropë, i mbështetur në Udhëzimet për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve që janë Viktima të Trafikimit, rithekson kërkesën për të informuar dhe për të ndihmuar fëmijët që janë viktima, si dhe paraqet një listë të gjatë të llojeve të dëmeve dhe humbjeve që duhen shpërblyer, duke përfshirë dëmet materiale dhe morale (si dhe për shanset e humbura, si arsimimi), pavarësisht nga natyra e punës.<sup>563</sup>*

*Parimet e Rekomanduara dhe Udhëzimet mbi të Drejtat e Njeriut dhe mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore të UNHCR-së<sup>564</sup> e lidhin çështjen e konfiskimit të pasurive nga kriminelët me dëmshpërblimin e viktimave të trafikuar.<sup>565</sup> Kjo temë është përzgjedhur nga OSBE-ja (shih më poshtë). Ajo bën thirrje që interesat e fëmijëve të mbrohen gjatë procedurave të dëmshpërblimit.<sup>566</sup> Udhëzimi 9 i lidh të drejtat e viktimave për zhdëmtim (duke përfshirë dëmshpërblim) me "disponueshmërinë e asistencës ligjore dhe të ndihmave të tjera materiale," si dhe me informacionin që gjendet lehtë dhe me të drejtën për të qëndruar në atë shtet ndërkohë që procedurat ligjore janë në zhvillim e sipër.*

---

<sup>563</sup> Përgatitur nga Mike Dottridge për zyrën rajonale të UNICEF-it për CEE/CIS, 2006, f. 99-101.

<sup>564</sup> Raporti i Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut përpara Këshillit Ekonomik dhe Social, *E/2002/68/Add.1, ECOSOC, 20 maj 2002.*

<sup>565</sup> Po aty, Udhëzimi 4.

<sup>566</sup> Po aty, Udhëzimi 8.

Kur trafikimi arrin deri në dhunë me bazë gjinore, atëherë zbatohen standardet e tjera *soft law*, për të përforcuar të drejtën për dëmshpërblim, duke i detyruar shtetet që të ngrenë mekanizma dëmshpërblimi që mund të përdoren lehtë nga viktimat femra.<sup>567</sup>

---

<sup>567</sup> “Një numër i konsiderueshëm standardesh dhe traktatesh për të drejtat e njeriut që trajtojnë dhunën ndaj grave theksojnë gjithashtu rëndësinë e dëmshpërblimit:

- Paragrafi 10c i Rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 52/86 (Masat e parandalimit të krimit dhe të drejtësisë penale për të eliminuar dhunën ndaj grave: Strategjitë model dhe masat praktike për eliminimin e dhunës ndaj grave në fushën e parandalimit të krimit dhe të drejtësisë penale) nxit Shtetet Anëtare për të garantuar që gratë të cilat i janë nënshtruar dhunës të marrin zhdëmtim, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar kthim apo dëmshpërblim nga kriminelët ose nga Shteti.<sup>78</sup>
- Rekomandimi i përgjithshëm nr.19 i Kombeve të Bashkuara, i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, viti 1992, pranon se “shtetet mund të jenë përgjegjëse për aktet e privatëve nëse ato nuk veprojnë me kujdesin e duhur për ...të parashikuar dëmshpërblim.”
- Paragrafi 124(d) i Platformës së Pekinit për Veprim, e miratuar nga Konferenca 4 për Gratë e Kombeve të Bashkuara, 1995 (118), thotë se qeveritë duhet “të marrin masa për të siguruar mbrojtjen e grave që i nënshtrohen dhunës, të sigurojnë mundësi për zhdëmtime të drejta dhe efektive, duke përfshirë dëmshpërblimin dhe kthimin si dhe shërimin e viktimave.” Grupi Ndërkombëtar i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, shih profilin e vendeve, për Mbretërinë e Bashkuar.

### **Shtojca III: DOKUMENTET LIGJORE RAJONALE DETYRUESE (PËR SHTETET PALË)**

#### **Këshilli i Evropës**

Konventa e Këshillit të Evropës mbi Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>568</sup> (Konventa Evropiane kundër Trafikimit) hyri në fuqi më 1 shkurt 2008. Deri tani është ratifikuar nga 17 shtete dhe është firmosur nga 21 të tjera.<sup>569</sup> Kështu, deri tani ajo nuk ka fuqi detyruese por ka shumë gjasa që të bëhet një standard më i fortë gjatë viteve në vazhdim. Të 17 shtetet palë janë pjesëmarrëse në OSBE. (Konventa është e hapur për shtete që nuk janë anëtare të Këshillit të Evropës).

Konventa trajton çështje të “dëmshpërblimit dhe zhdëmtim ligjor” në nenin 15 dhe lidh të drejtën për mjetet e zhdëmtimit drejtpërdrejtë me disa të drejta anësore, siç janë: e drejta për t’u informuar për mjetet e zhdëmtimit në gjuhën që ata kuptojnë, e drejta për asistencë ligjore dhe ndihmë ligjore (por jo të drejtën natyrore për ndihmë ligjore falas), dhe mundësia që të ketë lejen e qëndrimit gjatë kohëzgjatjes së procedurave.<sup>570</sup> Për sa ka rëndësi për qëllimet e këtij studimi, Konventa shprehet se:

“3) Çdo Shtet Palë detyrohet të parashikojë, në të drejtën e tij të brendshme, të drejtën e viktimave për dëmshpërblim nga autorët e krimeve;

4) Çdo Shtet Palë detyrohet të miratojë masa legislative dhe masa të tjera të tilla që mund të jenë të nevojshme për të garantuar dëmshpërblim për viktimat në përputhje me kushtet sipas së drejtës së tij të brendshme, për shembull, përmes vendosjes së një fondi për dëmshpërblimin e viktimave ose përmes masave apo programeve që synojnë ndihmën sociale dhe integrimin shoqëror të viktimave, të cilat mund të financohen nga pasuritë që rezultojnë nga zbatimi i masave të parashikuara në nenin 23.”

Gjuha e përdorur në këtë Konventë për detyrimin për të mundësuar dëmshpërblim duket se është më e fortë se sa ajo e Protokollit të Trafikimit. Megjithatë, e drejta mbetet një e drejtë për të përfituar dëmshpërblim nga keqbërësi, ndërkohë që kompensimi i financuar nga shteti mbetet i kufizuar në “atë që parashikohet nga e drejta e brendshme.” Raporti shpjegues i Këshillit të Evropës thotë se “Qëllimi i këtij neni është sigurimi që viktimat e trafikimit të

<sup>568</sup> Miratuar më 16 maj 2005, hyri në fuqi më 1 shkurt 2008.

<sup>569</sup> Statusi në 18 prill të vitit 2008. Për statusin aktual, shih [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/trafficking/default\\_en.asp](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/trafficking/default_en.asp)

<sup>570</sup> Shih raportin shpjegues para. 192-196.

qenieve njerëzore të dëmshpërblehen për dëmet e pësuar.”<sup>571</sup> Parashikohet në mënyrë të vlefshme që kjo e drejtë do të thotë padi civile kundër trafikantit, e cila i mbulon “si dëmet materiale (siç janë shpenzimet për trajtimin mjekësor) ashtu edhe ato jomateriale (vuajtja e pësuar).”<sup>572</sup> Vështirësitë logjistike në ngritjen e padisë kundër trafikantit janë tashmë të njohura.

Këshilli i Evropës sugjeron gjithashtu që fondet që rezultojnë nga pasuritë kriminale mund të përdoren për të financuar skemën e shtetit (dhe në mënyrë konfonduese e ngatërron këtë skemë me skemën e shtetit që mbështet viktimat në përgjithësi në vend që të përqendrohet tek dëmshpërblimi individual), duke u bazuar kryesisht tek standardet e Konventës Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme<sup>573</sup> (KEDVKDh) si model.<sup>574</sup> Në mënyrë domethënëse, Konventa Evropiane kundër Trafikimit nuk thotë që të gjitha viktimat e trafikimit kanë të drejtën për t’u dëmshpërblyer nga shteti, por që shteti duhet të krijojë një fond, i cili mund të jetë i kufizuar në kuptim të “bazës ligjore për dëmshpërblim, kuadrit administrativ dhe rregullimeve operacionale” nga e drejta e brendshme ose nga standardet e përcaktuara prej KEDVKDh-së. Kjo e kufizon detyrimin që Shteti duhet të paguajë dëmshpërblim në çështjet e “dëmeve të rënda fizike dhe dëmtimeve shëndetësore që vijnë si pasojë direkte e një krimi të qëllimshëm e të dhunshëm.”<sup>575</sup>

Në lidhje me të drejtat anësore, raporti shpjegues thotë se “është e rëndësishme së dorës së parë” që (viktimat) të informohen për çdo procedurë që mund të përdorin për të përfituar dëmshpërblim” si dhe për të drejtat e tyre për marrjen e lejeve të qëndrimit që i krijojnë atyre mundësinë të jetojnë në atë shtet për të ndjekur ecurinë e kërkesës së tyre. Po aty përmendet gjithashtu se kjo duhet të ndodhë “që në kontaktin e tyre të parë me autoritetet kompetente.”<sup>576</sup> Ndërkohë që e drejta për ndihmë ligjore falas nuk trajtohet nga kjo konventë, Memorandumi Shpjegues u kujton shteteve palë se Gjykata Evropiane për të Drejtat Njeriut (GjEDNj) është shprehur në disa çështje civile se ekziston e drejta për ndihmë ligjore falas sipas nenit 6(1) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

---

<sup>571</sup> *Explanatory Report - Action against Trafficking in Human Beings* (Raporti shpjegues – Veprime kundër trafikimit të qenieve njerëzore), 16 maj 2005, f. 52.

<sup>572</sup> Para. 197.

<sup>573</sup> Konventa Evropiane për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme [ETS Nr.116] <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Word/116.doc>

<sup>574</sup> Para. 198-199.

<sup>575</sup> Neni 2(1).

<sup>576</sup> F. 52-53.

Qëndrimi i GjEDNj është i tillë që duhet të përcaktohet nëse dalja përpara gjykatës pa ndihmën e avokatit do të jetë efektive, në kuptimin që personi i interesuar do të ishte në gjendje që ta paraqiste çështjen e tij në mënyrë të duhur e të kënaqshme.

Në çështjen *Golder v. Mbretërisë së Bashkuar*, GjEDNj-ja mori parasysh kompleksitetin e procedimit dhe natyrën emocionale të situatës, për të vendosur nëse personi mund ta përfaqësonte çështjen vetë. Nëse jo, ata vendosën që t'i jepej ndihmë ligjore falas në interes të drejtësisë.<sup>577</sup> Pra, të drejtën për t'u informuar për dëmshpërblim dhe ndihmën ligjore falas e nënvizon më tepër kjo Konventë për shtetet palë sesa ndonjë dokument tjetër.

KEDVKDh-ja<sup>578</sup> parashikon një skemë dëmshpërblimi të financuar nga shteti i cili, si minimum, kompenson nënshtetasit dhe banorët e përhershëm<sup>579</sup> të shtetit palë, të cilët janë viktimat të “dëmtimeve të rënda fizike ose të çrregullimeve shëndetësore që i janë shkaktuar nga një krim i dhunshëm dhe i qëllimshëm.”<sup>580</sup> Edhe pse jo të gjitha shtetet e OSBE-së apo të Bashkimit Evropian janë palë të kësaj Konvente, ajo shihet si standardi qendror evropian mbi skemën e dëmshpërblimit të financuar nga shteti. Komentari i Konventës sugjeron që përkufizimi i dëmtimit mund të mbulojë edhe dëmtimet e shkaktuara nga dhuna psikologjike dhe se termi shëndet “mund” t'i referohet shëndetit mendor.<sup>581</sup> Dëmshpërblimi duhet të mundësohet edhe kur shkelësi nuk është ndjekur penalisht as nuk ka qenë dënuar<sup>582</sup> dhe duhet të mbulojë si minimum: humbjen e të ardhurave, shpenzimet për trajtimin mjekësor, për spitalin dhe për varrimin, si dhe mjetet e jetesës së personave në ngarkim.<sup>583</sup> Komentari përmend faktin që dëmet morale si dhimbja dhe vuajtja, humbja e shpresave në jetë, si dhe shpenzimet shtesë shkaktuar nga paaftësia, nuk janë të detyrueshme për kompensim, por u nënshtrohen politikave dhe legjislacionit vendas. Është e rëndësishme të theksohet se ka kufizime të lejueshme mbi të drejtën e kërkuarit, sipas karakterit të kërkuarit dhe veprimeve të tij të mëparshme:

“1. Dëmshpërblimi mund të zvogëlohet apo të refuzohet në varësi të sjelljes së viktimës ose të kërkuarit përpara krimit, gjatë krimit dhe pas krimit, ose në lidhje me dëmtimin apo me vdekjen.

---

<sup>577</sup> F. 53.

<sup>578</sup> Ndërmjet shteteve të trajtuara në këtë studim, KEDVKDh është ratifikuar nga Rumania, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Ukraina dhe Shqipëria.

<sup>579</sup> Nocioni “banor i përhershëm” ka si qëllim mbrojtjen e punëtorëve të rregullt emigrantë, ndërkohë që është e qartë, se këto dispozita nuk parashikojnë asgjë për emigrantët jo të rregullt. Shih para. 22-27, Raporti Shpjegues dhe Komentari.

<sup>580</sup> Apo personat në ngarkim, neni 2(1).

<sup>581</sup> Para. 18-19, Raporti Shpjegues dhe Komentari.

<sup>582</sup> Neni 2(2).

<sup>583</sup> Neni 4.

2. Dëmshpërblimi mund të zvogëlohet apo të refuzohet gjithashtu në varësi të përfshirjes së viktimës apo kërkuesit në krimin e organizuar ose të anëtarësisë së tij në një organizatë që kryen krime të dhunshme.

3. Dëmshpërblimi mund të zvogëlohet apo të refuzohet gjithashtu nëse dhënia e tij, apo dhënia e plotë e tij, do të binte në kundërshtim me sensin e drejtësisë ose me politikat publike (*ordre public*).<sup>584</sup>

Kjo do të thotë, për shembull, se kërkuesi me dënime të mëparshme pa lidhje me krimin në fjalë mund t'i mohohet dëmshpërblimi. Kjo mund të ndodhë edhe nëse mendohet që kërkuesi e ka "provokuar" krimin ose ka kontribuar në ndonjë mënyrë për të.<sup>585</sup>

## **Bashkimi Evropian**

Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së i datës 15 mars 2001 për pozitën e viktimave në procesin penal<sup>586</sup> paraqet në hollësi garanci të shumta që u duhen siguruar të gjitha viktimave të krimit në shtetet e BE-së, duke përfshirë të drejtën për mbështetje dhe për informacionin mbi procedurat (duke përfshirë edhe dëmshpërblim),<sup>587</sup> të drejtën për ndihmë ligjore dhe asistencë,<sup>588</sup> të drejtën për mbrojtje dhe për minimizimin e traumës gjatë procesit gjyqësor,<sup>589</sup> të drejtën e viktimës që banon në një shtet tjetër të BE-së për të patur të njëjtat të drejta me banorët rezidentë<sup>590</sup> dhe, më e rëndësishmja, të drejtën për dëmshpërblim:

### *“Neni 9. E Drejta për dëmshpërblim gjatë procesit penal*

1. Çdo Shtet Anëtar duhet të garantojë se viktimat e veprave penale kanë të drejtë që t'u jepet vendim brenda afateve kohore të arsyeshme gjatë procesit penal për dëmshpërblim prej autorit të veprës, përveç rasteve të caktuara kur legjislacioni i brendshëm parashikon se dëmshpërblimi mund të jepet në një mënyrë tjetër.
2. Çdo Shtet Anëtar duhet të marrë masat e përshtatshme për të nxitur autorin e veprës penale që t'u japë dëmshpërblimin e duhur viktimave.
3. Përveç rasteve kur ka nevojë urgjente për të në procesin penal, pasuria që mund të merret, sekuestruar gjatë procesit penal, e cila u përket viktimave, u kthehet atyre pa vonesë.

---

<sup>584</sup> Neni 8.

<sup>585</sup> Para. 33 - 37, Raporti Shpjegues dhe Komentari.

<sup>586</sup> [http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2001/l\\_o82/l\\_o8220010322en00010004.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2001/l_o82/l_o8220010322en00010004.pdf).

<sup>587</sup> Nenet 4, 13 dhe 14.

<sup>588</sup> Neni 6.

<sup>589</sup> Nenet 2, 5, 8 dhe 15.

<sup>590</sup> Neni 11.

Kjo e drejtë kufizohet nga fakti se duhet një vendim i shpejtë në lidhje me dëmshpërblimin nga autori i veprës penale gjatë procesit penal, dhe duke “e inkurajuar” më tepër sesa duke e detyruar autorin e veprës penale për të zhdëmtuar në mënyrë të përshtatshme viktimat. Prandaj, nuk krijohet një e drejtë për rikuperimin e dëmeve nga autori i veprës penale apo për dëmshpërblim nga shteti, dhe kjo mund të rezultojë nga fakti se vendimi kufizohet në çështje që lidhen me procesin penal dhe pranon faktin se, në disa shtete të BE-së, ky mund të mos jetë forumi i duhur për kërkesat për dëmshpërblim.

Direktiva e Këshillit të BE-së e vitit 2004 për Dëmshpërblimin e Viktimave të Krimeve<sup>591</sup> parashikon sistemin e bashkëpunimit për të lehtësuar mundësinë e marrjes së dëmshpërblimit nga ana e viktimave të krimeve të dhunshme dhe të qëllimshme, të kryera në territorin e këtyre vendeve.<sup>592</sup> Ajo detyron shtetet që të krijojnë skemën e financuar nga shteti për pagesat në këto raste<sup>593</sup> dhe që të vendosin struktura bashkëpunimi për individët nga shtete të tjera anëtare të BE-së, për të garantuar që ato lehtësisht të mund të përfitojnë nga skemat e vendeve, nënshtetasit e të cilave ato janë.

Prandaj, një mekanizëm dëmshpërblimi i financuar nga shteti duhet të ekzistojë në çdo shtet anëtar edhe pse mund të jetë për kategori të kufizuara krimesh. Sigurisht, që nuk ka asnjë pengesë për shtetet për të shkuar përtej kësaj kategorie të kufizuar, për shembull, duke ndërmarrë hapa për të dëmshpërblyer viktimat për krime të kryera jashtë territorit të tyre.

Sipas pikëpamjes së Grupit të Ekspertëve të Komisionit të Evropës për Trafikimin, viktimat e trafikimit duhen konsideruar në mënyrë automatike se kanë të drejtë për të përfituar nga skemat e ngritura për viktimat e krimeve të dhunshme dhe të qëllimshme,<sup>594</sup> dhe sugjerojnë se:

“nevojitet një instrument ligjor detyrues i BE-së për pozitën në procesin penal të personave të trafikuar, për të garantuar trajtim të përshtatshëm, ndihmë, mbrojtje dhe dëmshpërblimin e viktimave”<sup>595</sup>

---

<sup>591</sup> 29 prill 2004,

[http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2004/l\\_261/l\\_26120040806en00150018.pdf](http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/en/oj/2004/l_261/l_26120040806en00150018.pdf).

<sup>592</sup> Neni 1.

<sup>593</sup> Nenet 2 dhe 12 (2).

<sup>594</sup> Para. 129, *Raporti i Grupit të Ekspertëve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore* (Bruksel, 22 dhjetor 2004).

<sup>595</sup> *Mendimi i Grupit të Ekspertëve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore të Komisionit Evropian* i datës 11 tetor 2005.

si prioritet i BE-së, pasi mendojnë se normat ligjore ekzistuese janë të pazhvilluara në lidhje me viktimat e trafikimit. Gjithashtu, ata theksojnë se ndihma ligjore dhe qëndrimi i përkohshëm janë të nevojshme përgjatë ecurisë së procedimeve ligjore dhe se viktimat duhet të kenë të drejtë dëmshpërblimi për humbjet ekonomike, si dhe për dëmtimet që kanë pësuar.<sup>596</sup> Vihet re se Vendimi Kuadër i Këshillit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>597</sup> nuk përmban parashikime të veçanta për dëmshpërblimin, dëmet apo mundësinë për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, as Plani i BE-së për Praktikën e Mira, Standardet dhe Procedurat për të Luftuar dhe Parandaluar Trafikimin e Qenieve Njerëzore.<sup>598</sup>

---

<sup>596</sup> Seksioni 6.6, *Raporti i Grupit të Ekspertëve për Trafikimin e Qenieve Njerëzore* (Bruksel, 22 dhjetor 2004).

<sup>597</sup> 2002/629/JHA.

<sup>598</sup> 2005/C311/01.



## **Shtojca IV: DOKUMENTE RAJONALE POLITIKISHT TË DETYRUESHME**

### **Këshilli i Evropës**

Këshilli i Ministrave i Këshillit të Evropës ka miratuar një sërë rekomandimesh lidhur me viktimat e krimit apo lloje të caktuara krimesh, të cilat janë të politikisht detyrueshme për të gjitha Shtetet anëtare.<sup>599</sup> Rekomandimi Rec (2006) 8 i Komitetit të Ministrave të Shteteve Anëtare për Ndhimën ndaj Viktimave të Krimit është më i fundit prej tyre, ishte miratuar pas Konventave të Trafikimit dhe të Dëmshpërblimit dhe në thelb konfirmon çështjet kryesore lidhur me të drejtat që kemi shqyrtuar më lart, për shembull:

“8.1 dëmshpërblimi duhet dhënë nga shteti:

- për viktimat e krimeve të rënda, të qëllimshme dhe të dhunshme, duke përfshirë dhunën seksuale;
- për personat familjarë të shkallës së parë dhe ata në ngarkim të viktimës e cila ka vdekur si pasojë e krimit të tillë.”

Megjithatë, ai pohon se këto skema duhen zbatuar “pavarësisht nga kombësia e viktimës” dhe inkurajon bashkëpunimin midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në drejtime të njëjta si ato që kërkohen nga BE-ja. Ato japin hollësi lidhur me natyrën e dëmeve që duhen zhdëmtuar nga shteti dhe theksojnë se për dëmet morale dhe rehabilitimin:

- “8.6... duhet ofruar trajtim dhe rehabilitim për dëmet fizike dhe psikologjike
- 8.7... duhet (marrë) parasysh dëmshpërblimi për humbjen e të ardhurave, shpenzimet e varrimit dhe humbjen e të drejtës së kujdestarisë për personat në ngarkim. Shtetet gjithashtu mund të marrin parasysh dëmshpërblimin për dhimbjet dhe vuajtjet.
- 8.8 Shtetet mund të marrin parasysh mjetet për të zhdëmtuar dëmet që vijnë si pasojë e krimeve kundër pronës.”

Rekomandimi i vitit 2000, i cili përqendrohet në trafikimin e qenieve njerëzore,<sup>600</sup> kufizohet në garantimin se “viktimat mund t’i paraqesin paditë e tyre edhe para gjykatave civile që janë kompetente që të marrin vendime ... dhe t’iu njohin atyre shpërblimin e dëmeve,”<sup>601</sup> por në

---

<sup>599</sup> Shih *Victims – Support and Assistance* (Viktimat – Mbështetja dhe Ndihma) (Këshilli i Evropës, 2006) për të gjitha dokumentet.

<sup>600</sup> Veprime kundër trafikimit të qenieve njerëzore për qëllim të shfrytëzimit seksual, Rekomandimi R (2000) 11 i Komitetit të Ministrave më 19 maj 2000 (dhe memorandumit shpjegues.)

<sup>601</sup> Shih memorandumit shpjegues.

vitin 2002 Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës rekomandoi se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që shtetet “të parashikojnë krijimin e sistemeve të financimit me qëllim që të dëmshpërblejnë viktimat (femra) (të dhunuara).”<sup>602</sup>

## **OSBE-ja**

Plani i Veprimit i OSBE-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore<sup>603</sup> kërkon nga Shtetet pjesëmarrëse që të marrin parasysh krijimin e një fondi me të ardhura që janë produkte të konfiskuara nga trafikimi për t’i përdorur në dobi të viktimave të trafikimit, duke përfshirë krijimin e fondit për t’i dëmshpërblyer ato.<sup>604</sup>

## **Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore**

Udhëzimet për Planet e Veprimit Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>605</sup> të grupit *Task Force* të Paktit të Stabilitetit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore theksojnë dëmshpërblimin nga shfrytëzuesit dhe mbikëqyrjen e paanshme të shumave të dhëna në lidhje me dëmet e pësuar.

---

<sup>602</sup> Shih Rekomandimin R (2002) 5 për mbrojtjen e grave ndaj dhunës, para. 36 dhe 37.

<sup>603</sup> Vendimi i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së Nr. 557, 24 korrik 2003.

<sup>604</sup> Seksioni III, Para. 1.5.

<sup>605</sup> <http://www.stabilitypact.org/trafficking> .

**Shtojca V: TABELAT E NËNSHKRIMEVE DHE TË RATIFIKIMEVE TË STANDARDEVE NDËRKOMBËTARË PËRKATËSE**

SIMBOLET: P = palë, N = nënshkruar, R = data e ratifikimit, F = në fuqi/ hyrja në fuqi, Z = e zbatueshme (i detyrueshëm politikisht)

Konventat Ndërkombëtare – ligjërish të detyrueshme për shtetet anëtare:

	Shqipëria	Franca	Moldavia	Rumania	Rusia	Mbretëria e Bashkuar	SHBA	Ukraina
Konventa e Kombeve të Bashkuara për Krimin e Organizuar Ndërkombëtar (KKBKON) 29.9.03	P R 21.8.02	P R 29.10.02	P R 16.9.05	P R 4.12.02	P R 26.5.04	P R 9.2.06	P R 3.11.05	P R 21.5.04
Protokolli i KKBKON për të Parandaluar, Suprimuar dhe Dënuar Trafikimin e Personave, veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve, 15.12.2003	P R 21.8.02	P R 29.10.02	P R 16.12.05	P R 4.12.02	P R 26.5.04	P R 9.2.06	P R 3.11.05	P R 21.5.04
Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punonjësve Emigrantë dhe të Anëtarëve të Familjeve të Tyre	–	–	–	–	–	–	–	–
	<b>Shqipëria</b>	<b>Franca</b>	<b>Moldavia</b>	<b>Rumania</b>	<b>Rusia</b>	<b>Mbretëria e Bashkuar</b>	<b>SHBA</b>	<b>Ukraina</b>
Konventa 29 e ILO-s Për Punën e Detyruar 1930	P R 25.6.57	P R 24.6.37	P R 23.3.00	P R 28.5.57	P R 23.6.56	P R 3.6.31	–	P R 10.8.56
Konventa 105 e ILO-s Për Zhdukjen e Punës Së Detyruar 1957	P R 27.2.97	P R 18.12.69	P R 10.3.93	P R 3.8.98	P R 2.7.98	P R 30.12.57	P R 25.9.91	P R 14.12.00
Konventa 97 e ILO-s Për Migracionin për Punësim (Rishikuar) 1949	P R 2.3.05	P R 29.3.54	P R 12.12.05	–	–	P R 22.1.51	–	–
Konventa 143 e ILO-s Për Punonjësit Emigrantë (Parashikime shtesë) 1975	P R 12.9.06	–	–	–	–	–	–	–
Konventa 95 e ILO-s Për Mbrojtjen e Pagave 1949	P R 2.8.01	P R 15.10.52	P R 12.8.96	P R 6.6.73	P R 4.5.61	Denoncuar në 1983	–	–
Konventa 181 e ILO-s Për Agjencitë Private të Punësimi 1997	P R 30.6.99	–	P R 19.12.01	–	–	–	–	–

## Standardet Ndërkombëtare – politikisht të detyrueshme

	Shqipëria	Franca	Moldavia	Rumania	Rusia	Mbretëria e Bashkuar	SHBA	Ukraina
Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimit dhe të Abuzimit të Pushtetit (miratura nga OKB Rez. 40/34 e As.Përg., 29 nëntor 1985)	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z
Parimet Themelore Dhe Udhëzimet për të Drejtën e Mjeteve Mbrojtëse për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare. (OKB Rez. 60/147 e As. Per., 16 dhjetor 2005)	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z
Parimet e Rekomanduara dhe Udhëzimet mbi të Drejtat e Njeriut dhe mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore (Raport i UNHCHR-it në ECOSOC E2002/68/Add. 1, ECOSOC 20 maj 2002)	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z
Udhëzimet mbi Drejtësinë e të Miturve që janë Viktima dhe Dëshmitarë të Krimit ECOSOC Rez. 2004/27	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z

## Konventa rajonale, direktiva, rekomandime – ligjrisht dhe politikisht të detyrueshme – sipas organizatave

	Shqipëria	Franca	Moldavia	Rumania	Rusia	Mbretëria e Bashkuar	SHBA	Ukraina
<b>Këshilli i Evropës – ligjrisht të detyrueshme për shtetet palë</b>								
Konventa Evropiane për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore Seria e Konventave të KE-së [CETS] Nr.197	P R 22.12.05 F 6.2.07	P R 9.1.08	P R 16.5.05 F 19.5.06	P R 16.5.05 F 21.8.06	–	N 23.2.07	–	N 17.11.05
Konventa Evropiane për Dëshmipërblimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme Seria e Konventave e KE-së [CETS] Nr.116	P R 1.3.05 F 26.11.04	P R 1.2.90 F 1.6.90	–	P R 15.2.06 F 1.6.06	–	P R 7.2.90 F 1.6.90	–	N 8.4.05
<b>Këshilli i Evropës – politikisht të detyrueshme për shtetet anëtare</b>								
Rekomandimi Rec (2006) 8 i Komitetit të Ministrave për ndihmën ndaj viktimave të krimit	Z	Z	Z	Z	Z	Z	–	Z
Rekomandimi Re (2000) 11 i Komitetit të Ministrave për veprime kundër trafikimit të qenieve njerëzore për qëllim të shfrytëzimit seksual	Z	Z	Z	Z	Z	Z	–	Z

## Konventa rajonale, direktiva, rekomandime – ligjërish dhe politikisht të detyrueshme – sipas organizatave

	Shqipëria	Franca	Moldavia	Rumania	Rusia	Mbretëria e Bashkuar	SHBA	Ukraina
<b>Bashkimi Evropian – ligjërish të detyrueshme për anëtarët e BE-së</b>								
Direktiva e Këshillit të BE-së, 29 prill 2004, për dëmshpërblimin e viktimave të krimit (2004/80/KE)	–	F	–	F	–	F	–	–
Vendimi Kuadër i Këshillit të BE-së 19 korrik 2002 për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2002/629/JHA)	–	F	–	F	–	F	–	–
<b>Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSCE) – politikisht të detyrueshme për Shtetet pjesëmarrëse</b>								
Plan i Veprimit të OSBE-së për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore Vendim i Këshilli të Përhershëm të OSBE-së Nr.557, 24 korrik 2003	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z	Z
<b>Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore – politikisht të detyrueshme për shtetet partnere</b>								
Task Force për Trafikimin e Qenieve Njerëzore Udhëzime për Planet Veprimi Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore	Z	–	Z	Z	–	–	–	–

## Bibliografia

Materialet bazë si ligjet dhe çështjet gjyqësore gjenden të gjitha të detajuara tek shënimet në fund të faqeve. Ato nuk përsëriten këtu.

*A Global Alliance Against Forced Labour* [Aleanca globale kundër punës së detyruar], (ILO, 2005)

*Alliance News, Access to Justice, Issue 26* [Lajmet e aleancës, Mundësia për t'iu drejtuar organeve të drejtësisë, Nr. 26] (Aleanca globale ndaj trafikut të grave, dhjetor 2006)

*Attorney General's Annual Report to Congress on US Government Activities to Combat Trafficking in Persons* [Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm të Kongresit lidhur me veprimtarinë e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të Luftuar Trafikimin e Personave] (Vitet financiare (FY) 2001-2005)

Brienen, M. E. I. dhe Hoegen, E. H., *Victims of Crime in 22 European Criminal Justice Systems: The implementation of Recommendation (85) 11 of the Council of Europe on the Position of the Victim in the Framework of Criminal Law and Procedure* [Viktimat e krimit në 22 sistemet evropiane të drejtësisë penale: Zbatimi i Rekomandimit (85)11 të Këshillit të Evropës mbi pozitën e viktimës në kuadrin e të drejtës dhe procedurës penale] (Nijmegen, Netherlands, Wolf Legal Productions, 2000).

Carrera, Sergio dhe Guild, Elspeth, *An EU Framework on Sanctions against Employers of Irregular Immigrants: some reflections on the scope, features and added value* [Kuadri i Bashkimit Evropian mbi masat ndaj punëdhënësve të emigrantëve të parregullt: reflektime mbi shtrirjen, tiparet dhe vlerën e shtuar], Dokument politik (*Policy Brief*) nr. 140 (Center for European Policy Studies, 2007)

*Crime Victims' Rights in America: An Historical Overview* [Të drejtat e viktimave të krimit në Amerikë] (National Center for Victims of Crime), e disponueshme në [http://www.ncjrs.gov/ovc\\_archives/ncvrv/2005/pg4b.html](http://www.ncjrs.gov/ovc_archives/ncvrv/2005/pg4b.html).

Cunneen, M., "Lobbying in Europe" [Lobim në Evropë] në *Sector Project against Trafficking in Women* (eds.), *Challenging Trafficking in Persons: Theoretical Debate and Practical Approaches* [Programi i sektorit kundër trafikimit të grave: Problematika e

trafikimit të qenieve njerëzore, Debat teorik dhe qasje praktike], (Baden-Baden, Nomos-Verlag, 2005).

*Directory of International Crime Victim Compensation Programs* [Drejtoria e Programeve të Dëmshpërblimit të Viktimave të Krimit Ndërkombëtar], e cila gjendet në:

<http://www.ojp.usdoj.gov/ovc/publications/infores/intdir2005/welcome.html>

Dottridge, Mike, *Reference Guide on protecting the rights of child victims of trafficking in Europe* [Udhëzues referencash për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, viktima të trafikimit në Evropë], (UNICEF, 2006).

Gao, Y., *Chinese Migrants and Forced Labour in Europe* [Emigrantët kinezë dhe puna e detyruar në Evropë], (ILO, 2004).

*Handbook on establishing effective labour migration policies in countries of origin and desination* [Manual për krijimin e politikave efikase të emigracionit për punë në vendet e origjinës dhe të destinacionit], (OSCE/ILO, IOM, 2006).

“How ILS are used,” [Si përdoren standarde ndërkombëtare të punës] botim i ILO-s në *Internet*, i disponueshëm në:

<http://www.ilo-mirror.cornell.edu/public/english/standards/norm/introduction/used.htm>.

*Human Trafficking and Forced Labour Exploitation, Guidance for Legislation and Law Enforcement* [Trafikimi njerëzor dhe shfrytëzimi i punës së detyruar, Udhëzues për legjislacionin dhe zbatimin e ligjeve], (ILO Special Programme to Combat Forced Labour, 2005).

“Human Trafficking Evokes Outrage, Little Evidence” [Trafikimi i qenieve njerëzore shkakton zemëratë, pak prova], gazeta *Washington Post*, 23 shtator 2007.

*Human Traffic, Human Rights: Redefining Victim Protection* [Trafiku i qenieve njerëzore, të drejtat e njeriut: ripërcaktimi i mbrojtjes së viktimave], (Anti-Slavery International, 2002).

“ILO calls for strengthening labour inspection worldwide” [ILO bën thirrje që të forcohet inspektimi i punës në gjithë botën], deklaratë për shtyp i ILO-s, 16 nëntor 2006.

ILO Forced Labour Survey [Studim i ILO-s mbi punën e detyruar], Komiteti i Ekspertëve të ILO-s, 2007.

ILO Migrant Labour Survey [Studim i ILO-s mbi punën e emigrantëve], Komiteti i Ekspertëve të ILO-s, 2007.

IOM Handbook on Direct Assistance for Victims of Trafficking [Manuali i IOM-it mbi ndihmën e drejtpërdrejtë për viktimat e trafikimit], (IOM, 2007).

Interpretative notes for the official records (travaux préparatoires) of the negotiation of the United Nations Convention against Transnational Organized Crime and the Protocols thereto [Shënime shpjeguese të procesverbaleve zyrtare të bisedimeve për Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Ndërkufitar dhe Protokollet e saj] A/55/383/Add.1.

Joint Comments of ETUC, PICUM and SOLIDAR on Expected [European] Commission Proposals to Fight Illegal Employment and Exploitative Working Conditions [Komentet e përbashkëta të Konfederatës së Bashkuar për Tregtinë Evropiane (ETUC), Platformës për Bashkëpunim Ndërkombëtar për Emigrantët pa Dokumente (PICUM) dhe SOLIDAR mbi propozimet të pritshme të Komisionit për luftën kundër punësimit “të paligjshëm” dhe kushteve shfrytëzuese të punës], 26 prill 2007. I disponueshëm në

<http://www.picum.org/sites/default/files/data/joint%20comments%20ETUC%20PICUM%20SOLIDAR%202604507%20EN%20final.pdf>

Joint Committee on Human Rights of the UK Parliament report on reviewing the Proceeds of Crime Bill [Raporti i Komitetit të Përbashkët për të Drejtat e Njeriut pranë Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar mbi rishkrimin e ligjit Për Produktet e Krimin], 2001/2. <http://www.publications.parliament.uk/pa/jt200102/jtselect/jtrights/43/4303.htm>

Joint Written Intervention on Concerning the Principles and Guidelines on the Right to a Remedy and Reparation for Victims of Gross Violations of International Human Rights Law and Serious Violations of International Humanitarian Law [Ndërhyrje e përbashkët me shkrim mbi Parimet Themelore dhe Udhëzimet për të Drejtën e Mjeteve Mbrojtëse për Viktimat e Shkeljeve të Mëdha të së Drejtës Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Shkeljeve të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare], Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, Mbledhja 61, 14 mars -22 prill 2005, Pika 11 e programit: Të drejtat qytetare dhe politike, 10 shkurt 2005.



Legislative Guide for the implementation of the Protocol to prevent, suppress and punish trafficking in persons, especially women and children, supplementing the United Nations Convention Against Transnational Organized Crime [Udhëzues legjislativ për zbatimin e Protokollit mb Parandalimin, Suprimimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore, veçanërisht të Grave dhe të Fëmijëve, në plotësim të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar], UNODC Pjesa e dytë, [http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative\\_guides/03%20Legislative%20guide\\_Trafficking%20in%20Persons%20Protocol.pdf](http://www.unodc.org/pdf/crime/legislative_guides/03%20Legislative%20guide_Trafficking%20in%20Persons%20Protocol.pdf)

Malpani, R., *Legal Aspects of Trafficking for Forced Labour Purposes* [Aspektet ligjore të trafikimit për qëllime të punës së detyruar] (ILO, prill 2006).

*National Referral Mechanisms: Joining Efforts to Protect the Rights of Trafficked Persons, A Practical Handbook* [Mekanizmat Kombëtare të Referimit, Bashkimi i përpjekjeve nëmbrojtje të të drejtave të personave të trafikuar, Manual Praktik], (OSBE/ODIHR, 2004)

*Opinion of the Experts Group on Trafficking in Human Beings of the European Commission* [Mendim i grupit të ekspertëve të Komisionit Evropian mbi trafikimin e qenieve njerëzore], 11 tetor 2005, i disponueshem në: [http://ec.europa.eu/home-affairs/doc\\_centre/crime/docs/opinion\\_expert\\_group\\_06\\_05\\_31\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/home-affairs/doc_centre/crime/docs/opinion_expert_group_06_05_31_en.pdf)

Pearson, E., “Historial Development of Trafficking – The Legal Framework for Anti trafficking Interventions” [Zhvillimi historik i trafikimit - Kuadri ligjor për ndërhyrjet kundër trafikimit] tek Cunneen, M., “Lobbying in Europe” [Lobimi në Evropë], tek Programi i sektorit kundër trafikimit të grave, *Challenging Trafficking in Persons: Theoretical Debate and Practical Approaches* [Sfida ndaj trafikimit të qenieve njerëzore: Debat teorik dhe qasje praktike], (Baden-Baden, Nomos-Verlag, 2005).

Pleasence, Profesor P., *Causes of Action: Civil Law and Social Justice* [Shkaqet për të ngritur padi: E drejta civile dhe drejtësia sociale], (Londër, Legal Services Research Centre, 23 mars 2006). Përmbledhje e disponueshme në: <http://www.lsrc.org.uk/publications/summary2006english.pdf>

Proposal for a Directive of the European Parliament and of the Council providing for sanctions against employers of illegally staying third-country nationals [Propozim për Direktivën e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që parashikon sanksionim ndaj

punëdhënësve të shtetasve të vendeve të treta të cilët qëndrojnë në mënyrë ilegale], 16.5.2007, i disponueshëm në:

<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2007:0249:FIN:EN:PDF>

Report of the Expert Group on Trafficking in Human Beings of the European Commission [Raport i grupit të ekspertëve të Komisionit Evropian], Bruksel, 22 dhjetor 2004.

[http://ec.europa.eu/home-affairs/doc\\_centre/crime/docs/opinion\\_expert\\_group\\_04\\_xx\\_xx\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/home-affairs/doc_centre/crime/docs/opinion_expert_group_04_xx_xx_en.pdf)

Ryan, Bernard (red.), *Labour Migration and Employment Rights* [Emigrimi për punë dhe të drejtat e punësimit], (Londër, 2005).

*Ten ways to protect undocumented migrant workers* [Dhjetë mënyra për të mbrojtur punëtorët emigrantë pa dokumenta], (PICUM, 2005).

Thompson, K., *A summary of challenges facing legal responses to human trafficking for labour exploitation in the OSCE region* [Një përmbledhje e sfidave të cilat përballen me përgjigje ligjore në çështje të trafikimit njerëzor për shfrytëzimin e punës në rajonet e OSBE-së], Zyra e përfaqësuesit të posaçëm të OSBE-së dhe koordinatorit kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Occasional Paper [Kumtesë e rastit] Nr.1, 2006.

*Trafficking for forced labour: How to monitor the recruitment of migrant workers* [Trafikimi për punë të detyruar: Si të monitorohet rekrutimi i punëtorëve emigrantë], (ILO, 2006).

*Trafficking for labour and sexual exploitation in Germany* [Trafikimi për shfrytëzimin e punës dhe shfrytëzimin seksual në Gjermani], (ILO, 2005).

Tyuryukanova, E., *Forced Labour in the Russian Federation Today: Irregular Migration and Trafficking* [Puna e detyruar në Federatën Ruse sot: Migracioni i parregullt dhe trafikimi i qenieve njerëzore], (ILO, 2005).

*Undocumented Migrants have rights: an overview of the international human rights framework* [Migrantët pa dokumenta kanë të drejta: një tablo e kuadrit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut], (PICUM, March 2007).

*United States Attorneys' Manual* [Manuali i Prokuroreve Federalë të Shteteve të Bashkuara

*Victims – Support and Assistance* [Viktimat – Mbështetje dhe Ndihmë], (Këshilli i Evropës, 2006).

## **Shqipëria**

*Analiza e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri*, (OSBE, 2006).

*The Girls and The Trafficking: Study on the development of trafficking in women in Albania* [Vajzat dhe trafikimi: Studim mbi zhvillimin e trafikimit të grave në Shqipëri], (Vatra, 2005).

*Monitoring of the Court decisions related to THB in the District Courts of Tirana, Vlora, Shkodra for the period 2001–2003* [Monitorimi i vendimeve gjyqësore në lidhje me veprat e trafikimit të qenieve njerëzore, të dhëna nga gjykatat e rretheve Tiranë, Vlorë, Shkodër për periudhën 2001-2003] (CLCI/QNLQ, 2005).

“Prioritetet afatshkurtra për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe disa prej arritjeve kryesore në vitin 2006,” Koordinatori Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

## **Franca**

Basic Social Rights [Të drejtat themelore sociale], PICUM,  
<http://www.picum.org/article/basic-social-rights-france>

Brienen, M. E. I. dhe Hoegen, E. H., *Victims of Crime in 22 European Criminal Justice Systems* [Viktimat e krimit në 22 sistemet Evropiane të drejtësisë penale], (Nijmegen, Netherlands, Wolf Legal Productions, 2000), f. 295-352, i disponueshëm në:  
<http://rechten.uvt.nl/victimology/Brienenhoegen/BH.html#index>

“Dozens convicted in French trial over Bulgarian baby-trafficking network” [Dhjetra të dënuar në gjyqin francez në lidhje me rrjetin bullgar të trafikimit të foshnjave], International Herald Tribune, 2 shkurt 2007,  
<http://www.ihf.com/articles/ap/2007/02/02/europe/EU-GEN-France-Baby-Trafficking.php>.

EC European Judicial Network Pages on Compensation to Victims of Crime [Faqet e rrjetit evropian të Komisionit Evropian për dëshmshpërblimin e viktimave të krimit] [http://ec.europa.eu/civiljustice/comp\\_crime\\_victim/comp\\_crime\\_victim\\_fra\\_en.htm#1](http://ec.europa.eu/civiljustice/comp_crime_victim/comp_crime_victim_fra_en.htm#1).

“A titre d’exemple, la faute pourra etre retenue en cas d’imprudence, d’injures proferées, de participation a une bagarre ou à une activité delictueuse” [Për shembull, faji mund të caktohet në rast të moskujdesjes, të fyerjeve, të pjesëmarrjes në një përlëshje ose në një veprimtari që përbën kundërvajtje], Faqja e *Internet-it* të FGTI-së <http://www.fondsdegarantie.fr/>.

*Esclavage Encore* – Actualité juridique [Ende skllavëri – Aktualitete juridike], botimet e muajve prill dhe nëntor 2006 (Comité Contre l’Esclavage Moderne).

“FATIMA O. – APRÈS LE PROCÈS”, 21 prill 2005 (Comité Contre l’Esclavage Moderne) në <http://www.esclavagemoderne.org/actujuridique.php?id=27>.

Gao, Yun dhe Poisson, Veronique, *Le trafic et l’exploitation des immigrants chinois en France* [Trafikimi dhe shfrytëzimi i migrantëve kinezë në Francë], (ILO, mars 2005).

“Olivia et Mabelle: Esclavage en HLM (habitation à loyer modéré)” [Olivia dhe Mabelle: Skllavëri në strehimin me qira të arsyeshme], *Esclavage Encore*, Nr.29 korrik 2006, (Comité Contre l’Esclavage Moderne), i disponueshëm në [http://www.esclavagemoderne.org/img\\_ee/ee29.pdf](http://www.esclavagemoderne.org/img_ee/ee29.pdf).

*Sans papiers mais pas sans droits*, botimi i 4-t, (GISTI, qershor 2006). I disponueshëm në <http://www.contrelatrite.org>

## **Moldavia**

Centre for Prevention of Trafficking in Women (CPTW), Activity Report 2003–2006 [Raportet e veprimtarisë për periudhën 2003-2006 të Qendrës për Parandalimin e Trafikimit të Grave].

Cojocar, C. dhe Wiseman, H., *Trafficking in Persons – An In-depth Analysis of Closed Criminal Case Files in Moldova for 2004-September 2005* [Trafikimi i personave – Një analizë e thelluar e dosjeve të çështjeve penale të mbyllura në Moldavi për periudhën 2004 – shtator 2005], qershor 2006

*Human Trafficking Assessment Tool Moldova Report* [Raporti për Moldavinë i instrumentit të vlerësimit të trafikimit njerëzor](ABA-CEELI, qershor 2005).

Mann, Lori J. dhe Dolea, Igor, *OSCE Trial Observation Manual for the Republic of Moldova* [Manual i OSBE-së mbi Vëzhgimin e Gjyqeve për Republikën e Moldavisë], (OSBE, 28 shkurt 2006).

Minutes of Technical Coordination Meeting chaired by OSCE Mission in Moldova [Procesverbali i mbledhjes së koordinimit teknik drejtuar nga Misioni i OSBE-së në Moldavi, dhjetor 2006].

*Trafficking in Human Beings in Moldova Normative Acts* [Aktet normative për trafikimin e qenieve njerëzore në Moldavi] (OSBE/La Strada, 2006).

## **Rumania**

Protection for the Victims of Human Trafficking in Romania, Analysis of Judge Nicoleta Stefanoi [Mbrotjtja për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore në Rumani, analizë e gjyqtarës Nicoleta Stefanoi], e disponueshme në [http://www.antitrafic.ro/sections/1/asfgds/?t\\_id=op12p4&lang=en](http://www.antitrafic.ro/sections/1/asfgds/?t_id=op12p4&lang=en) .

Evaluation of Anti-trafficking Policies in Romania [Vlerësim i politikave Antitrafikim në Rumani], raporti i UNICEF-it, i disponueshëm në [http://www.childtrafficking.org/pdf/user/UNICEF\\_Evaluation\\_of\\_Antitrafficking\\_Policies\\_in\\_Romania.pdf](http://www.childtrafficking.org/pdf/user/UNICEF_Evaluation_of_Antitrafficking_Policies_in_Romania.pdf) .

Ministri i Drejtësisë së Rumanisë përpara Konferencës 27 të Ministrave Evropianë “Victims: Place, Rights, Assistance” [Viktimat: qëndrimi, të drejtat, ndihma], 12–13 tetor 2006, Yerevan. Këshilli i Evropës MJU-27 (2006)12.

*Victims — Support and Assistance* [Viktimat – Mbështetje dhe ndihmë], Botim i Këshillit të Evropës, shtator 2006 dhe një kumtesë në konferencë e mbajtur nga Eugenia Chivulescu, Ludwig Boltzmann Institute, Vienë, mars 2007.

## **Federata Ruse**

*Report of ILO Committee of Experts on the Application of Conventions and Recommendations* [Raporti i Komitetit të Ekspertëve të ILO-s mbi zbatimin e konventave dhe rekomandimeve], (ILO, 2007).

Tyuryukanova, E., *Forced Labour in the Russian Federation Today: Irregular Migration and Trafficking in Human Beings* [Puna e detyruar në Federatën Ruse sot: Emigrimi i parregullt dhe trafikimi i qenieve njerëzore], (ILO, 2005).

US State Department TIP report [Raport i Departamentit Amerikan të Shtetit për Trafikimin e Qenieve Njerëzore], qershor 2007, i disponueshëm në <http://www.state.gov/g/tip/rls/tiprpt/2007/82807.htm> .

*Victims – Support and Assistance* [Viktimat – Mbështetje dhe ndihmë] (Botim i Këshillit të Evropës, shtator 2006).

## **Ukraine**

N. Ahtirskaja, *Trafficking in Persons in Ukraine: Evidence of Court Practice* [Trafikimi i personave në Ukrainë: Evidentimi i praktikës gjyqësore (Akademia e Gjyqtarëve të Ukrainës, 2006).

“EU-Ukraine start negotiations on new Enhanced Agreement” [BE – Ukraina fillojnë negociatat për Marrëveshjen e “Zgjeruar”], deklaratë për shtyp e Bashkimit Evropian, 2 mars 2007.

Kiryana, T. dhe van der Linden, M., *Trafficking of migrant workers from Ukraine: Issues of labour and sexual exploitation* [Trafikimi i punëtorëve emigrantë nga Ukraina: Çështje të shfrytëzimit të punës dhe atij seksual], (ILO, 2005).

Statistikat e IOM-it, 2007.

Strekalov, Y., *Ukrainian Legislation Against Trafficking in Human Beings* [Legjisalcioni ukrainas kundër trafikimit të qenieve njerëzore], studim i pabotuar, i mbështetur nga Kordinatori i Projektit të OSBE-së në Ukrainë, në arkivat e ODIHR, 2006.

Shvab, Inna, *Issues of pre-trial and judicial investigations into human trafficking cases: An analysis of selected cases* [Çështje të hetimeve përpara gjykimit dhe hetimeve gjyqësore në çështje të trafikimit të qenieve njerëzore: Analizë e çështjeve të përzgjedhura], studim i pabotuar, i mbështetur nga Koordinatori i Projektit të OSBE-së në Ukrainë, në arkivat e ODIHR-it, 2007.

Wijers, M. dhe Haveman, R., *Trafficking in human beings for the criminal justice chain in Ukraine* [Trafikimi i qenieve njerëzore për zinxhirin e drejtësisë penale në Ukrainë], (IOM, 2006).

## **United Kingdom**

*2005 Criminal Statistics, England and Wales* [Statistikat për krimin 2005, Anglia dhe Uells], tabelat shtesë vëllimi 2, Home Office.

Annual Report and Accounts 2004/5 of CICA (Criminal Injuries and Compensation Authority). [Raporti Vjetor dhe Llogaritë i CICA-s 2004/5]

“Assets Recovery Agency abolished” [Shkrihet Agjencia për Rimarrjen e Pasurive], Faqja e Internet-it të lajmeve në BBC-së, 11 janar 2007 në [http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk\\_news/6251339.stm](http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/6251339.stm) .

*The Code of Practice for Victims of Crime* [Kodi i Praktikës për Viktimat e Krimin] i disponueshëm në <http://www.homeoffice.gov.uk/documents/victims-code-of-practice>

“Migrants ‘deceived and exploited’ ” [“Emigrantët ‘të mashtruar dhe të shfrytëzuar’ ”] dhe “Joining the Immigrant Underclass” [Të bashkohesh me shtresën e ulët të emigrantëve], Faqja e Internet-it të lajmeve BBC, 25 prill 2007.

“MP meets Ministers over cocklers” [Deputeti takon Ministrin për njerëzit që mbledhin midhje], Faqja e Internet-it të lajmeve BBC, 12 shkurt 2004.

“New Deal for Trafficking Victims” [Ofertë e re për viktimat e trafikimit], gazeta *The Guardian*, 24 mars 2007.

*Prosecutor’s Pledge* [Premtime të prokurorit] (Crown Prosecution Service, 2005).

“The Scandal of Morecambe” [Skandali i gjirit Morecambe], gazeta *Daily Telegraph*, 13 shkurt 2004.

“Sex slaves’ win cash in landmark legal deal” [‘Skllavët që përdoren për seks’ fitojnë para nga marrëveshje historike ligjore”], gazeta *The Observer*, 16 dhjetor 2007.

“Sexual Offences Act 2003: Definitive Guidelines” [“Ligji për Krimet Seksuale 2003: Udhësime Përfundimtare”] (Sentencing Guidelines Council, 2007).

UK Action Plan on Tackling Human Trafficking [Plan Veprimi i Mbretërisë së Bashkuar për Trajtimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore], mars 2007, gjendet në [http://www.london.scb.gov.uk/files/resources/trafficking/uk\\_action\\_plan\\_on\\_tackling\\_human\\_trafficking.pdf](http://www.london.scb.gov.uk/files/resources/trafficking/uk_action_plan_on_tackling_human_trafficking.pdf)

*Victims and Witnesses: Providing Better Support* [Viktimat dhe dëshmitarët: Dhënia e mbjeshtetjes më të mirë (National Audit Commission, 2 dhjetor 2003).

### **Shtetet e Bashkuara të Amerikës**

*Attorney General’s Annual Report to Congress on U.S. Government Activities to Combat Trafficking in Persons FY 2005* [Raporti vjetor i Prokurorit të Përgjithshëm para Kongresit për veprimtarinë e qeverisë së SHBA-së për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore Viti Financiar 2005](June 2006), gjendet në <http://www.justice.gov/archive/ag/annualreports/tr2005/agreporhumantrafficking2005.pdf>

*Attorney General’s Guidelines for Victim and Witness Assistance* [Udhëzuesit e Prokurorit të Përgjithshëm për ndihmën ndaj viktimave dhe dëshmitarëve], në [http://www.justice.gov/olp/pdf/ag\\_guidelines.pdf](http://www.justice.gov/olp/pdf/ag_guidelines.pdf)

Bahan, Della dhe Batra, Puja, *Seeking Justice for Trafficked Domestic Workers in American Courts* [Kërkimi i drejtësisë për punëtorët e trafikuar që punojnë si shtëpiakë], kumtesë paraqitur në konferencën 8-të vjetore të IWPR-it (International Women’s Policy Research) (qershor 2005)



Baker, Tom, *Reconsidering Insurance for Punitive Damages* [Rishqyrtimi i siguracionit për dëme ndëshkuese në tejkalim të dëmeve të pësuar], 1998 Wisc. L. Rev. 101. Clarren, Rebecca, “Paradise Lost: Greed, Sex Slavery, Forced Abortions and Right-Wing Moralists” [Parajsa e humbur: babëzia, skllavëri seksuale, aborte të detyruar dhe moralistët e krahut të djathtë], *Revista Ms. Magazine* (pranverë 2006).

*Crime Victim Compensation: an Overview* [Dëmshtëpërblimi për viktimat e krimit: Pasqyrim i përgjithshëm], në <http://www.nacvcb.org/index.asp?bid=14>

*Fact Sheet: Certification for Victims of Trafficking* [Fleta e të dhënave: Vërtetimi për viktimat e trafikimit] në [www.acf.hhs.gov/trafficking/about/cert\\_victims.html](http://www.acf.hhs.gov/trafficking/about/cert_victims.html)

Goodwin, Catharine, *Imposition and Enforcement of Restitution* (Detyrimi dhe zbatimi i kthimit), *Federal Probation* (Revista e Shërbimit Federal i Provës), 62-72 (qershor 2000).

Ho, Christopher dhe Chang, Jennifer, *Drawing the Line After Hoffman Plastic Compounds v. NLRB: Strategies for Protecting Undocumented Worker in the Title VII Context and Beyond* [Vija ndarëse pas çështjes *Hoffman Plastics*; Strategjitë për mbrojtjen e punëtorëve të padokuntuar në kontekstin e Titulli VII e më tej], 22 *Hofstra Labor & Empl. L. J.* 473 (2005).

Johansson, Lars E., *The Mareva Injunction: A Remedy in the Pursuit of the Errant Defendant* [Masa sigurimi *Mareva*: Instrument në ndjekje të të paditurit të arratisur], 31 *U.C. Davis L. Rev.* 1091 (1998).

Kim, Kathleen and Hreshchshyn, Kusia, *Human Trafficking Private Right of Action: Civil Rights for Trafficked Persons in the United States* [E drejta për padinë civile në rastet e trafikimit: Të drejtat qytetare për personat e trafikuar në Shtetet e Bashkuara], 16 *Hastings Women's L. J.* 1 (2004).

Kim, Kathleen and Werner, Daniel, *Civil Litigation on Behalf of Victims of Human Trafficking* [Proceset civile në emër të viktimave të trafikimit të personave], (2005)

Kleinhaus, Brian, Note, *Serving Two Masters: Evaluating the Criminal or Civil Nature of the VWPA and MVRA Through the Lens of the Ex Post Facto Clause, the Abatement Doctrine, and the Sixth Amendment* [Në shërbim të dy zotërinjve: Vlerësimi i natyrës civile

dhe penale të VWPA-së dhe të MVRA-së nëpërmjet lenteve të klauzolës *Ex Post Factor*, doktrina e zbritjes dhe amendamenti i Gjashtë), 73 Fordham L. Rev. 2711 (maj 2005).

Kull, Andrew, *Restitution's Outlaws* [Kriminelët e kthimit], 78 Chi. Kent L. Rev 17 (2003).  
Note, *Remedying the Injustices of Human Trafficking Through Tort Law* [Shënim, Ndreqja e padrejtësive të trafikimit të qenieve njerëzore] , 119 Harv. L. Rev. 2574 (2006).

*Ordering Restitution to the Crime Victim* [Urdhërimi i kthimit të dëmit ndaj viktimave të krimit], Legal Series Bulletin # 6, nëntor 2002 (Office of Victims of Crime).

Trang, Linda, Note, *The Taxation of Crime Victim Restitution: An Unjust Penalty on the Victim* [Shënim, Tatimi mbi kthimin e dëmit të marrë nga viktima e krimit: Një ndëshkim i padrejtë për viktimën], 35 Loyola (Los Angeles) L. Rev. 1319 (2002).

Wasserman, Rhonda, *Equity Renewed: Preliminary Injunctions to Secure Potential Money Judgments* [Rinovimi i së drejtës: Masat paraprake për sigurimin e vendimit të mundshëm i cili jep dëmshpërblim], 67 Wash. L. Rev. 257 (1992).

Ky udhëzues paraqet një pasqyrë të legjislacionit, politikave, dhe mekanizmat për të siguruar mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të personelit të forcave të armatosura. Ai paraqet shembuj nga i gjithë rajoni i shtrirjes së prezencës së OSBE-së, praktikave që kanë pasur sukses, dhe gjithashtu përmban rekomandime të masave që shtetet duhet të permbushin, në mënyrë që të sigurohen që politikat dhe praktikat të jenë në përputhje të plotë me standartet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të angazhimeve të dimensionit njerëzor të OSBE-së.

Ky manual ka për qëllim që të gjithë individët që luajnë një rol në promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave të njeriut të personelit të forcave të, të tillë si deputetë, zyrtarë të qeverisë, hartues të politikave, personelit ushtarak, gjyqtarët, shoqatat profesionale ushtarake, dhe organizatat jo-qeveritare. Shpresojmë që ky publikim të inkurajojë të gjitha palët e interesuara, që të marrin masat e nevojshme për të siguruar që personeli i forcave të armatosura të jetë në gjendje të gëzojë të drejtat e tyre të plota si qytetarë.